PARIME TË PERGJITHËSHME

TË

SË DREJTËS CIVILE

TË KOMPILLUEME

Prej

NIKO EV. TSITSOS

Avokat

BKSH

KORÇË

Shtypëshkronja **DHORI KOTI.**

1931

BKSH

PARIME TË PERGJITHËSHME

TË

SË DREJTËS CIVILE

TË KOMPILLUEME

Prej

NIKO EV. TSITSOS
Avokat

KORÇË
Shtypëshkronja **DHORI KOTI.**
1931

BKSH

BKSH

PARATHËNIE

Mungesa në letraturën jurîdike Shqìptare e një vepre, në të cilën të jenë të përmbledhura në mënyrë sistematike principet e përgjithëshme të së Drejtës Civile, më shtyti të botonj këtë punim; Qëllimi i jem ka qënë lehtësimi i gjithë atyrevet që do të dëshëronin të bëjnë një studjim sistematik të këtyre parimevet, të cilat shkurtimisht ekspozohen në këtë libër. Pengime teknike nuku përmetuanë që të tregohen në tekst mburimet, nga të cîlat u përmbloth lânda; Gati gjithë përmbajtja e këtij libri është përmbledhur nga veprat e shkrimtarëvet që figurojnë në Bibliografîn' e këtij punimi. Jam përkujdesur, me sa më ka qënë e mundur, që mos të largohëm nga roli i thjeshtë î "Kompilatorit", por, që të mos jetë vepra e metë, kam armonizuarë lândën me ligjat shqipëtare në fuqi.

Korçë, Maj 1931.

Punuësi

BASHT

Ç' do eksemplar duhet të përmbajë nënëshkrimin e autorit.
Pronësinë letrare të veprës e mban autori.

BKSH

BIBLIOGRAFI

Dalloz.	Code Civil Annoté.
Dalloz.	Précis de Droit Civil.
M. Planiol.	Traité élémentaire de Droit Civil.
Colin et Capitant.	Droit Civil Français.
Δ. Θεοφανοπούλου.	Σύστημα Ἀστικοῦ Δικαίου: Γενικαὶ Ἀρχαί.
Ἀ. Μομφεράτου.	Ἐγχειρίδιον Ἀστικοῦ Δικαίου: Γενικαὶ Ἀρχαί.
Ἀλκ. Κρασσᾶ.	Σύστημα Ἀστικοῦ Δικαίου: Γενικαὶ Διδασκαλίαι.
Δ. Παπουλια.	Γενικαὶ Ἀρχαὶ Ἀστικοῦ Δικαίου.
M. Λιβαδᾶς:	Ἐγχειρίδιον Πολιτικῆς Δικονομίας.
Fr. Ricci.	Corso Teorico-pratico di Diritto Civile.
C. Windscheid.	Parimet e përgjithëshme të së Drejtës Civile (Përkthim greqisht).
F. Regelsberger.	Mësimet e përgjithëshme të së Drejtës të Pandektavet (përkthim greqisht).

BKSH

BIBLIOGRAFI

BKSH

TABELLË ANALITIKE E LANDËS

PJESA E PARË

KAPTINA A!

E Drejta. Ligja. Interpretim' i Ligjavet.

Paragraf		Faqe
1.	— Nosjone dhe definisjone të para.	9
2.	— E Drejta pozitive. E Drejta Naturale. Morali.	12
3.	— Pjesëtimi i së Drejtës Pozitive.	12
4.	— Dispozita urdhënuëse dhe dispozita plotësuëse [ose deklarative.	13

KAPTINA B!

5.	— Mburimet e së Drejtës Civile.	15
6.	— Ligja.	15
7.	— Kontrol' i konstitucionalitetit të ligjavet.	18
8.	— Zakoni.	20
9.	— Provimi i zakonit.	21
10.	— Mjetet e provimit të zakonit.	22
11.	— Abrogim' i ligjës.	23
12.	— Kritika e ligjavet.	25
13.	— Interpretim' i ligjavet.	26
14.	— Anologjia dhe restriksjoni.	32
15.	— Doktrina.	34
16.	— Jurisprudenca.	35

BKSH

Paragraf Faqe

17. — Organizim' i Gjykatavet. 36
18. — Kodi Civil Shqiptar. 38

PJESA E DYTË

KAPTINA A!

Sfera e aplikimit të së Drejtës.

19. — Kufitë tokësore të ligjës. 40
20. — Ligjat Ndëshkimore, Policore dhe të Sigurimit (Publik. 42
21. — Ligjat q' u përkasin gjendjes dhe zotësisë të (personavet. 42
22. — Ligjat q' u përkasin sendevet. 46
23. — Ligjat q' u përkasin trashëgimevet. 48
24. — Ligjat q' u përkasin substancës dhe efekteve (të kontratavet 50
25. — Ligjat q' i përkasin formës aktevet. 52
26. — Ligjat regulluëse të provës të aktevet. 54

KAPTINA B!

27. — Kufitë kohësore të ligjës. 55
28. — Gjendja dhe zotësia e personavet. 60
29. — Të drejtat reale. 64
30. — Trashëgimet dhe dhurimet. 65
31. — Kontratat. 68

KAPTINA C!

32. — Llojet e kanunevet të së Drejtës. 72

BKSH

PJESA E TRETE

KAPTINA A!

Paragraf		Faqe
33.	— Të drejtat përgjithësisht.	74
34.	— Klasifikimi i të drejtavet.	75
35.	— Të drejtat reale.	77
36.	— Të drejtat personale ose creance.	78
36 bis.	— Krahasim i së drejtës reale me të drejtën personale.	80
37.	— Të drejtat reale aksesore	81
38.	— Të drejtat intelektuale.	83
39.	— Të drejta të transferueshme dhe të pa transferueshme.	83

KAPTINA B!

40.	— Subjekt të drejtash.	84
41.	— Personat fizike.	86
42.	— Personat juridike ose personat morale.	88

KAPTINA C!

Objekt të drejtash.

43.	— Sendet përgjithësisht.	90
44.	— Sende të trupta, sende të pa-trupta.	91
45.	— Sende që mund të jenë ose jo objekt zotërimi.	91
46.	— Sende të konsumueshme, sende të pa konsumueshme.	92
47.	— Sende të zëvëndësueshme, sende të pa-zëvëndësueshme.	93
48.	— Sende të trupta.	94
49.	— Sende të lujtëshme, sende të pa-lujtëshme	94

BKSH

Paragraf Faqe

50. — Sende të pjesëtueshme, sende të pa-pjesëtueshme. 98

KAPTINA Ç!

51. — Sende kryesore, sende aksesore. 99
52. — Frutat. 99

KAPTINA D!

53. — Pasunia. 100
54. — Shpenzimet. 102

KAPTINA E!

55. — Monedha. 104
56. — Valutat. 106

PJESA E KATËRTË

KAPTINA A!

Theori e përgjithëshme e aktevet juridike.

Krijimi, ndryshimi dhe të shuemit e të drejtavet.

57. — Nosjone të përgjithëshme. 107
58. — Krijim të drejtash. 108
59. — Vetësim të drejtash. 108
60. — Ndryshim të drejtash. 111
61. — Shuemja e së drejtavet. 112
62. — Ngjarje juridike. 113
63. — Aktet juridike. 114
64. — Parimi i lirisë së palëvet në aktet juridike. 115

BKSH

Paragraf Faqe

65. — Kufizimi i vulnetit, urdhri publik, dhe zakonet (e mira. 116
66. — Klasifikim kryesor i aktevet juridike. 117
67. — Konditat e eksistencës dhë të vleftësisë të aktevet (juridike. 121
68. — Zotësia për me bâ akte juridike. 126
69. — Akord midis deklarimit dhe vulnetit. 128
70. — Veset e vulnetit. 132
71. — Lajthimi. 133
72. — Dheli. 136
73. — Dhuna. 138
74. — Lëndimi. 140

KAPTINA C!

75. — Mënyrat e deklarimit të vulnetit. 142
76. — Përfaqësimi. 143
77. — Ratifikimi. 147

KAPTINA Ç!

78. — Nuliteti i aktevet juridike. 148
79. — Nulitete absolute. 149
79. *b.*- Anulluëshmënia ose nulitete relative. 152
80. — Ineksistencë. 156

KAPTINA D!

81. — Modalitetë e aktevet juridike. 157
82. — Kondita. 158
83. — Disa kondita të veçanta. 162
84. — Gjendja tue qënë kondita e mvarur. 163
85. — Efektet e konditavet. 166
86. — Afati. 169

BKSH

KAPTINA E!

Paragraf		Faqe
87.	— Veprimet e pa-ligjëshme.	171
88.	— Elementat e veprimit të pa-ligjëshme.	173
89.	— Shkallësimi i veprimit të pa-ligjëshme.	177
90.	— Resposabilitet eksepsjonal në rastet fatore.	178
91.	— Modifikime konvencionale të regullavet ligjore.	179
92.	— Provimi i fajevet.	180

KAPTINA Ë!

93.	— Koha.	181
94.	— Pjesëtimi i kohës.	183
95.	— Dita e ndërkallur.	184
96.	— Përcaktimi i kohës.	184
97.	— Llogaritja e kohës.	185

KAPTINA F!

Parashkrimi

98.	— Definisjoni dhe arësyet justifikative.	187
99.	— Renoncimi i parashkrimit.	192
100.	— Pezullimi i parashkrimit.	194
101.	— Ndërpremja e parashkrimit.	198
102.	— Koha që lypet për parashkrim.	204
103.	— Konsekancat e parashkrimit.	208
104.	— Parashkrimi i prapsimevet.	210

PJESA E PESTË

KAPTINA! A

Sigurimi i të drejtavet

105.	— Sigurimet.	211

RKSH

Paragraf Faqe

106. — Sekuestrimi. 212
107. — Burgim për detë. 212
108. — Vumja e vulavet. 213
109. — E drejta e mbajtjes. 214

KAPTINA B!

110. — Mprojtja e së Drejtavet 216

KAPTINA C!

Mprojtja e së drejtavet me fuqin e vetë

111. — Mbrojtja dhe vetëgjyqësia 217

KAPTINA Ç!

Mprojtja gjyqësore

112. — Padia. 219
113. — Pjesëtimi i padievet. 221
114. — Bashkim padinash. 224
115. — Konsekancat e ngrehjes të padies. 225

KAPTINA D!

116. — Prapsimet. 226
117. — Kontra-padia. 229

KAPTINA E!

118. — Provimi. 230

KAPTINA Ë!

119. — Vendimi. 231
120. — Gjëja e gjykueme. 135

BKSH

Paragraf		Faqe
121.	— Influenca në gjyqin penal të gjësë së gjykueme (në gjyqin civil.	237
122.	— Influenca në gjyqin civil të gjësë së gjykueme (në gjykatën ndëshkimore.	239
123.	— Arbitrazhi.	241

ERRATA

Në	faqen	181	në vënt	§87	Shkruaj	§93
„	„	183	„ „	§88	„	§94
„	„	184	„ „	§89	„	§95
„	„	184	„ „	§90	„	§96

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

BKSH

PARIME TË PËRGJITHËSHME
TË
SË DREJTËS CIVILE
TË KOMPILLUEME

BKSH

PJESA E PARË

KAPTINA A.

E Drejta. Ligja. Interpretim'i Ligjavet.

§ 1.— Nosjone dhe definisjone të para.

E Drejta, të drejtat. — Fjala e *"drejtë"* ka tri kuptime: 1. E Drejta tregon tërësinë e regullavet ose të ligjavet që qeverisin aktivitetin e njeriut në shoqërinë njerëzore (e Drejta Nërkombëtare), ose në një komunotet politik të çaktuar (E Drejta Shqiptare, e Drejta Franceze, e Drejta Italiane, e Drejta Gjermane).

Njeriu, një krijesë llogjike dhe morale, me vulnet të lirë dhe i destinuarë prej naturës së tij që të rojë në Shoqëri, ka për qëllim bashkërrojtjen e tij me njerës të tjerë. Njeriu, dyke ju bindur një ndjenjë q'ekziston brenda në naturën e tij, nuk jeton vetë dhe i shkretë, larg nga tërësija njerëzore, por kërkon bashkëjetimin e tij në shoqëri, massi nevoj'risht me t'u lindur bëhet anëtar i një tërësije, të ngushtë ose të gjërë, të families, të komunës, të popullit, të Shtetit; Në këtë bashkëjetim social zhvillohet karakteri i tij moral, plotësohet natura e tij përgjithësisht nga rellasjonet me njerës të tjerë dhe kështu përmbushet misjoni i tij.

Rojtja dhe bashkëjetesa në shoqëri parasypozojnë veprim të vulnetit në botën e përjashtme. Nga ky bashkëjetim në shoqëri lindin interesa të pa-numurta, që puthiten njëra-jetrës, por shumë herë dhe përpiqen midis tyre, formohen mijëra dhe mijëra relasjone të anëtarëvet të shoqërisë midis tyre dhe me tërë Shoqërinë. Pra, është nevoja që vulnetet e veçanta dhe interesat të përulen njëra-jatrës, dyke sakrifikuar se i cili një pjesë të lirisë tij naturale, dhe të bashkohen për të realizuar një qëllim mâ të përgjithëshmë, massi në këtë mënyrë themelohet godina Shoqënore dhe sigurohet

jeta e bashkëtë, në të cilën fonksjonojnë me armoni Liria dhe Regulli.

Kështu, formohet mbi vulnetin vetiak vulneti i përgjithëshmë, i cili u vé fré vulnetevet dhe interesavet vetjake, domethënë vihen kanune që përçaktojnë kufit' e pushtetit të vulnetit vetjak dhe sjelljet e njërit ndaj të tjerëvet. Pra, ajo që heq vijën, me të cilën ndahen këto interesa vetjake, përshkruan kufitë e qarkut brenda të cilit njeriu mundet të lëvizë dhe të vepërojë lirisht dhe pas dëshirës së vetë, përçakton të drejtat dhe detyrat e tij dhe përgjithësisht krijon dhe mpron nga çdo atakim dhe siguron këtë gjendje sendesh, në të cilën vetëm mundet të ekzistojë jeta sociale, është e Drejta. Pa të drejtë organizimi social nuk mundet të fonksjonojë as një minutë.

Nga sa u thanë më sipër kupëtohet lehtazi se: e Drejta objektive është vulnet' i përgjithëshme i shoqërisë i eksprimuar në Ligja, dhe, massi është vënë prej Shoqërisë, quhet *pozitive.*

2. Të drejtat janë pushtetet, të cilat sikundër u tha më sipër u janë njohur anëtarëvet të shoqërisë prej së Drejtës, dhe të cilat u përmetojnë të bëjnë vepra të çaktuara. Për shëmbëll janë të drejta: *E drejta e pronësisë*, e cila i përmeton pronjëtarit të përdorë një send për dobinë ekskluzive të vetë, tue u përjashtuarë çdo tjetër personë. *E drejta e testatimit,* e cila i përmeton një persone të dispononjë pasurin' e vetë në trashëgimtarë të pëlqimit saj. *Pushteti atënor* është një e drejtë, se i përmeton atit të imponojë vulnetin e tij në edukimin e fëmijëvet të tij.

Gjith' ashtu themi: *e drejta e peshkimit, e drejta e gjuajtjes, të drejtat politike, e drejta e popujvet të vet-qeverisen, etj, etj.*

Brenda në një të drejtë mundet të përmblidhen shumë pushtete; Për shëmbëll në të drejtën e zotërimit kemi pushtetin e përdorimit të sendit edhe pushtetin e çfrutizimit tij. Në gjuhën e përditëshme quajmë të drejta dhe këto pushtete, kur se në realitet këto nuk janë të drejta, por pushtete

legale të përmbledhura po në një të drejtë. Kur e drejta përmban vetëm një pushtet, si për shëmbëll të drejtën e kreditorit që të kërkojë kthimin e sendit të hojtur, at' here kuptim' i së drejtës dhe ay i pushtetit legal koincidojnë.

Nga të drejtat duhen çquar cilësitë juridike të subjektevet të drejtash, si për shëmbëll zotësia me kontraktue, me testatue. Është e vërtetë që këto cilësi janë të nevojëshme për fitimin ose për transferimin e të drejtavet, por nuk janë të drejta; Gjith' ashtu nuk janë të drejta dhe parasypozimet, mbi të cilat këto bazohen, si për shëmbëll *madhoria*.

Për kundrejt të drejtës ekziston detyra ose e të gjithëvet për të mos bërë veprime që mundet të cënojnë të drejtën ose të personavet të caktuara për me bâ ose mos me bâ një vepër.

Ndonse prej çdo të drejte lind detyrë, kjo nuk do të thotë se dhe në çdo detyrë korespondon dhe një e drejtë. Përshëmbëll në detyrën e Shtetit që të konservonjë mjetet e komunikasjonit nuku korespondon nonjë e drejtë.

Në rastet, në të cilat së drejtës i korespondon një detyrë, relasjoni i tyrevet njëra me tjatrën nuku është i njëjtë. Është e vërtetë që, në rastet më të shumëta, detyra vjen si konsekancë e së drejtës, por mundet që të ngjasë dhe e kundërta, d.m.th. e drejta të rjedhë prej detyrës; Për shëmbëll: nga detyra për yshqim me të cilën ligja ngarkon disa persona, rjeth e drejta e personavet të favorizueme që të kërkojnë hyshqimin. Gjith' ashtu ngjet edhe me detyrën e tytorit, i cili është ngarkuar prej ligjës që të përkujdeset për personën e mitun ose për administrimin e pasurisë tij dhe nga kjo detyrë rjeth e drejta, e cila ka për qëllim që të bëjë të mundëshme realizimin e detyrës, me të cilën ka një përmbajtje të njëjtë.

3. Fjala e drejtë më në funt tregon shkencën që meret me të Drejtën dhe me mburimet e saj (legjislasjon, jurisprudencë, etj), se e Drejta është një shkencë. Këtë kuptim ka fjala kur themi: Fakultet i së Drejtës, student i së Drejtës.

§ 2. — E Drejta pozitive. E Drejta naturale. Morali.

E Drejtë pozitive quhet e *Drejta* (në kuptimin e parë të fjalës) që është e vënë, domethënë e formulluar në Ligja, në dispozita që përmbajnë një *urdhër të autoritetit publik* dhe që, në rast nevoje, janë të sanksjonuara me ndërhyrjen e forcës, të cilën disponon ky autoritet, forcë q' e përdor për detyrimin e subjektevet të Ligjës për t' a respektuar ose për ndëshkimin e atyrevet që i kontravenë dhe e shkelin.

E Drejtë naturale quhet tërësija e regullavet të së Drejtës, të cilat duket se rjedhin nga natura dhe nga arësyeja; Gjenden, pra, këto të njëjta dhe identike në më të shumëtat e legjisllasjonevet të vëna prej popujvet të civilizuar dhe duken si *typi kryesor*, me të cilin legjislasjonet duhet të konformohen, kur ky konformitet nuk ekziston édhe.

E Drejta, pozitive ose naturale qoftë, ndryshon nga *morali*. Morali është, sikundër dhe e Drejta, një tërësi regullash të destinuara për të qeverisur aktivitetin njerëzor dhe këto regulla kanë eksprimimin e tyre jo në Ligja të shkruara, por në *ndërgjegjen* dhe në *arësyen* njerëzore.

Por, e Drejta dhe Morali ndonse takohen në qëllim, nuk puthitet njëra-jatrës; Një vepër ndonse e ligjëshme, mundet mos të jetë morale dhe vice versa.

Qëllim' i moralit është sjellja e njeriut në një perfeksjon ideal, kur se ay i së Drejtës është që t' i shtrojë nënë një regull, gjë që është kondita themelore për ekzistencën si të njerësvet, ashtu dhe të shoqërivet.

Me gjith' këtë do të shohim më tej, kur të bëhet fjalë mbi Nenin 11 të dispozitavet mbi aplikimin dhe interpretimin e ligjavet përgjithësisht, se Ligja, në lidhjen e konvansjonevet, u imponon personavet respektimin e regullavet të Moralit.

§ 3. — Pjesëtimi i së Drejtës Pozitive.

E Drejta ndahet në të *Drejtë Kombëtare* dhe në të *Drejtë Nërkombëtare.*

E Drejta Nërkombëtare është ajo që regullon marëdhâniet e Kombevet midis tyre; *Quhet e Drejtë nërkombëtare publike*, kur meret me interesa politike më shumë, dhe e *Drejtë nërkombëtare private*, kur okupohet me marëdhaniet të një nature private midis personavet me kombësi të ndryshme ose të ci'at posedojnë pasuni ose kanë interesa në shumë Shtete.

E Drejta Kombëtare zbatohet mbi një komp të caktuar dhe ndahet në të *Drejtë publike* dhe në të *Drejtë private.*

E Drejta publike është ajo, që regullon konstitusjonin e Shtetit dhe raportet dhe marëdhaniet e këtij më privatët, subjektët e vetë, dhe ndahet në degë të ndryshmë: *në të Drejtën konstitucionale, të Drejtën administrative, të Drejtën ndëshkimore, të Drejtën Fiskale.*

E Drejtë private quhet ajo, e cila regullon rellasjonet dhe marëdhâniet midis privatëvet, subjektë po të një Shteti.

E Drejta private ndahet: në *të Drejtën Civile,* në të *Drejtën Tregëtare,* në të *Drejtën Detare,* në të *Drejtën Proceduriale.*

E Drejtë Civile është ajo, e cila regullon relasjonet e njeriut si pjesëtari të families, relasjonet e tij me pasurinë e vetë, marëdhaniet pasurore të njeriut me të tretet dhe, më në funt, fatin e pasurisë pas vdekjen të njeriut.

E Drejta Tregëtare zbatohet mbi tregëtarët, dhe e *Drejta Detare* mbi marinarët dhe njerëzit e detit, domethënë këto dy degë të së Drejtës aplikohen mbi disa kategori personash posaçërisht, dyke u marë para-sysh profesjoni spesjal q' eksersojnë.

E Drejta Procedurjale përmban regullat, në konformitet me të cilat, në rast konflikti, aplikohet e Drejta private dhe administrohet Drejtësija.

§ 4. — Dispozita urdhënuëse dhe dispozita plotësuëse ose deklarative.

Quhen *urdhënuëse* dispozitat ose ligjat, të cilat urdhë-

rojnë ose ndalojnë disa vepra ose u imponojnë disa kalitete personavet. Urdhënuëse janë gjithë dispozitat, prej të cilavet formohet e Drejta publike. Gjith' ashtu kanë po këtë karakter urdhënuës dhe shumë dispozita të së Drejtës private, për shëmbëll gjith' ato q' i përkasin së Drejtës familiare.

Përkundrazi, pjesa m' e madhe e dispozitavet që, në të drejtën private, u përkasin raporevet të një nature pasurore ose ekonomike nuk kanë përveç se një karakter deklaratif ose plotësuës. Kjo gjë don me thënë se, këto dispozita plotësojnë stipulasjonet, me të cilat vulneti i palëvet cakton lirisht konsekancat e aktevet juridike të bëra prej tyre, stipulasjone të cilavet ligja u njeh vleftë të detyrueshme (Neni 1113 Kodit Civil).

Në aktet më të zakonëshme, vulneti i palëvet manifestohet shumë herë vetëm për stipulasjonet më me rrëndësi: për shëmbëll, në një kontratë shitje-blemjeje zakonisht vulneti i palëvet manifestohet për sendin e shitur, çmimin e shitjes, datën e dorëzimit dhe atë të pagimit, etj; Për të tjera objekte, fjala bije për detyrimin e shitësit që të kujdeset për sendin e shitur deri në dorëzim, të garantojë blerësin për veset e fshehura që mundet t' a bëjnë sendin e shitur të pa-përdoruëshme, etj, palët kontraktuëse prezumohet se dëshërojnë që këto të regullohen simbas dispozitavet të zakonëshme, që tradisjonalisht regullojnë shit-blemjet. Ligj' i shkruar dyke formulluar këto regulla të zakonëshmë, shpëton palët nga përkujdesje të tepërta. Por, Ligja dyke veprruar kështu "*nuk imponon, por proponon*'. Pra, palët kanë liri të plotë mos t' u shtrohen këtyre regullavet që kanë një kësilloj karakteri deklaratif, interpretuës të vulnetit të tyre të prezumuar, por në vënd të tyre të venë regulla dhe stipullime të ndryshme.

Shpesh herë takon të jetë shumë delikate çështja që të çkoqitet, kur ndodhemi përpara një regulli të së Drejtës Civile ose të së Drejtës Tregëtare, në se dispozita ligjore ka një karakter urdhënuës ose vetëm deklaratif, plotësuës, mas-

si ligjvuësi, i cili në disa raste eksprimohet shprehimisht mbi këtë pikë, dyke u shtuar dispozitavet fjalët *"për ndryshe është mul"*, nuk e bën gjithmonë këtë shtim.

KAPTINA B.

§ 5. — Mburimet e së Drejtës Civile.

Ligja dhe zakoni. E Drejta civile ka dy mburime: Ligjën e shkruar dhe zakonë (ligjën e pa shkruar); *Por, nga të dy mburimet,* vetëm ligja e shkruar prezanton të *drejtën në formën e saj të qartë.*

§ 6. — A. — Ligja.

I. *Ligja* është *Kanun të Drejtë* i vënë prej Shtetit. Veglat shtetnore, me anën e të cilavet ushtrohet Pushteti Legjislatif, caktohen në Nenit 8 të Statutit Themeltar dhe këto vegla janë dy: Mbreti dhe Parlamenti.

Elementet që lypen për formimin e Ligjës caktohen prej Statutit Themeltar dhe janë:

a) *Propozimi.* E drejta dhe nisjativa e propozimit të ligjavet u përket, simbas Nenit 9 të Statutit, Parlamentit dhe Mbretit, i cili e ushtron me anën e Ministravet.

b) Votimi prej Parlamentit, i cili bëhet simbas regullavet të Nenit 42 të Statutit; Votim' i ligjavet bëhet një herë parimisht, dy herë artikull për artikull dhe t'rësisht. në tre ditë të ndryshme; Por, Kodet e paraqitura prej Qeverisë dhe të pregatifura prej një Komisjoni të posaçmë të krijuem me ligjë, massi të pranohen në parim, votohen tokësisht (en bloe) në dy mbledhje në ditë të ndryshme.

Me anën e votimit prej Parlamentit të projektit, krijohet vulneti i njërit prej faktorëvet të Pushtetit Legjislatif për që projekti i propozuar të jetë *kanun së drejte.* Por, nuk mjafton ky vo im, massi lypet:

c) Pëlqimi i Mbretit, si mbas Nenit 74 të Statutit, domethënë konsanteman' i tij për që projekt' i votuar prej Par-

lamentit të bëbet kanun së Drejte. Me pëlqimin e Mbretit formohet puthitja e vulnetevet të të dy faktorëvet legjislatif, të Mbretit dhe të Parlamentit. Por, ky vulnet i të dy faktorëvet legjislative duhet të manifestohet, dhe për këtë gjë është nevojë për t' u bërë.

ç) Promulgimi dhe shpallja e ligjës. Këto përmbarohen prej Mbretit, si Kryetarit të Pushtetit Përmbaruës. Pëlqimi dhe promulgimi i ligjës bëhen "uno actu" dhe një-kohësisht. Shpallja e ligjës është një veprim administratif, të cilën Mbreti, si Kryetar i Pushtetit Përmbaruës, e ushtron me anën e Ministravet.

Me promulgimin edhe shpalljen, ligja bëhet e plotë, por, si mbas Nenit 44§2 të Statutit, hyn në fuqi një muaj pas botënimit, përveç rastit kur ligja çakton vetë një afat të ndryshmë për hymjen e saj në fuqi. Në kohën që ndërmjetëson midis botënimit dhe hymjes në fuqi të ligjës, kjo ekziston, por nuk ka fuqi (vacatio legis). Kjo ekzistenca typike e ligjës ka konsekanca me shumë rrëndësi, domethënë:

á) Si mbas Nenit 12§2 të Statutit, nuk mund të abrogohet, të ndryshohet, as të pezullohet, përveç se me një ligjë tjetër, si gjithë ligjat e tjera në fuqi.

b') Merr datë të caktuar — e cila është emri i ligiës — dyke u konsideruar m' e vjetër nga çdo tjetër ligjë të botënuarë mâ von, pa u marë para sysh në se kjo é dyta u vu më parë në fuqi.

Si mbas Nenit 74§3 të Statutit, mos promulgimi dhe mos shpallja e projekt-ligjës të votuar prej Parlamentit brenda tre muajvet qysh nga data e paraqitjes për pëlqim, konsiderohet si refuzim nga an' e faktorit tjetër legjislatif, të Mbretit.

II. — Kanune të Drejtë mundet të vihen dhe pa bashkëpunimin e Parlamentit. Të tillë janë:

1. *Dekret* quhet urdhëri i dhënë prej Mbretit.

Në Shtetet konstitucionale ligja rjeth nga bashkëpunimi i Parlamentit dhe i Mbretit, por për zbatimin dhe për

aplikimin e ligjës është i nevojëshmë vepërimi i Pushtetit Përmbaruës me sistemin e Dekretevet. Këto Dekrete janë dy llojesh:

a") Si mbas autorizimit të përgjithëshmë që i jepet prej Nenit 78 të Statutit, Mbreti ka të drejtë të dekretojë rregullore që shpjegojnë mënyrën e zbatimit të ligjavet. Këto Dekrete nuk mundet të përmbajnë dispozita të rea, që nuk i përfshin ligja; Pra nuk mundet të ndryshohet me 'to, as të pezullohet ligja, as pjesërisht, as tërësisht, massi kjo është vepër e Pushtetit legjislatif.

Dekretet pregatitin vetëm zbatimin e ligjës — e cila n' hollësirat e saj aplikohet prej Administratës — dhe nuk përmbajnë kanun të drejtë

b") Kur Parlamenti nuk ndodhet i mbledhur dhe çfaqen nevoja tepër të ngutëshme të justifikueme, Mbreti, në bazë të Nenit 96 të Statutit dhe nën përgjegjësin' e Këshillit Ministruer, ka të dreitë të bëjë dekret ligje, të cilat në hapjen e sesjonit më t' afërmë, brenda 15 ditvet duhet t' i paraqiten Parlamentit bashkë me raportin justifikuës për bisëdim edhe shqyrtim.

Në qoftë se brenda kësaj kohe nuk paraqitet Dekret ligja ose, massi u paraqit, u refuzua prej Parlamentit, at' here quhet vetiu e rëzuar.

Por n' as një rast dhe për as ndonjë arësye nuk abrogohen, as modifikohen kodet me anë Dekret-ligjash. Dekretet ordinare hyjnë në fuqi qysh prej ditës shpalljes; Sa për Dekret-ligjat, këto hyjnë në fuqi si edhe ligjat ordinare.

2. — *Urdhëra* të dhëna prej veglavet të tjera shtetnore, në bazë dhe me fuqi autorizimi legjislatif. Kësilloj kanune të Drejtë janë kryesisht *urdhërat policore.*

III. — Përveç Shtetit mundet t' akordohet pushteti që të venë kanune të drejtë për regullimin e rellasjonevet të tyre të brëndëshme dhe në të tjera organizata sociale (autonomi). Por, është një çështje në se realizim' i këtij pushteti formon një mburim të veçantë kanuni të drejtë, massi:

1.) Në rastin që ky pushtet akordohet me rugën legji-

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

slative, për shëmbëll Bashkive, komunitetevet fetare, at' here kemi kanun të drejtë me autorizim legjislatif.

2.) Por, në rastin që çështja është për pushtetin e shoqjatavet për regullimin e rellasjonevet të tyre të brëndëshme me anën e statutit, at' here ky pushtet krijon relasjone ligjore të përkufizuara midis shoqjatës dhe anëtarëvet të saj; Pra, nuk munt të bëhet fjalë për kanun të drejtë.

§ 7. — Kontrol' i konstitucionalitetit të ligjavet.

Nënë fuqinë të një konstitucioni kombëtar, as një nga Pushtetet Publike nuk është sovran, domethënë i pa kontrolluëshmë n' eksersimin e pushtetit. Përkundrazi, parimi është që çdo Pushtet publik është i kontrolluëshmë dhe sidomos me mjete juridike. Sovraniteti i pa kontrolluëshme rezidon në kombi dhe nuk munt të delegohet. Çdo sovranitet i deleguem është i kontrolluëshmë.

Ky parim aplikohet dhe mbi Pushtetin Legjislativ në eksersimin e fonksjonevet të tij legjislative.

Në këtë parim të përkufizimit të gjithë fuqive të delegueme, në parimin e superioritetit të Statutit mbi ligjat ordinare, si edhe në Nenin 232 të Statutit — i cili dekllaron të pafuqishme gjithë dispozitat e ligjavet që vijnë në kundrështim me dispozitat statutore — bazohet kontrollim' i konstitucionalitetit të ligjavet dhe zgjidhet çështja në se gjyqtari ka të drejtën dhe detyrën të mos aplikojë ligjen anistatutore.

Gjyqtari, të cilit i prezantohet një konflikt, ka të drejtë të çmojë gjithë elementat e atij konflikti dhe, posaçërisht, ligjat dhe regulloret q' i përshtaten çështjes ndërgjyqëshme.

Në këtë rast është i detyruar të regullojë konfliktet e ligjavet, massi duhet të giykojë dhe, për këtë shkak, duhet të marë një anë. Kështu regullon konfliktet e ligjës kombëtare me ligjën e huaj, ato të ligjës vjetër dhe të ligjës ré, ato të ligjës dhe të regullores; Ky konflikt' i fundit midis ligjës dhe regullores i afrohet më shumë konfliktit midis ligjës ordinare edhe superlegalitetit konstitucionel, Statutit, dhe

duhet të na shërbejë si model.

Kur se gjyqtari refuzon aplikimin e një regulloreje policore, të cilën e gjen në kundrështim me një parim ligjor, për se nuk do të mund' te të refuzojë aplikimin të një dispozite të ligjit ordinar, të cilin e gjen në kontradiksjon me një parim të superlegalitetit konstitucionel, të Statutit? Kjo nuk është tjetër gjë, veç se një regullim konflikti midis dy ligjavet që nuk janë të një lloji; Domethënë gjyqtari interpreton ligjën konstitucionale dhe ligjën ordinare, sheh në se këto pajtohen njëra me tjetrën dhe, në rastin që janë të pa-pajtueshme, sakrifikon atë që është në rangun mâ të poshtmë. Dekllarimi i një ligje antikonstitucionale nuku ka as një ndryshim nga dekllarim' i një regulloreje administrative të pa-ligjëshme.

Gjyqtari ka të drejtën dhe detyrën të ekzaminojë në se ligja është kompozuarë si mbas Statutit? Po, gjyqtari detyrohet pik-së-pari të konstatojë në se ligja, që do t' aplikojë, ekziston si e tillë. Për lind çështja: Cili është kriterium-i dhe cilat janë mjetet, me të cilat gjyqtari heton ekzistencën e vërtetë të ligjës?

Pëlqimi nga an' e Mbretit, kontrafirma e Kryeministrit dhe e Ministrit kompetent dhe përgjegjës, promulgimi dhe shpallja, janë elementat e ligjit nga pik-pamja e formës dhe këto duhet t' i ekzaminojë gjyqtari, massi pa pëlqimin e Mbretit nuk ekziston ligja, pa kontra-firmën e Ministrit kompetent dhe atë të Kryeministrit as një akt i Mbretit nuk është i vlefshë dhe i zbatueshme, si kundër në mënyrë formele urdhëron Neni 73 i Statutit, dhe, më në funt, pa promulgimin dhe shpalljen fuqia detyruëse e ligjit nuk është *aktive*.

Massi ligja ellaborohet në Parllament, pyetet: Ka të drejtën dhe detyrën gjyqtari të hetojë në se ligja u ellaborua në Parllament në konformitet me Statutin, domethënë në se bisedimi dhe votimi u bënë me quorum, me shumicë absolute të deputetëvet të ndodhur gati, nj' herë parimisht e dy herë artikull për artikull dhe tërësisht në tre ditë të ndryshme dhe më në funt të hetojë dhe në se deputetët janë

zgjedhur ligjërisht?

Jo, gjyqtari nuk ka të drejtë të hyjë në ekzaminimin e këtyre hollësiravet.

Në personën e Mbretit trupëzohet kuptimi abstrakt i personës juridike të Shtetit, pra, si i tillë Mbreti është vegla mâ e naltë e vulnetit të Shtetit, kështu që del konsekanca se vulneti i Mbretit konsiderohet si ay i Shtetit. Projekt' i votuar prej Parlamentit, massi të pëlqehet prej Mbretit, bëhet ligjë; Mbreti, passi të japë pëlqimin, si kryetar i Pushtetit Përmbaruës promulgon ligjen dhe urdhëron shpalljen e saj, dyke vërtetuar se u votua prej Parlametit dhe kështu ligjá vjen në dijeni të çdo shtetasi, të gjyqtarit dhe të çdo autoriteti Shtetnor, dyke sjellë vërtetimin, si në krye dhe në funt, të veglës shtetnore — si legjislative ashtu edhe përmbaruëse — mâ të naltë së bashku me kontrafirmat e Kryeministrit dhe të Ministrit kompetent dhe përgjegjës, se ligja u votua prej Parlamentit.

Këtij vërtetimi të rjedhur prej Mbretit, i cili vetë ka të drejtë të ekzaminojë — para se të japë pëlqimin — në se ligja u votua prej Parlamentit në konformitet me Statutin, duhet t' i binden cili-do dhe vetë gjyqtari.

§ 8. — B. — Zakoni.

Zakon ose ligj' e pa shkruar quhet e Drejta që mburon drejt-për-së-drejti prej Shoqërisë; Zakoni rjeth nga *vulneti i Shoqërisë për të Drejtën*, vulnet i cili manifestohet me aplikimin e zakonit

Zakoni mundet të rjedhë dhe të ekzistojë dhe pa sypozimin e Shtetit, massi, sikundër dijmë prej historisë, zakoni ekzistonte para kohës në të cilën Shteti filloj të kupëtojë misjonin e tij legjislatif.

Zakoni manifestohet me aplikim; Por, fakti që ky aplikim rjeth prej vulnetit të Shoqërisë për të Drejtë nuk është i vetë-kupëtuëshme, duhet të rezultojë nga ndodhja e disa cilsinavet, të cilat formojnë, që të përdorim këtë ekspresjon, elementat e zakonit. Këto elementa janë:

1. Aplikim i gjatë dhe vazhduës; Numuri i rastevet të aplikimit dhe kufit' e kohës, brenda në të cilën këto duhet të zgjaten, nuk munt të caktohen.

2. Aplikimi duhet të jetë uniformë. Disa eksepsjone të ralla nuk mundet të konsiderohet se e cënojnë uniformitetin, massi ato mundet të quhen dhe si shkelje e regullit.

3. Aplikimi të rjedhë nga vulneti për zbatim kanuni të Drejtë; Me fjalë të tjera, aplikimi duhet të rjedhë nga ndërgjegja e aplikuësit të zakonit se, dyke vepëruar kështu zbaton kanun të Drejtë (opinio necessitatis).

4) Veprat që formojnë zakonë duhet të bëhen botënisht, domethënë duhet të bëhen me kësilloj mënyre, që mos të jenë të mfshehta, misterioze dhe të pa-dijtura.

5. Këto vepra duhet të mos vijnë në kundrështim me regullin publik dhe me moralin, se për ndryshe nuku formojnë të Drejtë.

Zakoni është ose i *përgjithëshmë*, kur zbatohet prej gjithë Kombit o-e *lokal*, kur zbatohet vetëm në një vënt të Shtetit. Zakoni lokal predominon mbi zakonin e përgjithëshmë në vëndin, ku i pari zbatohet.

Zakonet (në kuptimin ordinar të fjalës) që aplikohen në për marëdhëniet formojnë zakon (në kuptimin teknik të fjalës) vetëm kur konkurojnë elemeniat e nevojëshme për ekzistencën e tij, ndryshe, dhe posaçërisht kur mungon ajo që u qojt më sipër *opinio necessitatis*, nuk ekziston zakon, por disa hadete (usages) çë takojnë në profesjonet, në tregëti ose në marëdhëniet. Këto hadete kanë një lloj rrëndësie për interpretimin e aktevet, massi në rast dyshimi prezumohet se dekllarim' i vulnetit korespondon në zakonin q' ekziston në marëdhaniet.

§ 9. — Provimi i zakonit.

Në aplikimin e së Drejtës të pa-shkruar — të zakonit — lind çështja në se gjyqtari ka të drejtë *ex officio* të formojë konviksjonin e tij për ekzistencën e zakonit, dyke u pranuar se zakoni është ligjë, e cila duhet të jetë në dijeni'

e gjyqtarit (*jus novit curia*).

Çështja është diskutuar shumë në doktrinë dhe shkrimtarët nuk mbeten dakord.

Ndaj në Neni 102 i Shtojcës dytë Pr. Civile e ka zgjidhur çështjen. Dyke u marë për bazë parimi se gjyqtari ka dijeni të së Drejtës (*jus novit curia*), gjyqtari duhet të dijë jo vetëm ligjën e shkruar, por dhe atë të pa shkruarën, zakonë, dhe t'a zbatonjë këtë kur i çfaqet rasti, në qoftë se e dij. Por, në qoftë se zakoni nuk është i dijtur prej gjyqtarit, ky ka të drejtë të urdhërojë provimin e ekzistencës të zakonit.

Faktet që duhet të provohen, janë ato që formojnë elementat e zakonit; Tnema e provimit duhet kryesisht të përmbajë:

1.) Vepra të njëjta të bëra pa nonjë pushim;

2.) Përsëritjen e tyrevet në mënyrë uniforme.

§ 10. — Mjetet e provimit të zakonit.

Neni 102 i Shtojcës dytë të Pr. Civile e reshton zakonin në kategorin e faktevet, massi manifestimi i zakonit bazohet në kësilloj fakte. Mjetët provuëse që përmetohen të përdoren, janë: Vendime gjyqsore të dhëna midis të tjerë ndërgjyqës, me të cilat është pranuar ekzistenca e zakonit tani të kontestuar, dëshmimtarë, dokumenta të vjetra të depozituara me arshivat të Autorit tëvet loka e dhe që janë redaktuar me qëllim vërtetimin e një zakoni në fuqi

Sikundër dhe çdo fakt tjetër, ekzistenca e shëmbëllavet, në të cilat bazohet zakoni, mundet të provohet dhe me betim; Përkundrazi deferimi i betimit është i pa-pranuëshme, kur propozohet për që shëmbëllat formojnë zakon, massi ky është një kanun të Drejtë, për të cilin gjykon vetë gjyqtari.

Faktet që formojnë elementat e zakonit duhet të propozohen që në seancën e parë, përndryshe janë të pa-pranuëshme. Por, massi ato fakte të jenë propozuar në mënyrën e treguar syprì, bisedimi në se ato fakte formojnë za-

kon është i pranueshmë në çdo stancë të gjyqit.

Ligja, për t' i lehtësuar gjyqtarit hetimet në se faktet e propozuara formojnë elementat e zakonit, i jep të drejtë që mos përkufizohet vetëm me provat e ofrueme prej palëvet; Gjykata, dyke vepëruar *ex officio*, ka të drejtë të bëjë çdo tjetër hetim që i duket i nevojëshmë dhe, kur konsideron se është nevojë, të invokojë ndërmjetësimin e Ministrisë së Drejtësisë pranë Qeverivet të huaja, gjykatavet të huaja ose fakultevet Drejtësije. (Neni 102§2 i Shtojcës dytë të Pr. Civile).

§ 11. — Abrogim' i ligjës.

E drejta, nga natura e misjonit të saj, nuku është as e pa-ndryshueshme, as e përherëshme; Ligjëvuësi ka pushtetin të abrogojë dhe të ndryshojë ligjën e vënë prej tij dhe këtë gjë mundet t'a bëjë dhe sikur t'a ketë deklaruarë kanunë të pa ndryshueshmë, qofë dhe që t' a ketë dekllaruar të pa-ndryshueshme dhe për një kohë të caktuar.

Abrogim' i ligjës quhet ngritja, çfuqizimi, pushim' i fuqisë detyruëse të ligjës. Ligja abrogohet ose prej vetiut ose prej tjetër ligje, e cila abrogon të vjetrën shprehimisht ose heshtësisht.

- Ligja abrogohet prej vetiut, kur, e promulguar për një kohë të caktuar ose për deri sa vazhdon një situatë, kalon koha e caktuar ose pushon ajo gjendje. Kjo gjë ngjet me ligjat e qojtura transitore, të cilat ndihmojnë në vajtjen prej një legjislasjoni në një tjetër.

Legjislasjoni shqiptar ka dispozita pozitive mbi abrogimin e ligjavet. Neni 12§2 i Statutit dispozon se: "Ligjat nuk mund të çfuqizohen, të ndryshohen, të pezullohen, veç se me një ligjë tjetër," dhe Neni 4 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, më çkoqitërisht thotë: "Ligjat abrogohen vetëm kur ligjat e mâ-pasme përmbajnë një dekllarim të shprehun të ligjëvuësit për këtë, ose kur dispozitat e rea nuk pajtohen me ata të mâ-parëshmet, ose kur ligja e ré regullon të tanë lânden që ka qënë

regullue me ligjën e mâ-parëshme".

U tha mâ sipër se ligja abrogohet ose shprehimisht ose heshtësisht.

Abrogim' i shprehun quhet ay, i cili rezulton nga një artikull special i ligjës së ré, ku thuhet: "Ligja e . . . . . abrogohet". Shëmbëlla m' e çquar abrogimi të shprehun ndodhet në Nenin 61 të Ligjës mbi aplikimin e Kodit Civil shqiptar, me të cilin u abroguan "en masse" gjithë ligjat civile të mâ-parëshme shqiptare; As një abrogim tjetër nuk munt të krahasohet me këtë operasjon kolosall

Abrogim i heshtun eksiston kur ligja e ré përmban, po për atë objekt, një dispozitë të ré, që vjen në kundrështim me ligjën e vjetër; Në këtë rast ligja e vjetër mbetet pa fuqi. Domethënë dispozitat juridike abrogohen, kur futen në fuqi dispozita të rea, që kundrështojnë ose ndryshojnë të vjetrat *(lex posterior derogat priori)*.

Gjith' ashtu ligja e vjetër konsiderohet heshtësisht e abrogueme, kur ligja e ré plotëson ose përsërit tërësisht përmbajtjen e saj, massi dy ligja të njëjta në lândë nuk mundet të qëndrojnë së bashku. — Ky rast ka konsekanca praktike me rëndësi, massi në qoftë se ligja e ré abrogohet prapë, nuku vjen në fuqi ligja e vjetër.

Abrogim' i heshtur nuku shuan gjith' monë ligjat e mâ-parëshme; Vetëm çfuqizon ato prej dispozitave të ligjit të vjetër, të cilat do të ndalonin aplikimin e ligjës së ré.

Kur abrogimi i heshtur ka për efekt çfuqizimin e një dispozite kryesore të ligjës së vjetër, kjo e fundit tërheq gjithë dispozitat sekondare që mvaren prej saj, të cilat dhe abrogohen bashkë me 'të.

Kur një ligjë rampllasohet prej një tjetre, abrogohet dhe përjashtimi q' ekziston në ligjën e vjetër? Kjo është një çështje interpretimi.

Ligja nuku munt të konsiderohet e abrogueme nga shkaku se u çduknë arësyet që provokuan promulgimin e saj *(cessante ratione legis, non cessat lex ipsa)*. Çdukja e shkakevet që provokuan ligjën, mundet të japë protekst për a-

brogimin e ligjës vjetër me një ligjë të ré.

Po cili e ka të drejtën e abrogimit të ligjavet? Të drejtën të abrogimit të një ligje e ka natyrisht autoriteti që pati pushtetin t' a ve ë. Kështu, pra, një ligjë konstitucionale nuku mundet t' abrogohet përveç se prej Pushtetit Konstitucional, dhe jo prej një ligje ordinare, ca më pak prej një dekreti.

Një ligjë ordinare munt t' abrogohet vetëm prej Pushtetit legjislatif dhe jo prej një dekreti. Duhet, pra, respektuar hierarhia e Pushtetevet të vendosura; Por, dispozi at e një dekreti munt të abrogohen prej një ligje, ato të një ligje ordinare munt t' abrogohen prej një ligje konstitucionale. Pushteti superior mundet të prishë veprën e Pushtetit të subordonuar.

Me zakon nuk abrogohet ligja; Dispozita statutore dhe pozitive (Neni 12§2, i Statutit, Neni 4 i Kodit Civil) e kanë zgjidhur definitivisht këtë çështje.

Ligja nuk munt t' abrogohet nga mos-përdorimi (desuetudo), massi Statuti Shqiptar në Nenin 12§2 urdhënon se: "Ligjat nuk munt të çfuqizohen, të ndryshohen, të pezullohen, veç se me një ligjë tjetër."

§ 12 Kritika e ligjavet.

Sikundër është e dijtur, ligjat vijnë në dijeninë t' onë prej një komunikimi të shkruar. Lind, pra, pyetja në se teksti që na prezantohet është teksti i vërtetë i ligjës i thjeshtë në tërësinë dhe në pjesat e tij.

Vepërimi që ka për qëllim konstatimin e teksit të ligjës, quhet *kritika e ligjavet*. Kjo kritikë ka një rëndësi të madhe për ligjat, origjinal' i të cilavet mungon, po të cilat ndodhen në kopjo, si p'r shëmbëll ngjet me ligjat romano-bizantinë.

Kritika ka një rëndësi mâ të vogël për ligjat e réa, teksti i të cilavet na dorëzohet drejt-për-së-drejti me botimin e tyrevet në fletoren zyrtare. Me gjith këtë dhe ligja-

vet të rea mundet t' u vihet në dyshim thjeshtësija:

1. *Për shkak gabimi-shtypi.* Kjo ngjet kur teksti i botuar në fletoren zyrtare ndryshon nga ay i pëlqyer prej Mbretit: Gabim' i shtypit rëndon ose kopistin e tekstit ose radhonjësin. Korizhimi mundet të bëhet ose zyrtarisht prej veglës shtetnore kompetente dyke u botuar teksti korekt në fletoren zyrtare ose me kri:kën. Gjyqtari ka të drejtë të korizhojë gabimin e shtypit, massi është i detyruarë të aplikojë tekstin ekzakt të ligjës.

2. E ndryshme nga gabim' i shtypit është *mos vrejtja* në kohën e pëlqimit *(sanction)*; Kjo ngjet kur teksti i pëlqyer nuk' është identik me atë të votuar prej Parlamentit. Në këtë rast nuku mundet të bëhet fjalë për kritikë; Korizhimi bëhet tue u pëlqyer, promulguar dhe shpallur teksti i vërtetë, dyke u lënë në nj' anë ay i shpallur më parë.

3. Nga të dy rastet e sipërmëndura ndryshon *mos-vrejtja në redaktim të ligjës.* Kjo ngjet në kohën e hartimit të ligjës në Parlament. Këshilloj raste mos-vrejtje janë a-o, të cilat shkakëtohen, kur bëhen referime nga një nen në një tjetër, kur neni në të cilin bëhet referimi, me ndërkalljen ose çdukjen të një neni tjetër mer numur të ndryshmë, i cili nga mos vrejtja nuk vihet në referimin, por mbetet n' atë numuri i vjetër. Në këtë rast, ajo që rridhi nga mos-vrejtja u bë ligjë dhe korizhimi mundet të bëhet vetëm me një ligjë tjetër.

Por korizhimi mundet të bëhet dhe me anën e Shkencës, tue u aplikuar kuptimi *(sens)* i vërtetë i ligjës në vënt të ekspresjonit tij të gabuar, por në këtë rastin e fundit nuk munt të bëhet fjalë për kritikë, por për interpretim.

§ 13. — Interpretim' i ligjavet.

I. Massi me anën e kritikës u konstatua teksti i ligjës, duhet t' i vijojë konstatimi i përmbajtjes të saj. Ky konstatim është i nevojëshmë jo vetëm në ligja që kanë kuptim të errët dhe të dyshimtë, por dhe në ç'do ligjë, kuptimin e

të cilit të rjedhur nga letra e vdekur, dëshëron t' a njohë anqetuësi.

Pra, veprimi që ka për qëllim konstatimin e përmbajtjes të ligjës, quhet *interpretim*.

Interpretimi mundet të bëhet si në ligjat, ashtu dhe në zakonet; Por, me qënë se për kuptimin e zakonit shumë rallë dalin dyshime, massi zakoni prezantohet në aplikimin e tij mbi relasjone jetore konkrete, bëhet fjalë zakonisht vetëm për interpretimin e ligjavet, të cilat prezantohen në formë abstrakte.

Interpretimi është *legal* ose *doktrinal*.

Interpretim legal quhet ay, me të cilin përmbajtja e ligjës bëhet një kanun të drejtë i ri, që përcakton kuptimin me të cilin duhet të meret ligja e vjetër, dhë ndahet në interpretim *autentik* dhe interpretim prej zakoni. Në interpretimin legal nuk ekziston në realitet interpretim, por një kanun të drejtë me fuqi retroaktive.

Statuti në Nenin 10 urdhëron që: "Interpretimi autentik i ligjavet i përket Pushtetit legjislatif".

Interpretim doktrinal quhet ay, që bëhet Shkencërisht në librat, në rivistat juridike, në mësimin e së Drejtës, të cilat që të gjitha formojnë atë që quhet doktrine.

Neni 2§1 i Dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht dispozon se: "N' aplikim, ligjavet nuk munt t' u jepet tjetër sens veç atij që del qartazi nga kuptimi vet i fjalëvet tue u marrë para sysh lidhja e tyne, si dhe nga qëllimi i ligjëvuësit".

II. Qëliimi i interpretimit është kontatimi i përmbajtjes të ligjës; Por, kur themi përmbajtje të ligjës ç' duam të themi? Dy mejtime të kundërta ekzistojnë mbi këtë çështje të diskutueshme.

Ligja rjeth nga mentimi i ligjëvuësit. Ky, massi mentohet thellë vendos për atë që do të ketë fuqi si kanun të drejte dhe më pas zgjeth fjalët, me të cilat manifeston mentimin e vetë. Fjalët janë mjeti për tregimin e mentimit të ligjëvuësit dhe për formimin po t' atij mentimi në studjue-

si i ligjës. Pra, ligjë është ekeprimim' i vulnetit të ligjëvuësit dhe kështu përmbajtja e ligjës është vulnet' i ligjëvuësit.

Për kundrazi, pas mejtimit tjetër, përmbajtja e ligjës është krejt e ndarë nga vulneti i ligjëvuësit dhe ekziston brenda në vulnet të ligjës vetë, si fuqije vitale dhe qëndruëse, në kuptimin, të cilin — dyke marë parasysh përgjithësisht të drejtën dhe relasjonet e njëkohëshme — e gjejmë brenda në fjalët e caktuara prej ligjëvuësit qoftë dhe në rastin, në të cilin qarisht duket se vulneti i tij ishte i ndryshme.

Që të dy theoritë përmbajnë elementa ekzakte, kështu që nuku mundet të pranohet njëra dhe të rezhetohet tjetra, por duhet të kombinohen dhe të pajtohen që të dyja.

Se, me gjithë që është gjë shumë e vështirë të hidhet më nj' anë vulnet i ligjëvuësit si përmbajtje e ligjës, por nuk është e mundur që të bëhet gjithë monë fjalë për 'të, massi nuku ka dyshim se mundet të ekzistojë një përmbajtje e ligjës, që ligjëvuësi në kohën e shpalljes mos t' a ketë patur as pak ndër sy. Veç kësaj, rëndësia që ka vulneti i ligjëvuësit për përmbajtjen e ligjës vjen dyke u dobësuar sa largohet koha nga epoka në të cilën u kompozua, dhe, koncepte justifikuëse të rea dhe të ndryshuara, udhëheqin interpretuësin të ndryshojë kuptimin e parë të ligjës. Në këtë rast përmbajtja e ligjës nuk është vulneti i ligjëvuësit, por kuptimi që përmban me vehte ligja, kuptim' i cili mburon nga ligja vetë, tue qënë i pa-vartur nga vulneti i ligjëvuësit.

III. Massi interpretimi ka për qëllim konstatimin e përmbajtjes të ligjës, duhet të ekzaminohet mënyra, mé të cilën realizohet ky qëllim.

1. Ligja prezantohet me fjalë. Pra, interpretimi duhet të caktojë pik-së-pari kuptimin, sensin e letrës të ligjës, tue u bazuar në regullat e gramatikës dhe të glosologjisë. Ky është *interpretimi gramatikal.* Kuptimi i fjalëve të ligjës caktohet prej zakonit gjuhësor, të cilit i pasoj ligjëvuësi. Akoma

dhe zakoni gjuhësor personal i ligjëvuësit duhet të meret parasysh, por me konditë që ajo që desh të eksprimonte të jetë e mundur të kupëtohet me atë ekspresjon, pas zakonit gjuhësor të përgjithëshmë. Në këtë rast ka rëndësi gjuha juridike, domethënë termat teknike të skencës jurore. Por termat juridike nuku janë gjith' monë të njëjta Për qartësimin e tyre na shërbejnë ligia të mâ pareshme, të nji-kohëshme ose dhe të mâ-pasme, si dhe literatura juridike e kohës, në të cilën u bë ligja.

2. Interpretimi gramatikal është fillimi, por jo dhe fundi i konstatimit të përmbajtjes të ligjes. Kjo posaçërisht provohet, kur nga letra e ligjës rjedhin shumë kuptime, prej të cilavet nuku munt përveç se njërën të deshte ligjëvuësi. Kështu, në qoftë se ligjëvuësi përdori fjalën *pasuri*, pyetet në se deshte të thotë për pasuri aktive ose pasive, pasuri të renduar me detyra ose jo.

Por, përveç kësaj që mundet ligjëvuësi mos jetë eksprimuar qarisht, nuk përjashtohet edhe rasti që ay të ketë përdorur një ekspresjon të gabuëshme. Nga gjithë këto provohet se nuku duhet të mjafthemi në rezultatin e interpretimit gramatikal, qoftë dhe sikur mos përmbajë ky no-një kuptim të kontradiktuëshmë.

Pra, për konstatimin e përmbajtjes të ligjës duhet të kërkojmë dhe të tjera mjete, përveç atyrevet të gjuhës.

Ky interpretim, nga mjetet që përdor për t' i arirë qëllimit tij, quhet *llogjik*, massi ato mjete janë regullat e përgjithëshme të mendimit. Për shëmbëll: ky interpretim mer para-sysh se në mâ të madhen përmbahet dhe m' e vogla, se kur ndalohet qëllimi ndalohet dhe mjeti, se ajo q' u vu për dobi të disa et nuku munt të aplikohet në mënyrë që t' u sjellë dëm, se posesori me keq-besim nuk munt të gjykohet me mënyrë mâ favorablë se posesori me mirëbesim; Gjith' ashtu mer parasysh ato që quhen *argumentum ad absurdum*, massi saktësija e mentimit provohet nga fakti se çdo mentim tjetër do ishte i pa-arësyëshme, dhe *argumentum a contrario*.

Posaçërisht interpretimi llogjik duhet të marë parasysh:

a') Lidhjen e brëndëshmë të dispozitës ligjore veçanërisht, vëndin ku ajo ndodhet në ligjë dhe relasjon' e saj me dispozitat e tjera po t' asaj ligje, të ligjave të tjera të një nature dhe të së gjithë të Drejtës tjetër.

Shumë dispozita janë konsekancat e një *aksiome;* Dyke dijtur aksiomën, mundet të konstatojmë përmbajtjen e dispozitës.

b') Gjendjen të mâ-parëshme se ligja, si edhe evolusjonin historik të kanunit q' është brenda në ligjë; Se relativisht janë pak ato ligja, të cijat futin kuptime krejt të rea, kurse shumica e ligjavet heqin përmbajtjen e tyre tërësisht ose pjesërisht nga e drejta e mâ parëshme dhe nuk prezantojnë veç se perfeksionimin e tyre ose rjedhin nga një të Drejtë të huaj dhe në këtë rastin e fundit duhet të drejtohemi n' atë.

c') Vepërimet pregatitëse të ligjës, domethënë projektet, raportet justifikuëse dhe bisedimet e Parlamentit. Por rëndësia e këtyrevet nuku duhet të ekzazherohet, massi nga pranimi i projektit të propozua nuku del konsekanca se janë pranuar dhe mejrimet e shtruara në raportet justifikuëse ose ato të formulluara në bisëdimet e Parlamentit; Ato mentime nuku përmbajnë veç se koncepte personale dhe shumë herë bëhen me qëllim që të votohet ose mos të votohet projekti. — S' ka dyshim se kanë një rëndësi mâ të madhe bisëdimet në Parlament, kur ato janë marë për bazë për t' u caktuar formullimi i ligjës, si dhe deklaratat e Ministravet ose të deputetëvet për përmbajtjen e një dispozite të ligjës, kur ato dekllarata janë të pranuara prej Parlamentit.

ç') Qëllimin e veçantë të ligjës ose të dispozitës tij veçanërisht *(ratio legis).* Nga qëllimi ndryshon fakti q' u bë shkaku për promulgimin e ligjës *(occasio legis);* Ky okazjon i ligjës shërben për konstatimin e përmbajtjes të ligjës, deri në pikën që tregon qëllimin e saj, përndryshe s' ka nonjë rëndësi, massi shpesh herë ligja zgjatet tej shkakevet q' e

provokuan.

d') Vleftën e rezultatit të dalë nga ky ose nga ay interpretim. E drejta është një pjesë e qytetërimit përgjithësisht, e lidhur ngushtë me konceptet dhe nevojat morale dhe ekonomike. Nga ky shkak duhet që, në rast dyshimi, interpretimi të korespondojë me sa është e mundur në nevojat e jetës sociale të një-kohëshme dhe të qytetërimit përgjithësisht.

IV. Në qoftë se rezulltati i rjedhur prej interpretimit llogjik koincidon me atë të interpretimit gramatikal, at' here përmbajtja e ligjës gjendet në kuptimin e fjalëvet dhe nuk justifikohet as një largim nga ky kuptim për shkak se ekzistojnë dyshime të vogla. Por puna ndryshon kur kuptimi i letrës të ligjës është i ndryshmë nga rezulltati që del prej interpretimit llogjik.

1. Ndryshimi mundet që rjeth nga shkaku se sensi i fjalëvet ka shumë kuptime. Në këtë rast përmetohet interpretimi llogjik.

2. Ndryshimi mundet që rjeth nga shkaku se kuptimi i fjalëvet nuk është i qartë. Në këtë rast interpretimi llogjik përmetohet vetëm kur rezulltati që del kga letra e ligjës është absurd, i pa arësyëshme.

3. Nryshimi mundet që rjeth jo nga pa-qartësia e fjalëvet por për shkak se, nga shka u i interpretimit llogjik, duket se letra e ligjës nuku përmban vulnetin e vërtetë të ligjëvuësit; Në këtë rast duhet të çquajmë:

a') Në qoftë se ligjëvuësi u eksprimua mâ ngushtë se sa deshte, at' here përmbajtja e ligjës zgjanohet dhe mbi çështje, të cilat nuk duken të përmbledhura në letrën e ligjës. Për shëmbëll: ajo çë thuhet për suksin mashkull, ka fuqi dhe për seksin femër. Ky është *interpretimi ekstensif.*

b') Në qoftë se ligjëvuësi u eksprimua mâ gjërë se sa deshte, përmbajtja e ligjës kufizohet dyke u përjashtuar çështje të cilat duket sikur përmblidhen në letrën e saj. Ky është interpretimi *restriktif.*

c') Në qoftë se duket sheshazi me sigurim se ligjëvu-

ësi tjetër gjë deshte dhe jo atë q' u formullua në ligjë, at' here nuk është e fuqishme as ajo q' u formullua, massi nuku deshte t' a formullonte ligjëvuësi — as ajo që desh t' a formullonte, po nuk e formullovi. Në këtë rast aplikohen regullat e shtruara në analogjinë dhe restriksione.

4. Në qoftë se ligjëvuësi disa raste i regullovi në një mënyrë të veçantë, mundet që nga kjo të nënkuptohet vullneti i tij, që në raste të tjera të ketë fuqi e kundërta si regull. Për shëmbëll: nga regulli i shtruar në Nenin 1334 K. C. pas të cilit "dota nuku munt të kushtitohet, as të shtohet prej bashkëshortevet, sa vazhdon martesa", del një regull tjetër, simbas të cilit çdo i tretë, përveç bashkëshortevet, munt të kushtituhojë dotë dhe pas martesës. Në këtë rast ligja përmban dy regulla, prej të cilavet vetëm njëra është shprehimisht i dekllaruar, kurse tjetrin e nxjen in me "argumentum e contrario". Interpretimi me argumentum a contrario aplikohet pa dyshim, kur regulli i shtruar në ligjën ka fuqi vetëm për rastin e treguar n' atë Por, në rastin që nga ky tekst mungon fjala "vetëm', at' here vetëm munt t'aplikohet inte pretimi me argumentum a contrario, kur me tjetër mënyrë qarisht provohet ekskluzivitet' i dispozitës. Interpretimi me argumentum a kontrario ngjet me interpretimin ekstensif, se që të dyja zgjanojnë përmbajtjen e ligjës por m' anën tjetër ndryshon nga kjo, massi nxjer një regull ligjor të ri, kurse interpretimi ekstensif gjendjen reale të një kanuni q' ekzistion e bën vetëm më të përgjithëshme.

V. Më në funt, në qoftë se çfaqen dispozita që nuk mundet të pajtohen njëra me tjetrën dhe nga të cilat njëra nuk është m' e ré se tjetra dhe nuk është i mundur konstatimi me regullat e interpretimit, at' here që të dy dispozitat e papajtueshme anullojnë njëra-tjetrën. Në këtë rast çështja kà për t' u gjykuar sikur nuk ekziston as një nga të dy dispozitat e pa-pajtuara me mënyrat e treguara më poshtë.

§ 14. Anallogjia dhe restriksioni.

Kur prezantohet një grindje, gjyqtari duhet të dijë dy

gjëra: 1) faktet e çështjes të kontestuar, dhe 2) dispozitën ligjore, nën të cilën ato futen. Por, mundet që mos ekzistojë no një dispozitë ligjore e këtillë, gjë e cila lehtazi kupëtohet, po të merret para-sysh se është gjë e pa-mundur që të përmblidhen në ligjat gjithë relasjonet reale q' ekzistojnë, sikundër është e pa-mundur që ligjëvuësi të paravështrojë ndryshimet eventuale të jetës sociale. Nga kjo pik pamje ekzistojnë mungesa në të drejtën.

Për m' anën tjetër gjyqtari nuku munt të refuzojë gjykimin, dyke pretekstuar heshtjen ose mos qartësinë të ligjës. Duhet, pra, të gjykojë dhe gjykimin t' a japë simbas ligjës. Nga kjo pik-pamje e dytë, e Drejta nuku ka mungesa. Po ku do të gjenden këto regulla, nga të cilat do të udhëhiqet gjyqtari?

Neni 2§2 i dispozitavet të përgjithëshme mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet, thotë: "Kur një kontestim nuku munt të zgjidhet me një dispozitë të çqueme të ligjës, meren para-sysh dispozitat që regullojnë raste shëmbëllore ose çështje analloge; Kur, me gjith' këtë, rasti mbetet i herrët, zgjidhja bâhet simbas parimevet të përgjithëshme të së Drejtës". Ligia, pra, ja ka treguar udhën gjyqtarit; Ky do të përdotë *anallogjinë* ose do t' a zgjidhë çështjen simbas parimevet të përgjithëshme të së Drejtës.

Anallogji quhet zgjanimi i një ose mâ shumë regullave së Drejte, mbi raste të njëjta, nga pik-pamja ligjore, me ato të paravështruara prej tyre.

Baza e anallogjisë është njëjësija e rastit që ka për t' u regulluar me atë që ka qënë regulluar që mâ-parë. Njëjësi ekziston kur që të dyja këto raste të kenë shënja esenciale ligjore komune, në lidhje me çështjen nënë gjykim, ndonse në të tjerat ekzistojnë ndryshime. Anallogjia me gjith' që ngjet me interpretimin ekstensif, por ka ndryshime themelore nga ay; Interpretimi ekstensif ka si parasypozim se ligjëvuësi deshte zgjeritin e kuptimit të ligjës, po nuk u eksprimua si duhej që t' a përmblechë atë në formullimin

e ligjës, kurse përkundrazi anallogjia parasypozon se ligjëvuësi nuk e mentovi këtë zgjerim dhe naturisht nuk ishte e mundur t' a deshte.

I pari kapërxen letrën e ligjës, e dyta kapërxen vulnetin e ligëvuësit. Nga ky shkak anallogjia nuk është interpretim, por aplikim ligje.

Sikundër me anallogjinë zgjanohet aplikimi i një kanuni të drejte, mundet të ngjasë dhe e kundërta, domethënë të përkufizohet aplikimi. Kjo quhet *restriksion.* Ky ngjet kur, me promulgimin e një ligje për regullimin e një kategorie rastesh, mâ pas del dhe një rast tjetër, i cili gabimisht përmblidhet në ligjë, kështu që është e sigurtë se ligjëvuësi, po t' a kishte para-sysh atë rast, nuku do t' a përmblihte brënda në ligjë.

§ 15 — Doktrina.

Kështu quhet Skenca e së Drejtës dhe, më posaçërisht, veprat e shtypura në të cilat eksprimohet kjo shkencë, këto vepra qofshin libra, artikulla rivistash, ose shënime të shtypura në botime mbi vendimet gjyqësore.

Rol' i doktrinës, i cili në kohërat e vjetra — para se të kodifikohet e Drejta — ka qënë tepër i math, ka shumë rëndësi dhe në kohërat e tanishme. Mentimet e shkrimtarëvet juristë shpesh herë invokohen përpara gjykatavet, të cilat pranojnë theorit' e atyrevet; Në shumë raste u kanë dhënë giykatavet orientasionë.

Gjith' ashtu shumë herë kanë inspiruar dhe ligjëvuësin. Shkenca e së Drejtës shqiptare nuku ka të tregojë édhe as një vepër të drejte civile. Kjo e metë plotësohet nga vepra në gjuhërat frëngjisht dhe ita'isht, të cilat u bëjnë me të vërtet nder Shkencës franceze dhe italiane; Kësilloj vepra janë: *Aubry et Rau:* Cours de droit civil français (12 volume). *Marcel Planiol:* Traité élémentaire de Droit Civil (3 volume). *Ambroise Colin et Capitant:* Cours élémentaire de droit civil français (3 volume). *Dalloz: Code civil aunoté,*

Francesco Ricci: Corso teorico-pratico di diritto civile, etj.

§ 16 Juriprudenca

Juriprudencë quhet mënyra, me të cilën interpretohen ligjat prej gjyqevet. Rol' i gjyqtarit, në krahësim me atë të legjislatorit, duket shumë i kufizuar, por në realitet afró barasohen.

Ligjat nuk kanë vleftë, përveç se kur aplikohen dhe nga mënyra me të cilën aplikohen; Pra, interpretimi i ligjavet prej Autoritetit gjyqësor i jep këtij raste të panumurta që të modifikojë dhe nga do nj' herë të paralizojë vulnetin e ligjëvuësit.

Gjykatat vendosin dita ditës mbi pikat q' u parashtrohen, pika të cilat janë të veçuara njëra prej tjetrës; Veç kësaj, gjykatat dyke mos qënë të lidhura nga vendimet e mâ-parëshme të tyre dhe të gjykatavet të tjera, të dhëna mbi pika similare, janë krejt të lira dhe mundin kur-do-herë të këmbejnë mentimet e tyre. Nga kjo gjë rezulton një "*variété*" vendimesh, të cilët mundet të jenë dhe në kundrështim njëra me tjetrën,

Gjithë Shtetet e qytetëruara botojnë vendimet më me rëndësi të gjykatavet në rivista të posaçme.

Në Shqipëri këtë misjon e mbush — me mënyrë shumë të metë — rivista e botuar prej Ministrisë së Drejtësisë, "Juriprudenca Shqiptare." Importanca e këtsilloj dokumentavet është e vetëkupëtuarshme.

Gjykatat në raste të njëjta ose analloge kanë një tendencë naturale që të konformohen me solusjonet e konsakruara që më parë prej atyrevet vetë ose dhe prej Gjykatavet të tjera. Por, kur pika q' u jepet për të zgjidhur ka qënë objekt i no njëj vendimit të Gjykatës së Diktimit, at' here gjykatat konformohen afro gjith' monë me doktrinën e atij vendimi, nga frika që mos t' u anullohen vendimet e dhëna. Vendimet e dhëna prej gjykatës së Diktimit në mbledhje të bashkëtë të të dy seksjonevet kanë një fuqi të posaçmë, massi janë të detyruëshme për Gjykatën e Shkallës

së Parë, që do t' a gjykojë po atë çështje.

Jurisprudenca, pra, prezanton karakterë të njëj zgjanimi, të njëj plotësimi të ligjës, por me këtë ndryshim: se ndjek evolusjonin, mbahet në armoni me ndryshimet sociale dhe me lëvizjen e idhevet.

§ 17. — Organizim' i Gjykatavet

Baza dhe syrpzimi i çdo shoqërije të qytetëruar është urdhëri ligjor, përdorimin e të cilit e ka shteti; Ky ngarkohet me dy detyra: a) mprojtjen e të drejtavet të pa atakuara édhe, dhe b) rivendosjen e atyrevet të atakuaravet.

Fonksjoni, pra, që meret me rivendosjen e të drejtavet të atakuara formon Pushtetin Gjyqësor të Shtetit, Pushtet i cili zbatohet prej një Autoriteti të veçantë dhe independent, prej Gjykatëvet *(Neni 118 i Statutit.)*

Si mbas ligjës mbi organizimin e gjykatavet, në fuqi qysh prej datës 1 Prill 1929, gjyqësia në çështje civile dhe penale administrohet prej:

1. *Gjykatavet të Paqit*, të përbëra prej një gjyqtari — gjyqtarit paqtuës — dhe me kompetencë gjykimi të çashtjevet përkufizimisht të caktuara ne Nenet 36e37 të ligjës Organizimit Gjykatavet.

Janë në kompetencën e gjykatavet të paqit gjithë padinat civile ose tregëtare, objekt' i të cilavet nuk kalon, në të holla ose në vleftë, të 2500 frangat arr dhe që nuk i shtrohen kompetencës të një gjykatës tjetër nga shkaku i cilësisë tyre pa u marë para-sysh vlefta e objektit të kontestuem. Kjo është kompentenca ordinare e gjykatavet të paqit.

Kompetenca eksepsjonale e tyre përmbleth gjykimin e gjith' atyre çështjevet, që posaçërisht dhe limitativisht caktohen prej ligjës.

Pas këtyre, në kompetencën e gjykatavet paqtuësa është dhe gjykimi i gjithë kontravencionevet dhe të çdo delikti, për të cilin ligja cakton një ndëshkim kontra lirisë personale, që nuk kalon në maksimum tre vjet ose një

ndëshkim gjobor, i cili vetëm ose i bashkuem me ndëshkimin e sipërtreguem të 4000 franga arr.

Por gjyqtarët paqtuësa kanë atribusjone edhe në çështje *jurisdiksjoni voluntar*, të cilat u referohen lândavet mâ të ndryshme.

2. *Gjykatat e Shkallës së Parë.* Këto janë gjykatat ordinare dhe ndahen në gjykata fillore dhe në gjykata kolegjiale.

a) *Gjykatat fillore* përbëhen prej gjyqtarit fillor ose prej ndihmësit të tij; Gjyqtari fillor gjykon vetë fillimisht padinat civile ose tregëtare që kanë një objekt, vlefta ose sasia e të cilit âsht mâ tepër se 2500 franga arr, por nuk kalon të 6000 frangat arr; Gjith' ashtu gjykojnë kontravencionet edhe deliktet që tërheqin burgim që nuk kalon në maksimum 3 vjet ose ndëshkim gjobor — të vetëm ose të bashkuem me burgimin — që nuk kalon në maksimum të 4000 frangat arr.

b) *Gjykatat Kolegjiale* përbëhen prej gjyqtarit fillor dhe prej dy anëtarëvet dhe gjykojnë çâshtjet civile ose tregëtare, që kanë një objekt në vleftë të pa-caktuëshme ose vlefta o shuma e të cilavet kalon të 6000 frangat arr, si dhe gjithë deliktet, të cilat tërheqin një ndëshkim kontra lirisë personale, minimum' i të cilit kalon të tre vjetet ose një ndëshkim gjobor, i cili vetëm ose i bashkuar me burgimin kalon në maksimum të 4000 frangat arr. Ligja mbi organizimin e gjykatavet njeh vetëm një degré jurisdiksjoni. Gjykatat e paqit dhe ato të Shkallës së parë gjykojnë në degré të parë dhe të fundit; Gjykata apeli nuk ekzistojnë në Shqipëri.

3. *Gjykata e Diktimit*, e cila ndahet në dy degë: në degën civile dhe në degën penale dhe ka qendën në kryeqytet. Se e cila nga të dy degët e gjykatës Diktimit përbëhet prej një kryetari, prej katër anëtarëvet dhe një ndihmës anëtari. Mbledhjet e përgjithëshme të kësaj gjykate i kryeson kryetari i degës civile.

Gjykata e Diktimit është kasasjon, thyen ose vërteton

vendimet e gjykatavet inferiore. Por, Neni 43 i ligjit mbi organizimin e gjykatavet i ka dhënë kompetencë gjyqit Diktimit t' i shqyrtojë çështjet edhe nga pik-pamja e faktit, tue i dhënë kësilloj gjyqit Diktimit një karakter gjykate të shkallës së dytë.

Në ellaborimin e jurisprudencës rollin kryesor e ka gjykata e Diktimit, e cila është organizuarë për sigurimin e unitetit të interpretimit të ligjavet. Sikundër u tha dhe më sipër, gjykata e Diktimit ose vërteton vendimet qi sillen për shqyrtim ose i thyen dhe i anullon. Kështu, pra, Gjykat' e Diktimit nuk gjykon çështjet, por gjykon vendimet e dhëna prej gjykatavet të tjera të Shtetit, massi misjon i saj është vrejtimi që *pikat ligjore* të vendimevet të gjykatavet të tjera të jenë konformue me ligjën.

Ndonse gjykatat nuk janë të detyruara, por në realitet konformohen me doktrinën e vendimevet të gjyqit Diktimit. Autoriteti i kësaj jurisprudence forcohet edhe nga fakti se Gjykata e Diktimit shumë rrallë largohet nga solusjonet që ka pranuar dhe kështu jurisprudenca e saj ka një fiksitet. Këmbimi i jurisprudencës, — kur është i nëvojëshmë — pas doktrinës, duhet të bëhet prej Këshillit të Përgjithëshmë të gjykatës Diktimit. Me këtë mënyrë gjykata e Diktimit i siguron interpretimit të ligjës një karakter sigurimi dhe pa-këmbyeshmënie, gjëra të cilat janë të nevojëshme për mprojtjen e interesavet private dhe të sigurimit të mârëdhanievet. Kështu, pra, lot rolin e një organi legjislatif, sikundër duhet dhe sikundër ka dashur dhe ka patur për qëllim ligjëvuësi.

§ 18 — Kodi Civil Shqiptar

Me dekret të Presidentit të Republikës Shqiptare u formua më 1927 një komisjon legjislatif, i cili u ngarkua me hartimin e kodevet të ndryshmë. Pemë e punës të këtij komisjoni janë, mid's të tjerave, Kodi Penal Shqiptar, i cili ka hyrë në fuqi qysh prej 1 Janar 1928 dhe, më von, Kodi Civil Shqiptar i vënë në fuqi më 1 Prill 1929.

Komisjoni legjislativ në hartimin e Kodit Civil shqiptar mori për bazë principale të tij Kodet Civile të Francës dhe t' Italisë, por shumë institusjone u regulluan pas kodevet të Helvetisë, të Gjermanisë dhe të Egjyptit; Pjesa e obligasjonevet u muar nga projekti i përbashkëtë italo-frances mbi obligasjonet. Kodi Civil, dyke patur për mburim kryesor Kodin e Napoleonit, që bazohet në parimet e Revolusjonit të Math Frances të 1789, ndjek po ato parime me të. Nuku pranon distenksjone sociale, i konsideron gjithë shtetasit baras njërin me jatrin nga pik-pamja e së drejtës civile pa distenksjon feje dhe seksi, siguron lirinë personale, mpron lirinë dhe sigurimin e pronësisë dhe paravështron që, nga vulneti partikollar, mos të krijohet pa-drejtësi pasurore.

Nga pik-pamja e klasifikimit të landës, Kodi Civil ndahet në katër libra, të cilat dhe këto ndahen në Titulla, në kaptina dhe në sekjone dhe përmban 2047 Nene. Precedojnë dispozitat mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, të përmbledhura në 11 Nene të veçanta. Libri i parë intitullohet: *personat dhe familia,* trajton relasjonet e persones me personat e tjera, me të cilat është lidhur me gjini, relasjone të krijuara me martesë dhe të zhvilluara me lindjen e fëmijëvet.

Libri i dytë: *trashëgimet,* domethënë fatin e pasurisë pas vdekjen e personës. Libri i tretë: *sendet, zotërimin* dhe *modifikimet e tij,* dhe i katërti: *mënyrat e fitimit dhe të transmetimit të zotërimit mbi sendet.*

Kështu, pra, Kodi Civil ndahet në katër pjesa; Por, zakonisht, në shkencë precedon një pjesë tjetër, *Parimet e Përgjithëshme të së Drejtës,* e cila aplikohet dhe është komune në të katër pjesat e tjera. Ky libër ka për qëllim mësimin e Parimevet të Përgjithëshmë të së Drejtës Civile.

PJESA E DYTË

KAPTINA A.

Sfera e Aplikimit të Ligjës.

Në këtë pjesë ka për t' u bërë fjalë mbi kufitë tokësore të ligjës — ndonse kjo landë është objekt i së Drejtës Nërkombëtare Private, -- dhe mbi kufitë kohësore të saj, massi ligjat zbatohen në kohë dhe në tokë të caktuara.

§ 19. — Kufitë tokësore të ligjës.

Ligjat janë vepra e një sovraniteti tokësor, i cili nevojërisht është i përkufizuarë. Shtetet e ndryshme, sovranë mbi tokat e tyre, janë të pamvartur njëri prej jatrit dhe sovranitet' i tyre përkufizohet vetëm mbi personat dhe mbi tokën e tyre. Në rastin që ky parim do të ap'ikohej absolutisht, do të refuzohej çdo autoritet në ligjat e një Shteti jashtë kufivet tij; Ç' do komp, pra, do të mbyllej në kufit' e veta dhe do të zbatonte vetëm brenda n' ato sovranitetin e vetë, por, m' anën tjetër do të humbiste çdo të drejtë mbi shtetasit e tij të ndodhur në shtete të huaj. Kështu në Shqipëri do të zbatoheshin vetëm ligjat shqiptare, por zbatim' i tyre do të përkufizoheshe vetëm në tokën e Mbretërisë Shqiptare.

Por shteti ka interes kryesor të mos humbasë autoritetin e vetë mbi ata prej shtetasit, të cilët udhëtojnë ose përkohësisht stabilizohen në mërgim në vise të huaja; Ky interes nuku mundet të gjejë satisfaksion përveç se me koncesione reciproke dhe të njëjta. Për shëmbëll: Shqipëria ka interes që disa prej ligjavet të saj t' i ndjekin shqipëtarët dhe jashtë kufisë të Mbretërisë; Por, reciprokisht, duhet të përmet jë të hyjnë dhe të zbatohen në Shqipëri ligjat e shtetevet të tjerë mbi shtetasit e huaj, që vijnë këtu në Shqipëri.

Sovraniteti i çdo shteti zgjatet më nj' anë mbi personat dhe m' anën tjetër mbi tokën e vetë, dhe çdo ligjëvuës, dyke zbatuar pushtetin e vetë brenda kufivet të Shtetit, vë ligjat për tokën e jurisdiksionit tij, kështu që atje ku mbarojnë kufitë tokësore të Shtetit, atje mbaron dhe fuqia e ligjës së tij.

Por, sovraniteti i ligjës mbi shtetasit, kur këta kapërxejnë kufin' e Shtetit, vazhdon të zbatohet mbi 'ta? Shtetasit e huaj të ndodhur në Shqipëri a duhet t' u binden ligjavet shqiptare? Këta shtetas të huaj, kur kanë pasuri në Shqipëri, ndonse banojnë jashtë Shtetit, duhet t' u shtrohen ligjavet shqiptare? Shqiptari, i cili ka pasuri jashtë Shtetit, duhet t' u bindet ligjavet të huaja? Aktet juridike që shqiptari bën jashtë Shtetit dhe ato që i huaji bën në Shqipëri, mbas ligjës të cilit Shteti do të regullohen? Dhe, në këtë rastin e fundit, si mbas cilës ligjë do të regullohet çështja e provimit?

Në Shkencën juridike dhe në jurisprudencën ka predonimuar theoria, simbas të cilës ligjat çquhen në dy kategori të mbëdha: në kategorin' e ligjavet që formojnë *statutin personal* dhe n' atë të *Statutit real.* Në kategorin' e ligjavet që formojnë statutin personal përmblidhen ligjat relative me personat; kudo që të ndodhet persona, kudo që të bëjë akte juridike, ligjat q' i përkasin personës e ndjekin dhe aplikohen mbi 'të.

Në kategorin' e ligjavet, që kushtituojnë statutin real përmblidhen dispozitat q' u përkasin sendevet, të cila nuku kapërxejnë kufitë tokësore të Shtetit dhe, sikundër këto ligja zbatohen mbi të huajt që kanë pasuri në Shqipëri, kështu dhe mbi shtetasit shqiptarë aplikohen ligjat e Shtetit, ku ndodhet pasuria e tyre reale. Por sendet e lujtëshme, që munden të transportohen nga një shtet në një tjetër, pas sistemit real a po pas sistemit personal do të regjohen?

§ 20. — Ligjat Ndëshkimore, Policore dhe të Sigurimit Publik.

Ligjat ndëshkimore dhe policore, si dhe ato të sigurimit publik, janë të detyruëshme për gjith' ata që ndodhen në tokën shqipëtare, thotë Neni 10 i dispozitavet mbi interpretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht. Arësyet, për të cilat ligjëvuësi urdhëron që ligjat penale, policore dhe të sigurimit publik janë të detyruëshme për të gjith' ata që ndodhen në tokën shqiptare, janë të vetëkupëtuëshme. Çdo shtet ka të drejtën dhe detyrën të paravështrojë konservimin edhe mprojtjen e vetë dhe të ndalojë çdo gjë që mundet t' i turbullojë qetësinë ose t'i verë në rezik sigurimin.

Pra, në qoftë se shtetasi i huaj do të mundte të turbullonte qetësinë dhe të kompromentonte sigurimin e shtetit pa patur frikën e një ndëshkimi, shteti at' here duhet të hiqte dorë nga qëllimi i konservimit të vetë.

Ligjat, për të cilat bëhet fjalë në nenin 10 të naltpërmëndur, nuku janë vetëm ato thjeshtësisht ndëshkimore, por edhe çdo regullore ose dekret që, simbas Statutit të çdo shteti, ka fuqi detyruëse. Pra, dhe regulloret dhe urdhërat e Bashkive për shëndetësi, pastrim, sigurim publik të dhëna në konformitet me ligjat e shtetit, janë të detyruëshme për të huajit.

I huaji nuku mundet të çkarkohet nga resposabiliteti q' i rjeth prej shkeljes të këtyre regullorevet, tue pretenduar mos dijenin' e tyre; Massi shtetasit shpiptarë nuku shpëtojnë nga resposabiliteti për shkeljen e tyre nga mos dijenia, nuku eksiston as nonjë arësye që të krijohet për të huajit një privillegjë dhe një gjëndje mâ avantazhoze, e cila do t' i shpëtonte këta nga përgjegjësia.

§ 21 — Ligjat q' u përkasin Gjendjes dhe Zotësisë të Personavet.

"*Gjendja dhe zotësia e personavet* — thotë neni 5 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjave përgjithësisht — *dhe marëdhëniet familiare regullohen simbas*

ligjës të Shtetit t' atyre personavet". Dispozitat që kushtituojnë statutin personal e pasojnë shtetasin shqiptar kudo që të vejë ay dhe këtë parim ka pranuar ligjëvuësi dhe për shtetasit e huaj. Ligjëvuësi me këtë dispozitë deklaron se statuti personal ka aplikim mbi cilin-do dhe kudo që kontrakton, shqiptar qoftë, i huaj qoftë, dhe ky parim liberal është pranuar pa rezervën e reciprocitetit.

Ligjëvuësi, kurse me nenin 5 të dispozitavet të naltpërmëndura, ka pranuarë statutin personal të çdo persone, në nenin 11 po t' atyre dispozitavet urdhëron: "*Me gjithë dispozitat e nenevet të mâ sipërme, në as një rast ligjat, veprimet dhe vendimet e huaja, si dhe disponimet dhe konvencionet private nuku pranohen, kur janë në kundrështim me ligjat ndalimtare të Mbretërisë, të cilat u përkasin personavet, sendevet ose veprimevet, as me ligjat q' u përkasin me çdo mënyrë rendit publik ose zakonevet të mira*". Aplikimi *në letër* i nenit 11 do të sillte në kontrathënie legjislatorin dhe m' anë tjetër do të çfuqizonte dispozitat liberale të nenit 5, massi ligjat që kushtituojnë statutin personal i përkasin urdhërit publik. Si duhet, pra, kupëtuar dhe aplikuar ky nen?

Është e ditur se *përjashtimi* nuku mundet të shtrihet tej rastevet të shprehuna që kishte para-sysh ligjëvuësi, por m' anën tjetër neni 11 i naltpërmëndur është i përgjithëshmë dhe nuku përmban numurim rastesh; Dyke ditur, pra, rastet e përmbledhura shprehimisht në përjashtimin, kupëtohet ci'at raste nuku përjashtohen dhe futen nënë regullin e përgjithëshmë të nenit 11 të dispozitavet mbi aglikimin dhe interpretimin e ligjavet përgjithësisht.

Lé të sypozojmë se ligja e huaj regullon statutin personal me një mënyrë të ndryshme nga ligja Shqiptare; Massi dispozitat relative me statutin personal janë të urdhrit publik po të aplikohej *në letrë* neni 11 i nalt-përmëndur, do të mos ishte e mundur të zbatohej statuti personal i të huajit si i ndodhur në kundrështim me ligjën shqip'are dhe nuku do të mbeteshe mâ vënt për aplikimin e nen't 5 të

dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht në as një rast.

Për shëmbëll: në një Shtet të huaj, ligjat e të cilit përmetojnë poligaminë, një njeri ka shumë gra dhe shumë fëmijë prej tyre; Lé të sypozojmë tani se gjykatat shqiptare në një çështje, q' u është sjellë për të zgjidhur, duhet të vendosin mbi legjitimitetin e fëmijëvet të lindura prej gravet të ndryshme; Cilën ligjë do të aplikojë gjykata, ligjën shqiptare apo statutin personal të të huajvet, por i cili vjen në kundërshtim me urdhërin publik shqiptar?

Naturisht gjykata do të aplikojë statunin personal, massi, po të meret para-sysh se ligjat shqiptare kanë fuqi vetëm në tokën shqiptare dhe nuku mundet të kapërxejnë kufit' e Shtetit, nuku munt të konsiderohet se urdhëri publik shqiptar cënohet me as një mënyrë për shkakun se një Shtet tjetër ka pranuar një statut personal të ndryshmë nga ay i joni, as ligjat t' ona të urdhërit publik ofendohen për shkakun se një Shtet i huaj ka pranuar poligaminë. Gjykata shqiptare, dyke aplikuar mbi të huajin statutin e tij personal, konstaton vetëm një fakt juridik, i cili eksiston në Shtetin e huaj; Por, as eksistenca në një Shtet të huaj të një statuti personal të kundërtë me të drejtën tonë publike të brëndëshme, as konstatimi ose konformimi i eksistencës të këtij statuti jashtë kufisë cënojnë me as një mënyrë moralin ose urdhërin publik shqiptar.

Për të pajtuar dispozitat e nenit 5 me ato të nenit 11 të dispozitavet mbi interpretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, duhet të meret para-sysh se teksti i nenit 11 thotë: "*Në as një rast ligjat, vepërimet dhe vendimet e huaja nuku pranohen, kur janë në* **kundërshtim** *me ligjat ndalimtare të Mbretërisë, të cilat u përkasin urdhënit publik dhe zakonevet të mira*". Por, kur ligjat e huaja vijnë në kundrështim me ligjat shqiptare? Kur fakti juridik që ka një vleftë juridike ngjet midis të huajvet në një Shtet të huaj, nuku mundet të konsiderohet se ndodhet me as një mënyrë në kundrështim me ligjat t' ona, të cilat nuku zba-

tohen as në Shtetin ku u bë ngjarja juridike, as mbi personat që janë palë në 'të. Por, në qoftë se fakti juridik, i ligjëshmë simbas ligjës të Shtetit të huaj, bëhet në Shqipëri, vetëm në këtë rast ekziston konflikt midis ligjës të huaj dhe ligjës Shqiptare dhe ka aplikim neni 11 i dispozitavet të naltpërmëndura. Për shëmbëll: një i huaj, i martuar nj' herë, kërkon të martohet për së dyti në Shqipëri para se të çkurorëzohet nga gruaja e parë. Ndonse ligjat e Shtetit të tij përmetojnë poligaminë, celebrimi i martesës së dytë nuku munt të përmetohet në Shqipëri, massi ligjat shqiptare jo vetëm q' e ndalojnë një kësilloj fakti, por dhe e paravështrojnë dhe e ndëshkojnë si faj.

Pra, vetëm në kësilloj raste ka vënt për aplikimin e nenit 11 të dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht dhe ligjat që kushtituhojnë statutin personal të të huajvet mbeten të pa fuqishme.

Shtetësia regjohet simbas statutit personal, domethënë aplikohet ligja e Shtetit, së cilit persona është shtetas. Në rastin që persona nuku ka as një shtetësi aplikohet ligja e Shtetit, ku persona ka banimin. Në qoftë se eksistojnë dy shtetësira të ndryshme po në një persone, preferohet shtetësia shqiptare; Kur që të dy shtetësitë janë të huaja, preferohet ajo e banimit dhe, kur nuku ka banim, ajo e qëndresës.

Martesa, për sa i përket formës të celebrimit, regjohet prej ligjës të vëndit ku celebrohet, simbas parimit "*locus regit actum*"; Po', fejesa, ndalimet, me një fjalë substanca e martesës, regjohen simbas ligjës të shtetit të së cilit prej kanditatëvet bashkëshortë.

Statuti personal i familjes regjohet simbas atij të burit, si kryetarit të families. Por, çkurorëzimi, massi i përket urdhrit publik, regjohet simbas ligjës të vëndit ku bëhet.

Konsekancat personale dhe pasurore të baskkëshortëvet regjohen në tërë kohën sa vazhdon martesa simbas ligjës të shtetësisë që kishte buri në kohën e celebrimit të martesës.

Legjitimimi ose mos-legjitimimi i fëmijëvet regjohet simbas ligjës të prindit; Pra, në qoftë se fëmija kërkon njojtjen e atësiës, do të aplikohet ligja e Shtetit të atit, dhe, në qoftë se kërkohet amësia, do të aplikohet ajo e shtetësisë të mëmës.

Ndalimi dhe pa-aftësimi regjohen simbas statutit personal t' atij që vihet nënë këto. Por, pranimi ose rezuzimi i tytoriës dhe i kujdestariës regjohen simbas ligjës t' atij, i cili thëritet në 'to.

§ 22. — Ligjat q' u përkasin sendevet.

"*Sendet e pa-lujtëshme* — thotë neni 6§2 i dispozitavet mbi interpretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht — *u shtrohen ligjavet të vëndit, ku ndodhen*". Të drejtat mbi sendet e pa-lujtëshme regjohen simbas ligjës të vëndit, ku ndodhen (*lex rei sitae*), massi sendet e pa lujtëshme formojnë pjesë të tokës së shtetit dhe janë të bashkuara me sovranitetin e tij. Dispozita e nenit 6 të naltpërmëndur relative me sendet e pa-lujtëshmë aplikohet jo vetëm mbi pronjat e ndodhura në tokën shqipëtare, qofshin ato të zotënuara dhe prej shtetasvet të huaj, por edhe mbi sendet e pa-lujtëshme të ndodhura në një shtet të huaj. Pra, në qoftë se gjyqtarit shqiptar i çfaqet rasti që të gjykojë një çështje relative me pronja të pa-lujtëshme, të ndodhura në tokën e një shteti të huaj, ay duhet të aplikojë ligjën e shtetit ku ndodhen ato, qoftë dhe në rastin që pronjari të jetë shtetas shqipëtar.

Ligjat që kushtituojnë statutin real janë ato, që kanë objekt sendet e pa-lujtëshme ato yetë, pa u marë parasysh persona q' i zotëron. Kur dispozita ligjore ka parasysh personën ose aktin, ndonse u referohet pronjavet të pa-lujtëshme, nuku bën pjesë të statutit real. Për shëmbëll: ligjat q' u përkasin trashëgimevet, nuku bëjnë pjesë të statutit real, ndonse u referohen dhe sendevet të pa-lujtëshme.

Për të vendosur në se sendet e lujtëshme të një shtetasi të huaj, por të destinuara për shërbimin e një pronje

të pa-lujtëshme të ndodhur në shqipëri, janë të pa-lujtëshme prej destinimit, do të meret para sysh ligja shqiptare.

Gjith' ashtu simbas ligjës shqiptare do të regjohen të drejtat të cilësuara prej ligjës të pa lujtëshme nga objekti, të cilit i referohen.

Të drejtat e uzufruktit, të përdorjes dhe të bujtjes, servitudet dhe gjith' ato të drejta q' i referohen eksersimit edhe gëzimit të së drejtës pronësisë, regjohen simbas ligjës të vëndit, ku ndodhen pronjat.

Ipoteka konvencionale regjohet simbas ligjës te vëndit ku ndodhet pronja, por dhe aktet e bëra në vënde të huaja mundet të paraqiten për inskriptim, mjafton të jenë regullisht të legalizuara.

Ipoteka legale q' u akordohet të mitunvet dhe të ndajuemvet mbi pasurin e tytorëvet dhe ipoteka legale q' i akordohet gruas mbi pasurin' e burit, regjohen simbas statutit personal të këtyrevet.

Për sa u përket sendeve të lujtëshme, po ay neni 6 thotë: *'Sendet e lujtëshme u shtrohen ligjavet të zotënuësit, përveç kur në ligjat e vëndit, ku ndodhen ato sende, ka dispozita të kundërta"*. Kur bën fjalë ligja në këtë rast për sende të lujtëshme, ka para-sysh se cilin send veçanërisht dhe jo ato që përbëjnë një *universalitet* ose pasurinë të lujtëshme të personës. Parimisht, pra, sendet e lujtëshme u shtrohen ligjavet të Shtetit të zotënuësit. Por fraza: *"përveç kur në ligjat e vëndit, ku ndodhen ato sende, ka dispozita të kundërta"*, përmban një përjashtim nga parimi i sipërmë. Dispozita e ligjës lokale at' here është e kundërtë me atë të ligjës persoanle, kur të dy dispozitat janë të pa pajtueshme, kështu që, po të aplikohej ligja e shtetësisë të zotënuësit, do të vinte në kundrështim me ligjën lokale. Është për të vënë oroé se ligja bën fjalë për dispozita *të kundërta* dhe jo për dispozita *të ndryshme*. Për shëmbëll: Simbas nenit 1065 të Kodit Civil posedimi me mirëbesim ka efektin e titullit, për sa u përket pronjavet të lujtëshme. Në qoftë se një shqiptar posedon me mirëbesim një send të një të huaji

dhe ligja e Shtetit të këtij të fundit nuku e njeh këtë parim, shtetasi i huaj nuku mundet të invokojë ligjën e Shtetit të vetë, massi ay vjen *në kundërshtim* me ligjën shqiptare; Pra, në këtë rast do të aplikohet ligja shqiptare.

Bashkëpasunimi në pjesa të pa ndara të sendevet të lujtëshme midis shumë të huajvet me shtetësi të ndryshme, regjohet simbas ligjës të vëndit, ku ndodhen ato. Massi nuku eksiston nonjë arësye që të preferohet ligja e Shtetit të njërit të huaj nga ay i tjetrit, duhet të predominojë midis tyre ligja lokale dhe ajo të aplik het.

§ 23. — Ligjat q' u përkasin Trashëgimevet.

Thamë më sipër se gjendja dhe zotësia e personavet regjohen simbas ligjës të Shtetit, të cilit ato persona janë shtetas; Se sendet e pa-lujtëshme regjohen simbas ligjës të vëndit, ku ndodhen, dhe sendet e lujtëshme simbas ligjës të Shtetit të zotënuësit. Por, me ç' mënyrë do të regullohet trashëgimi i një të huaji, trashëgim i cili mundet të përbëhet prej sendesh të lujtëshme dhe të pa-lujtëshme, si mbas statutit personal apo simbas statutit real?

Prej theorivet të ndryshme q' eksistojnë mbi këtë çështje, ligjëvuësi shqiptar ka pranuar atë, simbas të cilës trashëgimi i një të huaji duhet të regjohet gjithë-monë simbas ligjës të Shtetit, së cilës shtetas ishte në gjalljen e tij *de cujus*-i; Neni 7 i dispozitavet mbi interpretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, thotë: *"Por trashëgimet legjitime ose testamentare, si për radhën e trashëgimit, ashtu edhe për masën e të drejtavet trashëgimore dhe për vleftësiën thelbësore të disponimevet, regullohen mbas ligjës të Shtetit të* **de cujus**-*it, çdo lloj që të jetë ajo pasuri edhe kudo që të ndodhet"*.

Neni 7 i dispozitavet të naltpërmëndura cakton *përkufizimisht* rastet, në të cilat aplikohet ligja e huaj në regullimin e trashëgimit të *de cujus* it të huaj dhe këto janë radha e trashëgimit, masa e së drejtavet trashëgimore dhe vleftësia thelbësore e disponimevet. Por, për sa u përket forma-

vet të jashtme të disponimevet testamentare, duhet të meren parasysh ligjat e vëndit, ku u bë testamenti, për veç rastit kur testatori preferovi të ndjekë format e caktuara prej ligjës të Shtetësisë së vetë (shif nenin 8§1 të dispozitavet në fjalë).

Zotësia e trashëgimtarit për me trashëgue regjohet simbas *Statutit personal*, massi simbas këtij regullohet zotësi' e personavet. Pra, në qoftë se një shqiptar thëritet si trashëgimtar në trashëgimin e një shtetasi të huaj dhe kontestohet zotësi' e tij, kjo regjohet simbas ligjavet shqiptare. Në qoftë se disponimet e *de cujus*-it ose dispozitat e ligjës të huaj vinë në kundrështim me të drejtën publike shqiptare, at' here, në konformitet me nenin 11 të dispozitavet në fjalë, neni 7 po i këtyre dispozitavet nuku ka vënt për aplikim.

Neni 7 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht aplikohet në gjithë llojet e trashëgimevet, testamentarë ose legjitimë qofshin, kudo që të çelet trashëgimi dhe kudo që të ndodhet pasuria, e cila formon trashëgimin. Pra, në qoftë se një gjerman vdes në Shqipëri dhe pasurija e tij ndodhet në Francë, në rastin që çelet një padie relative me këtë trashëgim në Shqipëri dhe gjykatat shqiptare duhet t' a zgjidhin çështjen, duhet t' aplikojnë ligjën gjermane, që është ajo e gjendjes personale të *de cujus*-it, pa u marë para sysh ligja e shtetit, në të cilin ndodhet pasuria që përbën trashëgimin.

Rezerva ligjore regullohet dhe ajo simbas ligjës të shtetit të *de cujus*-it, massi dhe trashëgimi legjitim po simbas asaj ligje regjohet.

"*Substanca dhe efektet e dhurimevet dhe të disponimevet të vulnetit të mbramë* — disponon neni 8§2 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht — *konsiderohen të regullueme mbas ligjës të shtetit të disponuësavet*". Kur bën fjalë ligja për dispozita të vulnetit të mbramë në këtë rast, ka para-sysh si ato me titull universal, ashtu dhe ato me titull partikollar, massi

ligja nuku bën nonjë përjashtim.

Konditat që mund t' u vihen disponimevet të vulnetit të mbramë, massi i përkasin substancës t' atyrevet dhe jo formës, regjohen simbas ligjës të shtetit të testatorit.

Por, dhe në rastin që kondita të jetë e vlefshme simbas ligjës të testatorit, qoftë dhe kontra urdhrit publik ose zakonevet të mira të Shtetit, ku ndodhet pasuria e disponuar, prapë së prapi do të aplikohet ligja e shtetit të disponuësit.

Me gjith këto shtetasi i huaj mund të çfuqizojë ligjën e tij kombëtare, për sa u përket substancës edhe efektevet të disponimevet tij ; Kjo rezulton nga paragrafi i fundit i nenit 8 të naltpërmëndur, ku thuhet: *"Ky regull aplikohet, kur nuk provohet një vulnet i kundërtë"*. Naturisht disponuësi mundet mos të aplikojë ligjën e shtetësisë së tij vetëm në dispozitat ligjore që kanë një karakter interesi privat, si për shëmbëll në të drejtën e shtimit, në pagimin e detavet e tjera; Por me as një mënyrë nuku mund të shkelë dispozita q' i përkasin urdhërit publik të shtetit tij, massi këto, simbas parimit *"publicum jus privatorum pactis mutari non pote t"*, kurkush nuku mund t' i çfuqizojë; Kështu, pra, nuku mund të bëjë të vlefshme një konditë, që, simbas ligjës të shtetit tij, është nul ose të bëjë një emërim trashëgimtari të ndaluar po prej asaj ligje.

§ 24. — Ligjat q' u Përkasin Substancës dhe Efektevet të Kontratavet.

Në nenin 8 paragraf' i fundit të dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, thuhet: *"Substanca dhe efektet e obligimevet konsiderohen të regullueme mbas ligjës të vëndit,* ku *janë bâ veprimet dhe, kur kontraktuësat e huaj kanë po një shtetësi, mbas ligjës të shtetit tyre. Ky regull aplikohet, kur nuk provohet një vulnet i kundërtë"*.

Në kontratat vulneti i palëvet predominon dhe, kur ato janë ligjorisht të formueme, kanë fuqi ligje për ata q' i

kanë lidhur dhe kanë po atë fuqi detyruëse me dispozitat e vëna prej ligjëvuësit. Në këtë parim dhe legjislatori shqiptar ka bazuar dispozitën e naltpërmëndur të nenit 8 të dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet.

Vulneti që regullon obligimet e lidhura mundet të jetë ose i shprehun ose i prezumuem. Në qoftë se është i shprehun, at' here aplikohet dispozita e nenit 8, simbas të cilës "ky regull aplikohet kur nuku provohet një vulnet i kundërtë". Kjo do të thotë se, në qoftë se kontraktantët deklarojnë se konvencion' i tyre duhet të regjohet prej një ligje tjetër të ndryshme nga ligja e shtetit tyre ose të ndryshme nga ligja e vëndit, ku kontraktojnë, do të aplikohet ligja e caktuar prej tyre dhe vetëm kjo. Por, në qoftë se kontraktantët nuku deklarojnë shprehimisht vulnetin e tyre mbi ligjën, e cila do të regjojë kontraton, at' here duhet të prezumohet, të caktohet se me cilën ligjë heshtësisht deshin t' a regullojnë atë. Pra, në qoftë se kontraktantët të huaj në vëndin ku kontraktojnë, kanë që të gjithë një shtetësi, prezumohet se vulneti i tyre ishte për që kontrata të regjohet simbas ligjës të shtetit tyre; Në këtë rast aplikohen dispozitat e nenit 8 dhe kontrata regjohet simbas ligjës të shtetësisë të kontraktantëvet.

Në qoftë se kontraktantët kanë shtetësi të ndryshme, at' here kontrata e tyre regjohet simbas ligjës të vëndit, ku u lith konvencioni dhe për këtë arësye neni 8 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet regullon në këtë mënyrë rastin që kemi para sysh, massi s' ka për se të preferohet ligja e shtetësisë të njërit prej asaj të tjetrit.

Kur ligja në këtë rast bën fjalë për substancën dhe për efektet e obligimevet, duhet të kupëtohen me fjalën *substancë* gjithë konditat dhe elementat si edhe cilësit' e tjera të brëndëshme, të cilat janë të nevojëshme për vleftësin' e obligimit; dhe me fjalën *efekte* duhet të kupëtohen relasjonet juridike midis kontraktantëvet, q' u rjedhin prej tyre. Pra, si vleftësi' e brëndëshme e aktit, ashtu edhe konsekan-

cat që rjedhin prej saj, regullohen simbas mënyrës të treguar në këtë nenin 8 paragraf' i 2 të dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht.

Midis efektevet të obligimit — për të cilat bëhet fjalë në nenin 8 të dispozitavet të sipërmëndura — nuku përmblidhet efekti relatif me transferimin e zotnimit mbi sende të pa lujtëshme ose mbi të tjera të drejta të pa lujtëshme, massi këto regjohen simbas dispozitavet të nen't 6§2 të dispozitavet në fjalë, domethënë simbas ligjës, ku ndodhen ato, dhe me qënë se ato dispozita janë të urdhërit publik, nuku është e mundur që të çfuqizohen prej interesit të palëvet.

Neni 8 i dispozitavet preliminare disponon se, kur kontraktuësat e huaj kanë po një shtetësi, obligimi regullohet simbas ligjës të Shtetit tyre. Kur ligja në këtë rast bën fjalë për kontraktuës që të dy të huaj përmbleth në këtë eksprimim edhe shtetasit shqiptarë; Pra, kur dy shtetas shqiptarë kontraktojnë në një Shtet të huaj, efektet e obligimit do të regjohen simbas ligjës shqiptare.

Obligimet e rjedhura prej veprimevet të pa-ligjëshme, regjohen simbas ligjavet të vëndit, ku u bë vepra.

§ 25. — Ligjat q' i Përkasin Formës Aktevet.

Forma e përjashtme e aktevet regjohet simbas parimit *"locus regit actum,"* në të cilën ligjëvuësi ka bazuar nenin 8§1 të dispozitave mbi interpretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësis't, ku thuhet: *"Format e përjashtme të aktevet midis të gjallëvet dhe t' atyne të vulnetit të mbramë caktohen simbas ligjës të vëndit, ku bëhen. Por, disponuësit ose kontraktuësit kanë tagrin me ndjek format e ligjës të Shtetit të tyre, kur ajo ligjë është e bashkëtë për të gjitha palët."*

Parimi *"locus regit actum"* mund t' aplikohet edhe mbi aktet, për të cilat ligja e Shtetit të kontraktuësavet lyp një forme solene? Përgjegja është afirmative. Për shëmbëll: simbas nënit 1489 të Kodit Civil çdo dhurim duhet të bëhet me akt-publik, për ndryshe është nul. Po të sypozohet se

një shqiptar i ndodhur në një Shtet të huaj, ligjat e të cilit i konsideroinë si të vjefshme dhe dhurimet e bëra me shkresa private, akti është i vjefshme dhe për pasurin' e dhuruësit të ndodhur në Shqipëri. Massi ligja konsideron si të vjefshme — për sa i përket pasurisë të ndodhur në Shqipëri — testamentat të bëra jashtë Shtetit dhe simbas formës të caktuar prej ligjës lokale, qoftë e ndryshme kjo nga ligja shqiptare, nuku eksiston as nonjë arësye që parimi i pranuar për testamentat mos të ketë aplikim për aktet e tjera.

Forma e aktevet, me të cilat transferohet zotnimi mbi sende të pa-lujtëshme ose mbi të drejta të tjera të pa-lujtëshme nga një persone në një tjetër, regjohet simbas ligjës të vëndit, ku ndodhet pasuria e pa-lujtëshme. Pra, dhurimi i sendevet të pa-lujtëshme, kushtitnimi i ipotekës, detyrimi për të bërë transkriptimin regjohen simbas ligjës të vëndit ku ndodhen pronjat, të cilavet u referohet akti.

Format e aktevet që regullohen simbas ligjës të huaj janë vetëm format e jashtme, domethënë ato, që me as një mënyrë nuku u referohen as substancës të aktit, as zotësisë të disponuësit ose të kontraktuësavet.

Sa do që format e jashtme të aktevet regullohen simbas ligjës të vëndit ku bëhen ato, por efektet e atyre aktevet — dhe posaçërisht kur i përkasin gjendjes të personës — regullohen simbas ligjës kombëtare të atij, për të cilin bëhet akti. Për shëmbëll: akti i lindjes do të bëhet në formën e urdhëruar prej ligjës të vëndit, ku u bë lindja; Por, efektet ose konsekancat e këtij akti do të regjohen simbas statutit personal të prindit.

Neni 8 i dispozitavet në fjalë përmban një përjashtim të parimit "*locus regit actum*", massi u njeh palëvet tagrin të ndjekin formën e urdhëruar prej ligjës së tyre kombëtare, mjafton që ajo shtetësi të jetë e njëjtë për gjithë palët. Pra, në qoftë se të huajit kanë shtetësi të ndryshme, nuku mundet t' a bëjnë aktin në formën e caktuar prej ligjës kombëtare të njërit prej tyre; Duhet të konformohen simbas li-

gjës të vëndit. Ligja i ka lënë palët të lira të regullojnë simbas dëshirës së tyre efektet e konvencionevet dhe marëdhëniet q' u rjedhin prej tyrevet, por nuku mundin t' a regullojnë simbas pëlqimit të tyre formën e aktevet, massi për këtë janë të detyruar të respektojnë ligjën.

§ 26. — Ligjat Regulluëse të Provës të Aktevet.

"*Mjetet provuëse të obligimevet*" — thotë neni 9 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht — "*caktohen mbas ligjës të vëndit ku âsht bâ veprimi.*" Ndonse forma e aktit dhe provimi i tij janë dy gjëra me kuptime të ndryshme, me gjith' këtë forma e caktuar për disa akte, shërben për provimin t' atyre q' u kontraktuan; Dhe, me qënë se forma e aktevet regjoh t — sikundër u tha më sipër — prej ligjës të vëndit ku bëhen, rezulton se dhe mjetet provuëse duhet të regjohen po simbas asaj ligje. Përveç kësaj palët kujdesen të konstatojnë aktet me prova në vëndin, ku i lidhin ato; Drejtohen në persona kompetente për të kërkuar informata dhe këto persona kanë gjith' monë para-sysh ligjën e vëndit tyre. Është, pra, e drejtë dhe e arësyëshme që mjetet provuëse të regjohen prej ligjës të vëndit, ku u bë akti.

Në rastin që kontraktuësat në Shtet të huaj kanë që të gjithë një shtetësi dhe, për sa i përket formës të aktit, kanë preferuar atë të caktur prej ligjës së tyre kombëtare, provimi gjith' monë do të regjohet simbas ligjës të vëndit, ku u formua akti, massi ligjëvuësi nuku ka vënë as një përjashtim në nenin 9 të dispozitavet në fjalë.

Kompetenca dhe format proceduriale regullohen mbas ligjës të vëndit, ku bëhet gjykimi, massi do të pushonte sovraniteti i Shtetit, në rastin që një ligjë e huaj do të regullonte jurisdiksionet dhe do të caktonte mënyrat e procedimit.

Mënyrat e ekzekutimit t' aktevet dhe të vendimevet regullohen simbas ligjës të vëndit, ku bëhet ekzekutimi.

Vendimet e autoritetëvet të huaja në çështje civile ek-

zekutohen në Shqipëri, kur deklarohen të ekzekutueshme, simbas formavet të caktuara në procedurën civile, përveç kur eksistojnë dispozita të ndryshme në traktate nërkombëtare. Në vendimet e autoritetëvet gjyqësore të huaja për çështje civile, përmblidhen edhe vendimet për çështje tregëtare.

KAPTINA B.

§ 27. — Kufitë Kohësore të Ligjës.

Ligjëvuësi shqiptar, tue ndjekur shëmbëllën e gjithë legjislasjonevet të rea, ka pranuar parimin, simbas të cilit ligjat nuku kanë fuqi mrapavepruëse, por zbatohen mbi marëdhâniet juridike që krijohen pas shpalljes së tyre. Kështu, pra, në nenin e parë të dispozitavet mbi intepretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht dispozon: "*Ligja urdhëron vetëm për kohën e ardhëshme. Nuku ka fuqi mrapavepruëse*".

Parimi i mos prapaveprimit të ligjavet bazohet në llogjikën dhe në mprojtjen e interesavet të partikollarëvet; As një sigurim nuku do të eksistonte për të drejtat, pasurinë, gjendjen personale, aktet juridike dhe efektet e kontratavet të privatëvet, në rastin që do të ishte e mundur që këto të ndryshoheshin dhe të suprimoheshin nga ndryshimi i vulnetit të ligjëvuësit. Interesi i përgjithëshme — i përbërë prej interesave të veçanta të partikollarëvet — lyp që, gjith' ato veprime juridike të bëra regullisht nënë fuqinë të një ligjë, të jenë të vlefshme dhe të qëndruëshme dhe në rast ndryshimi të legjislasjonit.

Por, në qoftë se parimi i nenit 1 të dispozitavet në fjalë duhet t' i shërbejë ligjëvuësit si udhëheqës në veprimet e tij, nuku e ndalon as pak këtë që të largohet nga ay parim, i cili është vënë për ata që janë të detyruar t' a observojnë dhe t' a bëjnë të observohet, por jo për ligjëvuësin, për të cilin nuku janë vënë dhe ligjat e tjera. Pra, kur

nevojat shoqnore lypin që ligja e ré të influencojë dhe veprimet dhe marëdhâniet e mâ-parëshme, ligjëvuësi jo vetëm mund, por dhe detyrohet t' a bëjë këtë. Për veç kësaj ligja e re ka fuqi të njëjtë me atë të nenit 1 të dispozitavet të naltpërmëndura dhe kështu kontra dispozitës atij neni mundet t' i japë vetë-vehtes, shprehimisht ose heshtësisht, fuqi prapavepruëse.

Kur faktet juridike zhvillohen dhe përfundohen për nj' heresh, ato natyrisht regjohen simbas ligjës në fuqi në kohën, kur ato u bënë, kështu që nuku ka vënt çështja e prapaveprimit ose mos prapaveprimit të ligjës. Çështja e prapaveprimit të ligjës lind n' ato raste, në të cilat faktet juridike të bëra në kohën kur ishte në fuqi ligja e vjetër, zhvillohen edhe përfundohen kur është në fuqi ligja e re; Pra, simbas cilës ligjë do të regjohen këto fakte, simbas ligjës të vjetër, apo simbas asaj të ré? Për shëmbëll: Është bërë një testament, i cili eksiston édhe, tue qënë gjallë testatori, kur hyn në fuqi një ligjë e ré, e cila regullon zotësinë me testue dhe disa dispozita substanciale me një mënyrë të ndryshme nga ajo e vjetra. Pra, ligja e re as no një efekt nuku do të ketë mbi këtë testament? Naturisht, si në këtë rast dhe n' ato q' i përngjasin, ligja e ré ka një influencë mbi faktin juridik, ndonse të bërë në kohën e ligjës së vjetër. Nga ky shëmbëll del konsekanca se, parimi i mosprapaveprimit të ligjës, nuku duhet të kupëtohet në mënyrë që të përjashtohet çdo influencë e ligjës së ré në zhvillimin të faktevet juridike, të lindura në kohën që ishte në fuqi ligja m'e përparëshme.

Pika, në të cilën qëndron influenca prapavepruëse e ligjës, është respektimi i së *drejtavet të fituara.* Pra, në rastet, në të cilat aplikimi i ligjës së ré cënon të *drejta të fituara,* akti juridik do të regjohet vetëm simbas ligjës në-në fuqin' e të cilës u bé.

Por, kur mundet të quhet një e drejtë e fituar? Kjo është një nga çështjet mâ të ngatëruara dhe mâ të vështira të skencës juridike dhe kësaj pyetje nuku i kanë dhënë

përgjigje definitive as doktrina, as jurisprudenca.

Kemi thënë më sipër se brenda në një të drejtë mundet të përmblidhen shumë pushtete; Për shëmbëll: jam zot i një pronje, në të cilën mund të mbjell pemë, të ndërtonj, t' a rëmonj dhe, me një fjalë, t' a përdor dhe t' a çfrutizonj. Këto pushtete më akordohen prej ligjës së vjetër, nënë fuqin' e së cilës u bëra zot. Një ligjë e ré vihet në zbatim, e cila pushtetin me ndërtue, me mbjell pemë e subordonon nga respektimi i disa konditavet. Në këtë rast nuku mundet të pretandonj se, massi ligja e vjetër m' i njinte ato pushtete, ligja e ré nuku mundet të prapaveprojë dhe të m' i cënojë. Por, në rastin që brenda kohës, në të cilën ishte në fuqi ligja e vjetër, e kam ushtruar pushtetin dhe kam ndërtuar ose mbjellë pemë në pronjën, jam bërë zot i godinës së ndërtuar, i pemëvet të mbjella, kështu që *kam fituar një të drejtë,* të cilën ligja e ré nuku mundet të m' a cënojë dhe të më detyrojë të konformohem me konditat e vënë prej saj. — Tjetër shëmbëll: Ligja më akordon zotësinë për përmbushjen e disa aktevet të jetës sivile dhe politike; Më pas një ligjë e ré i limiton ose i ngreh disa nga ato zotësira. Dhe në këtë rast gjith' ashtu nuku është e mundur të invokohet ligja e vjetër për përmbushjen — tue qënë në fuqi ligja e ré — të një akti, për të cilin ligja e vjetër m' a njinte zotësinë, massi *zotësia* nuku është një e drejtë, por një *pushtet* vetëm i njohur prej ligjës. Por, në rastin që akti u përmbush në kohën, kur ishte në fuqi ligja e vjetër, at' here ndodhemi përpara një fakti të përmbushur ligjorisht, i cili është mburim të drejtash që nuku mundet t' i cënojë ligja e rè.

Shumë më të dobëta se pushtetet janë *shpresat,* të cilat nuku mundet të krahasohen as pak me të drejtat. Shëmbëll: Jini trashëgimtar' i prezumuem i A dhe, në rastin që ky vdes pa testament, do të thëriteni si trashëgimtar legjitim i tij. Por A vdes kur ndodhet në fuqi një ligjë e

ré, e cila e ndryshon radhën në mënyrë që nuku thëriteni mâ në trashëgim. Naturisht nuku mundet të invokoni faktin se simbas ligjës të vjetër ishit trashëgimtar i **A**, massi me që ky vdiq, kur zbatohej ligja e ré *nuku fituat as nonjë të drejtë*, por kishit vetëm një shpresë të bëheshit trashëgimtar' i tij. Pra, ligja e ré nuku u cënon as no një të drejtë. Por, në rastin që shpresa të realizohej tue vdekur **A** në kohën q' ishte në fuqi ligja e vjetër, at' here do të ndodheshim përpara një të drejte, të cilën ligja e ré nuku do mundte t' a cënonte.

Nga sa u thanë më sipër rezulton se duhet të çquhen nga të *drejtat* ato, që nuku janë veçse *pushtete* ose *shpresa*. Pra, *për efektet e mos prapaveprimit të ligjës, vetëm at' here quhet e drejta e fitueme, kur eksiston një fakt, i cili sjell të drejta simbas ligjës së kohës, në të cilën ay fakt u përmbush.* Në qoftë së prej faktit ligjorisht të plotësuar lind një e drejtë në favor të persones, ajo e drejtë hyri në pasurinë të saj dhe ligja e ré nuku mund t' a privonjë prej të drejtës në fjalë.

Parimi i mos prapaveprimit të ligjës nuku është vënë për ligjëvuësin, por për gjyqtarin. Pra, në qoftë se ligjëvuësi e do, ligja mundet të ketë fuqi prapavepruëse.

Nuku i shtrohen parimit të nenit parë të dispozitavet mbi interpretimin edhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, domethënë kanë fuqi prapavepruëse, ligjat q' i përkasin urdhrit publik, si për shëmbëll ligja themelore e Shtetit, ligjat politike, ligjat relative me organizimin e pushtetevet botënore, ligjat proceduriale dhe ato të kompetencës. Arësyeja për të cilën këto ligja prapaveprojnë është se, në landën të cilën regullojnë, privatët nuku mundet të invokojë të drejta të fituara, por vetëm pushtetë dhe naturisht mbi interesat private, predominon interesi i përgjithëshme. Por, kur eksistojnë *të drejta të fituara*, ligja, qoftë e inspiruar prej arësyesh urdhëri publik qoftë dhe prej atyre q' i përkasin akoma dhe formimit të shoqërisë ose dhe prej konsiderasionesh moraliteti publik, duhet t' i respektojë ato të drejta,

Parimi i mos prapaveprimit të ligjavet është shprehimisht i konsakruar dhe me dispozitë statutore, e cila përjashton vetëm ligjat që lehtësojnë ndëshkimet penale; Ky përjashtim, i cili rezulton dhe prej nenit 2 të Kodit Penal, bazohet në arësye drejtësie dhe njerëzimi, massi kur një ndëshkim konsiderohet shumë i rëndë dhe pa no një dobi, nuku eksiston as një arësye për aplikimin e tij.

E drejta e ligjëvuësit që t' u japë ligjavet fuqi prapavepruëse limitohet prej dispozitavet statutore, me të cilat garantohen të drejtat e shtetasvet, si për shëmbëll janë ato të nenit 198 të Statutit. Pra, të drejtat të garantuara prej Statutit, ligjëvuësi me as një mënyrë nuku mundet t' i ndryshojë as për të arthmen, as për të kaluemen.

Regulli i mos paraveprim't të ligjavet nuku aplikohet mbi ligjat *interpretative*, ato domethënë që kanë për qëllim të shpjegojnë dhe të fiksojnë kuptimin të herët ose të kontestuar të një ligje të mâ parëshme. Ligja mundet të kalifikohet prej ligjëvuësit prapavepruëse me dispozitë të shprehun, kur ligja i jep vetë vehtes shprehimisht fuqi prapavepëruëse ose dhe me dispozitë, nga përmbajtja e së cilës del qarisht vulneti i ligjëvuësit për t' i dhënë ligjës fuqi prapavepruëse, si për shëmbëll kur për arësye politike ose sociale ose ekonomike ose morale u imponua një modernizim q' i përket urdhërit botënor, fjala bije abrogim' i sklavërisë. Kur ligja nuku përmban dispozitë të shprehun për prapavepërim, at' here ndodhemi përpara një çështjeje fakti, e cila do të zgjidhet me mjetet e interpretimit. Gjith' ashtu ka fuqi prapavepruëse ligja, e cila ndryshon kanune të drejte, mbi të cilat bazohen të drejta të përherëshme. si zotërimi, servitudet reale; në këtë rast duhet t' i jepet ligjës së ré fuqi retroaktive që mos të vazhdojë indefinitivisht një gjendje e konsideruar prej ligjës së ré e dëmshme. Ligja interpretative — e vënë në zbatim në kohën që një padie është e ngrehur — duhet të aplikohet prej giyqtarit, në qoftë se nuku është dhënë vendimi definitif; Por, vendimet e më-parëshme janë të drejta të fituara, ashtu sikundër janë

dhënë.

Me ligjat interpretative barasohen ligjat *rektifikative*, të cilat kanë për qëllim reparimin e gabimevet të ngjara në një ligjë të mâ parëshme.

Gjith' ashtu kanë fuqi prapavepruëse ligjat relative me organizimin e pushtetevet publike, konstitusionale ose dhe vetëm organike qofshin ato, si edhe ligjat që regullojnë gëzimin e të drejtavet politike dhe ato që caktojnë pazotësinë të rjedhur prej ndëshkimevet simbas ligjës zgjedhjevet.

Ligjat relative me organizimin e gjykatavet dhe me kompetencën janë, pa kur fare dyshimi, prapavepruëse, kur *jurisdiksioni kompentent* u suprimua krejt, tue u zëvëndësuar prej një tjetri. Në rastet e tjera, simbas mentimit që prodominon në juriprudencë dhe në shumicën e autorëvet, ligjat relative me organizimin e gjykatavet dhe me kompetencën kanë fuqi prapavepruëse dhe regjojnë dhe faktet të mâ-parëshme se promulgimi i tyre, qoftë dhe kur padia është ngrehur. Kur ligja ndryshon kompetencën e gjykatavet, zbatohet dhe mbi çështjet, për të cilat nuku është dhënë nonjë vendim definitif, massi ndërgjyqësit nuku mundet të thuhet se kanë të drejtë të fituar para se të jepet vendimi definitif; kur bëhet fjalë për vendime definitive, duhet të kupëtohen jo vetëm vendimet e preme, por edhe ato q' i shtrohen një ruge kanunore. Por, kur çështja është regulluar me një vendim definitif ose me anë ujdie, renoncimi, vendimi gjyqësor, pohimi, ligja e ré nuku prapavepron.

Statuti themeltar i Mbretnis Shqiptare me nenin 218 dispozon se "ligjet nuku mund të kenë fuqi prapavepruëse", pra ligjëvuësi dhe ca më tepër gjykatat nuku kanë të drejtë t' u japin fuqi prapavepëruëse ligjavet të promulguara pas shpalljes të Statutit të naltpërmëndur.

§ 28. — Gjindja dhe Zotësia e Personavet.

Përgjithësisht është pranuar parimi, simbas të cilit ligjat që regullojnë gjindjen dhe zotësinë të personavet aplikohen retroaktivisht dhe zbatohen për nj' heresh mbi gjith'

ata që ndodhen nënë konditat e paravështruara prej ligjës së ré. Por, ky regull bën konfuzion midis gjindjes të personës (status personale) në kuptimin e ngushtë të fjalës dhe pushtetevet që rjedhin prej kësaj gjindjeje, të cilat kushtituojnë *zotësin' e personavet*, kështu që nuku mundet të aplikohet absolutisht.

Gjendja e personavet është e pa ndryshueshme dhe kushtituon një të drejtë të fitueme me t' u realizuar cilësitë kushtitutive të lypuna prej legjislasjonit në fuqi; Ligja e ré regulluëse e gjendjes personavet nuku mundet t' i privonjë nga kjo gjendje, të cilën gjykatat e ngarkuara me zbatimin e ligjës së ré janë të detyruara t' a respektojnë si të pa revokuarshme.

Relativisht me zotësin' e personavet, solusjonet janë krejt të ndryshme. Kur themi *zotësi,* duhet të kupëtojmë disa pushtete q' i përmetojnë njeriut të bëjë këto ose a'o akte të caktuara, kështu që një ligjë e ré mundet t' i ndryshojë ose dhe t' i anullojë këto pushtete, të cilat deri sa nuku janë ushtruar nuku formojnë ato vetë të drejta të fituara. Por, kur ushtrimi i këtyre pushtetevet është manifestuar me akte të plotësuara nënë fuqin' e ligjës së vjetër, këto akte mbeten të vlefshme, qoftë dhe pas hyrjes në fuqi të ligjës së ré, e cila i ngreh autorit t' atyre aktevet zotësinë që gëzonte më parë.

Shtetësia shqiptare e fituar simbas ligjës së vjetër nuku mundet të ngrihet prej ligjës së ré, e cila ndryshon konditat e lypuna për fitimin e shtetësisë. Por ligja e ré që ndryshon konditat e lypuna për fitimin e shtetësisë shqiptare aplikohen mbi të huajt që janë tue plotësuar formalitet' e lypuna prej ligjës së mâ-parëshme para se t' i kenë mbaruar ato.

Regullat e Kodit Civil relative me absentët janë të aplikuëshme edhe mbi absencat e mâ-parëshme, efektet e të cilavet nuku janë ndjekur veç se mas promulgimit të këtij kodi.

Gjendja e bashkëşhortëvet si të tillë që rezulton prej

martesës, nuku mundet të cënohet prej ligjës së re. Pra, një martesë e vlefshme ose e pa vlefshme simbas legjislasjonit, nënë fuqin' e të cilit u celebrua, mbetet e vlefshme ose është nul me gjithë ndryshimin e bërë në legjislasion. Martesat e celebruara vleftësisht vazhdojnë të eksistojnë dhe të sjellin gjithë efektet e tyre qoftë dhe kur vihet në zbatim një ligjë e ré që cakton ndalime, të cilat po të eksistonin më parë do t' a bënin martesën të pa-vlefshme.

Provimi i martesës duhet të bëhet simbas ligjës, nënë fuqin' e të cilës u celebrua ajo.

Zotësia personale e bashkëshortëvet, posaçërisht ajo e gruas, caktohet prej ligjës së ré, massi kjo zotësi është një pushtet që rjeth nga martesa. Por, autorizimi i burit për ushtrimin prej gruas së martuar të një profesjoni ose të një industrie i lypur simbas dispozitavet të nenit 191 të Kodit Civil është i nevojëshmë dhe për martesat e kontraktuara para këtij kodi.

Kur ligja e ré krijon padie prej fejesës për dëmshpërblime, ligja e ré zbatohet edhe për fejesat e bëra para hyrjes në fuqi të saj, por të zgjidhura më pas.

Dispozitat e ligjës së ré relative me çkurorëzimin aplikohen dhe mbi martesat q' eksistojnë édhe, qoftë dhe kur kërkohet çkurorëzimi për shkake të ngjara më parë se të vihet në fuqi ligja e ré. Këto solusjone duhet të jepen dhe për dispozitat relative me veçimin personal.

Gjendja që rezulton prej bijësisë legjitime, adoptive ose naturale u jep si prindërvet ashtu edhe fëmijës të drejta të pa revokuarshme, në kuptimin se një ligjë e ré nuku munt të modifikojë gjendjen e këtyre personavet të fituar në kohën q' ishte në fuqi ligja e vjetër. Nga ky regull rezulton se atësia dhe bijësia të rjedhura prej një martese të bërë nënë fuqin' e ligjës së vjetër regjohen simbas kësaj ligje dhe jo simbas ligjës së ré. Por, privilegjet, pushtetet ose avantazhet që janë të bashkuara me gjendjen që rezulton prej bijësisë legjitime, adoptive ose naturale — massi këto nuku janë të drejta të fituara — regjohen simbas li-

gjës së ré. Kështu, pra, ligja e ré mundet të modifikojë midis atit dhe fëmijës të drejtat dhe detyrat e mâ-parëshme, kaqe për sa u përket personavet sa edhe për sa i përket pasurisë.

Gjendja civile e fëmijës të zënë në kohën e ligjës vjetër, por të lindur në kohën q' është në fuqi ligja e ré, regjohet si mbas kësaj ligjës të ré. Provimi i bijësisë dhe mënyrat e provimit të saj, parimisht, regjohen simbas ligjës të vjetër.

Për sa i përket adoptimit, ligja e ré nuku munt të ngrehë kalitetet e atit dhe të fëmijës adoptive të fituara, massi këto rjedhin prej një kontratoje të thjeshtë. Pra, konditat e përshkruara për vleftësinë e adoptimit prej ligjës së ré nuku mundet të aplikohen në adoptimet e mâ parëshme se ligja e ré. Por, ligjëvuësi mundet kurdoherë të regullojë simbas dëshirës së tij dhe të modifikojë të drejtat që rezultojnë prej adoptimit.

Institusioni i pushtetit atënor, i vënë me qëllim dobie sociale dhe jo për interesin e prindërvet, nuku krijon të drejta të fituara, kështu që regjohet simbas ligjës së rè.

Pra, ligja e ré, e cila ndryshon të drejtat e rjedhura prej pushtetit atënor, kaqe për sa u përket raporevet me personën e fëmijës, sa edhe raporevet me pasurin' e tij, do të aplikohej për nj' herjesh mbi gjith' ata që janë të veshur me atë pushtet.

Gjith' ashtu ligja, e cila shpejton ose vonon moshën, në të cilën mbaron pushteti atënor, aplikohet me nj' herë mbi gjith' ata, të cilët simbas ligjës të mâ-parëshme duhej të mbeteshin mâ shumë ose mâ pak nënë atë pushtet.

Gjith' po ky solusion aplikohet, domethënë do të aplikohet ligja e ré dhe në rastin që një ligjë suprimon pushtetin atënor dyke krijuar disa shkake të rea pa-denjësie. Ligja e ré, e cila heq fëmijën nga pushteti atënor, shkakëton pushimin për nj' herjesh të uzufruktit legal të atit dhe të mëmës.

Ligjat relative me *madhorinë,* me *miturinë,* me *zotësitë* ose *pa-zotësitë* që rezultojnë prej këtyre, aplikohen dhe mbi situatat e mâ-parëshme se promulgimi i tyre, por me rezervën gjith' monë që aktet e bëra i shtrohen ligjës së vjetër dhe konsiderohen të vlefshme, tue sjellë efektet e tyre juridike. Pra, në qoftë se ligja e ré pakëson kohën e lypur për madhori, gjith' ata që patnë të përmbushur moshën e duhur simbas ligjës së ré, në kohën kur kjo hyn në fuqi, bëhen madhorë; Dhe gjith' ata që ishin madhorë simbas ligjës së vjetër, por nuku kanë mbushur moshën e lypur prej ligjës së ré bëhen të mitur me të hyrë në fuqi kjo ligjë, por gjith' aktet e bëra prej ish-madhorit mbeten plotësisht të vjefshme.

Parashkrimi i padievet relative me tytorinë që ka i mituni kontra tytorit regjohet simbas ligjës së ré, kur madhoria u mbush në kohën q' është në fuqi ligja e ré, pa u marë para sysh as pak fakti se gjerimi u bë në kohën, kur ishte në fuqi ligja e vjetër; Kjo ngjet posaçërisht me parashkrimin e padies për dhënien e llogarisë të tytorisë.

Dispozitat e ligjës së ré relative me *ndalimin* edhe *paaftësimin* aplikohen edhe mbi personat, zotësi' e të cilavet ka pas qënë e regulluar prej ligjës së mâ-parëshme.

§ 29. — Të Drejtat Reale.

Natura e sendevet regullohet, parimisht, simbas ligjës të tanishme; Por, Marëdhâniet kontraktuale të lindura para promulgimit të saj dhe për eksekutimin e të cilavet palët nuku mundeshin për veç se të referoheshin në ligjat, të cilat ishin në fuqi në kohën e kontraktimit, regjohen simbas ligjavet t' asaj kohe.

Eksersimi, mënyra e përdorjes ose e konservimit të një të drejte regjohen prej ligjës të tanishme, massi nuku damtohet no një e drejtë e fitueme; Por, aktet e përmbushura ligjorisht që më parë regjohen simbas ligjës të kohës kur u përmbushnë.

Gjith' ashtu simbas ligjës aktuale regullohen dhe të

drejtat aksesore të së drejtavet reale, si padiet dhe servitudet legale; Për shëmbëll: kur ligja e ré përkufizon zotënimin tue imponuar një servitude ose çduk një servitudë q'ekzistonte që më parë.

Mënyra e fitimit ose e humbjes të zotënimit dhe të së drejtës reale regjohet simbas ligjës të kohës, kur u bë akti. Parimi i mos prapaveprimit të ligjavet aplikohet me një mënyrë të përgjithëshme në pronësi, e cila është garantuar dhe me dispozitat e nenit 198 të Statutit.

Efektet e së drejtës uzufruktit si dhe koha e vazhdimit të tij regullohen, jo simbas ligjës që është në fuqi në kohën kur çelet uzufrukti, por simbas ligjës q' ishte në fuqi në kohën e konstituimit të uzufruktit.

Servitudet e imponueme prej ligjës, të cilat janë pushtete të akorduara prej saj, disponohen prej ligjëvuësit, i cili i krijon, i modifikon ose i suprimon simbas dëshirës tij; Pra, në rast konflikti mbi këtë do të meret para sysh ligja në fuqi në kohën e konfliktit. Kur mbi një servitudë legale eksiston një konvencion partikolar ose shënja të jashtme që tregojnë një konvencion të heshtur, a' here konflikti duhet të zgjidhet simbas ligjës të kohës, kur është bërë konvencioni ose simbas ligjës, në kohën e së cilës janë bërë shënjat e jashtme. Në servitudet legale nuku mundet të ketë fuqi prapavepruëse ligja e ré, kur ndodhet përpara faktevet të përmbushura ligjorisht nënë fuqin' e ligjës së vjetër, massi kur një pushtet ushtrohet, transformohet në të drejtë të fituarë.

Servitudet konvencionale regullohen simbas ligjës, e cila ishte në fuqi në kohën kur u bë kontrata.

§ 30 — Trashëgimet dhe Dhurimet.

Trashëgimi ab intestato. Ligja, nënë fuqin' e të cilës u çel trashëgimi, cakton cilat janë personat që kanë zotësinë dhe thëriten të mbledhin trashëgimin ab intestato. Gjithë po ajo ligjë regjon zotësinë me trashëgue dhe mënyrën e pjesëtimit të trashëgimit. Pra, kërkimet respektive të ndërgjy-

qësvet regullohen simbas ligjës që ishte në fuqi në kohën e vdekjes të *de cujus*-it dhe jo simbas ligjës që ishte në fuqi në kohën, kur u ngreh padia relative me pronësinë e këtij trashëgimi.

Deri në çeljen e trashëgimit, trashëgimtarët e prezumuem kanë, jo të drejtë të fituar, por vetëm një shpresë, të cilën ligjëvuësi mundet t' a ndryshojë në çdo kohë.

Trashëgimtari nuku mund të privohet nga të drejtat e tij trashëgimore prej një ligje më të ré se vdekja e *de cujus*-it; Pra, trashëgimi i çelur para hyrjes në fuqi të Kodit Civil dhe i mbetur vakant deri në promulgimin e tij do të regjohet simbas ligjës të kohës të vdekjes.

Forma e pranimit ose e renoncimit të një trashëgimi, ajo e likujdimit dhe e pjesëtimit regjohet simbas ligjës që është në fuqi, kur bëhen këto akte, qoftë dhe kur kjo ligjë është promulguar më pas se çelja e trashëgimit.

Trashëgimi testamentar. Zotësia e testatorit për me disponue duhet të eksistojë kaqe simbas ligjës në fuqi në kohën e redaktimit të testamentit, sa edhe simbas ligjës që është në fuqi në kohën e vdekjes së tij. Kështu ligja e ré që deklaron të zotin të testojë një njeri, i cili kishte redaktuar më parë një testament, ndonse ishte i pa zoti, nuku vleftëson testamentin e tij. Ligja që i jep prapë testatorit zotësinë që kishte në kohën e redaktimlt të testamentit dhe të cilën një ligjë ndërmjetësuëse i kishte hequr, i jep testamentit në fjalë fuqin' e tij të mâ parëshme.

Zotësia me marë prej trashëgimi testamentar regjohet simbas ligjës në fuqi në kohën, kur çelet trashëgimi, kështu që ay që ishte i zoti me marë simbas ligjës të mâ-parëshme nënë të cilën ngjavi vdekja e *de cujus*-it nuku munt të privohet nga trashëgimi dhe në rastin që ligja e ré e deklaron të pazotin me qënë trashëgimtar.

Forma e testamentit regjohet simbas ligjës në fuqi në kohën, kur ky u redaktua. Kështu testamenti i redaktuar simbas gjithë formavet të lypuna prej ligjës q' ishte në fuqi në kohën e redaktimit tij, mbetet i vlefshmë dhe i fuqi-

shmë dhe pas hyrjes në fuqi të një ligje të ré, e cila lyp formalitete më të shumëta, qoftë dhe kur testatori vdiq pasi u vu në zbatim ligja e re; Për kundrazi një testament i pa fuqishmë, nga mungesa e një forme të lypur prej ligjës të kohës redaktimit, mbetet prapë i pa fuqishmë dhe në ligjën e re, e cila lyp vetëm formalitetet që ka testamenti në fjalë. Për të shpëtuar nga formalitetet e lypuna prej ligjës së ré, testamenti duhet të këtë një datë të saktë para promulgimit të kësaj ligje.

Interpretimi i vulnetit të testatorit duhet të bëhet tue u marë parasysh ligja e kohës, në të cilën u bë testamenti. Kështu, për të caktuar karakterin e lujtëshmë ose të pa lujtëshmë të sendevet të lëna trashëgim, duhet të meret para sysh ligja e kohës, kur u redaktua testamenti. Për shëmbëll: një njeri me një testament i ka lënë trashëgim të shoqes uzufruktin e pronjavet të tij dhe zotërimin e mobilavet; Para vdekjes të testatorit, një ligjë e ré ka kalifikuarë të lujtëshme sende që më parë ishin cilësuar të pa lujtëshme. Në këtë rast do të aplikohet ligja e vjetër, në kohën e të cilës u redaktua testamenti.

Zotësia e dhuruësit dhe e donatarit do të regjohet simbas ligjës, e cila ishte në fuqi në kohën kur dhurimi u bë i plotë. Pra, një ligjë, e cila ndryshon regullat mbi zotësinë e dhuruësit ose të donatarit, do të zbatohet në dhurimet që nuku janë bërë edhe të plota në kohën, kur kjo ligjë hyn në fuqi; Por, ligja e ré nuku ka fuqi prapavepëruëse, domethënë nuku mund të zbatohet mbi ato dhurime, të cilat janë të plota n' atë kohë, kur ligja e ré hyn në fuqi.

Dhurimet q' u janë bërë të pas-lindurvet — disponon neni 36 i ligjës mbi aplikimin e Kodit Civil — para hymjes në fuqi të Kodit të ri i shtrohen konferimit simbas regullavet të caktueme në këtë kod. Sa për dhurimet e tjera të bëra para se të hyjë në fuqi Kodi i ri, ato regullohen simbas ligjavet të mâ-parëshme, domethënë në këtë rast Kodi Civil nuku ka fuqi prapavepruëse.

§ 31. — Kontratat

Kontrata, prej së cilës rjedhin për nj' heresh të drejta ose detyra në marëdhëniet midis palëvet kontraktuëse, që të eksistojë vleftësisht duhet të respektojë ligjat në fuqi në kohën, kur hiri i palëvet koincidon. Pra, vleftësia e konvencionevet regullohet ekskluzivisht simbas ligjës në fuqi në kohën, kur u kontraktuan ato, çfarëdo qoftë dispozita e kundërtë e ligjës së ré *(tempus regit actum)*. Kështu kontrata, e *vlefshme* massi u observuan konditat thelbësore ose *nul* massi i mungojnë ato kondita, nuku mundet as të anullohet as të vleftësohet prej një ligjës të ré, e cila disponon se lypen kondita të rea ose deklaron të tepërta konditat e caktuara që më parë.

Zotësia e palëvet regjohet simbas ligjës, e cila eksistonte në kohën e lidhjes të konvecionit.

Efektet edhe konsekancat juridike që rjedhin prej kontratavet, regullohen simbas ligjës, e cila ishte në fuqi në kohën, kur kontrata u përmbarua; Massi në këtë kohë caktohen ose lindin të drejtat dhe detyrat e kontraktantëvet është një nevojë llogjike që, gjith' ato që rjedhin prej kontratos, të regullohen prej ligiës në fuqi, kur kontrata mori ekzistencën e saj. Çdo e drejtë e tanishme ose dhe vetëm eventuale, e cila lind prej një kontratoje, nuku mundet të cënohet në efektet e saj prej ligjavet më të rea. Kështu, të drejtat e lindura prej kontratavet konsiderohen si të fituara jo vetëm kur ato të drejta janë të çelura, por akoma dhe kur janë dhe vetëm *eventuale*, domethënë janë të subordonuara ose të varura nga kondita ose nga fakte të pa-plotësuara édhe. Këto solusjone jepen dhe në rastin që kontrata është e heshtun, dhe kur efektet kontraktuale rjedhin prej stipullimevet shprehimisht të bëra prej palëvet ose prej dispozitavet ligjore të vëna prej ligjëvuësit me qëllim plotësimi të vulnetit të palëvet, kur ato heshtin.

Kontratat duhet të interpretohen dhe të regullohen tue u marë parasysh ligja, e cila ishte në fuqi, në kohën q' ato kontrata u formuan.

Forma e jashtme e aktevet juridike, pranueshmënia dhe fuqia e mjetevet provuëse regjohen simbas ligjës në fuqi në kohën, kur ato akte u kontraktuan. Pra, një konvencion i fuqishmë në kohën, kur u kontraktua, mbetet prapë i tillë dhe në rastin që një ligjë e re të lypë formalitete më të shumëta ose të ndryshme nga ato të përshkruara prej ligjës së më-parëshme; Për kundrazi konvecioni është nul për shkak mos respektimi të formës të lypun prej ligjës, nënë fuqin' e të cilës u kontraktua, dhe në rastin që mban formën e lypur prej ligjës së ré.

Format që duhen ndjekur për provimin e kontratës do të regullohen simbas ligjës së kohës lidhjes të kontratos. Konditat, nga të cilat subordonohet mënyra e provimit të kontratos, caktohen jo prej ligjës të kohës kur eksërsohet padia, por prej ligjës të kohës, kur e drejta e palëvet lindi; Kur se forma, nënë të cilën duhet të administrohet prova do të regjohet simbas ligjës në fuqi, kur u dha prova. Pra, një mjet provuës i përmetuar prej ligjës, nënë fuqin' e të cilës u lith konvecioni, mundet të përdoret për provimin e tij dhe kur ay mjet provuës është i ndaluar prej ligjës në fuqi. Gjith' ashtu për provimin e një konvencioni të bërë nënë fuqin' e ligjës vjetër nuku mund të përdoret një mjet provuës i ndaluar prej ligjës së vjetër, por i përmetuar prej asaj të ré.

Çartja e kontratos regjohet simbas ligjës të kohës, kur kjo kontrato lindi; Kështu, pra, ligja e re nuku mundet të çveshë njërën nga palët prej padies për çartje q' i akordonte ligja, në kohën e së cilës u lith kontrata.

E drejta e zgjidhjes ose jo të konvencionit qirasë, në rastin që shitet sendi i dhënë me qira, massi është një konsekancë e rjedhur prej kontratos, do të regjohet simbas ligjës të kohës q' u lith kontrata. Për kundrazi përsëritja e heshtur e kontratos, massi parasypozon një hir të ri të palëvet qoftë dhe të heshtur, formon një kontrato të re; Pra, do të regjohet simbas ligjës, nënë fuqin' e të çilës lindi kjo kontrata e re.

Ligjat që regjojnë interpretimin e konvencionevet zbatohen dhe mbi konvencionet e lidhura në kohën e ligjës së vjetër.

Kamata konvencionale regjohet prej ligjës në fuqi në kohën, kur u bë konvencioni. Pra, ligja e ré nuk munt të pakësojë përqindjen e kamatës të pranuar që më parë prej palëvet, simbas lirisë q' u ishte akorduar prej ligjës së vjetër.

Ligja e ré, e cila ndryshon përqindjen ligjore të kamatës, nuku aplikohet në oblig'met e lindura nënë legjislasjonin e mâ-parëshmë, për sa i përket *efektit direkt* të këtyre obligimevet dhe jo të një fakti që është i mâ-pasme se ato, si për shëmbëll mos pagimi i obligimit të kontraktuar.

Pra, në qoftë se ndjekjet giyqësore për mos-pagimin e obligimit kanë filluar qysh prej ligjës së ré, gjykata munt të detyrojë debitorin të paguajë kamatat që nga data e kërkesës me përqindjen e kamatës ligjore të ligjës së ré, ndonse kjo përqindje është më e lartër se ajo e ligjës vjetër, massi *mora* nuku është nonjë nga konsekancat e konvencionit, por një fakt i mâ-pasmë se ky.

Parashkrimi, në qoftë se u plotësua nënë fuqin' e ligjës vjetër, do të regjohet për sa u përket konsekancavet të tij simbas kësaj ligje dhe jo simbas ligjës të ré. Por, kur koha e lypur për parashkrim nuku është plotësu r, kemi vetëm një shpresë dhe jo nonjë të drejtë të fituar ose librim nga nonjë obligim; Pra, paramisht ligja e re aplikohet në parashkrimet e pa-plotësuara.

Kështu, në qoftë se padien e vjetër, të pa-parashkruëshme simbas ligjës të vjetër, e vé në parashkrim ligja e ré, parashkrimi fillon që nga data e hymjes në fuqi të ligjës së ré; Gjith' ashtu në rastin që ligja e rè abrogon një parashkrim, i cili eksistonte simbas ligjës vjetër, mbetet pa nonjë efekt edhe koha e ecur deri në ditën e abrogimit, massi nuku u plotësua parashkrimi.

Fillimi, pezullimi dhe ndërpremja e parashkrimit për kohën para hyrjes në fuqi të Kodit të ri, caktohen simbas

ligjavet të mâ-parëshme, por kur ligja e ré vé në zbatim një mënyrë të re pezullimi ose ndërpremjeje të parashkrimit ose kur për herën e parë pranon dispozita për pezullim ose ndërpremje, fuqia e ligjës së rè zgjatet dhe mbi parashkrimet e filluara.

Kur koha e lypur për parashkrim zgjatet prej ligjës së ré, parashkrimet e pa plotësuara regullohen simbas ligjës të ré tue u llogaritur dhe koha e ecur simbas ligjës të vjetër.

Kur afati i parashkrimit simbas Kodit të ri është mâ i shkurtër se ay që caktonin ligjat e mâ-parëshme, meret para-sysh afati mâ i shkurtër, dyke filluar qysh prej ditës së hymjes në fuqi të Kodit Civil të ri, se po të kishte fuqi prapavepruëse ligja e ré, në këtë rast do të ndodheshin në rezik të deklarohen të parashkruara pa-pandehur të drejtat. Por, kur afati më i gjatë që caktonin ligjat e më-parëshme për parashkrim, mbaron më shpejt se afati më i shkurtër që cakton Kodi Civil i ri, parashkrimi plotësohet me mbarimin e afatit më të gjatë; domethënë në qoftë se koha e mbetur për parashkrim simbas ligjës së vjetër është më e pakët prej kohës të caktuar prej ligjës së ré, nuku ndërpritet parashkrimi i vjetër, por ka për t' u aplikuar massi plotësohet më shpejt. Për shëmbëll: në parashkrimin tridhjet' e gjashtë vjeçar të nenit 1661 të Mexhelesë prej të cilit kanë kaluar tridhjet' e dy vjet, massi Kodi Civil i ri në nenin 2034 cakton kohën e parashkrimit ordinar në tridhjetë vjet, do të aplikohet parashkrimi i vjetër, i cili përmbushet me kalimin dhe të katër vjetevet të mbetura.

Parashkrimi vetësimtar, për të cilin bëhet fjalë në nenin 2037 të Kodit Civil të ri, aplikohet mbi çdo lloj pronjë, por, massi institusioni i uzukapionit nuku që i njohur prej ligjavet të mâ parëshme, fillon vetëm qysh prej ditës të hyrjes në fuqi të Kodit të ri.

Kur pronja ka qënë tokë shtetnore dhe parashkrimi vetësimtar âsht plotësuar simbas ligjavet të mâ-parëshme aplikohet parashkrimi i ligjës së vjetër; Por, kur parashkrimi vetësimtar ka ecur pjesërisht simbas ligjës së vjetër,

massi Kodi Civil i ri lyp elementa më të shumëta për këtë parashkrim, ky ndërpritet, koha e ecur më parë nuku llogaritet dhe fillon parashkrimi i ri qysh prej ditës që hyri në fuqi Kodi Civil i ri.

Kur ligja e re deklaron të parashkruëshme ato të drejta, të cilat simbas ligjës së vjetër ishin të pa-parashkruëshme, posedimi i filluar para hyrjes në fuqi të ligjës së re nuku duhet të llogaritet.

Dispozita ligjore e re që, tue vënë një send jashtë tregëtimit, e bën të pa-parashkruëshme të drejtën relative me atë send, ndalon parashkrimin e së drejtës këtij sendi qoftë dhe kur ka filluar para promulgimit të kësaj ligje.

KAPTINA C.

§ 32. — Llojet e kanunevet të së Drejtës.

Ligjat ndahen në shumë kategori.

Ligja *universale* janë ato, të cilat zbatohen mbi gjithë shtetin; Ligja *partikolare* quhen ato, që aplikohen vetëm në një pjesë të shtetit. Të çquemit të ligjavet në këtë mënyrë ka rëndësi pratike, massi ligja partikolare predominon, në vëndin ku aplikohet, mbi ligjën universale.

Ligja *gjenerale* quhen ato, që përmbajnë regulla juridike, të cilat zbatohen përgjithësisht mpi gjithë relasjonet për të cilat janë vënë, si për shëmbëll ligjat relative me pyjet. Ligja *speciale* janë ato, të cilat zbatohen mbi një relasjon të posaçmë ose mbi një të drejtë të caktuar, tue mos u zgjanuar në një rast tjatër të posaçmë. Shumica e ligjavet kanë një karakter gjeneral dhe janë regulla abstrakte, kur se ligjat speciale krijojnë në favor të personës ose të relasjonit juridik, për të cilin janë vënë, një privilegjë.

Pra, kemi ligja *komune*, të cilat zbatohen mbi të gjithë, si për shëmbëll ligja e minieravet; dhe ligja *eksepsionale*, të cilat aplikohen, për arësye mirëbërësie, vetëm mbi një klasë të çaktuar personash, sendesh ose marëdhëniesh

juridike, si për shëmbëll, një ligjë për mprojtjen e produktorëvet të duhanit.

Ligja eksepsionale krijon në favor të personavet ose të relasjonevet, për të cilat u vu, një benefic ose privilegjë. Privilegji, personal ose real qoftë, akordohet prej pushtetit legjislatif ose dhe prej pushtetit përmbarues të autorizuar me ligjë për këtë qëllim, massi ky formon një eksepsion nga regulli i përgjithëshmë.

Privilegjet çduken për shumë arësye, si për shëmbëll: me renoncim, parashkrim, mos përdorje, por edhe me ligjë, — sikundër ngjet mbi çdo të drejtë, — por zakonisht në këtë rast të fundit caktohet dëm-shpërblim në favor të personës, që damtohet nga ngritja e privilegjit.

Zakonisht kanunet e së drejtës përmbajnë urdhëra, domethënë caktojnë se një gjë duhet të zbatohet si *e drejtë*. Por, eksistojnë dhe kanune të drejte, të cilët nuku përmbajnë urdhër. Kësilloj kanune janë:

a) *Ligjat interpretative*, domethënë ato, të cilat caktojnë më-posaçërisht përmbajtjen e një tjetër kanuni.

b) *Ligjat negative*, domethënë ato që ndalojnë aplikimin e përmbajtjes të një tjetër kanuni të drejtë mbi raste të caktuara, si për shëmbëll neni 1487 i Kodit Civil, i cili dispozon se: "*Bashkëshortët nuku munden, sa vazhdon martesa, m' i bâ njani tjetrit ndonjë liberatitet*".

Kodifikim quhet reformimi i tërësisë të legjislasjonit të shtetit ose të një pjese të tërë të saj.

Në paragrafin 4 të këtij libri u bë gjërë e gjatë fjalë për dispozitat *urdhënuëse* dhe për dispozitat *plotësuëse* ose *deklarative*.

PJESA E TRETË

KAPTINA A.

§ 33. — Të drejtat përgjithësisht.

Thamë më sipër se të drejtat janë pushtetet, që i janë njohur një persone prej ligjës, dhe i përmetojnë të bëjë vepra të caktuara.

Po t' a analizojmë këtë definision, nxjerim këto konsekanca:

Që të eksistojë një e drejtë, duhet *të eksistojë më parë një kanun të drejtë*, pa kanun të drejtë nuku munt të eksistojë e drejtë; Pra, pa të drejtë objektive, nuku munt të eksistojë e drejtë subjektive. Me një fjalë që të eksistojë pushtet, duhet të eksistojë që më parë kanun të drejtë që t' a njohë këtë pushtet

Konsekanca e dytë që del nga definision' i sipërmë është se, subjekt' i së drejtës dhe objekt' i saj nuku mundet të jetë një dhe po ajo personë, domethënë kur-kush nuku munt të ketë të drejta kontra vet-vehtes; Pra, që t' eksistojë një e drejtë, duhen persona të ndryshme.

Konsekanca e tretë është se e drejta nuku i imponohet atij q' e ka, domethënë nuku është detyruar ky që t'a eksersojë, *por i është përmetuar eksersimi.* Me pak fjalë, ay q' e ka të drejtën, mundet t' a eksersojë ose jo ose dhe t'a jetërsojë, dyke hequr dorë nga e drejta ose dyke e transferuar atë.

Më në funt konsenkanca e katërtë është se, që t' eksistojë e drejtë, duhet që ky pushtet të jetë e mundur të realizohet në rast nevoje dhe me forcë të jashtëme. Pushtetet q' u janë njohur personavet për t' u dhënë satisfaksion interesavet të tyre kanë nevojërisht si parasypozim posibilitetin të një force, të një shtrëngimi kundrejt personavet të tjera, të cilat mundet të kontestojnë ose të ndalojnë ekser-

simin e atyre të drejtavet. Pra, të drejtat nuku mund të realizohen përveç se me ndihmën e së Drejtës dhe mjetet janë *padia* ose *prapsimi* (*exceptio*).

§ 34. — Klasifikimi i së drejtavet.

I. Të drejta absolute dhe të drejta relative.

Të *drejta absolute* quhen ato, në të cilat pushteti i personës drejtohet kontra çdo të treti dhe imponon një detyrë ose një kufizim në veprimet e të tretëvet. Për shëmbëll: me qënë se jam zot i një shtëpije, të drejtën e zotnimit kam të drejtë t' a përdor kontra të gjithëvet. Cili do, gjithë bota janë të detyruar të mos më cënojnë në ushtrimin e të drejtës. Të drejta absolute janë: të drejtat reale, shëmbëlla m' e mbaruar e të cilavet është e drejta e pronësisë, të drejtat familiare, të drejtat politike, të drejtat publike ose të lidhura me personalitetin, si për shëmbëll e drejta e punës, e tregëtimit, e shkrimit, e fjalës e tjera.

Të *drejta relative* quhen ato, të cilat imponojnë detyrë kontra një ose shumë personavet të caktuara dhe drejtohen vetëm kontra atyrevet. Për shëmbëll: A më detyron 1000 franga; e drejta ime drejtohet vetëm kontra A, vetëm kontra këtij mund t' a ushtronj. Në të drejtat relative hyjnë të drejtat e kreancës.

II Të drejta politike. Të drejta civile.

Të *drejta politike* quhen ato, me të cilat i njihet personës pushteti të marë pjesë deri më një pikë në pushtetin politik, domethënë në qeverimin e Shtetit Si shëmbëlla të drejtash politike sjellim të drejtën e votimit, të drejtën m' u zgjeth deputet. Të drejtat politike fi'ohen dhe konservohen në konformitet me Statutin dhe me ligjat e tjera. Nuku kemi për t' u okupuar këtu me 'to.

Të *drejta civile* quhen gjith' ato të drejta, të cilat nuk kanë karakter politik. Të drejtat civile i gëzon, parimisht, çdo njeri, massi ato janë të do-mos-doshme në jetën e së cilit, kur se kjo nuku ngjet në të drejtat politike. Është një gjë e qartë se, që të rojë njeriu nuku është e do-mos-dosh-

me' që të ketë të drejtën e votimit, por pa të drejtën të punojë, të blerë, të sheshë e tjera nuku do të mund'te të bënte as një çap në jetën sociale.

Të drejtat civile ndahen dhe këto në tre kategori:

1. Të drejtat e bashkuara me personalitetin, të cilat quhen të *drejtat e njeriut* ose *të drejta publike.* Kësilloj të drejta janë ato, që rezultojnë nga kaliteti i tillë i njeriut si për shëmbëll: e drejta që ka çdo njeri të rojë, të jetë i lirë, e drejta e nderit, e drejta e lirisë të ndërgjegjes, të fjalës e tjera. Ushtrimi i këtyre të drejtavet, massi hyn në sferën e së drejtës publike dhe garantohet prej institusionevet të asaj, nuku ka lidhje me të drejtat civile dhe me studijimin e këtyrevet. Por, në rastin që një e drejtë kësilloj nature shkelet abuzimisht, ay që pësovi prej këtij faji mundet të kërkojë kontra shkakëtarit *reparimin civil* për dëmin që e gjeti, simbas nenit 1149 të Kodit Civil. Kjo e drejtë, massi ka për qëllim një dëm-shpërblim në të holla formon një të drejtë, e cila hyn në kategorin' e të drejtavet pasurije.

2. *Të drejtat e families* janë ato që rezultojnë nga kaliteti i njeriut si bashkëshort, si prind, si gjini, si krushqi, si fëmijë e tjera. Tërësia e këtyre regullavet formon *gjendjen e personës (status personae).*

Këto të drejta prezantojnë këtë karakteristik, se janë *njëkohësisht të drejta* dhe *detyra*; Për shëmbëll: pushteti atënor nuku është vetëm e drejta e prindit të përkujdeset për edukimin e femijëvet të tij, por dhe detyra që t' u japë këtyrevet mjetet për këtë edukim.

Të drejtat e families dhe të drejtat civile kanë këtë karakteristik të bashkëtë, se nuku kanë ngjyrë pasurore. Me gjithë këtë, shpesh herë kanë si konsekancë disa të drejta pekuniare, domethënë pasurore, si për shëmbëll të drejtën e hyshqimit, të drejtën e trashëgimit.

3. *Të drejtat pasurore,* të cilat formojnë të drejta që përfundimisht u sjellin titullarëvet të tyre një satisfaksion në të holla ose, të pakëtën, të çmuëshme në të holla; Për shëmbëll e drejta e pronësisë,

Të drejtat pasurore ndahen dhe këto në tre klasa: në *të drejta reale,* në *të drejta kreance* dhe, më në funt, në *të drejta intelektuale,* domethënë të drejtat e autorëvet, të artistëvet, të çpikësvet mbi veprat ose çpikjet e tyre.

§ 35. — Të Drejtat reale.

Të drejta reale janë ato që kanë për objekt sendet e botës së jashtme, naturën impersonale, si toka, shtëpitë, sendet të lujtëshme; Këto të drejta i japin titullarit tyre një pushtet drejt-për-së-drejti dhe imediat mbi këto sende, pushtet i cili është më pak ose më shumë i gjërë simbas të drejtës vetë, dhe për këtë shkak këto të drejta quhen reale *(jus in re.)*

Të drejtat reale ndahen në *të drejta reale kryesore* dhe në *të drejta reale aksesore.* Për të drejtat reale aksesore, massi këto formojnë garancin' e një të *drejte kreance* ose *personale,* do të bëhet fjalë pas si më parë të trajtohen të drejtat personale.

Të drejtat reale kryesore — të cilat nuku janë aksesore të një të drejte personale ose kreance — quhen ato që akordojnë pushtetin për të përdorur një send, për të hequr nga ay gjithë gëzimet dhe gjithë dobitë në një masë pak a shumë të plotë. Të drejtat reale kryesore klasifikohen dhe këto në dy grupe:

a. Në të drejtën e pronësisë, dhe b. të drejta reale mbi sendin e tjetrit.

E drejta e pronësisë është e drejta m' e plotë që mund të eksersojë njeriu mbi një send. Pronjëtari, tue u përjashtuar çdo i tretë, gëzon gjithë avantazhet që mund të sjellë sendi. Ka, pra, mbi këtë send një të drejtë eksklusive dhe gati absolute (neni 794 i Kodit Civil), deri sa kjo e drejtë nuku është kufizuarë me eksistencën mbi sendin e vetë dhe në fitim të një të treti të no-njërës nga të drejtat e kategorisë që shënohet më poshtë.

Të drejta reale mbi sendin e tjetrit. Këto të drejta, numuri i të cilavet është limitativisht i caktuar prej ligjës, janë;

A. — *Uzufrukti* ose e drejta me përdorue dhe me gëzue, sa rron uzufruktuari, sendin, pronjar i të cilit është një tjetër persone; Ky pronjar është përkohësisht i çveshur nga gjithë avantazhet e pronësisë. Për shëmbëll: një legatar, i cili me fuqin' e një testamenti mori uzufruktin e një shtëpie, pronjë të të vdekurit, ka të drejtë deri sa rron vetë të banojë n' atë shtëpi, të përdorë sendet e lujtëshme të saj ose, në qoftë se e preferon, t' a lëshojë me qira, të marë qiratë (neni 832 e tjera të Kodit Civil).

B. — *E drejta e përdorjes dhe e drejta e bujtjes*, të cilat janë uzufrukte të përkufizuara (nenet 876-884 të Kodit Civil).

C. — *Servitudet (servitudë kalimi, servitudë pamjeje, servitudë për mos me ndërtue e tjera)*, të cilat janë barë të vëna mbi një send të pa-lujtëshmë në dobi të një pronje tjetër (neni 885 e tjera të Kodit Civil).

Ç. — *Enfiteozi*, i cili është një lloj qiradhënieje me afat shumë të gjatë (neni 1530 e tjera të Kodit Civil).

§ 36. — Të Drejtat personale ose kreance.

E drejta personale ose *e drejta e kreancës* është pushteti i një ose shumë personavet mbi vulnetin e një ose shumë personavet të caktuara. Titullari i së drejtës personale, domethënë *kreditori* mund t' a detyrojë *debitorin* të bëjë në favor të tij këtë ose atë prestim, domethënë ose t' i japë nonjë gjë ose të bëjë ose mos të bëjë gjësendi në favorin e tij. Për shëmbëll: e drejta që ka kapitalisti që i hojti debitorit 1000 franga të kërkojë nga ky kthimin e sumës në skadimin e caktuar; E drejta e qiradhënësit të një shtëpie të kërkojë pagimin e qirasë të caktuar; E drejta e qiramarësit të kërkojë nga qiradhënësi t' i prokurojë gëzimin e shtëpisë; E drejta e një direktori theatroje të ndalojë artistin, pensionerin e tij të lozë në një skenë tjetër kundrështare, etj. janë të drejta personale.

Ajo që formon traitën më karakteristike të së drejta-vet personale është se këto, tue qënë një pasuni, një ele-

ment *aktif* në pasurin' e titullarit të së drejtës korespondojnë nevojërisht në një detyrë të debitorit dhe formojnë një element *pasif* në pasurin' e këtij. Krejt e kundërta ngjet në të drejtat reale, në të cilat titullari i së drejtës nuk i mer kur-kujt as gjë, e drejta e tij nuk vobektëson as njeri; s'ka të drejtë të kërkojë as gjë prej kurkujt, përveç që mos t' i cënojnë të drejtat e tij përdorimi dhe gëzimi, q' ay vetë i mbush drejt-për-së-drejti mbi sendin që është objekt' i së drejtës së tij.

Nga shëmbëllat të drejtash personale q' u treguan më sipër, duket se ato shpesh herë kanë për rezultat t' i transferojnë kreditorit pronësinë e një sendi të debitorit; Prandaj komentatorët nga do nj' herë të drejtat personale i quajnë *jus ad rem* për të treguar se kanë për qëllim t' i transferojnë titullarit tyre pronësinë, zotnimin e një sendi q' është e një të treti, të debitorit. Kështu, me këtë mënyrë e drejta personale duket si një e drejtë reala ose *jus in re.* Me të vërtet, në një shtet të qytetëruar gjithë sendet e naturës impersonale, të botës së jashtme, jo vetëm toka, por dhe objektet e tjera materiale, që janë të afta t' i sjellin njeriut një dobi, formojnë objekt pronësie individuale; Vetëm sendet që janë pa zot dhe zotnimi i të cilavet fitohet me pushtim formojnë eksepsionë (për shëmbëll: kafshët e egëra). Pra, një personë që të bëhet zot-pronjar i një sendi, duhet t' a marë zotnimin nga ay, i cili e ka dhe për këtë gjë duhet të formohet një rapor obligimi midis palëvet, të lidhet një kontrato shitje-blemjeje, duhet që pronjëtari i tashmë të bëhet debitor' i sendit që do të transmetohet dhe pronjari i arthmë të bëhet kreditor' i saj.

Por, fusha e të drejtavet personale është shum' e gjërë. Një e drejtë kreance mundet të ketë lidhje me tërë prestimet, çfarë do qofshin ato, që prezantojnë një interes të çmueshme në të holla të ndryshme nga interesi, i cili konsiston në një transferim zotërimi. Kështu, pra, e drejta e kreancës nuku ka gjithë-monë për qëllim transferimin e zotërimit të sendit që ka për objekt. P'ër shëmbëll: U jap me qira një

shtëpi për dy vjet me çmim-qiraje të përvitëshme të pajtua-; U jap hua kalën dhe arabanë t' ime për një muaj; Mbetem zot i shtëpisë të dhënë me qira, i kalit dhe i arabasë të hojtura. Kreditori, në këto shëmbëlla, domethënë qiramarësi ose huamarësi fitojnë vetëm të drejtën t' a përdorin sendin vetëm sa vazhdon koha e caktuar.

M' anën tjetër, e drejta personale mund të ketë për objekt jo dhënien e një sendi, por detyrimin *me bâ ose mos me bâ* një fakt, gjë e cila mundet të ketë për kreditorin një vleftë të çmueshme në të holla. Për shëmbëll: një komisionar lith një kontrato me një industrial për shitjen e produivet të këtij; një punëtor lith një kontrato pune dhe i jep me qira shërbimet e tij një patroni (obligime me bâ). Ose shitësi i një kapitali tregëtar mer angazhamentin, shprehimisht ose heshtësisht, që, dyke shitur magazenë, të mos hapë një magaze po t' atij lloji dhe po n' atë lagje ose n' atë qytet (obligim mos me bâ);

§ 36 bis — Krahasim i së drejtës reale me të drejtën personale.

Me sa u treguan më sipër lehtazi kupëtohen diferencat esenciale q' i çquajnë të drejtat reale nga të drejtat personale. E drejta reale është një e drejtë *absolute*, gjë kjo që do të thotë se nuku konsiston në një lidhje juridike midis dy personavet; Është një e drejtë mbi një send dhe titullari e ekserson këtë të drejtë vetë pa patur nevojë për ndihmën e një të treti. Kjo është e qartë për sa i përket së drejtës zotënimit, e cila është mënyra fitimi të drejte të një sendi më e plota dhe më e mbaruara.

Sa u thamë më sipër për të drejtat reale mundet të aplikohen gjith' ashtu dhe mbi të drejtat, të cilat kanë për objekt pronjën e një të treti; Për shëmbëll: *uzufruktuari* përdor dhe gëzon sendin pa patur nevojë të ndihmës ose të lejës të pronjarit të çveshur. Gjith' ashtu, *pronjari*, që ka një *servitudë* mbi pronjën fqinjë, ka të drejtë të bëjë gjithë veprat, të cilat janë konsenkancë e gëzimit të kë-

saj servitude; Pronjari i *pronjës shërbyëse* duhet t' u bindet këtyre vepravet.

Për kundrazi e drejta personale është një e drejtë *relative*; Është një lidhje obligimi midis dy personavet; Rezumohet në pushtetin e kreditorit të kërkojë që debitori të ekzekutojë obligimin e tij; deri më një masë, pak a shumë të gjërë, e drejta personale subordonon aktivitetin juridik të një persone të caktuar (të debitorit) në favor dhe për interesin e një tjetri (të kreditorit). Në të drejtat personale vihet në shërbimin të kreditorit një personë, ajo e debitorit vetëm.

Të drejtat reale janë të një nature *negative*; Kjo domethënë se zotënuësi ka të drejtë të kërkojë që mos të çytet prej kur-kujt në ushtrimin e së drejtës së tij; Naturisht me të ngjarë çytja, at' here e drejta bëhet *pozitive*, domethënë zotënuësi ka të drejtë të kërkojë që, e drejta që ju cënua t' i jepet prapë.

E kundërta ngjet në të drejtat personale, të cilat janë *pozitive*, domethënë kreditori ka të drejtë të kërkojë prej debitorit që ky të bëjë ose të prestojë atë, që është objekt' i obligimit. Por, eksistojnë raste, në të cilat dhe e drejta personale mundet të jetë negative; Shëmbëll: A i premton B se nuk do të naltësojë murin e shtëpisë së tij; në këtë rast e drejta e B, ndonse një e drejtë personale, është të një nature negative.

§ 37. — Të drejtat reale aksesore.

Thamë më sipër se eksistojnë disa të drejta reale, rol' i të cilavet konsiston në garantimin e ekzekutimit ose të pagimit të një të drejte kreance. Këto të drejta janë *pengu, privilegjet dhe ipoteka*

Për të kupëtuar rolin që lozin të drejtat reale aksesore duhet të dijmë se, kur një debitor është detyruar kundrejt shumë kreditorëvet dhe nuku ka me se t' i paguajë, kreditorët e ndajnë dëmin q' i gjen proporcionalisht që të gjithë së bashku. Kjo do të thotë se vlefta e pasurisë të debitorit tyre e sekvestruar dhe e shitur do të ndahet midis kredi-

torëvet në përpjesëtim të kreancavet të tyre respektive, pá u marë para sysh data e kreancavet (*neni 1881 i Kodit Civil*). Një kreditor, me gjith që gjendja e tanishme e debitorit tij prezanton gjithë garancitë, duhet të ketë gjith' monë frikën se kjo situatë mundet të ndryshohet me lindjen e obligimevet të rea të debitorit tij, kështu që pasuria e tij mundet të mos jetë e mjaftë sa t' u japë satisfaksion që të gjithë kreditorëvet. Pra, për t' u mprojtur kontra një kësilloj reziku, kreditori mundet të kërkojë nga debitori t' i kushtituojë një *të drejtë reale aksesore* mbi këtë ose atë send të caktuar të pasurisë së tij; Për shëmbëll: do t' i kërkojë debitorit një send të lujtëshmë (mobillo të vlefshme, titull burse) si penk ose do të kërkojë një sigurim tue vënë ipotekë mbi një tokë ose shtëpi të debitorit tij.

Dobia që heq kreditori nga kjo e drejtë reale aksesore është dubël:

Pik së pari, në qoftë se debitori nuku paguan detën e tij në skandimin, kreditori, massi t' a shesë sendin e penguem ose të ipotekuem, nga çmimi do të paguhet më parë se çdo tjetër kreditor. Kjo është e drejta e preferimit që formon garancinë të kreditorit dhe e cila e ndryshon konditën e tij nga ajo e kreditorëvet ordinarë — të cilët quhen *shirografarë* — që janë të ekspozuar në reziket e insolvabilitetit të debitorit të tyre.

Pos kësaj, kur e drejta reale aksesore është e vënë mbi një pronjë të pa-lujtëshme (*ipotekë, privilegjë mbi send të pa-lujtëshme*), kreditori është armatosur me një *të drejtë ndjekjeje*, domethënë mund t' a zerë sendin që i është lënë ipotekë dhe në rastin që pronja pushovi të ndodhet nënë zotërimin e debitorit tij dhe ka shkuar në duart e një të treti, për t' u paguar mbi çmimin (*neni 1896 i Kodit Civil*). Për kundrazi, kreditorët shirografarë nuku mundet të venë dorë përveç se mbi pasurinë të debitorit tyre në kohën që i bëjnë ndjekjet gjyqsore; Nuku mundet këta të venë dorë mbi pasurinë që pati jetërsuar debitori që më parë.

§ 38. — Të drejtat intelektuale.

Të drejtat reale dhe të drejtat personale formojnë më të shumëtat dhe ato më me rëndësi nga të drejtat pasurore; Por nuku janë dhe të vetëmat, massi eksistoin një kategori elementash begatimi që nuku mund të futen as në kategorin' e të drejtavet personale, as n' atë të së drejtavet reale. Këto të drejta quhen *intelektuale*. Kësilloj të drejta janë: të drejtat e autorëvet, shkrimtarë ose artistë, mbi veprat e tyre — shkrime, piktura, statua, gravura e tjera — të drejtat e çpikësvet mbi çpikjet e tyre, të drejtat e tregëtarëvet dhe të industrialëvet mbi markat dalluëse, mbi brevetat, mbi desenet industriale, mbi emërin dhe klientelën e shtëpive tyre tregëtare e tjera.

Në këtë kategori ndërmjetëse të së drejtavet intelektuale duhet gjith' ashtu të kllasifikohen të drejtat e ofiqarëvet ministerielë — notarë, avokatë, axhentë kambjoje, — të doktorëvet mjekë mbi kabinetin e tyre medikal. Këto të drejta nuku janë as të drejta personale, as të drejta reale, por të drejta **speciale, sui gjeneris** të drejta, të cilat hyjnë që të gjitha në kategorin' e të drejtavet *pasurore*, domethënë prezantojnë një vleftë të çmuëshme në të holla.

§ 39. — Të drejta të transferuëshme dhe të pa transferuëshme.

Të *drejta të transferuëshme* quhen ato, që mundet të transferohen nga ay q' i gëzon në të tjera persona.

Të *drejta të pa-transferuëshme* quhen ato, që nuku mund të transferohen në trashëgimtarët ose në të tjera persona, massi janë lidhur ngushtë me personën q' i gëzon; Kësilloj të drejta janë ato të families. Pos këtyre, eksistojnë dhe të tjera të drejta pasurore që janë të pa transferuëshme, si përdorja, bujtja, uzufrukti, të cilat shuhen me vdekjen e atij q' i gëzonte dhe nuku mundet të transferohen me pasurinë tjetër të *de cujus*-it në trashëgimtarët.

Më në funt eksistojnë të drejta, të cilat janë lidhur me një cilësi, kështu që, ay q' i ka këto cilësi, fiton edhe të

drejtat. Për shëmbëll: Eksistojnë të drejta kreance që janë me të tillë mënyrë të lidhura me shkresën që provon eksistencën e së drejtës, sa që poseduësi i shkresës fiton dhe të drejtën; Kësilloj të drejta janë *biletat në urdhër të sjellësit;* Me këto është lidhur dhe e drejta e kreditorit. Cilido që fiton posesjonë e tyre, fiton dhe zotërimin dhe të drejtën. Gjith' ashtu ngjet me biletat e theatros, të trenit e tjera.

KAPTINA B.

§ 40. — Subjekt të Drejtash.

U tha më sipër se të drejtat janë pushtetet që i janë njohur një persone prej ligjës, pushtete të cilat i përmetojnë të bëjë vepra të caktuara. Me këtë pushtet lidhet një subjekt domethënë sjellësi i së drejtës. Ky subjekt quhet *personë* dhe zotësia për me qënë personë domethënë subjekt' i zoti që të ketë të drejta dhe detyra quhet *personalitet* ose *zotësi juridike.*

Në favor të personës është vënë e drejta, e cila ka për qëllim t' i japë satisfaksion interesit të personës. Por, në rastin që qarku i personavet, në favor të së cilavet eksiston interesi, është i gjërë (shtetasit) ose pëson ndryshime periodike (anëtarët e shoqatës), arësye oportuniteti konkurojnë që personat, në favor të së cilavet eksiston interesi, të mos quhen njëkohësisht si sjellës të së drejtës, por në këtë cilëcin' e tyre zëvëndësohen prej një subjekti tjetër të vetëm, i cili quhet *person juridik* ose *person moral,* për t' u çquar nga personat e tjera, të cilat janë naturale.

Relasjonet e personavet me të drejtën dhe detyrën janë:

1. Regullisht pushtetin e përmbledhur në të drejtën e ushtron vetë persona q' e ka atë pushtet. Por, mundet që ky të ushtrohet jo prej atij q' e ka, por n' emër të tij prej një persone tjetër (përfaqësuësit), prej atij, për shëmbëll, i cili ushtron pushtetin atënor, prej tytorit, prej të porositurit.

2. Interesi, realizimin e të cilit ka për qëllim e drejta,

regullisht i përket atij q' e ka atë interes, por kjo nuk është e do-mos-doshme. Mundet që ay, në favorin e të cilit eksiston interesi, të jetë nonjë personë tjetër dhe jo ajo, q' e ka të drejtën. Kjo ngjet në të drejtat e besuara, si për shëmbëll në zotërimin e transferuar për arësye administrimi.

3. Me humbjen e personës q' e ka të drejtën mundet që, deri sa kjo të zëvëndësohet prej një tjetre, të ndërmjetësojë një kohë, në vazhdimin e së cilës eksiston një gjendje e mvarur, e cila mundet të regullohet me mënyra të ndryshme, dyke u pranuar:

a') se në kohën që ndërmjetëson, ay q' e ka të drejtën është personë juridike, sikundër ngjet në trashëgimet vakante (hereditas jaceus), ose

b') se ay që do t' a ketë të drejtën në të arthmen, konsiderohet sikur eksiston në kohën që ndërmjetëson, sikundër ngjet me trashëgimin q' i vjen një të zânuni por të pa linduri édhe, ose

c') se e drejta eksiston, por ndodhet e mvarur, kështu që persona që ka m' e pas në të arthmen të drejtën konsiderohet se e fitovi qysh prej kohës që fillovi kjo gjendje e mvarur. Por, në qoftë se është e pa-mundur të regullohet çështja në kohën që ndërmjetëson me një nga mënyrat e sipërtreguara — gjë e cila ngjet në sendet e lânuna doret *(neni 1068 i Kodit Civil)*, por të pa pushtuara édhe prej një tjetri — at' here nuk eksiston e drejtë, por një gjendje reale që mund të formojë një fillim lindjeje të drejte.

4. Sikundër ngjet me të drejtën, kështu edhe detyra duhet të ketë një sjellës domethënë subjektin e saj, debitorin. Sa u thanë më sipër për të drejtën kanë aplikim dhe për detyrën.

5. Regullisht e drejta dhe detyra ndahen në persona të ndryshme. Me gjithë këtë është e mundur që brenda në të drejtën të jetë dhe detyra që i korespondon, si për shëmbëll edukimi i fëmijës prej prindit. Kjo ngjet me të drejtat që kanë për qëllim realizimin jo të interesit të vetë t' atij q' e ka të drejtën, por, të paktën në pjesën më të madhe,

të një të treti.

§ 41. — Personat fizike

Personë fizike është njeriu Personalitet' i njeriut fillon qysh prej kohës që *ndahet i gjallë* nga barku i mëmës së tij. Deri n' atë minutë nuku ka jetë të veçantë, është pjesë e barkut të mëmës *(pars viscerum matris)*.

U tha më sipër se për t' u fituar personeliteti duhet që njeriu të lindë i gjallë; Eksepsjonalisht fëmija e pa lindur édhe ka zotësinë me fitue të drejta qysh prej kohës që është zënë; Para lemjes konsiderohet sikur figuron midis personavet. Romanët theshnin për fëmijën e zënë por jo të lindur: *"nasciturus pro jam nato habetur, quotiens de commodis ejus agitur"*, domethënë fëmija e zënë para se të lindet quhet si e lindur, kur e lypin interesat e saj. Kodi Civil shqiptar ka aplikuar eksepsionin e naltpërmëndur në nenin 458.

Ky personalitet i anticipuem q' i njihet fëmijës të zënë mundet të sjellë efekte të dobishme në fitimin e një kombësie të re ose në njojtjen vulnetarisht të atësisë ose të amësisë naturale, por gjithëmonë ky regull aplikohet vetëm dhe ekskluyivisht *në interesin* e fëmijës.

Personaliteti i njeriut mer funt me vdekjen e tija Të vdekurit nuku janë persona. Në këtë rast lind pyetja: kur një personë pretandon se një përsonë tjetër ndodhet gjallë ose vdekur, cilit i ngarkohet bara e provimit? Sigurisht atij q'e pretandon faktin.

Por, takon që të ngjasin vdekje të shumë personavet të humbura në një aksident, në një mbytje uji ose në një zjar dhe nuku dihet se cili vdiq më parë për të caktuarë mënyrën e rjedhjes të trashëgimit të atyre personavet.

Dy raste munden të çfaqen: ose është i mundur caktimi i kohës të dy ose më shumë vdekjevet ose nuku është i mundur.

I. Rasti i parë: Data respektive e vdekjevet është e mundur të caktohet. Në këtë rast çështja nuku ka pengime,

2. *Rasti i dytë.* Nuku eksiston as një cirkostancë *de facto*, e cila të përmetojë caktimin e datës respektive të vdekjes të *komorientëvet* — të personavet të vdekura së bashku — me anë induksioni.

Kjo çështje është biseduar shumë në skencën juridike dhe solusjone të ndryshme i janë dhënë çështjes; Kodi Civil shqiptar e ka zgjidhur definitivisht me dispozita pozitive. Neni 652 i Kodit Civil tekstualisht thotë: *"Në qoftë se midis dy ose më shumë personavet që thiren respektivisht me trashëgue njëri tjetrin ka dyshim se cili ka vdekur mâ i pari, ana që pretandon vdekjen e mâ parëshmë të njërit ose të tjetrit, duhet t' a provojë; Në mungesë prove, prezumohet se ata të gjithë kanë vdekë po në një kohë dhe nuku transmetohet as një e drejtë nga njëri tek tjetri".*

Disa ndryshime që eksistojnë midis personavet fizike kanë konsekanca në marëdhëniet juridike; Të tilla janë: *mituria dhe madhoria, sëmundjet e trupit ose të mëndjes* dhe *absenca.*

Mitunië është gjendja e personës, e cila, tue u marë para sysh mosha e vogël — nënë njëzet vjet — prezumohet se nuku ka arirë një shkallë developimi intelektual të mjaftë që të përmbushë akt'et e nevojëshme për ushtrimin e të drejtavet të saj civile. Pa-zotësia që rezulton nga mituria bazohet në nevojën e mprojtjes të të mitunit, është pra vetëm një pazotësi *ushtrimi.* I mituri gëzon gjithë të drejtat e tij private, por aktet e nevojëshme për ushtrimin e të drejtavet tij përmbushen jo prej tij, por prej një *përfaqësuësi ligjor,* prej atit ose prej tytorit.

Madhorië është gjendja e personës, e cila massi kalovi moshën njëzet vjet prezumohet se ariti në një developim intelektual të mjaftë për të eksersuar ajo vetë gjithë të drejtat e saj. Madhori — *thotë neni 379 i Kodit Civil* — âsht i zoti për gjithë vepërimet civile, pos përjashtimevet të caktueme me dispozita të posaçme.

Absencë është gjendja e personës që nuku duket mâ në vëndin e banesës ose të qëndresës së mbrame të saj

dhe nuku ka as një lajmë për të. Ajo që karakterizon absencën e një persone, nuku është vetëm mungesa nga banesa e saj, por është fakti i çdukjes saj pa që të japë lajmë; Nuku dihet se ç' u bë persona, në se është gjallë ose vdekur *(nenet 80 dhe 102 të Kodit Civil).*

Disa sëmundje kanë konsekanca në marëdhëniet juridike; Për shëmbëll: i verbëri, shurth-memeci kanë zotësi juridike të kufizuar, si bije fjala i verbëri, massi nuku mundet me këndue, nuku mundet me bâ testament të fshehët. Sëmundjet mendore që kanë konsekanca në marëdhëniet juridike janë ato, që shkakëtojnë ndodhjen e personës në një gjendje dobësie mendore të zakonëshme, e cila e bën të pa-zotin m' u kujdesue për interesat e veta. Neni 380 i Kodit Civil ka parasysh të çmëndurit që ndodhen në një gjedje të zakonëshme çmëndimi.

Gjith' ashtu ka zotësinë e ushtrimit të së drejtavet civile të përkufizuar *"mëndje-dobëti* — thotë neni 395 i Kodit Civil — *gjendja e të cilit nuku është aqe e rëndë, sa së shkakëtojë ndalimin."*

§ 42. — Personat juridike ose personat morale.

Personë juridike ose, ndryshe, *personë morale* quhet ajo krijesë, e cila, ndonse nuku ka eksistencë naturale, njihet prej së drejtës si subjekt të drejtash dhe detyrash dhe si e veshur me vulnet.

Nga ky definision lehtazi kupëtohet se personat juridike kanë zotësinë të marin pjesë në jetën juridike massi u është njohur prej ligjës personaliteti, domethënë kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat civile edhe të çfaqen përpara drejtësisë për mprojtjen e këtyre të drejtavet. Personat juridike ndahen në tre klasa, të cilat janë:

A. *Shoqjatat.* Fjala shoqjatë, në kup'imin e gjërë të saj, domethënë grupe të përbëra prej njerës, të cilët mblidhen edhe bashkojnë me një mënyrë vazhduëse dijeninë, aktivitetin e tyre qoftë me qëllim realizimin e fitimevet, — gjë e cila ngjet me shoqëritë civile dhe tregëtare, — qoftë me

qëllim tjetër jo fitim-prurës (shoqjatat e thjeshta).

Shoqiatat edhe shoqëritë, të cilat massi kanë një jetë më vazhdueše se ajo e njeriut lozin një rol kaqe të math në jetën sociale, që të mundin t' a përmbushin këtë rol duhet t' u njihet nevojërisht e drejta të kenë një pasuri, të mundin të kontraktojnë, të bëhen kreditorë dhe debitorë, pronjarë, të mundin gjith' ashtu të çfaqen para gjyqevet për të mprojtur të drejtat e tyre. Për ndryshe, po të mos mundnin të marin pjesë në jetën juridike, jeta e tyre do të qé e shkurtër, aktiviteti i tyre shumë i përkufizuar. Kjo është kllasa e parë.

B. Kllasa e dytë përmban organet e mbëdha, të cilat sigurojnë fonksionimin të jetës kombëtare të një populli dhe të grupevet tokësore të ndryshme të tij; Këto organe janë: *Shteti, prefekturat, komunat*, por m' anën tjetër eksistojnë dhe *stabilimenta publike*, të cilat kanë për mision sigurimin e fonksionimit të shërbim evet të asistencës, të edukimit.

Persona morale principale e së drejtës publike është Shteti, i cili, nga pik-pamja e relasjonevet të tij pasurore, është subjekt të drejtash edhe detyrash. Karakteri i Shtetit në regjimet liberale është ay i shoqjatës të përbërë prej tërësisë të anëtarëvet të tij, të shtetasvet *(universitas personarum)*. Çdo Shtet regullon me legjislasjonin e vetë mënyrën e përfaqësimit të tij në marëdhëniet juridike; Ndaj né Shtetin e reprezanton Ministri i Financavet.

Edhe këto organizata të mbëdha marin pjesë në marëdhëniet juridike; kontraktojnë, fitojnë, jetërsojnë, çfaqen dhe gjykohen para gjykatavet një si personat e tjera.

C. Kllasa e tretë e personavet juridike janë *fondacionet*. Fondacione quhen vepra mirëbërëse të çdo lloji si asile, spitale, instituta shkencore, artistike, letrare, mirëbërësie e të tjera të pa-ndaluara prej ligjës, të krijuara prej privatëvet në gjalljen ose me vdekjen e tyre. Kodi Civil në nenin 445 na jep këtë definision për fondacionet: "*Fondacioni ka për*

objekt destinimin e një pasunie për dobiën e një qëllimi të posaçmë".

Kur krijohet një kësilloj vepre, që të jetë e mundur të fonksjonojë kjo efektivisht dhe të sjellë dobi, duhet të fitojë personalitetin juridik domethënë zotësinë të ketë të drejta dhe detyra; Me këtë mënyrë i përmetohet fondacionit të ketë një pasuri të vetë dhe gjithë cilësitë e tjera që e bëjnë të aftë të marë pjesë në jetën juridike.

Kushtituimi, fonksionimi dhe likujdimi i personavet juridike regjohet simbas regullavet të caktuara në titullin XV të librit të parë të Kodit Civil.

Posë shoqjatavet q' u është njohur personaliteti juridik, Kodi Civil njeh dhe të tjera kolektivitete personash fizike, të cilat nuku kanë personalitet. Neni 426 i Kodit Civil, thotë: *"Shoqatat që nuku kanë ose që nuku mund të marin personalitet, traitohen si shoqënina de fakto dhe për veprimet juridike të bame kundrejt një të treti n' emër të një shoqjate asodore, âsht përgjegjës vepruësi, e në rast që veprimi bahet prej shumë personash, këta janë përgjegjës solidarisht".* Nga teksti i sipërmë i ligjës rezulton se nuku kemi nonjë person ideal si subjekt të drejtash dhe detyrash, por anëtarë të shoqjatës *de fakto,* të cilët janë titullarë të pasurisë.

KAPTINA C.

Objekt të drejtash.

§ 43. — Sendet përgjithësisht.

"Sende quhen përgjithësisht gjithë gjanat, që munt të formojnë objekt zotnimi publik ose privat", thotë neni 774 i Kodit Civil.

Sendet nga natura e tyre janë të destinuara t'u shërbejnë nevojavet të njeriut dhe format juridike me të cilat përmbushet ky destinim janë: *e drejta e zotërimit* dhe *e drejta mbi send të huaj.*

Sendet ndahen në dy kategori kryesore: *1) sende të trupta* dhe *sende të pa-trupta,* dhe *2) sende të lujtëshme* dhe *sende të pa-lujtëshme* ose *prona.*

§ 44. — Sende të trupta, sende të pa-trupta.

Sende të trupta janë ato, që kanë një eksistencë materiale, "*quae tangi possunt*" theshin juristës romanë; Të tilla janë gjithë sendet që na rethojnë dhe të cilat i përdor njeriu që t' u shërbejnë nëvojavet të tija.

Sendet e trupta ndahen në grupe të ndryshme:

A. Sende që munt të jenë objekt zotërimi ose që nuk mund të jenë objekt zotërimi.

B. Sende të konsumuëshme dhe sende të pa-konsumuëshme.

C. Sende të zëvëndësuëshme dhe sende të pa-zëvëndësuëshme.

§ 45. — A. — Sende që mund të jenë ose jo objekt zotërimi.

Shumica e sendevet materiale mundet të jenë objekt të një të drejte zotërimi privat; Por, posë këtyre eksistojnë disa sende të tjera, të cilat nga shkaku i naturës së tyre nuku mundet të jenë objekt të një zotërimi privat, si për shëmbëll: era, deti, uji që ecën. Këto sende ndodhen në përdorimin e të gjithëvet, prandaj quhen sende të bashkëta, "*res communes*".

Midis sendevet që mundet të jenë objekti i një të drejte zotërimi, eksistojnë disa që janë rezervuar për përdorimin kolektif të njerësvet dhe nuku mundet të jenë objekt i një zotërimi privat Në këtë rast themi se këto bëjnë pjesë të pasurisë publike.

Pasunia e personavet publike, si Shteti, Bashkitë, Komunat, ndahet në dy kllasa: a') *pasuri domaniale.* Formojnë pjesë të pasurisë domaniale të Shtetit — thotë *neni 789 i Kodit Civil* — rrugët Kombëtare, provinciale, dhe krahinarë, bregu i detit, limanët, lëmënjtë, përënjtë dhe fortesat;

dhe b') *pasuri patrimoniale.* Si mbas dispozitës të *nenit 790 të Kodit Civil,* bëhen pasuri patrimoniale e Shtetit tokat e fortifikimevet që nuku kanë më të këtillë destinim, si dhe gjithë sendet e tjera që pushojnë të jenë të destinueme për përdorim publik dhe për mprojtje Kombëtare.

Pasuria domaniale e shtetit, urdhëron *neni 791 i Kodit Civil,* është prej naturës të saj e pa-jetërtueshme. Sa për pasurinë patrimoniale, ajo mundet të jetërsohet në konformitet me dispozitat e ligjavet.

Formojnë pjesë të pasurisë domaniale të Shtetit, pra janë të pa-jetërtueshme, jo vetëm sendet e pa-lujtëshme të nëmëruara më sipër, por edhe sende të lujtëshme, si libra dhe dorëshkrime të bibliotekavet publike, dokumentat e arshivavet, pikturat, statuet dhe objekte të tjera të muzévet, që kanë një vleftë artistike ose arkeollogjike.

§ 46. — B. — Sende të konsumuëshme, sende të pakonsumuëshme.

Sende të konsumuëshme janë ato që konsumohen nga vepra e njeriut që i përdor; Të tilla janë: sendet hyshqimore, metalet e vyera të monedhuara, kartë-monedha, massi këto të fundit, tue u përdorur dhe tue u këmbyer, shpenzohen, gjë kjo që për të zotin e tyre është një konsumim.

Shumica e sendevet janë, për kundrazi, *të pa konsumuëshme,* domethënë mundet të jenë objekt i vepravet gëzimi të përsëritura, pa që të çduken ato krejt nga pasuria. Të çquemit të sendevet në të konsumuëshme dhe të pakonsumuëshme prezanton një interes të math në të drejtën e uzufruktit. Simbas dispozitavet të nenit 838 të Kodit Civil, në qoftë se uzufrukti përfshin gjana që nuku mund të përdoren pa u konsumue, si të holla, drithna, pije, uzufruktuari ka të drejtë me i përdor, por detyrohet me pague vleftën e tyre në mbarim të uzufruktit simbas të çmuemit q' është bërë në fillim. Nga sa u thanë më sipër, kupëtohet se uzufruktuari bëhet zot i vërtetë i sendevet të konsumuëshme, por në mbarimin e uzufruktit detyrohet të paguajë

vleftën e tyre simbas estimimit të bërë që në fillim. Uzufrukti i sendevet të konsumueshme quhet më posaçërisht *gatiuzufrukt*. Sa u thanë për uzufruktin aplikohen dhe në kontraton e huas.

§ 47. — C. — Sende të zëvëndësueshme, sende të pazëvëndësueshme.

Sende të zëvëndësueshme (*res fungibiles*) quhen ato, të cilat mund të zëvëndësohen njëra me tjatrën në një pagim; Sendet e zëvëndësueshme kanë dhe vleftë libruese në obligimet, massi kreditorit i është indiferent të marë këtë ose atë send. Sende të zëvëndësueshme janë sendet e lujtëshme që përçaktohen me numurim, me matje ose me peshim.

Sende të pa-zëvëndësueshme (*res non fungibiles*) quhen ato, të cilat nuku mund të zëvëndësohen me të tjera në një pagim. Sendet e pa-zëvëndësueshme quhen dhe *trupe të caktuara*. Debitori i një sendi të pa-zëvëndësueshme është i detyruar të dorëzojë po atë objekt që detyron dhe jo një tjetër *ekuivalent*.

Kllasifikimi i obligimevet në *deta lloji* dhe në *deta trupesh të caktuara* bazohet në të çquemit të sendevet në sende të zëvëndësueshme dhe në sende të pa-zëvëndësueshme. Themi se një obligim ka për objekt një *lloj* (*genus*), kur sendi i detyruem është i caktuar vetëm me kalitetin dhe me sasiën e saj, si për shëmbëll: një qint qillograme grurë, dhjetë killë misër, një qint metro shajak, të huanj 1000 franga arr. Themi se *deta* ka për objekt një *trup të caktuar*, kur objekti i detyruar është individualisht i caktuar dhe kur duhet t' i dorëzohet kreditorit sendi i caktuar, i pajtuar, ay vetë dhe jo një tjetër, si për shëmbëll në depoziton, në të cilën depozitari është i obliguar të dorëzojë po atë send që ju dorëzua t' a ruajë. Në kontraton e shitjes, kur objekt' i konvencionit janë gjëra që formojnë pjesë të një grumbulli të caktuem që janë shitur me peshë, me numur ose me masë — sende të zëvëndësueshme — reziku

është për shitësin deri sa të peshohen, të numurohen ose të maten ato sende. Por, në qoftë se gjërat janë shitur *en bloc* — trup i caktuar — reziku është për blerësin. (*Nenet 1391 dhe 1392 të Kodit Civil*).

§ 48. — Sende të pa-trupta.

Sendet të pa trupta janë gjëra krejt abstrakte, si për shëmbëll: çpikja e një savanti, e një çpikësi, firma dhe klientela e një tregëtari, shërbimi që debitori premtovi të bëjë, vjershat e një poeti, veprat e një artisti. Sendet e pa-trupta, ndonse kanë një eksistencë abstrakte, por reprezantojnë për njerinë që i krijovi një vleftë të çmueshme në të holla. Në kategorinë e sendevet të pa-trupta hyjnë — *simbas dispozitavet të nenit 785 të Kodit Civil* — të drejtat dhe obligimet, qofshin dhe ipotekore, padinat, aksionet ose pjesat e tyre në shoqëri tregëtare ose industriale, si dhe rantat jetore ose të përhershme. Zotërimi bën një përjashtim nga sa u thanë më sipër dhe është një e drejtë e trup'ë, massi absorbon gjithë dobinë ekonomike të sendit deri në pikën sa e drejta edhe sendi të konfondohen.

§ 49. — Sende të lujtëshme, sende të pa-lujtëshme.

Ky është kllasifikimi kryesor i sendevet i bazuar në diferencën naturale më të madhe q' eksiston midis sendevet. Kodi Civil vetëm këtë kllasifikim të sendevet bën në nenin 774 të Kodit Civil, ku thuhet: "*Gjithë gjanat që mund të formojnë objekt zotërimi publik ose privat, janë sende të lujtëshme ose të pa-lujtëshme*".

Sende të lujtëshme. Definisionin e sendevet të lujtëshme na e jep Kodi Civil në nenin 784, ku thuhet: "*Janë të lujtëshme prej naturës së tyre trupat që munden m' u transportue nga një vënd në një tjetër, qoftë se këto luejnë me fuqinë e vetë, si kafshët, qoftë se luejnë me një fuqi të jashtme, si sendet pa shpirt, edhe sikur këto sende të formojnë koleksione ose kapital tregëtie*".

Pos sendevet të lujtëshme prej nature, eksiston dhe një

kategori tjetër sendesh, të cilat cilësohen si të lujtëshme pre ligjës; Neni 785 i Kodit Civil numuron cilat janë sendet që karakterizohen prej ligjës si të lujtëshme.

Sende të pa-lujtëshme. Sende të pa-lujtëshme janë toka dhe çdo send tjetër i bashkuar me 'të naturisht ose artificialisht. Neni 775 i Kodit Civil dallon sendet e pa-lujtëshme në të tilla o prej *nature,* o prej *destinimit* ose prej *objektit të cilit i referohen.*

Janë sende të pa-lujtëshme prej nature — thotë neni 776 i Kodit Civil — tokat, godinat, mullinjtë dhe ndërtesat e tjera që janë të ngulura mbi shtylla ose që formojnë pjesë të një godine.

Simbas nenevet 777, 778, 779 të Kodit Civil konsiderohen gjith' ashtu të pa-lujtëshme mullinjtë, banjat dhe të gjitha ndërtesat e tjera notore, kur këto janë dhe duhet të mbeten të lidhura fortësisht me litar ose me vargje në një breg dhe mbi atë breg ndodhet një godinë postafat e destinueme për shërbimin e tyre; Drunjtë, deri sa nuku rëzohen, frutat e tokës dhe të drunjvet deri sa nuku mblidhen ose këputen, burimet, depozitat uji, dhe remat e ujnavet, si edhe kanalet që sjellin ujrat në një godinë ose në një tokë, konsiderohen dhe këto si sende të pa-lujtëshme.

Quhen *sende të pa-lujtëshme prej destinimit* gjith' ato sende të lujtëshme, të cilat pronjari ja bashkon pronjës për shërbimin dhe kultivimin e saj. Këto sende të lujtëshme cilësohen prej ligjës si të pa-lujtëshme për të bërë më të ngushtë lidhjen q' i bashkon këto sende me pronjën dhe për të ndaluar që të ndahen në dëm të pronjarit. Konsekanca është kjo: në rastin që shitet pronja, konsiderohen dhe këto si të shitura së bashku me pronjën, përveç rastit që eksiston konditë e kundërtë; Gjith' ashtu nuku mundet të sekvestrohen prej kreditorëvet veçanërisht pronjës. Është për të vënë oroé se, që të bëhet i pa-lujtëshme prej destinimit një send i lujtëshme i vënë n' atë pronjë, duhet të vendoset atjé prej vetë pronjarit; Sendet e sjella prej qiramarësit ose prej bujkut e ruajnë gjith' monë karakterin e tyre si të

lujtëshme.

Neni 780 i Kodit Civil numuron sendet e pa lujtëshme prej destinimit, të cilat janë: kafshët e destinuara për lëvrimin e tokës, veglat bujqësore, bari dhe fara q' u jepen qiramarësvet dhe gjysatarëvet, kashta, lëpushkat dhe plehnat, shtrydhoret, kazanet, llambikot, vozat dhe butet dhe gjithë sendet e tjera që pronjari ja ka dorëzuar qiramarësit ose gjysatarit për shërbimin dhe kultivimin e pronjës. Gjith' ashtu janë sende të pa-lujtëshme prej destinimit gjithë sendet e lujtëshme, që zotënuësi ja ka aneksuar një toke ose godine për të mbetur atjé qëndrimisht; Të këtilla janë, thotë neni 781 §2 i Kodit Civil, sendet e ngjitura me gjips, kërqele, shtuk ose tjetër, ose që nuku mund të çkëputen pa u thye ose cënue ose pa çart ose prish pjesën e tokës ose të ndërtesës, së cilës i janë ngjitur. Pasqyrat, kuadrat dhe stoliië e tjera konsiderohen qëndrimisht të bashkueme me ndërtesën, kur këto formojnë një trup me drasoren, me faqen e murit ose me tavanet. Statuet, kur janë të vendosura në një kamare ose mur të bame postafat për 'të ose kur janë pjesë e një ndërtese në mënyrën e sipërtreguar, konsiderohen të pa-lujtëshme.

Sende të pa-lujtëshme prej objektit të cilit i referohen konsiderohen prej ligjës disa sende të pa-trupta, të cilat numurohen prej nenit 782 të Kodit Civil. Këto janë: të drejtat e emfiteodhanësit dhe emfiteomarrësit mbi pronjat emfiteotike, të drejtat e uzufruktit dhe të përdorjes mbi sendet e pa-lujtëshme, si dhe ato të bujtjes, servitudet prediale dhe më në fund padinat që kanë për qëllim marjen në posedim të sendevet të pa-lujtëshme ose të së drejtavet relative me 'to.

Të çquemit të sendevet në të lujtëshme dhe në të pa-lujtëshme ka këto konsekanca pratike:

1. *Forma e jetërsimit.* Jetërsimi me dëshirë bëhet me menyra të ndryshme dhe ndiqen regulla të posaçme për se cilën nga të dy kllasat e sendevet. Kur jetërsohet një pronjë prej atij që nuku është zot-pronjar, *zoti pronjar' i vër-*

tetë mundet t' a revandikojë midis duarvet të vetësuësit.

Për të mprojtur vetësuësin kontra një kësilloj reziku, ligja urdhëron që jetërsimet e sendevet të pa-lujtëshme si dhe kushtituimi i të drejtavet reale të pa-lujtëshme, kur këto bëhen me akte midis të gjallëvet, duhet t' i shtrohen *publicitetit*, kështu që ay, i cili vetëson një pronjë të mundë të informohet mbi origjinën dhe mbi gjërësinë të së drejtës të jetërsuësit.

Për kundrazi jetërsimet e sendevet të lujtëshme nuku i shtrohen as një publiciteti. Ay që me mirëbesim vetëson një send të lujtëshme nuku ka frikë se xhvishet nga ajo e drejtë, qoftë dhe kur ay që ja jetërsovi nuku ishte zoti i vërtetë i sendit; Vetësuësi mprohet prej faktit se posedimin e ka me mirëbesim, simbas nenit 1065 të Kodit Civil.

2. *Posedimi i sendevet të pa-lujtëshme* mprohet prej padiesh speciale, të cilat janë padiet posedimore, që i janë akorduar posesorit pa u marë parasysh në se është ose jo pronjar i sendit të pa-lujtëshmë.

Krejt e kundërta ngjet me sendet e lujtëshme, posesori i të cilavet nuku ka padie posedimore, për të cilën as që ka nevojë, massi i mjafton fakti që të ketë posedimin me mirëbesim të sendit, që të konsiderohet si zot *(neni 1065 i Kodit Civil)*.

3. *Uzukapioni* ose, ndryshe, *parashkrimi vetësimtar* ka një rol dubël në sendet e pa-lujtëshme. Më njërën anë, ay që me mirëbesim vetëson një send ose një të drejtë reale mbi një t' atillë send me fuqiën e një titulli q' âsht transkriptue regullisht dhe që nuku është nul për të meta formu, bëhet pronjar massi të posedojë dhjetë vjet të pakëtën qysh prej datës të transkriptimit të titullit *(neni 2037 i Kodit Civil)*. M' anën tjatër, ay që posedon qoftë dhe me keq besim një send të pa-lujtëshme, fiton zotërimin e atij sendi massi të kalojnë tridhjetë vjet (neni 2034 i Kodit Civil).

Në sendet e lujtëshme aplikohet vetëm parashkrimi vetësimtar tridhjetëvjetuer, pa u marë para sysh as pak mun-

gesa e mirëbesimit (*neni 2034 i Kodit Civil*). Por, kur posesori i sendit të lujtëshmë e ka posedimin e sendit me mirëbesim, ky fakt mjafton që t' a bëjë zot (*neni 1065 i Kodit Civil*)

4. *Vetëm sendet e pa-lujtëshme mundet të ipotekohen*, në parim. Sendet e lujtëshme dhe vleftat e lujtëshme lihen *peng* për të siguruar një detë.

5. *Jetersimi i sendevet të pa-lujtëshme të të pa-zotëvet* është mbështjellë me disa formalitete, të cilat nuku lypen për jetërsimin e sendevet të lujtëshme të tyre.

6. *Gjykatë kompetente* për gjykimin e një padieje, që ka për objekt një send të pa-lujtëshme, është ajo në qarkun e juridiksjonit të së cilës ndodhet pronja (*forum rei sitae*). Për kundrazi, kur objekt' i padies është një send i lujtëshmë, kompetente është gjykata e banimit të të padituit (*nenet 15 dhe 29 të shtojcës së dytë të Procedurës Civile*).

§ 50. — Sende të pjesëtuëshme, sende të pa-pjesëtuëshme.

Sende të pjesëtuëshme janë ato, që mundet të pjesëtohen në sende të tjera më të vogla, pa që t' u damtohet as lloji, as vlefta, kështu që mbeten copra lë njëjta nga pikpamja e lândës, por të ndryshme vetëm nga sasia, si për shëmbëll: një arë, vera, vaji e tjera. Pjesëtimi i sendevet ka rrëndësi kur eksistojnë shumë bashkëzotënuës. Bashkëzotërimi i sendevet, që janë *naturisht* ose *juridikisht* të pa-pjesëtuëshme, është në pjesa të pa-ndara (*partes pro indiviso*), domethënë në pjesa *ideale* të sendit.

Shumica e sendevet të lujtëshme janë të pa-pjesëtuëshme, si për shëmbëll: masat, henët, statuet, librat dhe gjithë sendet që luejnë me fuqinë e vetë, si kali, kau etjera.

Prej sendevet të pa-trupta janë të pa-pjesëtuëshme *përdorja* edhe *bujtja*, shpesh herë dhe obligimet, si për shëmbëll *obligimi më bâ*. Janë të pjesëtuëshme *uzufrukti, enfiteozi* si dhe shumica e obligimevet.

KAPTINA Ç.

§ 51. — Sende Kryesore, sende aksesore.

Regullisht çdo send është objekt të drejte indepedent. Por, shpesh herë një send pason një tjetër si aksesor. *Aksesor* quhet sendi independent, i cili i bashkohet një sendi tjetër në mënyrë të përhershme për lehtësimin ose forcimin e përdorimit tii, tue u konsideruar kështu si pjesë e sendit kryesor. Aksesor mundet të ketë, i lujtëshmë ose i pa lujtëshmë qoftë sendi.

Të çquemit e sendevet në kryesore dhe në aksesore ka konsekanca pratike, massi në kontraton e shitjes ose në trashëgimin të një sendi, për shëmbëll të një shtëpije, lind çështja se cilat bëjnë pjesë të sendit. Aksesore mundet të jenë sende të lujtëshme, si për shëmbëll çelsat, llozet ose të pa-lujtëshme, si truall etjera. Në sendet aksesore ka aplikim regulli: "*accessorium sequitur principalis*" domethënë sendi aksesor pason sendin kryesor.

Posë kuptimit të sendit aksesor, kemi dhe atë të akcedimit. *Akcedim* quhet e drejta, me fuqin e së cilës i zoti i një sendi fiton zotërimin e çdo sendi tjetër që bashkohet ose njëtrupëzohet me të, qoftë naturisht, qoftë artificialisht, i lujtëshmë ose i pa lujtëshmë qoftë sendi kryesor, si për shëmbëll: frutat, aluvionet, ishullat dhe ishullëzat si dhe të mbushmet dheu që formohen në shtretnat e lumënjvet e të përënjvet t' afta për lundrim ose bartje, etjera. *(Nenet 801, 804 etjera të Kodit Civil).*

§ 52. — Frutat.

Fruta quhen produitë periodike që mundet te japë një send pa ju cënuar substanca. Pra, sendet që mbijnë nga toka, vé-të të zogjvet, qumështi, pjellat edhe leshi i kafshëvet janë fruta; Gjith' ashtu fruta janë qiratë e pronjavet, kamatat e kryegjëvet.

Neni 802 i Kodit Civil i ndan frutat në dy kategori;

në fruta naturale dhe në fruta civile.

Fruta naturale janë ato që rjedhin drejt-për-së-drejti prej sendit, edhe sikur të mos konkurojë në 'to industria e njeriut, si drithnat, bari, drutë, pjellat e kafshëvet dhe produktet e gurorevet.

Frukta civile janë ato që nxiren rastësisht prej sendit, si kamatat e kryegjavet, kanonet enfiteotike dhe çdo rantë. Qiratë e çdo lloji të pronavet hyjnë në kategorinë te frutavet civile.

Frutat quhen të pa *çkëputme (fruktus pendentes)* deri në çkëputjen e tyre nga sendi; Para se të çkëputen formojnë një me sendin dhe nuku mundet të jenë objekt akti juridik të veçantë, përveç se si sende të arthme. Massi frutat të ndahen nga sendi quhen të *çkëputme* dhe për atë që i çkëputi me dorën e vetë ose me anën e të prepozuemvet të tij me qëllim që të vetësojë posesion' e tyre, quhen fruta të mbledhura *(fruktus percepti)*.

Frutat civile quhet se fitohen dita-ditës.

KAPTINA D.

§ 53. — Pasunia.

Pasuni *(patrimonium)* quhet tërësia e të drejtavet dhe detyravet pasurore të një persone. Në pasuninë përmblidhen si të drejtat reale ashtu dhe ato të kreancavet dhe të drejtat e trashëgimit. Gjith' ashtu janë pasuni dhe posesioni, si e drejtë subjektive, si dhe të drejtat me afat dhe ato të mvarura nga një konditë. Me termën pasuni duhet të kupëtojmë tërësisht pasuninë aktive dhe gjith' ashtu tërësisht pasuninë pasive, domethënë fitime dhe dëme së bashku.

Nuku janë pasuni shpresat, si për shëmbëll: shpresa e një trashëgimi legjitim të arthmë, kur ay që ka m' u trashëgue rron, nuku është pasuni.

Mbetën jashtë kuptimit të pasunisë gjith' ato të drejta që nuku kanë një karakter pekuniar ose të çmuëshme në

të holla; Të tilla janë: të drejtat e families, pushteti atenor, pushteti i burit dhe të drejtat e bashkuara me njerinë ose të drejtat publike.

Pasunia formon një tërësi, *një universalité juridike* independente nga elementat që e përbëjnë. Ndryshimet që bëhen në numurin e gjithë këtyre elementavet, shtimet ose pakësimet të aktivit ose të pasivit, nuku cënojnë karakterin e këtij *universaliteti juridik*. Por, pasunia eksiston akoma dhe kur nuku ka as të drejta, as obligime; Fëmia që lindet ka dhe ajo një pasuni; Çdo personë ka nevojërisht një pasuni. Konsekancat e këtij koncepti të pasunisë janë këto dy:

1. Simbas nenit 1881 të Kodit Civil *"pasunia e debitorit formon garanci të bashkëtë për kreditorët e tij"*, të cilët kanë të drejtë të sekvestrojnë dhe të shesin pasuninë e tij në qoftë se nuku eksekuton obligimet e tija. Por kjo garanci që kanë kreditorët, e kanë mbi *pasuninë* si tërësi dhe mbi këtë ose mbi atë send te caktuar të debitorit. Pra, në qoftë se një nga elementat që përbëjuë pasurinë e debitorit pushon të bëjë pjesë të pasunisë së tij, për shkak se ky e shiti ose ndryshe e jetërsovi, debitorët nuku mundet të venë dorë mbi 'të.

2. Kur vdes persona, pasunia konservon njësinë e saj, dhe, nënë emërin e trashëgimit, vete në duart e trashëgimtarëvet të të vdekurit.

Trashëgimi mundet t'i vejë një ose shumë persosavet. Kjo mundet të bëhet qoftë më trashëgim legjitim *(ab intestato)*, qoftë me trashëgim testamentar.

Në trashëgimet ab intestato ligja cakton se cilat janë personat që thiren për të mbledhur trashëgimin, prandaj ky trashëgim quhet legjitim.

Në trashëgimin testamentar vetë i zoti i pasunisë tregon personat, në të cilat dëshëron të tranferojë të drejtat e tij. Ky tranferim aplikohet jo vetëm në të drejtat, por dhe në detyrat.

Tranferimi i së drejtavet bëhet ose *me titull partikollar*, kur suksesori vetëson shumë ose një të drejta të çak-

tuara, ose *me titull universal*, kur suksesori fiton tërësinë, *universalitetin* e të drejtavet të një persone ose një pjesë të kësaj tërësije.

Tranferimi i pasunisë me titull universal bëhet vetëm në kohën e vdekjes, domethënë me titull trashëgimi. *Suksesori me titull universal* më nj' anë mer gjithë të drejtat e *de cujus*-it, dhe m' anën tjetër detyrohet të paguajë gjithë obligimet që detyronte ay.

Suksesorë me titull universal janë: *trashëgimtarët legjitimë dhe gjithë trashëgimtarët e tjerë që thiren prej ligjës në trashëgimin e të vdekurit; Legatarët universalë ose me titull universal.* Si mbas dispozitave të nenit 1118 të Kodit Civil "*konsiderohet se çdo kontraktuës ka stipullue për vehten e tij, për trashëgimtarët, si dhe për ata që heqin të drejta nga ay*", kështu, pra, mundet të thuhet se suksesorët me titull universal kanë qënë të përfaqësuar prej personës, nga e cila heqin të drejta; kjo do me thënë se gjithë aktet juridike të këtij, parimisht, u janë të dobishme ose të dëmshme. Por,. ligja u njeh suksesorëvet universalë të drejtën të shpëtojnë nga konsekancat e këtij përfaqësimi dyke renoncuar trashëgimin ose dyke e pranuar me beneficin e inventarit.

Suksesorë me titull partikollar janë giithë ata, të cilët fituan nga i zoti, ose që në gjalljen e tij, si për shëmbëll donatarët, blerësit, ose me vdekjen e tij, si për shëmbëll legatarët, një të drejtë të çaktuar. Suksesorët me titull partikollar nuku janë të detyruar të paguajnë detat e të vdekurit, nga i cili heqin të drejtat; Detat rëndojnë pasuninë tërësisht dhe jo veçanërisht të drejtat që vetësuan suksesorët me titull partikollar.

§ 54. — Shpenzimet.

Shpenzimet që mundet të bëhen mbi një send janë ose të *nevojshme* ose *të dobishme* ose *luksuoze.*

Shpenzime të nevojshme quhen ato, pa të cilat sendi humbet ose keqësohet, si për shëmbëll: goditja e një muri,

që është gati të rëzohet dhe të shkakëtojë rëzimin e gjithë godinës, goditja e hendekevet për të mprojtur pronjat nga ujrat e lumit, të mbjellunit e drunjvet të rea, në vënt t' atyrevet të prishura.

Shpenzime të dobishme quhen ato me të cilat sendi përmirësohet, domethënë shtohet vlefta ose të ardhurat e sendit, si për shëmbëll, futja e kafshëvet në arë për t' a plehruar.

Shpenzime lluksuoze quhen ato, të cilat kryesisht bëhen për kënaqësi dhe zbukurim, por mundet të jenë dhe të dobishme, si për shëmbëll: një kopësht me lëndinë, një godinë e zbukuruar me mermere, me kollonada, me piktura. Kodi Civil nuku bën fjalë për këtë lloj shpenzimi.

Të çquemit të shpenzimevet në të nevojshme dhe të dobishme ka këto konsekanca pratike.

Simbas nenit 1063 të Kodit Civil, posedüesit, me mirëbesim ose me keqbesim qofshin, mund të pretandojnë për përmirësimet e bëra prej tyre vetëm shumën ma të vogël midis *shpenzimevet* dhe vleftës së shtueme me ato përmirësime.

Si mbas nenit 1064 të Kodit Civil, vetëm posedüesi me mirëbesim ka të drejtë me ndalë sendet e poseduemë për shkak të përmirësimevet që ka bërë me të vërtet dhe që eksistojnë, në qoftë se në vazhdimin e gjyqit për revendikim ka kërkuar pagimin e këtyre përmirësimevet dhe ka dhënë një farë prove për eksistencën e tyre përgjithësisht. Kjo është një e drejtë personale që ligja i ka akorduar posesorit kontra pronjarit revandikuës.

Për sa u përket shpenzimevet luksuoze, në rastin që këto kanë sjellë përmirësim në sendin, do të aplikohen dispozitat q' u përkasin këtyre përmirësimevet; Por, në rastin që këta nuku i kanë sjellë no një përmirësim sendit, massi pronjëtari nuku u begatua, posesori nuku ka të drejtë të kërkojë dëm-shpërblime për shpenzimet luksuoze të bëra.

KAPTINA E.

§ 55. — Monedha.

Lëvizja e pasurisë bazohet, në pjesën e saj më të madhe, në *këmbimin* domethënë në dhënien e një sendi kundrejt një tjetri Nga nevoja e lehtësimit të lëvizjes të këtij këmbimi mburon njojtja e një mjeti të përgjithëshme këmbimi domethënë të një sendi, të cilin të gjithë e pranojnë kënaqësisht, massi janë të sigurtë se atë munden t' a këmbejnë me çdo send që të dëshërojnë. Pra, ky mjet këmbimi i përgjithëshmë është *monedha* ose ndryshe *paraja.*

Monedha do të mos ishte e mundur të sillte këtë shërbim, po mos të qé e aftë që të formojë bazën të matjes dhe të caktimit të vleftës të sendevet të tjera. *Monedha është massa komune e vleftës dhe shërben për të eksprimuar vleftën pasurore të thjeshtë ose ideale.*

Shumë obligime kanë për përmbajtje një vlefte pasurore të thjeshtë; Për shëmbëll: obligimet prej huaje, prej çmimi shitjeje të detyruar, prej veprimi të pa-ligjëshmë, prej kambiali, prej tatimesh janë që të gjitha obligime të thjeshta vlefte ose sasie. Monedha është sendi me të cilën përmbushen obligime të thjeshta vlefte.

Kur themi *pagim* në kuptimin e përmbushjes të një detyre, duhet të kupëtojmë larjen e një obligimi të thjeshtë vlefte me monedhë. Nga kjo pik-pamje monedha është dhe *mjet i përgjithëshmë pagimi.*

Fjala *monedhë* duhet të meret me dy kuptime: të gjerë dhe të ngushtë.

A. — Monedhë, *në kuptimtn e gjërë të fjalës,* quhet masa e njohur e vleftës dhe sjellësi i kësaj vlefte në marëdhëniet.

Monedhë në kuptimin e gjërë të fjalës nuku janë vetëm monedhat vëndëse, por dhe bonot e Shtetit dhe banka-notat. Pos këtyrevet, monedhë në kuptimin e gjërë të fjalës janë dhe monedhat e huaja dhe banka-notat të pranuara

dhe të njohura efektivisht në marëdhëniet.

B. Monedha, *në kuptimin e ngushtë të fjalës,* bazohet në dispozitat ligjore të Shtetit. Monedhë në kuptimin e ngushtë është ajo, të cilën jemi të detyruar t' a marim, monedha e Shtetit e njohur si sjellës vlefte me dispozita ligjore, *mjeti ligjorisht i njohur për pagimin e detavet.* Me një fjalë monedhë quhet ajo, të cilën një kreditor, q' i detyrohet vlefta e një sendi, është i detyruar t' a pranojë.

Konsekanca e këtyrevet është qarkëllimi i detyrueshme, në kuptimin se këto sende duhet të meren në vënd të vleftës të sendit. Qarkëllimi i nevojëshmë mundet të bazohet në ligjë ose në zakon.

Kur një dispozitë ligjore bën fjalë për *monedhë,* për të çquar në se ligjëvuësi e ka përdorur fjalën në kuptimin e gjërë ose të ngushtë, duhet *t' a interpretojmë,* domethënë t' a nxjerim nga përmbajtja dhe nga qëllimi i dispozitës.

Shumë ligja — civile, tregëtare, proceduriale — bëjnë fjalë për monedhë në kuptimin e gjërë.

Kemi tre lloj monedhë:

1. Monedha e tregut, e cila është e pranueshme në marëdhëniet për çdo pagim.

2. Monedha e vogël, e cila shërben për pagime të vogla, dhe

3. Banka-nota, vlefta e së cilës në realitet mvaret nga njojtja e tyre. Banka-nota ka si parasypozim një monedhë tjetër dhe referohet në një shumë monedhe metalike.

Gjith' ashtu në monedhat duhet të çquhen:

a') *Vlefta nominale e monedhës,* e cila tregohet nga gravura dhe në banka notat nga forma.

b') *Vlefta metalike* ose *thelbësore* (*intrinsèque*), e cila caktohet nga sasia e metalit të vyer, që përmban monedha. Ky element naturisht mungon nga banka-notat edhe nga kartë-monedhat përgjiihësisht.

c') *Vlefta këmbyëse* ose *ecëse* e monedhës, e cila është ajo që ka paraja e çdo lloji në krahasim me tjetër në për marëdhëniet. Në këtë rast duhet të çquhet vlefta e monedhës në Borsë nga ajo që ka në për marëdhëniet e vogla.

§ 56. — Valutat

Posë monedhës eksistojnë dhe të tjera mjete pagimi, të cilat kanë këtë karakteristik të bashkëtë: sjellësit e vleftës së tyre janë dokumenta të shkruara.

Kësilloji dokumenta të shkruara ose letra, në të cilat shtrohet një e drejtë pasurore, mundet të formullohen me shumë mënyra. Ka dokumenta kësilloji, që formojnë vetëm një mjet provuës të së drejtës ose krijimit të përmbajtjes tyre, si për shëmbëll është dëftesa që mer huadhënësi prej debitorit tij; Ka dokumenta të shkruara që përmbajnë dekllarimin e vulnetit të palëvet relativisht me të drejta pasurore, si për shëmbëll kontrata e shitjes e nënëshkruar prej palëvet. Mundet që dokumenta të jetë përherësisht e bashkuar me të drejtën pasurore, kështu që nga dokumenta të mvaret eksistenca dhe ushtrimi i pushtetit real dhe juridik, si për shëmbëll ngjet me kartë-monedhat dhe me *obligasionet (në kuptimin financiar të fjalës).*

E drejta e bashkuar me kartën mundet të jetë ose një e drejtë kreance, si për shëmbëll *bankë-notë, çek, kambjal,* ose e drejtë e rjedhur prej shoqërie, si për shëmbëll *aksion,* ose e *drejtë pengu.*

Valutat ose ndryshe vleftat janë *nominative* ose *anonime.* Kur në valutat nuku caktohet persona që ka të drejtën, at' here e drejta shprehimisht ose heshtësisht është e sjellësit. Simbas dispozitavet të nenit 1065 të Kodit Civil *"për titujtë te pruësi, posedimi i të tretevet me mirëbesim ka efektin e titullit në favor të këtyre".*

Në titujtë nominative caktohet shprehimisht emëri i personës që e ka të drejtën, dhe në këtë rast transferimi bëhet me *cedim.*

Kur e drejta i akordohet një persone të caktuar, si dhe personës që ka për t' u caktuar prej saj, letra quhet *në urdhër,* si për shëmbëll: *do t' i paguanj zotit* **A** *ose në urdhërin e tij.* Në këtë rast pruësi i parë i titullit mundet t' a transferojë me andosëman *(endossement)* titullin.

PJESA E KATËRTE

KAPTINA A.

Theori' e Përgjithëshme e Aktevet Juridike.

Krijimi, ndryshimi dhe të shuemit e të drejtavet.

§ 57. — Nosione të përgjithëshme.

Për krijimin, ndryshimin ose të shuemit të një të drejte, duhet të realizohen ato ngjarje, me të cilat ligja lith krijimin, ndryshimin ose të shuemit e një të drejte; Këto ngjarje quhen *ngjarje juridike*, domethënë ngjarje, të cilat nga pik-pamja juridike kanë rëndësi. Për shëmbëll: i premtonj **A** një mijë franga dhe ky e pranon premtimin t' im. Në këtë rast **A** fiton një të drejtë, e cila krijohet me fuqinë të konvencionit të bërë midis meje dhe **A**. Ky konvencion quhet *ngjarje juridike*. Tjetër shëmbëll: Thirem në një trashëgim dhe deklaronj se e pranonj këtë; Me këtë deklarimin t' im fitonj një të drejtë. Deklarimi i jem është një ngjarje juridike. Po të meret para-sysh shkaku i ngjarjevet, këto çquhen në *vepra* dhe në *fakte*.

Vepra juridike quhen ato, që lindin nga vulneti i lirë i njeriut dhe bëhen me qëllim krijimin, ndryshimin ose të shuemit të një të drejte.

Fakte juridike quhen gjith' ato ngjarje që tërheqin krimin, ndryshimin ose të shuemit e të drejtavet, pa patur nevojë për ndërhyrjen e një vulneti, domethënë ngjarjet independente nga vulneti i njeriut; Faktet juridike ndahen në dy kategori:

1. Fakte independente, të pa vartuna nga as një vulnet i njeriut, domethënë ngjarjet naturale ose akcidentale që tërheqin konsekanca juridike, si për shëmbëll, janë *lindja*, me të cilën fillon personaliteti domethënë zotësia për me pas të drejta dhe detyra, dhe *vdekja*, që është fundi i personalitetit dhe ka si konsekancë pjesëtimin e pasurisë të

de cujus-it. Gjith' ashtu *mituria, gjinia* dhe *kalimi i kohës;* Me këtë të fundit fitohen ose shuhen të drejta.

2. Faktet që rezultojnë nga vulneti i njeriut — ose nga mungesa e këtij vulneti ose nga pa-kujdesia — por pa nonjë qëllim nga an' e këtij që t' i bëjë të sjellin efekte juridike dhe të cilavet ligja u jep këtë konsekancë, si për shëmbëll: *deliktet* dhe *gati deliktet*, domethënë veprat e pa ligjëshme q'i shkakëtojnë dëm një të treti. Këto fakte kanë si rezultat krijimin e një të drejte në favor të viktimës kontra shkakëtarit të dëmit.

§ 58. — Krijim të drejtash

Një e drejtë krijohet kur gjithë parasypozimet e lypuna prej ligjës eksistojnë. Nga kjo del konsekanca se për krijimin e së drejtës nuku mjafton vetëm realizimi i ngjarjes, por duhet të konkurojë edhe ligja.

§ 59. — Vetësim të drejtash.

Vetësim, ose ndryshe *fitim të drejte quhet lidhja e kësaj me një personë të caktuar.* Një përsonë që të fitojë një të drejtë duhet që pik së pari fitimi i kësaj të drejte të jetë *ligjorisht* i mundur dhe më pas të realizohen gjithë ato ngjarje, që, si mbas ligjës, kanë fuqinë të sjellin fitimin e kësaj të drejte. Për shëmbëll: një personë dëshëron të fitojë të drejtë pengu mbi një njeri, por, massi kësilloj pushteti nuku njihet prej së drejtës, nuku munt të fitohet. Tjetër shëmbëll: Një njeri dëshëron të fitojë të drejtë ipoteke mbi një pronjë me *konvencion verbal*; Në këtë rast dhe pushteti njihet prej së drejtës dhe persona ka zotësinë të fitojë të drejtën e ipotekës, por, ngjarja me të cilën kërkon t'a bashkojë të drejtën, domethënë *konvencioni verbal*, nuku mjafton për fitimin e një kësilloj të drejte, massi si mbas dispozitavet të nenit 1911 të Kodit Civil "*ipoteka konvencionale duhet të kushtituhohet me akt-publik ose me shkresë private.*"

Thamë më sipër se për fitimin e një të drejte duhet të realizohen gjith' ato ngjarje — *ngjarjet juridike* — me të

cilat ligja lith këtë fitim. Këto ngjarje janë ose *veprim* i vulnetit të atij q'e ka të drejtën, si për shëmbëll: **A** gjen një send *të lânun doret (res derelicta)* dhe me pushtimin bëhet zot i gjësë së gjetun, si mbas dispozitavet të nenit 1067 të Kodit Civil; Në këtë shëmbëll **A** fitovi të drejtën e zotërimit me një veprim të vulnetit tij. Ose janë të tjera *ngjarje independente nga vulneti i personës*, si për shëmbëll: Vdes **A**, dyke lënë trashëgimtarë legjitime, të cilët fitojnë *ipso jure* posedimin e trashëgimit, simbas dispozitës të *nenit 653 të Kodit Civil;* Në këtë rast trashëgimtarët fitojnë të drejtën e posedimit të trashëgimit nga një ngjarje independente prej vulnetit të tyre, domethënë nga vdekja e *de cujus*-it **A**. Ose, në fund, mundet të jenë që të *dyja së bashku*, domethënë dhe veprimi i vulnetit t' atij q' e ka të drejtën dhe ngjarje të tjera independente, si për shëmbëll: Vdes **A** dhe lé një trashëgimtar, i cili, simbas dispozitavet *të neneve 656 dhe 661 të Kodit Civil*, dekllaron se e pranon trashëgimin; Në këtë rast trashëgimtari fiton të drejtën prej një ngjarjeje independente nga vulneti i tij, që është vdekja e *de cujus*-it **A** dhe prej veprimit të vulnetit tij, domethënë prej deklarimit për pranimin e trashëgimit.

Fitimi i së drejtës mundet të jetë *origjinal*, kur, ay që e ka të drejtën, nuku e bazon mbi të drejtën e një persone, si për shëmbëll: fitim zotërimi me pushtim. Përkundrazi fitimi quhet *derivatif*, kur bazohet në një të drejtë, e cila eksistonte tek i zoti i parë (*auctor*), si për shëmbëll në fitimin e zotërimit prej blerjeje.

Në fitimin derivatif të së drejtës zbatohet regulla: "*kur-kush nuku munt t' i transmetojë tjetrit të drejtë më të madhe nga ajo që ka vetë*", për të cilën juristët romanë theshin: "*nemo plus juris ad alium transferre potest, quam ipse habet*". Kjo domethënë se ay që nuk ka të drejë nuku mund të transferojë, ose ay që ka një të drejtë të vësuem ose të kufizuar, kështu dhe do t' a transferojë. Ay që fiton një të drejtë me mënyrën derivative, fiton bashkë me 'të dhe të drejtat që e pasojnë; Për shëmbëll: Bleva dhe m' u

dorëzua një shtëpi, së cilës u bëra zot, por, bashkë me shtëpinë fitova dhe servitudet që shtëpija ime ka si *pronjë zotnuëse* mbi *pronjat shërbyëse* fqinje; Ose më cedohet një kreancë, por bashkë me këtë fitonj dhe garancitë dhe ipotekat, në qoftë se ka, q' e sigurojnë atë kreancë.

Në fitimin e të drejtavet me mënyrë derivative ose 1) mbi të drejtën që eksiston krijohet një e drejtë, si për shëmbëll: pronjari ngarkon pronjën e vetë me një servitudë, me një ipotekë, domethënë mbi të drejtën e zotnimit tij krijohet një e drejtë tjetër, servitude, ipoteke, ose 2) një e drejtë që eksiston transferohet sikundër është, tërësisht ose pjesërisht, në një tjetër personë, kështu që vetëm subjekti i së drejtës ndryshohet, si për shëmbëll: në shitjen. Ky rast i dytë quhet *suksedim (successio)*, massi ay që e fiton të drejtën është suksesor' i zotnuësit të mà parëshme (*auctor*).

Regullisht gjithë të drejtat mundet të ndryshojnë subjektin e tyre, të fitohen me suksedim, qofshin dhe të drejta familiare, si për shëmbëll, pushteti atënor me adoptimin. Por, ky regull ka dhe përjashtime: të tilla janë disa të drejta të lidhura ngushtë me personalitetin (*jura personalissima*), të cilat nuku mundet të tranferohen; Për shëmbëll: tytoria, të drejtat e bashkëshortevet, servitudet personale etjera.

Suksedimi në *të drejtat pasurore* është ose i *posaçmë* ose *i përgjithëshme.*

1. Suksedimi i posaçmë eksiston kur transferohen pjesa pasurore — të drejta kreance ose reale — të caktuara individualisht.

2. Suksedim' i përgjithëshmë eksiston, kur tranferohet një tërësi pasurore — aktive dhe pasive — ose një pjesë e saj, por gjith' monë përjashtohen të drejtat të lidhura ngushtë me personën. Shëmbëll suksedimi të përgjithëshme është ay i një trashëgimtari në pasurin' e *de cujus*-it.

Tjetër klasifikim i fitimit të drejtavet është në *fitimprurëse* dhe në barësore (*lucrativa, onerosa*). Fitimprurës quhet kur, për fitimin e së drejtës, nuku bëhet nonjë *kun-*

dërprestim, sikundër ngjet në dhurimin dhe në trashëgimin; Nuk është fitimprurës, kur për të drejtën e fitueme jepet një kundër-prestim, si për shëmbëll ngjet në këmbimin, në shitjen e tjera.

§ 60. — Ndryshim të drejtash.

Ndryshim të drejte ngjet, kur kjo mbetet e njëjtë në substancë si më parë, *por ndryshovi disa cilësira* Pra, me qënë se e drejta nga pik-pamja e substancës është sikundër ishte më parë, do të zbatohen mbi 'të gjithë ato regulla, që aplikoheshin dhe më parë. Kështu, pra, në rastin që e drejta ishte e siguruar me garanci ose ipotekë, garancia dhe ipoteka mbeten prapë dhe në rastin që vjen një ndryshim i së drejtës.

Të drejtat ndryshohen massi të realizohen ngjarjet e lypuna prej ligjës për ndryshimin e së drejtës. Ndryshimi i së drejtavet mundet të ngjasë ose *në përmbajtjen* — sasi, kalitet — ose *në subjektin.* Shëmbëll: **A** më detyron 1000 franga dhe nuku m' i paguan në afat, kështu që ecin kamatat e caktuara që më parë; kam, pra, për të marë kryegjënë dhe, mbi 'të, kamatat. Në këtë shëmbëll ndryshimi i së drejtës ngjavi në sasi. Tjetër shëmbëll: **A** më detyron 1000 franga dhe më paguan vetëm 500 franga; Ndryshimi dhe në këtë rast ngjavi në sasi.

Tjetër shëmbëll: Pushteti që mburon nga një e drejtë reale është *negatif* dhe që të gjithë janë të detyruar mos më çyt'n në të drejtën t' ime reale; Por, në rastin që kjo e drejta ime reale çytet, at' here e drejta ime ndryshohet dhe bëhet *pozitive*, domethënë kam të drejtë të kërkonj të më ngëthehet sendi i jem. Në këtë shëmbëll ndryshimi ngjavi në kalitetin e së drejtës. Ose **A** detyrohet të më dorëzojë një kalë; Në qoftë se nuku m' a dorëzon, se e humbi, bie fjala, detyrohet të më paguajë vleftën e kalit; Dhe në këtë shëmbëll e drejta u ndryshua në kalitet, massi në vënt të kalit më detyrohen të holla.

Thamë më sipër se ndryshimi i së drejtës mundet të

ngjasë dhe në subjektin e së drejtës, në personën të atij që e ka të drejtën — në kredinat — ose të debitorit, si dhe në transferimin e së drejtës në shumë persona, rast ky i fundit, në të cilin e drejta ndahet midis tyrevet. Gjith' ashtu eksiston ndryshim' i së drejtës në personën, kur në të drejtën futet një kreditor i rri ose një debitor i rri, si për shëmbëll ngjet me cedimin e kredivet.

§ 61. — Shuemja e së drejtavet.

Shuemje të drejte quhet zgjidhja e të drejtës nga persona, me të cilën ishte lidhur deri tash. Shuemja e së drejtës shumë herë koincidon me humbjen e sendit. Por, kjo humbje nuku është e nevojëshme për shuemjen e së drejtës, e cila pa u cënuar as pak në substancën e saj mundet të bjerë në dorën e një persone tjetër, si, për shëmbëll, me *pushtim.* Të shuemit e së drejtës mundet të jetë:

A. - *Shuemje të drejte subjektive,* kur kjo ngjet në personën që e gëzonte deri tash dhe e drejta ndryshon vetëm zot, pa pushuar që të eksistojë, si për shëmbëll: I zoti i një pronje jetërson të drejtën e zotnimit tij që ka mbi këtë pronjë në favor të një tjetri; Në këtë shëmbëll kemi humbje të drejte, po jo dhe shuemjen të 'saj.

Shuemje të drejte objektive, kur humbja ngjet në të drejtën vetë, domethënë kur e dreita, e cila eksistonte në një personë, të pushojë së qëni, si për shëmbëll: aqitimi i një kreance me pagim, humbja e së drejtës zotërimit me prishjen e sendit, e tjera.

B. - *Shuemje të drejte ipso jure,* gjë e cila ngjet kur e drejta shuhet me t' u realizuar ngjarja shuhëse, si për shëmbëll: kërkimi prej huaje shuhet *ipso-jure* me të paguar debitori të hollat.

Shuemje të drejte me anë prapsimi (ope exceptionis), e cila ngjet kur e drejta nuku shuhet drejt-për-së-drejti, por kur, për shkak të një ngjarjeje, njëri nga kontraktantët mund t' a atakojë atë dhe t' a çduknjë me anë padije ose prapsimi; Në këtë rast e drejta eksiston deri sa të atakohet. Për

shëmbëll: në qoftë se debitori ka kontra kreditorit prapsimin e kompensimit, e drejta e kreditorit shuhet me t' a propozuar debitori këtë prapsimin e tij.

§ 62. — Ngjarje juridike.

Ngjarje juridike quhen ato, me të cilat ligja lith krijimin, humbjen ose ndryshimin e një të drejte, domethënë ngjarje juridike janë ato, të cilat lypen prej ligjës për krijimin, ndryshimin ose humbjen e një të drejte.

Në ngjarjet juridike janë për t' u vënë oroe posaçërisht këto:

A. Për t' u krijuar, ndryshuar ose humhur një e drejtë nuku lypen shumë ngjarje, *mjafton dhe vetëm një e tillë.* Për shëmbëll: me pushtimin e një sendi të lanun doret fitohet zotërimi mbi 'të. Kur konkurojnë shumë ngjarje, at' here këto mundet të mos koincidojnë në kohë, si për shëmbël: në *uzukapion* ose *parashkrimin vetësimtar.*

B. Ngjarjet juridike mundet të jenë: *Pozitive,* kur nga eksistenca e tyre mvaret krijimi, ndryshimi ose humbja e një të drejte. *Negative,* kur nga mos eksistenca e tyre mvaret krijimi, ndryshimi ose humbja e së drejtës, si për shëmbëll: shuemja e së drejtës më parashkrim është një ngjarje juridike negative, massi të shuemit e së drejtës shkakëtohet nga mos ushtrimi i saj prej atij q' e ka, brënda në një kohë të caktuar.

C. Ngjarjet juridike nuku është nevojë t' a sjellin nj' herjesh rezultatin e tyre, massi ky mundet të vonohet deri sa të realizohet një ngjarje tjetër, sikundër ngjet me *modalitetet* – konditë, afat; Për shëmbëll: **A** do të më japë 1000 franga, po të vijë anija nga Amerika.

Ç. Ngjarjet juridike mundet të referohen në këto kategori:

a') Në deklarimin e vulnetit të personës dhe në këtë rast quhen *akte juridike.*

b') Në deklarimin e vulnetit të gjyqtarit, dhe

c') në gjithë ngjarjet e tjera, dhe në këtë rast bëhet

fjalë për krijim, ndryshim ose humbje të ligjëshme të drejtash.

Këtu në parimet e përgjithëshme nuku do të bëhet fjalë për gjithë ngjarjet juridike, por vetëm për ato që nevojitin vrejtje të përgjithëshme dhe këto janë:

I. *Aktet juridike.*

II. *Veprimet e kontraligjëshme,* dhe,

III. *Kalimi i kohës.*

§ 63. — Aktet juridike.

Akt juridik quhet deklarimi i një vulneti individual të bërë me qëllim krijimin, humbjen ose ndryshimin e ligjëshmë të një të drejte; Domethënë: në qoftë se një personë dëshëron të krijohet, të humbasë ose të ndryshohet një e drejtë dhe këtë dëshirë, këtë vulnetin e saj e manifeston me një deklarim, at' here ky deklarim — në qoftë se vulneti i tij nuku është në kundërshtim me ligjën — quhet akt juridik. Kontratat shitje-blemjeje, qiradhënieje, kontrata e punës, kontrata e shoqërisë janë akte juridike që konsistojnë në një akord të dy ose më shumë vulnetevet të formuar për të krijuar obligime midis palëvet kontraktuësa; Kjo klasë aktesh juridike është m' e madhja dhe ka importancën më të madhe.

Me të vërtet mundet të thuhet se kontratat janë substanca e jetës juridike. Prandaj mund të thuhet se *vulneti* lot rolin kryesor në fushën e së drejtës civile; Vulneti është ay, nga i cili mburojnë shumica mâ e madhe e së drejtavet civile. Kjo gjë ngjet në sferën e së Drejtës ekonomike ose pasurore; Në këtë të gjitha regullohen prej kontraktantëvet dhe, sikundër u tha dhe më parë, ligjat që kanë relasion me këtë lândë — ligjat plotësuëse ose deklarative — nuku janë gjësendi tjetër veçse rezultat kontratash të sypozuara.

Por, nuku duhet të pandehet se kontratat vetëm janë akte-juridike; Eksistojnë dhe të tjera akte juridike, që nuku janë kontrata, si për shëmbëll *testamenti*, që është një

akt, me të cilin njeriu disponon pasurin' e tij që lë në kohën e vdekjes.

Në gjuhën e së drejtës fjala *akt* ka dy kuptime të ndryshme. Disa herë tregon një operasion juridik dhe i korespondon fjalës latine *"negotium"*; Shpesh herë tregon një *shkresë provuëse* dhe në këtë rast ka kuptimin e fjalës latine *"instrumentum"*. Një shit bjemje, një dhurim, një pagim, një falje dete, dyke u konsideruar ato si të tilla — pa u marë para sysh provimi i tyre — janë akte juridike *(negotium)*. Shkresat, notariale ose private qofshin, të cilat konstatojnë ato akte juridike janë *akte instrumentare*. Këtu kemi për t' u okupuar vetëm me *aktet juridike (negotium)*; Sa për studijimin e aktevet instrumentare, ay formon lândë të së Drejtës të Procedurës Civile.

Shëmbëlla: Redaktimi i *aktit* celebrimit të martesës (neni 151 i Kodit Civil); Çdo dhurim duhet të bëhet me *akt* publik, përndryshe është nul (neni 1489 i Kodit Civil); Transkriptimi i *aktevet* (neni 1864 i Kodit Civil); Kontratat e martesës duhet të stipulohen me *akt* publik para notarit dhe përpara martesës (neni 1325 i Kodit Civil), në gjithë këto shëmbëlla fjala *akt* është përdorur me kuptimin e shkresës *(instrumentum)*. Por, kur ligja bën fjalë se i mituri mundet të bëjë *akte* të një administrimi të thjeshtë, se *aktet* e bëra prej debitorit për të mashtruar kreditorët e tij janë nul, në këto shëmbëlla fjala *akt* ka kuptimin e një veprimi, e një akti juridik.

Me gjith' këtë në disa raste ligja bën konfuzion të së dy kuptimevet në një vetëm dhe një-kohësisht në një fjalë flet për aktin juridik dhe për provën e tij të shkruar, si, për shëmbëll, ngjet në nenin 1306 të Kodit Civil, i cili thotë: "Nuku munden m' u ndreq me as një *akt-konfirmimi* veset e një veprimi që është absolutisht nul".

§ 64. — Parimi i lirisë të palëvet në aktet juridike.

Një parim kryesor dominon lândën e aktevet juridike, që kanë lidhje me relasionet ekonomike ose pasurore: ky

është parimi i *lirisë së konvecionevet.* Me këtë duhet të kupëtohet se personat mundin të bëjnë gjithë aktet juridike që dëshërojnë dhe t' i bëjnë ato që të sjellin gjithë konsekancat juridike q' u intereson, por me këtë përkufizim që *akti* ose *efekti juridik* mos të jenë të ndaluara prej një dispozite të shprehun të ligjës. *Çdo send që nuku është i ndaluar, përmetohet.*

Ky parim eksprimohet në njërën nga artikullat më importante të Kodit Civil, në nenin 1113 §1, ku thuhet se: "*Kontratat e formueme ligjorisht kanë fuqi ligje për ata që i kanë lidhë*". Kjo domethënë se kontrata detyron një po si ligja. Ligja është kushtituuar prej urdhrit të vënë prej ligjëvuësit për interesin e përgjithëshme të shoqërisë; Nga ana tjetër kontrata është dispozita, të cilën kontraktantët ja imponojnë vetë-vehtes për të caktuar të drejtat e tyre dhe për të regulluar marëdhëniet e tyre private. Por, që të kenë kontratat fuqinë detyruëse të ligjës, duhet të jenë të formueme ligjorisht, domethënë të bashkojnë gjithë elementat e nevojëshme që u referohen kaqe lândës sa edhe formës së tyre; Kështu, pra, kur nonjë nga këto elementat e lypuna mungon, kontrata nuku eksiston, dhe massi nuku eksiston nuku ka fuqinë detyruëse të ligjës.

§ 65. — Kufizimi i vulnetit, urdhri publik, dhe zakonet e mira.

Sado e madhe qoftë liria, autonomia që i lihet vulnetit në fushën juridike, me gjithë këtë ka dhe kjo kufizimet e saj. Neni 11 i dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, dispozon se: "*....disponimet dhe konvencionet private nuku pranohen, kur janë në kundrështim me ligjat ndalimtare të Mbretërisë, të cilat u përkasin personavet, sendevet ose veprimevet, as me ligjat që i përkasin me çdo mënyrë rendit publik ose zakonevet të mira*". Por, cilat janë ato dispozita, fuqia absolute e të cilavet përkufizon fushën që është lënë e lirë në vulnetin e personavet?

Nga të dy ekspresionet e përdorura prej ligjës në ne-

nin 11 të dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht, njëra — kuptimi i së cilës nuku lé as një dyshim — është ajo e *zakonevet të mira.* Zakonet e mira janë *morali.* Pra, personat janë të ndaluara të shtrojnë në aktet e tyre juridike — vepra të vulnetit tyre — dispozita që vijnë në kundrështim me moralin; Në rastin që kanë vepëruar ndryshe, vepra e tyre është e kotë, vulneti i tyre është i çveshur prej çdo konsekance juridike. Këtë gjë nuku e thotë vetëm neni 11 i dispozitavet të naltpërmëndura, por dhe shumë dispozita të tjera të përndara në të drejtën, të cilat përsëritin po atë regullë në lânda të ndryshme, si, për shëmbëll, nenet 578, 1102, 1139 të Kodit Civil e tjera.

Nga këto tekste rezulton se: janë të ndaluara jo vetëm aktet juridike që vijnë në kundrështim me ligjat që interesojnë zakonet e mira, por dhe ato akte juridike që vijnë në kundrështim me mësimet dhe parimet e moralit. Pra, gjykatat kanë të drejtë të anullojnë çdo konvencion, çdo vepërim juridik, po t'a quajnë immoral.

Ekspresioni *urdhër publik* nuku është kaq' i kthjellte dhe i qartë, si i pari. Duhet, pra, të caktohet kuptimi.

Kur themi urdhër publik duhet të kuptojmë regullin në Shtet, domethënë një organizim të nevojshmë për fonksionimin e mirë të Shtetit. Pra, gjithë ligjat e së Drejtës Publike, në të cilat përmblidhen dhe ligjat ndëshkimore, janë të urdhërit publik. Me gjithë këtë dhe brenda në legjislasjonin civil eksistojnë shumë dispozita që i përkasin urdhërit publik, massi regullat që përmbajnë ato dispozita duken të domos-doshme për të mbajtur sigurimin, moralitetin publtk, për eksistencën e marëdhënievet paqësore midis shtetasvet, për lehtësimih e relasjonevet ekonomike të tyre. Këto dispozita, të cilat kështu kanë lidhje jo vetëm me interesin e disavet, por me interesin e përgjithëshme, duhet të mbeten të pa cënuara. Vulneti i partikolarëvet nuku mundet të largojë aplikimin e ligjavet që interesojnë urdhërin publik, *"jus publicum privatorum pactis mutari non potest"* theshin juristët romanë.

Studijimi i gjithë dispozitavet të së drejtës civile që interesojnë urdhërin publik, që prezantojnë karakterin e urdhërit publik, nuku është e mundur të bëhet këtu. Do të mjaftohemi vetëm me tregimin e disa shëmbëllavet dispozitash urdhëri publik.

Në të drejtën e families gjithë dispozitat ligjore kanë një karakter urdhëri publik; Me të vërtet shoqëria interesohet për aplikimin e regullavet që i përkasin organizimit të families, si, për shëmbëll, konditat e lypuna për lidhjen dhe zgjidhjen e martesës, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëvet, ato të prindërvet dhe të fëmijëvet, mënyrat e caktimit të bijësisë e tjera; Vetëm disa regulla që u përkasin konsekancavet pasurore të së drejtavet familiare, mundet të konsiderohen si të huaja ndaj urdhëri publik; Për shëmbëll sjellim këtu regullën, e cila u akordon prindërvet uzufruktin legal mbi pasurinë e fëmijëvet tyre deri sa të emanqipohen ose të mrijnë në moshën madhore (*neni 284 i Kodit Civil*). Suprimimi i kësaj të drejte në disfavorin të kësaj ose t' asaj persone naturisht nuku cënon as pak interesin e përgjithëshmë. Pra, një personë, e cila i dhuron ose i lé leg disa sende një fëmije, mundet të urdhërojë me një dispozitë të shprehun që prindi i fëmijës mos të gëzojë uzufruktin e sendevet të dhuruara ose të lëna leg fëmijës së tij.

Në të drejtën patrimoniale ngjet e kundërta. Shumica e dispozitavet ligjore nuku kanë karakter urdhëri publik. Me gjithë këtë takojmë dhe në këtë lândë regulla, të cilat prezantojnë karakterin e urdhrit publik; Të tilla janë dispozitat që kanë lidhje me organizimin e zotërimit, me kredinë tokësore ose të lujtëshme dhe — më përgjithësisht — gjithë regullat që justifikohen prej interesit të së tretëvet, ato, domethënë, që kanë për qëllim të ndalojnë kontraktantët t' u sjellin, me kontratat e tyre, dëme personavet të treta. Për shëmbëll: Neni 1328 i Kodit Civil, i cili urdhëron që "*konvecionet martesore të çdo lloji nuku mund të ndrohen me as një mënyrë mbas celebrimit të martesës*", është një dispozitë që interesoŋ urdhërin publik, kështu që nuku mu-

ndet të ndryshohet me konvencione të ndryshme të palëvet. Qëllimi kryesor, të cilit ligjëvuësi ka pandehur se do t' i arinte, dyke urdhëruar mos ndryshimin e konvencionevet martesore, është mprojtja e të tretëvet, të cilët mundet të kontraktonin me bashkëshortët në vazhdimin e martesës.

Pranë këtyre ligjavet që i përkasin interesit të përgjithëshme, eksiston një tjetër kategori dispozitash ligjore, të cilat kanë lidhje më shumë me inreresin privat, por ndryshimi i të cilavet me konvencione të palëvet nuku përmetohet; Këto quhen *dispozita proteksioni* dhe me këtë ekspresion duham të tregojmë ato dispozita, që kanë për qëllim mprojtjen e atyre personavet, të cilat mosha, seksi, dobësia mendore i bëjnë të pa-zota që të mprojnë vetëvehten në marëdhëniet juridike — këtë lloj lufte për jetën, — me një fjalë ato dispozita që kanë të bëjnë me pa-zotësitë (*mituri, ndalim, pa-aftësim*). Këto dispozita, naturisht, janë të pa-cënueshme, massi do të mos i arinin qëllimit për të cilin janë vënë, në rastin që do të përmetohej ndryshimi i tyre.

Gjith' ashtu dhe në kontratat, të cilat janë fusha posaçërisht e rezervuar për lirinë e vulnetit të palëvet, ato dispozita, me të cilat ligja ka për qëllim të ndalojë që njëri nga kontraktantët të abuzojë tue përfituar nga superioriteti i tij ekonomik në kuris të kontraktantit tjetër dhe t'i imponojë kondita *leonine*, interesojnë urdhërin publik; Pra, ndryshimi i tyrevet me konvencione partikolare është i ndaluar.

§ 66. — Klasifikim kryesor i aktevet juridike.

Klasifikimet kryesore të aktevet juridike janë këto:

I. *Akte një-anëshe (negotia unilateralia)* quhen ato që formohen me vulnetin vetëm të një persone, si për shëmbëll: testamenti, pranimi ose renoncimi i një trashëgimi; Këto janë akte juridike një-anëshe, massi janë të vlefshme me vulnetin vetëm të një persone.

Gjith' ashtu të lanunit doret të një sendi të vetë, pushtimi i një sendi të lanun doret e tjera, janë akte një-anë-

she, massi fuqia e se cilit akt prej tyre mvaret nga vulneti i një njeriut vetëm; Gjith' ashtu emanqipimi, njojtja e fëmijës naturale, janë dhe këto akte-juridike një-anëshe.

Akte dy-anëshe (negotia bilateralia) quhen ato që formohen me vulnetin e dy personavet, si, për shëmbëll, shitje blemja, qiradhënia, depozitoja e tjera; Këto janë akte juridike dy-anëshe, massi po të mos eksistojë vulneti i dy personavet nuku është i mundur formimi i tyre ligjorisht. Në aktet dy-anëshe vepërimi i dy personavet është *konditë*, nga e cila mvaret veprimi ligjor i tyre.

Zakonisht aktet dy-anëshe quhen dhe *konvencione*. Konvencion është akordi i dy ose i më shumë personavet për me krijue, ndryshue ose me shue një lidhje juridike, si për shëmbëll: shitje, këmbim, qiradhënie, hua, shoqëri, porosi, kontrato pune e tjera, ose për me krijue të drejta familie, si për shëmbëll: martesë, adoptim.

Një tjetër definision i konvencionit është dhe ky: "konvencion quhet koincidenca po mbi një send i dy vulnetevet të deklaruara, të cilat qëndrojnë njëra kundrejt tjetrës si propozim edhe pranim".

II. *Akte me titull darovor* janë ato, që i sjellin një persone një avantazhë, një dobi pa nonjë kundërprestim, si për shëmbëll: dhurimi, testamenti, depozitoja, huapërdorja e tjera. Ay që mer një obligim me një akt-juridik me titull darovor obligohet me një qëllim liberal, se dëshëron të bëjë një liberalitet, si për shëmbëll dhuruësi, ose me qëllim që t' i bëjë një shërbim tjetrit, si kundër ngjet me depozitarin, me atë që i jep darovisht huapërdorjen e një sendi, me atë që huan të holla pa kamatë.

Akte me titull barësor janë ato, me të cilat çdo kontraktuës mer një dobi kundrejt obligimit të vetë, domethënë imponojnë një sakrificë ekuivalente me dobinë që sjellin, si shitje-blemja, huaja me kamatë, këmbimi, e tjera.

III *Akte midis të gjallëvet (inter vivos)* janë ato, që sjellin efektin juridik qysh prej kohës që autori i tyre është i gjallë. Ky lloj aktesh juridike formon shumicën e aktevet

dhe janë këto ose konvencione, si për shëmbëll shitjeblemja, dhurimi e tjera, ose akte një-anëshe, si renoncimi, pushtimi.

Akte për shkak vdekjeje (mortis causa) ose, ndryshe, *të vulnetit të mbrame* quhen ato, që kanë për objekt transferimin e sendevet mas vdekjes të personës; Efektet juridike i sjellin pas vdekjes të disponuësit dhe mundet që të revokohen ose të modifikohen prej tij gjithë monë deri në minutën e vdekjes, prandaj quhen dhe akte të vulnetit të mbrame. Typi i aktit për shkak vdekjeje dhe i aktit njëanëshe është testamenti.

§ 67. — Konditat e eksistencës dhe të vleftësisë të aktevet juridike.

Elementi kryesor i çdo akti juridik është vulneti i autorit të tij. Kur akti është i një anëshmë eksiston vetëm një vulnet; Kur akti është i dy-anëshmë domethënë konvencion, duhet që vulnetet e kontraktantëvet të mbeten d' akord, të eksistojë hiri i palëvet.

Elementat e nevojëshme që lypen që të jetë akti juridik i vlefshmë dhe i fuqishmë përgjithësisht, janë këto:

1. *Vulneti* i autorit të aktit juridik. Por, massi vulneti është një gjendje e brëndëshme, psikollogjike, duhet:

2. *Deklarimi* i këtij vulneti, domethënë manifestimi i vulnetit në botën e përjashtme me një dekllarim, i cili tregon se vulneti eksiston. Deklarimi i vulnetit mundet të bëhet ose shprehimisht ose heshtësisht. Në më të shumëtat e rastevet deklarimi i vulnetit është i shprehun, domethënë i eksprimuar verbalisht ose me të shkrojtur; Por, mundet të jetë dhe i heshtur. Manifestimi i vulnetit është i heshtur, kur i interesuemi sillet me kësilloj mënyrë, sa nuku mbetet dyshim se dëshëron t' a bëjë aktin juridik; Si shëmbëll sjellim tekstin e nenit 661 të Kodit Civil, në paragrafin 3 të së cilit thuhet: "*Pranimi i një trashëgimi quhet se ësh-*

të bërë heshtësisht, kur trashëgimtari bën një vepër, e cila nevojërisht pasasypozon se ay ka dasht me pranue trashëgimin dhe atë vepër nuku do të kishte të drejtë me e bâ veçse si trashëgimtar", si për shëmbëll, kur paguan kreditorët e trashëgimit ose shet pasurinë që përbën trashëgimin.

Deklarimi i heshtur shpesh herë mundet të rezultojë edhe nga fakti i vazhdimit të një marëdhënieje juridike, e cila ka arirë në afatin e saj, si për shëmbëll: një qiramarës ka marë me qira një shtëpi për një vit; Në mbarimin e afatit qiramarësi vazhdon édhe t' a banojë këtë shtëpi me dijën e qiradhënësit. Në këtë rast kontrata e qirasë quhet e përsëritur, si mbas dispozitavet të nenit 1566 të Kodit Civil, tue u konsideruar prej ligjës se eksiston deklarim vulneti i heshtur.

3. Deklarimi, i cili formon elementin e përjashtme të aktit juridik, duhet të jetë *d' akord me vulnetin.* Në qoftë se deklarimi nuku është d' akord me vulnetin, në qoftë se eksiston ndryshim, dezakord midis vulnetit dhe deklarimit, në qoftë se persona deklaron një gjë, të cilën në realitet nuk e do, at' here akti juridik është *nul,* deklarimi nuku është i vlefshmë se nuku është d' akord me vulnetin, vulneti nuku është i fuqishmë se nuku u deklarua; Për shëmbëll: Dua të emëronj trashëgimtarin t' im **A** dhe emëronj **B.** Emërimi i **A** nuku është i fuqishmë se nuku e deklarova vulnetin t' im që desha t' a emëronja trashëgimtar; Por dhe emërimi i B nuku është i vlefshme, massi nuku desha t' a emëronja këtë trashëgimtar, por A.

Nga sa u thanë më sipër rezulton se: që të jetë akti juridik i fuqishme dhe i vlefshme, duhet që vulneti me deklarimin të jenë d' akord, të puthiten.

4. Deklarimi i vulnetit, që të sjellë konsenkancën ligjore, duhet të jetë i njohur prej së drejtës; Kjo domethënë se, ay që e bën deklarimin, duhet të ketë *zotësinë të bëjë vepërime juridike.* Në rastin që një njeri deklaron vulnetin e tij se dëshëron të krijohet një konsekancë ligjore, por ligja nuku e njeh këtë deklarim të vulnetit tij, akti juridik

është nul, as një konsekancë ligjore nuku krijohet; Për shëmbëll: bashkëshorti **A** i dhuron gruas së tij një send; Por, simbas dispozitavet të nenit 1487 të Kodit Civil "*bashkëshortët nuku munden, sa vazhdon martesa, m' i bâ njëri tjetrit ndonjë liberalitet*", domethënë ligja nuku i njeh dhurimet e bame midis bashkëshortëvet, kështu që dhurimi që **A** i bëri gruas së vetë është një *akt juridik nul.*

5. Vulneti, massi formon elementin e jashtme të aktit juridik, duhet të *mvishet me formën* e përshkruar prej ligjës; Kur themi formë, duhet të kupëtojmë mënyrën, me të cilën duhet të deklarohet vulneti. Në rastet, në të cilat deklarimi i vulnetit duhet të mvishet me një formë të caktuar prej ligjës, në qoftë se aktit i mungon ajo formë, akti juridik i tërë është nul.

Legjislasioni shqiptar nuku është formalist. Parimisht, aktet juridike nuku i shtrohen nonjë forme të caktuar. Një deklarim sempël i vulnetit, me çfarë do mënyrë qoftë bërë ay deklarim, sjell efektet juridike të kërkuara prej deklarusit. Në kohërat dhe në legjislasionet e vjetra aktet juridike bëheshin me forma të caktuara prej ligjës, si për shëmbëll *mancipatio*, *in jure cessio* të romanëvet. Por, në shoqëritë moderne, ku marëdhëniet janë të pa-reshtura, këto duhet të lidhen shpejt dhe sidomos vepërimet tregëtare që lypin shpejtësi.

Mungesa e formës në aktet juridike — me gjithë lehtësirat që siell — ka dhe kjo inkonveniente dhe rezike, qoftë nga pik-pamia e lidhjes të aktit vetë, qoftë nga pik-pamja e sigurimit të personavet të interesueme që të njohin aktin e bërë, qoftë më në funt nga pikë-pamja e konstatimevet, të cilat akti mundet t' i shkakëtojë më von. Nga sa u thanë më sipër rezulton se, parimi i mungesës të formës në aktet juridike, ka tré përjashtime:

a. — Eksistojnë disa akte juridike me rëndësi, për të cilat ligja imponon forma qoftë me qëllim që të mprojë të interesuarin kontra një vendimi të vetë shumë të shpejtë ose të pa mejtuar mirë, ose që t' a mprojë kontra çdo abuzimi

prej nonjë influence dhe t' i ruajë independencën e tij ose, më në fund, për të siguruar redaktimin e mirë edhe konservimin e aktit. Aktet të këtij lloji quhen *akte solonele.*

Në fushën e së drejtës familiare të gjitha aktet juridike i shtrohen një forme të caktuar prej ligjës. Kështu martesa duhet të celebrohet përpara oficarit të gjendjes civile, në prani të dëshmimtarëvet (*nenet 149, 151 të Kodit Civil);* Adoptimi duhet të bëhet përpara gjyqtarit paqtuës të vëndit të banesës të adoptuësit ose para një noteri (*neni 268 i Kodit Civil);* Njojtja e një fëmije naturale duhet të bëhet ose brenda në aktin e lindjes përpara oficarit të gjendjes civile ose me një akt autentik para ose mas lindjes (*neni 245 i Kodit Civil);* Emancipimi bëhet me deklaratë të prindit përpara gjyqtarit paqtuës ose me vendim të këshillit familiar *(neni 367 i Kodit Civil) e tjera.*

Në *të drejtën patrimoniale* ose, ndryshe, pasurore aktet solonele janë të ralla. Dhurimet midis të gjallëvet duhet të bëhen me akt-publik, përndryshe janë nul *(neni 1489 i Kodit Civil);* Ipoteka konvencionale duhet të kushtituhohet me akt-publik ose me shkresë private (*neni 1911 i Kodit Civil);* Kontratat e martesës duhet të stipullohen me akt publik përpara noterit dhe para martesës *(neni 1325 i Kodit Civil);* Për të qënë i vlefshmë nëvëndësimi, duhet që akti i huas dhe dëftesa e pagimit të kenë datë të saktë (*neni 1258 §2 i Kodit Civil*). Sa për testamentin, ay mundet të redaktohet simbas të tre formavet ligjore të caktuara *prej nenevet 508, 510, 515, 516 të Kodit Civil.*

b. — Disa akte juridike duhet të *botënohen* ose të sillen në dijeninë e të tretëvet, domethënë të personavet që nuku figurojnë si palë, por të cilat i interesojnë t' i dijnë ato akte juridike, massi mundet të sjellin efekte dhe për ato persona. Për këtë qëllim ligja organizon mënyra *publiciteti,* të cilat, ata që janë palë në aktet, duhet t' i përmbushin.

Kjo ngjet me aktet midis të gjallëvet relative me fitimin ose transferimin e së drejtës zotërimit mbi sende të pa-

lujtëshme ose të së drejtavet reale në sende të pa-lujtëshme, të cilat duhet të shënohen në regjistrat publike që se i cili mundet t' i konsultojë. Gjith' ashtu pranimi i trashëgimit me benefic inventari ose renoncimi i trashëgimit prej trashëgimtarit duhet të bëhen me deklarim përpara kryesekretarit të gjykatës Paqtuëse të qarkut, ku është çelur trashëgimi dhe deklarimi duhet të shtrohet në radhorin e posaçmë *(nenet 671, 681 të Kodit Civil).* Gjith' ashtu kontrata e martesës duhet të bëhet në një formë speciale publiciteti të caktuar në nenin 52 §8 të Kodit Civil.

Këto formalitete publiciteti nuku kanë as atë fuqi, as atë sanksion, që rezultojnë nga *soleniteti* i një akti. Këto nuku janë të nevojëshme, përveç se vetëm për t'u kundrejtuar të tretëvet. Kur nuku janë plotësuar, akti është i vjefshme, por nuku sjell as një efekt kontra personavet, në favor të së cilavet këto massa publiciteti janë përshkruar.

C. — Më në fund, palët që bëjnë një akt-juridik që ka një importancë, si për shëmbëll shitja e një pronje të pa-lujtëshme, ose që krijon marëdhënie juridike që vazdojnë, si për shëmbëll qiradhënia e një pronje, shoqëria, shoqjata, kanë interes të redaktojnë një akt të shkrojtur për të caktuar hollësisht kushtet e kontratos dhe për të ndaluar kontestasjonet që mundet të lindin në kohën e eksekutimit.

Palët mundet të mjaftohen me redaktimin prej tyre vetë të një shkrese, të cilën dhe e nënëshkruajnë; Në këtë rast themi se u bë shkresë private. Ose palët munden t' a bëjnë të konstatohet akti me anën e një ofiqari kompetent, një noteri.

Parimisht ligja nuku detyron kur-nonj' herë palët që të redaktojnë një instrument provimi — me përjashtimin naturisht të aktevet solonele, për të cilat u bë fjalë më sipër, — por i inciton, i shtyn që të redaktojnë akt të shkrojtur, dyke ndaluar provimin me tjetër mjet, përveç shkresës, të aktevet juridike, vlefta e të cilavet kalon të dyqint franga[1] arr. Pra, në realitet palët duhet të redaktojnë gjithë monë një shkresë, që të mundin të caktojnë më von kushtet dhe

konditat e vepërimit të bërë, kështu q' ato të ndodhen për rastin që mundet të ngrihej një grindje midis tyre për atë akt juridik. Por, duhet të kemi ndër sy se kjo shkresë nuku i shton kur-gjë vleftësisë të aktit juridik, i cili është i plotë me akordin vetëm të palëvet. Sa për shkresën, ajo formon vetëm mënyrën e provimit, në të cilën do të referohen kontraktantët, në rast nevoje. Akti juridik është i vlefshmë dhe pa këtë provë, por vetëm nuku mund të provohet.

6. Përmbajtja e vulnetit duhet të njihet prej së drejtës. Ligja mundet që t' a njohë deklarimin e një vulneti të një persone, por mundet dhe të mos njohë dhe *gjith' ato* që ajo personë do; Për shëmbëll: Do të të jap 100 franga, po t' a çnderosh **A.** Massi ligja nuk e njeh përmbajtjen e vulnetit t' im, akti është nul.

§ 68. — Zotësia për me ba akte juridike.

Thamë më sipër se, që të jetë akti juridik i fuqishme, duhet që ay që vepëron të ketë dhe zotësin' e duhur. Nuku mjafton që akti të jetë i dëshëruar, massi që të jetë i vjefshme duhet të jetë bërë prej një persone, e cila gëzon *një vulnet*, por ka dhe *zotësinë* të duhur për të bërë aktin juridik.

Zotësi juridike *quhet zotësia me fitue te drejta dhe me* **i eksersue.** Ky definision na tregon se eksistojnë dy grada në zotësi: 1. *Zotësi gëzimi* ose zotësi për t' a bërë personën titullare të drejtash civile, dhe 2. *Zotësi eksersimi* ose pushteti për të valorizuar, për të vleftësuar këto të drejta dhe për t' i transferuar në persona të treta.

A. — *Pa zotësi gëzimi.* Zotësia e gëzimit mundet të kupëtohet dhe pa zotësinë të eksersimit, massi titullari i një të drejte, simbas rastit, mundet të jetë i zoti ose i pazoti që t' a ushtrojë ose t' a vleftësojë atë të drejtë ay vetë. Me fjalë të tjera eksistojnë persona, të cilat ndonse kanë gëzimin e së drejtavet civile, por u mungon e drejta e eksersimit. Këto persona janë ato që quhen *të pazotë.* Në legjislasjonet moderne, paramisht, gjithë personat kanë gëzi-

min e së drejtavet civile; Ç' do personë, cila-do qoftë mosha, seksi, gjendja, akoma dhe kombësia e saj, ka gëzimin e së drejtavet civile. Njeriu nuk mund të rojë pa marë pjesë në marëdhëniet juridike dhe pa qënë titullar të drejtash civile. Ngritja e gëzimit të së drejtavet civile nga një njeri është e njëjtë me të shuemit e tij nga numuri i personavet, barasohet me vumjen e tij në gjendjen e robërisë, të sklavërisë të botës së vjetër.

Nga sa u thanë më sipër meret vesh se, pazotësitë të gëzimit janë *eksepsionale* dhe, mbi këtë, gjithë-monë *speciale* domethënë të tilla, që nuku i përkasin përveç se një ose shumë të drejtavet të caktuara.

Një personë e privuar nga të gjitha të drejtat e saj civile nuk është e mundur të kupëtohet.

Për shëmbëll sjellim disa raste pazotësie gëzimi:

1. Eksistojnë disa të drejta, gëzimin e të cilavet njeriu nuku e fiton, veç se massi të arijë në një moshë të caktuar. Kjo ngjet për aktin juridik të martesës, për ato të testamentit, të dhurimit midis të gjallëvet, për adoptimin.

2. Simbas dispozitës të nenit 3 të Kodit Civil "*i huaji gëzon të drejtat që kanë shtetasit, posë përjashtimevet të caktueme prej ligjës.*"

3. Ligja cakton në disa raste privimin e gëzimit të disa të drejtavet kontra personavet të dënuara për veprime të kontraligjëshme. Dënimet ndëshkimore i ngrehin të dënuarit gëzimin e disa të drejtavet civile. Shifni dhe *nenet 213 dhe 679 të Kodit Civil.*

4. Shoqjatat nuku mundet të marin personalitetin juridik pa u plotësuar formalitetet e lypuna prej *nenit 410 të Kodit Civil.*

B. — *Pa zotësi eksersimi.* Që të mundë një personë të eksersojë një të drejtë, duhet:

a') *Të ketë fuqinë mendore çmuëse,* domethënë të jetë në pozitë të kupëtojë konsekancat e vepravet të veta.

b') *Të mos jetë dekllaruar i pazoti prej ligjës.*

Nga këto rezulton se, pazotësia e eksersimit të së drejtavet rjeth nga dy shkake të ndryshme, është *naturale* ose *legale.*

Pazotësia naturale godit personat që nuku ndjejnë se ç' bëjnë, si për shëmbëll: fëmija që nuku kanë arirë édhe në moshën e arësyes, të çmëndurit nënë pushtetin e sëmundjes, idiotë; Personat që ndodhen nënë njërën nga këto gjendje, nuku mundet të marin pjesë në marëdhëniet juridike, masi janë të goditura prej një pazotësie eksersimi të përgjithëshme.

Pazotësia legale rjeth nga këto shkake: nga miturija, nga ndalimi për shkak dobësie mendore dhe për shkak dënimi me një ndëshkim kriminal, nga pa-aftësimi për shkak mëndjedobësije ose prodigaliteti.

Pazotësitë e eksersimit ndryshojnë njëra nga jatra: disa herë janë të përgjithëshme, domethënë u përkasin gjithë të drejtavet, sikundër ngjet me të *miturin*; Herë të tjera janë të limituara në disa akte, si kundër ngjet me të *miturin të emancipuar, me mëndjedobëtin* dhe *prodigun.* Në gjithë këto raste pazotësia nuku eksiston, përveç se kur është e urdhëruarë prej ligjës. Me fjalë të tjera *zotësia është regulli* dhe *pazotësia eksepsioni.* Çdo personë mundet të eksersojë të drejtat e saj civile, përveç kur ligja e radhit midis të pazotëvet.

Ky parim, i cili është pranuar prej Kodit Civil, figuron dhe në nenin 1087 të këtij Kodi, ku thuhet: "*Çdo person âsht i zoti me kontraktue, kur nuk âsht deklarue i pa zoti prej ligjës. Janë të pazotë me kontraktue në rastet e caktueme prej ligjës të mitunit, të ndaluemit, të pa-aftësuemit dhe gjith' ata, të cilëvet ligja nuku u njeh tagrin me lidhë disa kontrata të caktueme*". Aplikimin e këtij parimi e shohim dhe në *nenin 495 të Kodit Civil.*

§ 69. — Akord midis deklarimit dhe vulnetit.

Që të eksistojë një akt juridik, është i nevojshmë më parë se çdo gjë tjetër vulneti për krijimin, ndryshimin dhe

shuemjen e një të drejte; Por, vulneti si një gjendje e brëndëshme, psikollogjike, nuku është e mundur të jetë në dijenin' e të tretëvet; Pra, për t' u bërë i njojtur vulneti, duhet të manifestohet në botën e përjashtme. *Vulneti vetë nuku mjafton që të sjellë efekte juridike. Deklarimi është ay, i cili e manifeston vulnetin në botën e jashtme.*

Takon që deklarimi mos të jetë konformë me vulnetin, mundet që midis vulnetit dhe deklarimit të eksistojë një dezakord, mundet që persona të deklarojë se do një send, kur se deklarimi është për një send që nuku e do; Në këtë rast akti juridik është *nul.*

Pra, për eksistencën e një akti juridik të fuqishmë, akordi midis vulnetit dhe dekllarimit është i domosdoshme. Me një fjalë, *qe të jetë i fuqishmë një akt juridik, duhet të jetë konsekanca e vërtetë e vulnetit të deklaruësit.*

Dezakordi midis vulnetit dhe deklarimit mundet të eksistojë: 1) *pa dijen e deklaruësit,* ose 2) *me dijen e tij.*

1. Kur dezakordi midis vulnetit dhe deklarimit eksiston pa dijen e deklaruësit, at' here themi se ky ndodhet në *lajthim.*

2. Dezakordi midis vulnetit dhe deklarimit mundet të eksistojë tue qënë në dijë të deklaruësit ose për *lojnë,* ose për *mësim,* ose për *simulasion.*

Shëmbëll dezakordi midis vulnetit dhe deklarimit për mësim dhe lojnë: një student, për të kaluar kohën me kolegët e tij, redakton një testament, me të cilin emëron trashëgimtar një nga shokët e vetë; Ose redakton dhe nënëshkruan në urdhërin e një shoku — për stërvitje — një kambial. Në këto shëmbëlla eksiston dezakord midis vulnetit dhe deklarimit, massi testatori deklaron një gjë, që nuku është d' akord me hirin e tij, se deklarimin e bëri me qëllim zbavitjeje, mësimi, pra akti juridik është krejt nul.

Rasti më important, në të cilin dezakordi midis vulnetit dhe deklarimit është në dijen e deklaruësit, është simulasioni.

Simulasion quhet deklarimi i vulnetit i bërë me qëllim

të krijojë një akt juridik sipërfaqësisht, osë ndryshe: *simulasion quhet deklarimi pa vulnet të vërtetë.* Për shëmbëll: Debitori i shet një të treti gjithë pasurinë e tij; Por, shitja është *fiktive*, e bërë me qëllim që të çduket pasuria dhe mos të mundin të venë dorë kreditorët mbi 'të. Ose **A** i thirur si trashëgimtar renoncon, por është marë vesh me bashkëtrashëgimtarin e tij, i cili përfiton nga ky renoncim, që t' i ngëthejë pjesën e tij ose vleftën e saj.

Simulasioni mundet të eksistojë si në *aktet juridike një anëshe*, dhe në këtë rast ka për qëllim ndalimin e krijimit të një të drejte, si për shëmbëll: renoncim trashëgimi i simuluar, ashtu dhe në *aktet juridike dy-anëshe*, në të cilat palët kontraktuëse bëjnë një deklarim, prapa të cilit fshihet vulneti i tyre i vërtetë.

Simulasioni, massi vulneti me deklarimin janë në dezakord, është nul; Kjo rezulton dhe nga interpretimi i *nenit 1125 i Kodit Civil*, ku thuhet se: "*kundër-shkresat, që nuku janë konsiderue nul prej ligjës, kanë efekt midis kontraktuësavet dhe suksesorëvet me titull universal të tyre*"; Pra, *a contrario*, rezulton se, massi akti juridik i fshehur prapa simulasionit është i fuqishmë, akti juridik aparent është nul — *për sa u përket palëvet* — me që nuku është e mundur të kupëtohen dy konvencione kontradiktoare të kumuluara po mbi një personë.

Nuliteti i aktit juridik të simuluar është absolut.

Nuliteti kontra simulasionit propozohet prej kontraktantëvet midis tyre, *si dhe prej çdo të treti që ka interesë të ligjëshme, si dhe kontra të tretëvet, por tue u përjashtuar ata që kanë qënë të huaj në 'të dhe me mirëbesim kanë fituar të drejta nga akti juridik i simuluar.* Për simulasionë më posaçërisht duhen shtuar:

1. Deklaruësit kanë qëllim të krijojnë një akt juridik, por nënë 'të duhan të kontraktojnë tjetër, si për shëmbëll: nënë shitjen fshehin dhurimin. Në këtë rast akti juridik i fshehur është i fuqishme, në qoftë se është i ligjëshmë dhe përmban elementat e duhura.

2. Deklaruësit kanë qëllim krijimin e një akti juridik tjetër, i cili është nul si nga substanca, ashtu edhe nga forma, si për shëmbëll: prapa konvencionit shitjes fshihet një dhurim midis bashkëshortëvet në vazhdim të martesës; Në këtë rast dhe shitja është nul, si e bërë me simulasion, dhe dhurimi që fshihet prapa shitjes, massi vjen në kundrështim me nenin 1487 të Kodit Civil, ku thuhet se: "*Bashkë-shortët nuku munden, sa vazhdon martesa, m' i bâ njani tjetrit ndonjë liberalitet, veç se me akte të vulnetit të mbrame, simbas formavet dhe regullavet të cakiueme për akte kësodore*".

3. Deklaruësit nuku kanë qëllim të krijojnë tjetër aktjuridik, por me aktin përfaqe fshehin një dhel, si për shëmbëll: debitori jetërson pasurin' e tij për t' a fshehur dhe shpëtuar nga kreditorët. Akti juridik nuku është i fuqishmë, massi në këtë rast nuku eksiston vulnet, por palët kanë përdorur dhinakëri.

Gjith' ashtu simulasion eksiston edhe n' ato akte juridike, në të cilat të tjerë duken si palë, por të tjera janë të interesuarit.

Ay që pretandon se eksiston në aktin juridik lojnë, mësim ose simulasion, detyrohet t' a provojë pretendimin e tij.

Provimi i simulasionit. A. — Midis palëvet simulasioni është një marëveshje, një konvencion. Pra, posa që objekti i këtij konvencioni kalon të 200 frangat arr, marëveshja sekrete — nga e cila rezulton simulasioni — duhet të provohet me shkresë, dhe në rastin që akti fiktif është bërë me shkresë, duhet dhe konvencioni sekret të bëhet me shkresë, qoftë dhe kur suma nuku kalon të 200 frangat arr.

Kundër-shkresë (*contre-lettre*), quhet shkresa e destinuar për të konstatuar konvencionin e fshehtë, nga e cila shkresë do të rezultojë prova e simulimit të aktit juridik përfaqe. Pala që mban shkresën e dytë, domethënë kundërshkresën, me të cilën çduket ose ndryshohet përmbajtja e

shkresës së parë, domethënë shkresës për faqe, do të mundë lehtë të provojë simulasionin; Massi fuqia provuëse e të dy mjetevet provimi është e njëjtë, nga krahasimi i tyre do të dalë e drejta në shesh.

B. — Kur një i tretë është gati të provojë karakterin fiktif të aktit juridik që i propozojnë, *i përmetohet ç' do mjet provuës*, massi për këtë simulasioni është një fakt, për të cilin nuku mundet t' i kërkohet një provë e shkruar. I treti, përpara një akti të simuluar, ndodhet po n' atë gjendje, në të cilën ndodhet dhe pala që është viktimë e një dheli. I treti kërkon të provojë një fakt të ngjarë pa atë dhe jashtë atij, një fakt, i cili cënon të drejtat e tij dhe e damton.

Thamë më sipër se, kur eksiston dezakord midis vulnetit dhe deklarimit, akti juridik është nul. Por, kjo nuku mundet të meret absolutisht. Që të shkakëtohet nuliteti i aktit juridik, duhet që dezakordi midis vulnetit dhe deklarimit të jetë:

a) *I plotë*, domethënë përmbajtja e deklarimit mos të puthitet as pak me përmbajtjen e vulnetit, si për shëmbëll: i prezantohet **A** për nënëshkrim një akt, të cilin ky pa dijtur dhe, dyke pandehur se shkresa është për një konvencion qiradhënieje, e nënëshkruan, kurse ajo shkresë përmban shitje; Në këtë rast deklarimi nuku i përshtatet as pak vulnetit, massi **A** deklaron me aktin shitje, kurse në realitet dò qiradhënie; Shitja nuku është e vlefshme, massi nuku desh shitje, por as qiradhënia nuku është e fuqishme, massi nuku u bë deklarimi për qiradhënie.

2. *Esencial*, domethënë përmbajtja e deklarimit të ndryshojë esencialisht nga përmbajtja e vulnetit.

§ 70. — Veset e vulnetit.

Ay që bën një akt juridik mundet të ndodhet në lajthim ose vetiu ose të provokuar me mjete dhelparake; Mundet, gjith' ashtu, të cedojë dhe nënë një shtrëngim ose dhunë që eksersohet mbi 'të. *Lajthimi, dheli, dhuna* kanë për

efekt pakësimin — pak a shumë — të manifestimit të vulnetit dhe, në disa raste, i ngrehin vleftën e tij. Kjo ngjet, kur është e sigurtë se i interesuemi nuku do t' a bënte aktin juridik po mos të ndodheshe nënë influencën e lajthimit ose të dhunës.

Më në fund, takon shumë herë që akti juridik t' i shkakëtojë një dëm të math atij që e ka bërë; Në këtë rast themi se eksiston *Lëndim* dhe në disa raste lëndimi ligja e ndihmon të interesuemin, dyke i dhënë të drejtë që të kërkojë anullimin e aktit. Neni 1089 i Kodit Civil thotë: "*Kontraktuësi që ka dhënë hirin tue qënë në lajthim të ndjeshëm ose hiri i të cilit është marrun me dhunë ose tërhequn me dhel, mundet me kërkue anullimin e kontratos*". Duhet, pra, eksaminuar deri në ç' masë këto ngjarje domethënë *lajthimi, dheli, dhuna* ja ngrehin vleftën deklarimit të vulnetit.

§ 71. — Lajthimi.

Lajthimi eksiston kur mbeson njeriu në eksistencën të një kaliteti, të një fakti, të një ngjarjeje, të cilat në realitet nuku eksistojnë.

Lajthimi i bërë prej autorit të aktit juridik 'nuku ka gjithë-monë po atë rëndësi dhe nuku sjell gjithënjë po ato efekte; Duhet, pra, të çquhen tre gjendje të ndryshme:

A. — Lajthimi shumë herë shkakëton çdukjen e manifestimit të vulnetit, kështu që ndalon aktin juridik të formohet. Kjo gjë ngjet në tre ipotheza:

a') Lajthimi eksiston *në naturën e aktit juridik (error in negotio)*, si për shëmbëll: Dy persona vendosin të bëjnë një kontrato, që ka për qëllim transferimin e zotnimit të një sendi; Ay që do t' a marë sendin, mbeson se akti juridik është dhurim, kur se jetërsuësi ka për qëllim t' a shesë sendin; Në këtë rast eksiston lajthim reth naturës të aktit juridik, lajthim i cili ndalon akordin e të dy vulnetevet që janë të nevojëshme për formimin e kontratos; Nuku eksiston midis palëvet as shitje, as dhurim.

b') Lajthimi eksiston *mbi objektin e aktit juridik* (*error in corpore*), si për shëmbëll: palët lidhin një kontratë shitjeje, por eksiston lajthim mbi sendin e shitur; Gjith' ashtu një testator ka për qëllim të lerë si leg një send, por lajthit dhe, në vënd t' atij sendi, tregon një tjetër, të cilën e ka dispozuar më parë në favor të një tjetri.

c') Lajthimi eksiston *reth personës* (*error in persona*), në favor të së cilës u deklarua vulneti, por dyke u marë para sysh se deklaruësi kishte në konsiderasion një personë të caktuar, si për shëmbëll: Emëronj **A** trashëgimtar lajthimisht, kurse në realitet dua të emëronj **B.** Emërimi i **A** nuku është i vlefshmë se nuku e desha, por âs i **B** nuku është i fuqishmë, massi nuku e deklarova nulnetin t' im për emërimin e tij. Deklarimi duhet të bëhet për një personë të caktuar, në favor të së cilës deklarohet vulneti. Në rastin që kjo personë nuku është e caktuar, është një personë e tretë indiferente, lajthimi reth personës nuku ka rëndësi dhe akti juridik është plotësisht i vlefshmë. Për shëmbëll: Tregëtari nuku jep as pak rëndësi në se i shet **A** ose **B**; Tregëtari interesohet për çmimin e shitjes, për fitimin, persona e blerësit nuku ka rëndësi për të. Kjo ngjet me marëdhëniet më me rëndësi, si me shitjen e sendevet të pa-lujtëshme për shëmbëll.

B. — Lajthimi shpesh herë, ndonse nuku e çduk krejt, por *e ndryshon* seriozisht vulnetin, në kuptimin se ky lajthim determinon autorin e aktit të vepërojë. Po të ishte se vepruësi i aktit juridik do dinte të vërtetën, at' here do të mos e bënte atë akt. Pra, është e drejtë që ligja t' i ndihmojë dhe t' i përmetojë të kërkojë anullimin e një akti, të cilin, po të mos ndodheshe në lajthim, autori i aktit nuku do t' a bënte. Kjo ngjet në këto dy raste që pasojnë:

αα') Lajthimi eksiston mbi një kalitet të substancës të sendit, i cili është objekti i aktit juridik, domethënë mbi një kalitet, që palët ose njëra prej tyre e muar në konsiderasion kryesor për të bërë aktin juridik, kështu që nuku do t' a bënin aktin po t' a dijnin se ay kalitet nuku eksistonte,

si për shëmbëll: bleva një orë prej niqeli, tue pandehur se ishte prej platine.

66') Lajthimi eksiston mbi cilësinat e personës në një konvencion, në të cilin konsiderasjoni i kalitetevet të personës, me të cilën kontrakton i interesuari, është shkaku kryesor dhe determinuës i aktit juridik, si për shëmbëll: një njeri bën një dhurim në favor të një të treti, të cilin gabimisht mbeson se e ka nip. Tjetër shëmbëll: Porosit një tablo në piktori **A,** dyke e konsideruar këtë si një piktor me talent të math, gjë kjo që më determinovi t' i jap porosinë. Në këtë rast lajthimi im ka vesuar vulnetin t' im dhe akti juridik është i anuluëshmë.

C. — Më në fund eksistojnë raste, në të cilat lajthimi nuk veson aktin juridik, massi nuku ja ngreh vleftën manifestimit, domethënë deklarimit të vulnetit të palëvet. Kjo ngjet pikë së pari në ato raste, në të cilat mundet të thuhet se i interesuari do t' a bënte aktin juridik dhe sikur të ishte i informuar eksaktërisht.

Kjo ngjet më shumë në kontratat me titull barësor, kur lajthimi eksiston mbi personën; Me të vërtet, konsiderasioni i personës bashkëkontraktuëse nuku lot, afron kurë, nonjë rol determinuës, si për shëmbëll: një librëshitës shet një libër, e cila ju pagua peshin; Nuku ka as një rëndësi për librëshitësin në se blerësi është Pjetri ose Pavli. Në është se lajthit mbi personën e blerësit, ky lajthim nuku ka as pak nonjë influencë mbi vleftësinë të kontratos; Kjo gjë nuku është një shkak nuliteti.

Gjith' ashtu lajthimi nuku meret para-sysh, domethënë nuku shkakëton nulitetin e aktit juridik kur eksiston reth një kaliteti *"jo substanciel"* të objektit.

Lajthimi mbi shkakun shtytës, i cili e determinovi personën të bëjë një akt juridik, nuku cënon vleftësinë e këtij akti, si për shëmbëll: bleva një orë të re, për shkak se pandehnja se kisha humbur timen, por më pas shoh se u gabuash; Shitja në këtë rast është e vlefshme. Me të vërtet, shkaket që shtyjnë njerinë të bëjë këtë ose atë akt, janë të

jashtme, të huaja me këtë akt, vetëm ay i di. Do të mos eksistonte as një sigurim në marëdhëniet juridike, po të ishte e mundur të anulloheshin aktet juridike të bëra lirisht, me pretekstin vetëm se persona u determinua prej shkakevet të gabuara.

Duhet vënë oroé se lajthimi i autorit të aktit juridik mundet të eksistojë ose mbi *një cirkostancë fakti (lajthim fakti)* ose mbi eksistencën *e një dispozite ligjore (lajthim në ligjë)*. Që të dy llojet e lajthimit, massi vesojnë vulnetin, kanë si konsekaneë nulitetin e aktit juridik *(shif nenet 1090 dhe 1091 të Kodit Civil)*.

§ 72 Dheli.

Me fjalën *dhel* duhet të kupëtohet çdo lloj marifeti, dhinakërie, të cilat një personë i përdor për të mashtruar një tjetër. Pra, dheli sypozon manuvra mashtruëse, veprime dhe vërtetime të gënjeshtërta, të përdorura për të krijuar lajthimin në shpirtin e një persone dhe për t' a determinuar që të bëjë një akt.

Neni 1096 i Kodit Civil, në të cilin bëhet fjalë për *dhelin*, thotë: "*Dheli është shkak anulluëshmënie e kontratos, kur dredhitë e përdorura prej njërës nga palët ose prej një të treti me dijëniën e asaj kanë qënë t' atilla sa, po të mos ishin përdor, ana tjetër nuku kishte me kontraktue.*" Nga teksti i qartë i ligjës kupëtohet se, që të jetë dheli shkak nuliteti të aktit juridik, duhet të ketë eksersuar mbi vulnetin e viktimës një influencë determinante. Sigurisht ky regull duhet të aplikohet mbi gjithë aktet juridike; Dheli nuku mundet të jetë shkak nuliteti, për veç se kur ka vesuar dhe denaturuar deklarimin e vulnetit.

Dheli ka si konsekancë t' a lajthitë personën, kontra së cilës dirizhohet; Prandaj konsiderohet se ka vesuar deklarimin e vulnetit. Por, duhet vënë oroé që mos të bëhet konfuzion midis këtyre dy shkakevet nuliteti, domethënë *lajthimit* dhe *dhelit*. Lajthimi, kur nuk është i shkakëtuar prej dhelit, ka si konsekancë nulitetin vetëm në rastet e paravë-

shtruara prej nenit 1090 të Kodit Civil, domethënë kur lajthimi eksiston reth substancës sendit ose reth personës, kur çështja është për një akt të bërë *intujtu personae,* domethënë kur akti juridik është bërë tue u marë para sysh identiteti ose cilsinat e personës Për kundrazi, lajthimi i provokuar prej dhelit është gjithëmonë shkak nulliteti, kur ka patur një influencë determinuëse mbi vulnetin *(dolus semper praestatur.)*

Kështu, pra, lajthimi reth shkakevet shtytëse (motifs) anullon kontraton, kur kjo është rezultat i dredhivet dolozive të bëra prej palës tjetër, si për shëmbëll: bleva një kalë, për shkak se shitësi tue përdorur dhel, më bëri të mbesonj se i jemi humbi ose vdiq; në këtë rast mund të kërkonj anullimin e shitjes. Për kundrazi, një lajthim kësilloji, i cili do të mos ishte rezultat i dredhivet dolozive, nuku mundet të jetë shkak për nulitetin e aktit juridik.

Kur akti juridik është një konvencion, neni 1096 i naltpërmëndur lyp një konditë të posaçme që të konsiderojë se eksiston vesi i vulnetit: Duhet që dheli të jetë pratikuar prej njërës nga palët kontra tjetrës, ose, të pakëtën, që njëra nga palët të jetë në dijeninë të dhelit të përdorur prej të tretit. Në qoftë se dheli është vepra ekskluzive e një të treti, viktima mundet të kërkojë dëm-shpërblime nga fajtori, por nuku mundet të kërkojë anullimin e konvencionit dhe arësyeja është kjo: Kur *autori* i dhelit është njëri prej bashkë-kontraktantëvet, është e drejtë që pala tjetër, viktimë e këtyre dredhive, të mundë të anullojë konvencionin.

Por, në qoftë se dheli u bé prej një të treti, viktima nuku ka se ç' i thotë bashkëkontraktantit tij të pafajshmë nga çdo gabim, i cili nuku duhet të pësojë, me anullimin e kontratos, konsekancat e aktevet dolozive, në të cilat ka qënë krejt i huaj.

Neni 1096 i Kodit Civil duket sikur këtë konditë e lyp në gjithë rastet, kur akti i shkakëtuar nga dheli është një

konvencion. Me gjithë këtë dispozitat e nenit 1096 të Kodit Civil nuku janë të aplikueshme në dhurimet midis të gjalëvet, të cilat, kur janë të inspiruara prej dredhivet dhelparake, janë të anulluëshme, qoftë dhe kur fajtori është një i tretë, jo donatari. Dhurimi duhet të rjedhë vetëm nga ndjenja e mirënjojtjes ose e afeksionit dhe, me që vulneti i dhuruësit u mashtrua me dredhi dhe mënyra dhelpërake, liberaliteti humbet gjithë vleftën e tij. Posë kësaj, donatari nuku është i denjë për t' u mprojtur si një kontraktant ordinar, massi merr, por nuku jep kurgjë dhe do të ishte nga an' e tij një mungesë delikatese shumë e madhe po të kishte pretencën të mbajë fitimin të një liberaliteti të marun, kurse i provohet se ay liberalitet është rezultati i dredhivet dhelparake.

Kondita e lypun prej nenit 1096 të Kodit Civil siguris ht nuku aplikohet gjith' ashtu në aktet juridike një anëshe, massi këto rjedhin nga vulneti vetëm i një pale. Këto, pra, mbeten nënë fuqin' e parimit, simbas të cilit dheli është një shkak nuliteti në gjith' ato raste, kur nga ay u determinua persona të bëjë aktin juridik (*dolus semper praestatur*). Në këtë rast nuku është as pak nevojë të mundohemi të dijmë se cili është fajtori. Kështu, pra, neni 669 i Kodit Civil dispozon se pranimi i trashëgimit nuku mundet të kundrështohet veç se për shkak dhune ose dheli të pratikuara mbi trashëgimtarin; Nuku ka as nonjë rëndësi në se dheli është vepra e një kreditori të trashëgimit ose të një legatari ose të çdo tjetër persone.

Po ky solusion duhet dhënë gjith' ashtu dhe për renoncimet dhe për liberalitetet testamentare. Kur testatori u bë objekti i dredhivet dolozive, të cilat e determinuan të lerë një leg, nuliteti i këtij legu mund të deklarohet, qoftë dhe kur këto dredhi rjedhin prej legatarit, qoftë dhe kur rjedhin prej një të treti tjetër.

§ 73. Dhuna.

Dhunë quhet shtrëngimi i eksersuar mbi një njeri për

t' a determinuar të bëjë një akt juridik.

Dhuna është dy llojësh: *dhunë fizike* dhe *dhunë morale* ose *psikologjike.* Shtrëngimi, forca fizike e sjell viktimën në një gjëndje krejt pasive, si për shëmbëll: po të detyrohet një njeri të firmojë një shkresë, tue ju mbajtur dora, në këtë rast nuku eksiston vulnet i lirë, shumë-shumë një aparencë e gënjeshtërtë vulneti, si në rastin që kontrafaqohet firma. Me një fjalë, në rastin e forcës fizike deklaruësi nuku e dëshërovi aktin dhe deklarimi me vulnetin ndodhen në dezakord të plotë, pra akti është nul.

Nga sa u thanë më sipër meret vesh se, kur bëhet fjalë për dhunë si ves të vulnetit, ajo është *dhuna morale, psikologjike,* domethënë frikësime të drejtuara kontra një njeriu për t' i lindur në shpirtin e tij një frikë të madhe. Në këtë kuptim dhuna nuku shkakëton çdukjen e vulnetit. Ay që ka qënë objekt dhune morale, domethënë i frikësuar, ruan fakultetin të zgjedhë midis shumë determinimevet. Në qoftë se zgjeth atë, që e detyron të bëjë aktin që i diktohet, eksiston deklarim vulneti i vërtetë, por ky vulnet është i vesuar, massi u krijua nënë influencën e frikës; Duhet, pra, që ligja t' i vijë ndihmë persones të dhunuar dhe t' a mprojë nga konsekancat e dëmëshme të aktit juridik. Konditat që duhet të bashkojë dhuna për të sjellë këtë efekt caktohen prej *nenevet 1092, 1093 dhe 1094 të Kodit Civil,* dhe janë këto:

A. — Dhuna duhet të jetë e tillë, sa t'i bëjë përshtypje një persone të arësyeshme. Neni 1093 i Kodit Civil thotë tekstualisht: *"Dhuna duhet të jetë e atillë sa t' i bâjë përshtypje një persone me arësye dhe t' i shtjerë frikën se ka me ekspozue personen, nderin ose pasunin' e tij në një të keqe të pa-drejtë dhe të rrëndë. Në çmimin e këtyre sendevet meret parasysh mosha, seksi dhe gjendja e personavet".* Por, simbas dispozitavet të nenevet 1094 dhe 1095 të Kodit Civil, dhuna është shkak nuliteti të aktit juridik jo vetëm kur u eksersua mbi personën vetë që u determinua ajo vetë të bëjë aktin, *por gjith' ashtu kur është eksersuar kon-*

tra bashkèshortit, së parëlindurit ose të paslindurit e tij dhe qëllon përsonën, nderin ose pasurin e tyre. Kur frikësimi qëllon persona të tjera, gjyqtari mundet simbas cirkonstancavet të vendosë anullimin e aktit juridik.

B. — Dhuna duhet të jetë *e pa drejtë* dhe e *pa ligjëshme.* Eksersimi i një të drejte nuku formon një vepër dhune. Kështu, pra, kur një kreditor frikëson debitorin e tij tue i thënë se do t' i verë sekvestro po të mos i jepet garanci, ose kur një patron frikëson nëpunësin e tij se do t' a reshtojë me anën e policisë, në rastin që refuzon të nënshkruajë një pohim dete për reparimin e sendevet që pohon se i ka vjedhur, kjo lloj dhune nuku mundet të quhet si një ves i vulnetit.

Frika reverenciale ndaj ati, mëma ose tjetër të parëlindur vetëm dhe pa qënë e bashkuar me dhunë, nuku mjafton për të shkakëtuar anullimin e aktit juridik (*neni 1095 i Kodit Civil).* Shtrëngimi moral i inspiruar nga respekti që autori i aktit juridik ka në të parëlindurit dhe dëshira për mos t' u prishur qefin, nuku mundet të quhet se paralizon vulnetin e të paslindunit.

Duhet vënë oroé se dhe kur akti juridik i vesuar prej dhunës është një konvencion, padia për anullimin e aktit është e pranueshme, qoftë dhe kur autori i dhunës është një i tretë dhe bashkëkontraktanti nuku kishte dijeni të frikësimevet që e determinuan palën tjetër të kontraktojë.

Kur vesi i vulnetit është dheli, solusjoni është i ndryshmë. Arësyeja e këtij ndryshimi është se, mprojtja kontra dhunës nuku është kaqe e lehtë sa ajo kontra dhelit. Nga dhuna nuku mund të shpëtojë lehtë njeriu, kurse me një vrejtje më të madhe mundet të dalë në shesh dheli dhe dredhitë dolozive.

§ 74. — Lëndimi.

Lëndim — në kuptimin juridik të fjalës — është një dëm që e gjen një personë, kur bën akte juridike, dëm i cili rjeth nga disproporcioni midis avantazhevet që fiton dhe

kundërprestimevet që bën. Lëndimi, pra, nuku mundet të takohet veçse në aktet juridike barësore, si për shëmbëll: të shes shtëpinë kundrejt çmimit 20,000 frangavet, por kjo shtëpi ka një vleftë shumë të vogël. Lëndimi mundet të ngjasë jo vetëm në aktet dy anëshe, por dhe në disa akte një anëshe, si për shëmbëll pranimi i një trashëgimi ose renoncimi i tij prej trashëgimtarit.

Lëndimi ka si sypozim se persona e lënduar u gënjye mbi vleftën e vërtetë të sendit ose ka kontraktuar nënë influencën e një nevojë shumë të madhe të hollash, e cila e shtrëngovi të pranojë kondita dezavantazhoze; Pra, sypozon një ves të vulnetit, massi, pa qënë lajthimi ose shtrëngata e cirkonstancavet të jashtme, akti juridik nuku do të bëhej. Neni 1097 i Kodit Civil thotë: *në rast që prestimet ose obligimet e njërit nga kontraktuësat, në krahasim me dobitë që nxjer prej kontratos ose me prestimin e anës tjetër, janë jashtë çdo proporcioni, në mënyrë që simbas cirkonstancavet duhet të prezumohet se hiri i tij nuku ka qënë mjaftësisht i lirë, gjyqtari mbi kërkimin e anës së lëndueme mundet me anullue kontraton ose me i ulë ato obligime.*"

"*Padia për anullim për shkak lëndimi duhet të ngrihet brenda një viti çprej lidhjes të kontratos. Kjo padie mundet të mprapset në rast që ana tjetër ofron me pague një plotësuëse, të cilën gjyqtari e gjen të mjaftme,*" vazhdon neni 1097 në §2 dhe më poshtë shton: "*dispozitat e këtij neni nuku aplikohen në lëdimet që u përkasin disa kontratavet të posaçme.*" Nga raporti mbi projektin e unifikuem të obligasionevet rezulton se, veprimi i përgjithëshmë i lëndimit në kontratat është pranuar kur, nga disproporcioni midis obligacionit të marë përsipër nga njëri prej kontraktantëvet dhe avantazhit që ky heq nga kontratoja, prezumohet se hiri i tij nuku ka qënë mjatt' i lirë. Redaktuësit e projektit me dispozitat relative me lëndimin patnë për qëllim të goditin *uzurën e paligjëshme (kamatëlëpinjësinë)* në format e saj më të ndryshme.

Neni 1097 i Kodit Civil bën fjalë për lëndimin nër kontratat, por kjo dispozitë sigurisht ka vënd dhe shtrihet dhe në aktet një-anëshe; Dispozitat e këtij neni formojnë një rinësim, një inovasion të thellë në këtë institusion. *Neni 1097 i Kodit Civil*, përmban dy gjëra, të cilat janë për t' u vënë oreé, dhe këto janë:

1. Nuku ka para-sysh mprojtjen e njërës nga palët nga abuzimi i nevojës, nga mungesa e eksperiencës, por e konsideron çështjen nga pik-pamja e mungesës të lirisë të vulnetit të viktimës, dhe,

2. I jep gjyqtarit të drejtën ose t' a anullojë aktin juridik ose të korizhojë vesin e hirit, dyke ulur obligimet eksesive.

KAPTINA C.

§ 75. — Mënyrat e deklarimit të vulnetit.

Thamë më sipër se, për eksistencën e një akti juridik të fuqishme, duhet që vepëruësi i aktit të ketë zotësinë të bëjë veprime juridike, të koincidojë deklarimi me vulnetin; Për sa i përket formës, u tha se legjislasioni i jonë nuku është një legjislasion formalist. Me përjashtimin e disa rasteve, për të cilat ligja ka caktuar forma, në gjith' aktet e tjera juridike nuku është nevojë q' ato të vishen me nonjë formë të caktuar.

Në rastet, pra, në të cilat nuku është nevojë që të vishet akti me një formë të posaçme, deklarimi i vulnetit mundet të bëhet: 1) shprehimisht ose imediat, dhe 2) heshtësisht ose tërthorazi.

Deklarim i shprehun ose *imediat* quhet ay që bëhet me fjalë ose me zheste që kanë po atë kuptim me fjalët; Për shëmbëll: po t' i them **A** "e ble këtë send për tre franga" dhe ay të tundë kryen në shënjë pranimi, deklarimi i tij është i shprehun ose imediat, sikundër dhe po të theshte verbalisht **A** "e blé". Gjith' ashtu ngjet dhe kur, dyke da-

shhur të blé një send, e pyes **A** "sa e shet" dhe ay më thotë: "tre franga"; Po t' i numuronj **A** të tre frangat, deklarimi i jem është i shprehun.

Përgjithësisht eksiston deklarim' i shprehun i vulnetit, kur bëhet një veprim, i cili ka për qëllim t' a deklarojë atë vulnet.

Deklarimi i heshtur ose tërthorazi quhet ay, i cili del si rezultat nga një vepër tjetër, që tregon si konsekancë vulnetin e deklaruësit; Për shëmbëll: **A** emëron trashëgimtar **B** dhe më pas vdes; Thëritet **B** si trashëgimtar, por që të bëhet i tillë duhet t' a deklarojë vulnetin e tij. Deklarimin mundet t' a bëjë ose shprehimisht tue thënë: "Dëshëronj të bëhem trashëgimtar i **A**," ose heshtësisht tue u përzjerë në trashëgim, tue mbledhur kreancat e *de cujus*-it si trashëgimtar dhe në këtë rast nga këto veprat e tija del si konsekancë vulneti i tij se dëshëron të jetë trashëgimtar i **A**. *Neni 661 i Kodit Civil,* dyke treguar mënyrat e pranimit të trashëgimit, na jep në dy paragrafet e fundit definisjonin e deklarimit të shprehun dhe atë të deklarimit të heshtur. "*Quhet se — (pranimi)* thote neni 661 — *është bërë shprehimisht, kur një personë mer përsipër titullin ose cilësin' e trashëgimtarit me një akt publik ose me një shkresë private*". — "*Quhet se është bërë heshtësisht, kur trashëgimtari bën një vepër, e cila nevojërisht parasypozon se ay ka dasht me pranue trashëgimin dhe atë vepër nuku do të kish të drejtë me e bâ, veçse si trashëgimtar*". Parimisht, heshtja nuku mundet të konsiderohet si deklarim vulneti, *ay që heshtën nuku është d' akord.*

§ 76. — Përfaqësimi

Thamë më sipër se një nga elementat e domos-doshme të çdo akti juridik është deklarimi i vulnetit. Deklarimi i vulnetit mundet të bëhet ose prej vetë personës që është palë në aktin juridik ose prej një të treti. Pra, *përfaqësim* eksiston kur një personë vepëron në vënd të një tjetri, por akti juridik i përket këti të fundit. Kur një akt juridik bëhet

prej një persone për llogarë të një tjetri, por me kondita të tilla që efektet të produktohen drejt-për-së-drejti mbi kryen e të përfaqësuemit si kur t' a kishte bërë ay vetë aktin, kemi përfaqësim.

Institusioni i përfaqësimit lot një rol me shumë rëndësi në marëdhëniet juridike. Pik-së-pari kemi të pa-zotët, të cilët nuku mundin të eksersojnë ata vetë të drejtat e tyre, massi u mungon fuqia mendore çmuëse. Ligja, pra, u emëron këtyrevet një përfaqësuës, i cili vepëron për llogarë e tyre. I pa-zoti bëhet pronjar, kreditor, debitor, si kur ay vetë të kishte pasur kontraktuar. Më anën tjetër përfaqësimi lehtëson krijimin e marëdhënievet juridike midis personavet që kanë zotësinë juridike, dyke u përmetuar të bëjnë akte pa u ndodhur ata vetë. Institusioni i përfaqësimit çduk pamundësitë materiale ose të tjera, si për shëmbëll: largësinë, mungesën e eksperiencës, shumicën e punëvet e tjera, të cilat shumë herë do të ndalonin krijimin e një veprimi juridik. Por, atje ku kryesisht manifestohet dobia e përfaqësimit është sfera e së drejtës pasurore.

Pikat karakteristike të përfaqësimit janë këto:

1. Ay që bën aktin juridik vepëron në emër dhe për llogarë të një persone tjetër; Me fjalë të tjera, përfaqësuësi ka qëllim të vepërojë për një tjetër dhe ja bën të dijtur këtë qëllim personës, me të cilën bën aktin juridik. Kjo kondite duhet të konsiderohet si esenciale. Pra, në qoftë se përfaqësuësi, ndonëse vepëron për një të tretë, nuku ja bën të dijtur palës tjetër se është mesës, nuku eksiston përfaqësim; Konvencioni formohet midis të dy palëvet kontraktuëse. Kjo gjë ngjet në tregëti me *komisionin*.

2. Nuku mjafton që përfaqësuësi t' a bëjë aktin për llogarë të një persone të tretë, massi duhet të ketë fuqinë t' a përfaqësojë; Kjo fuqi jepet ose drejt-për-së-drejti prej ligjës, ose prej vetë të interesuemit

Ligja u jep përfaqësuësvet ligjorë të së pa-zotëvet: tytorit, simbas *nenit 333 të Kodit Civil*, atit administruës të pasurisë të fëmijëvet tij të mitur, simbas *nenit 281 të Kodit*

Civil, burit administruës të pasurisë dotale të gruas së tij, *si mbas nenit 1342 të Kodit Civil*, të drejtën që t' a përfaqësojnë.

Por, kur një personë ngarkon një tjetër për të bërë një ose më shumë vepërime juridike për llogarë të saj, at' here përfaqësimi nuku është ligjor, por rjeth prej konvencioni, është kontraktuel.

Duhet vënë orojé se mundet të eksistojë përfaqësim dhe në rastin që i interesuemi mos të ketë dhënë porosi, akoma dhe kur nuku ka dije se akti u plotësua për llogarë të tij. Kjo ngjet në *gjerimin e punëvet*. Le të sypozojmë se pasuria ose interesat e një p rsone që mungon ndodhen në rezik; Një mik i kësaj persone ndërhyn për t' a shpëtuar nga një dëm dhe në emërin e saj bën vepra administrimi të ngutëshme, dyke lajmëruar të tretët, me të cilët kontrakton, se vepëron si gjeruës punësh. *Gjeruësi* do të konsiderohet sikur ka kontraktuar me cilësi përfaqësuësi. *Ratifikimi* i të zot të pasurisë ose të interesavet të gjeruara, i cili vjen massi u plotësuan veprimet, ka po atë efekt, sikur të kishte dhënë faqi veprimi që më parë. Pra, gjithë konsekancat juridike të veprimit do të produktohen mbi personën e tij; "*Ratihabitio mandato aequi-paratur*" theshin juristët romanë, domethënë ratifikimi barasohet me porosinë. Duhet vënë orojé akoma se, dhe sikur i zoti i punëvet të gjeruara të refuzojë ratifikimin, prap-së-prapi deri më një masë përfaqësimi vepëron Me të vërtet, i zoti i punëvet është i detyruar kundrejt të tretëvet nga angazhamentat e lidhura në emërin e tij prej gjeruësit, në rastin që çështja u gjerua u administrua mirë, domethënë në rastin që i interesuemi, zoti i punëvet të gjeruara, pa një dobi *(neni 1139 i Kodit Civil)*.

Nga sa u thanë më sipër, duket se *ratifikimi* nuku është i njëjtë me *përfaqësimin;* Por, është e vërtetë se gjithë monë përfaqësimi, kur nuku është ligjor, parimisht sypozon një deklarim vulneti të së përfaqësuarit, i cili e autorizon përfaqësuësin t' a bëjë aktin juridik ose i ratifikon

gjerimin.

Kodi Civil bën fjalë për përfaqësimin *në nenet 1105—1112*, dhe parimi themelor që ka pranuar në këtë institusion është ky: *përfaqësuësi detyron të përfaqësuemin ndaj të tretëvet dhe të tretët ndaj i përfaqësuemi.*

Për përfaqësimin duhen thënë më posaçërisht dhe këto:

Veprimet e bëra prej përfaqësuësit në emërin e të përfaqësuemit, por brenda në kufitë e fuqisë që i është dhënë, sjellin drejt-për-së-drejti efekt si në favor, ashtu edhe kontra të përfaqësuemit *(neni 1105 i Kodit Civil)*.

Ligja nuku lyp që përfaqësuësi të ketë zotësi juridike që të obligohet personalisht. Mjafton të ketë zotësinë të lypur prej ligjës për të përfaqësuar të tjerë dhe akti juridik që bën mos të jetë i ndaluar për të përfaqësuemin; Domethënë, në qoftë se lypen kondita zotësie juridike për vleftësiën e aktit juridik, ato duhet të eksistojnë tek i përfaqësuari.

Vesi i vulnetit të përfaqësuësit ka si konsekancë anullimin e aktit juridik në favor të të përfaqësuemit. Por, kur vesi eksiston në vulnetin e të përfaqësuemit, veprimi juridik është i anulluëshmë, kur përfaqësuësi ka përkufizuar veprimin e tij vetëm në çfaqjen e vulnetit të të përfaqësuemit *(neni 1106 i Kodit Civil)*.

Të tretët që janë palë në aktin juridik, kanë të drejtë të kërkojnë nga përfaqësuësi të justifikojë pushtetet e veta dhe, në rastin që këto pushtete rjedhin nga një shkresë, përfaqësuësi duhet t' u japë një kopjo të asaj shkrese të vërtetuar me nënëshkrimin e tij *(neni 1107 i Kodit Civil)*.

Përfaqësimi duhet të jepet me akt publik, në qoftë se ligja lyp akt publik për veprimin, për të cilin u dha përfaqësimi. Por, në rastin që për atë veprim është e nevojëshme dhe mjafton një shkresë private, dhe sikur ay veprim të bëhet me akt publik, përfaqësimi mundet të jepet vetëm me shkresë private *(neni 1108 i Kodit Civil)*.

Ligja mpron gjith' ata të tretë, që kanë kontraktuar me përfaqësuësin pa dijtur se në atë kohë i përfaqësuemi,

ka pas përkufizuar ose revokuar pushtetet q' i ka pas dhënë përfaqësuësit; Përkufizimi ose revokimi nuku mund t' u kundrështohet të tretëvet që nuku muar dije për këto ngjarje *(neni 1109 i Kodit Civil)*.

Me të marë fund pushtetet, përfaqësuësi duhet t' i ngëthejë të përtaqësuemit aktin, me të cilin konstatohen ato pushtete. Ligja nuku i përmeton përfaqësuësit t' a mbajë atë akt për sigurimin e kredivet që ky ka kontra të përfaqësuemit *(neni 1110 i Kodit Civil)*.

Simbas *dispozitavet të nenit 1111 të Kodit Civil* është civilisht përgjegjës ay, i cili ka kontraktuar si përfaqësuës pa patur atë cilësi dhe kështu nga mos lidhja e kontratos ka shkakëtuar dëme personavet të treta, që kanë kontraktuar me 'të, por lypet që të tretët të ndodhen në mirëbesim.

Më në fund përfaqësuësi është i ndaluar të kontraktojë me vetë-vehten, qoftë për llogarë të tij, qoftë për llogarë të një të treti. Qëllimi i kësaj dispozite është që të ndalohet çdo posibilitet që mundet të kompromentonte interesat e të përfaqësuemit dhe giith' ato abuzime shumë të lehta që do të shkakëtonte një regullim i ndryshme i çështjes. Por, në rastin që i përfaqësuemi ka dhënë autorizimin për një gjë t' atillë ose e ratifikovi më pas, akti juridik i bërë në këtë mënyrë është i fuqishmë *(neni 1112 i Kodit Civil.)*

Përfaqësimi aplikoket mbi gjithë aktet juridike, por eksistojnë disa prej tyre, në të cilat ky institusion nuku ka aplikim. Disa raste — shumë të ralla — lypin ndërhyrjen e të interesuarit vetë dhe këto raste janë dy: *martesa* dhe *testamenti*.

§ 77. — Ratifikimi.

Sikundër u tha më sipër, takon që një personë të bëjë një akt juridik si përfaqësuës i një tjetri pa patur përfaqësim. I zoti i çështjes ka të drejtë t' a pranojë ose jo këtë. Pra, *pranimi i aktit juridik të bërë që më parë quhet ratifikim; "Ratihabitio mandato aequi paratur"* theshin juristët

romanë, domethënë *ratifikimi barasohet me porosinë.*

Deri sa fupia e aktit juridik mbetet e mvarur, veprimi mbi objektin e aktit konsiderohet si gjerim pun"sh me shpresën e pëlqimit të të zotit. Ratifikimi mundet të bëhet shprehimisht ose heshtësisht. Regullisht ratifikimi ka fuqi prapavepruëse, kështu që akti juridik bëhet i vlefshmë qysh në fillim, domethënë vepruësi konsiderohet sikur ka patur përfaqësim që në krye. Ratifikimi nuku mundet të eksistojë në aktet juridike, në të cilat deklarimi i vulnetit duhet të bëhet me një formë të caktuar, si për shëmbëll: shitja e një sendi të palujtëshme, testamenti nul, për të cilat nuku mjafton ratifikimi, por duhet një akt juridik i rri me do-e-mos. *Neni 1305 i Kodit Civil* bën fjalë për ratifikimin.

KAPTINA Ç.

§ 78. — Nuliteti i aktevet jurikike.

Akti juridik mundet të jetë i vesuar nga shumë pikëpamje. Kur themi se një akt juridik është i vesuar, duhet të kupëtojmë se ay nuku është konformë me kanunet e së drejtës.

1. Mundet t' i mungojë aktit juridik një element kryesor, i domosdoshmë për formimin e aktit juridik; Për shëmbëll: mungon vulneti i njërës nga palët në një kontrato; tjetër shëmbëll: në një martesë të projektuar një nga kandidatët bashkëshortë refuzon të japë konsantëmanë përpara ofiqarit të gjëndjes civile. Ose, në një projekt konvencioni shitjeje palët nuku mbeten d' akord mbi sendin e shitur dhe mbi çmimin. Në këto raste është e qartë se akti juridik nuk ka as no një vleftë, nuku mund të sjellë as një efekt juridik. Për të karakterizuar këtë gjendje doktrina përdor një termë shumë energjike: thotë se akti është i *pa qënë, nuku eksiston.*

2. Akti juridik shkel një dispozitë të ligjës, për shëmbëll përmban kondita që vijnë në kundrështim me urdhrin

publik ose me zakonet e mira. Ose akti duhej të bëhej në formë solonele, e cila nuku u mbajt. Ky akt, massi është bërë tue u shkelur ligja, nuku mundet të sjellë as një efekt juridik; Ligja e godit me një nulitet që quhet *absolut.*

3. Më në fund deklarimi i vulnetit mundet të jetë i pa-plotë, qoftë se rjeth prej një të pa-zoti të pa rehabilituar regullisht, qoftë se ay deklarim është i vesuar nga një prej vesevet të vulnetit që u studjuan më parë (*lajthim, dhel, dhunë*). Për të mprojtur të interesuarin kontra konsekancavet të veprës së tij, ligja i përmeton që ay t' u drejtohet gjyqevet për të deklaruar anullimin e aktit juridik. Në këtë rastin e fundit themi se akti është i *anulluëshme* ose është goditur prej *anulluëshmënie* ose *nuliteti relatif.*

Kështu, pra, eksistojnë *shkallë* në vleftësinë e një akti juridik dhe çquhen ato tue përdorur zakonisht termat: *ineksistencë, nulitet absolut, nulitet relatif* ose *anulluëshmënië.*

§ 79. — Nulitete absolute.

Nul *quhet akti juridik, i cili, ndonse naturisht eksiston, juridikisht është ineksistent, nuku eksiston* Akti nul është një ngjarje, e cila juridikisht nuku eksiston. Le të sypozojmë se u bë një akt juridik, tue u shkelur një dispozitë ligjore që i përket urdhrit publik. Për shëmbëll: një akt, i cili nga natura e tij hyn në kategorinë e aktevet *solonele* u bë pa u respektuar format e lypuna prej ligjës; Ose u vu në aktin juridik një konditë ose barë e paligjëshme. Në këtë rast themi se akti është *nul* me një *nulitet absolut.*

Pikat karakteristike të nulitetit absolut janë këto:

1. Ç' do personë, që ka një interes të pretandojë një nulitet kësodore, ka të drejtë t' a invokojë qoftë në formë *padieje,* qoftë në formë *prapsimi.* Pra, në qoftë se akti juridik i vesuar është një kontrato, nulitetin mundet t' a pretandojnë të dy palët kontraktuëse.

Por dhe çdo i tretë që ka interes të ligjëshme mundet t' a pretandojë nulitetin absolut, si për shëmbëll: një dhurues i dhurovi A një shtëpi me një akt privat veprim,

ky që vien në kundrështim me dispozitat e nenit 1489 të Kodit Civil, ku thuhet: "çdo dhurim duhet të bëhet me akt publik, për ndryshe është nul." Më pas ja shet këtë shtëpi një tjetër përsone, të cilën e ve dhe në posesionë të pronjës. Në qoftë se donatari padit blerësin, ky do t'a kundërshtojë dyke u bazuar në nulitetin absolut të dhurimit. Tjetër shëmbëll: *nenet 1348 dhe 1350 të Kodit Civil* goditin me nulitet absolut jetësimin ose obligimin e dotës *pa hirin e të dy bashkëshortëvet dhe pa autorizimin e gjykatës.* Dispozitat e këtyrevet nenevet janë prej atyre të urdhrit publjk. Pra, në qoftë se buri shet një pronjë dotale, zotërimi i pronjës nuku transferohet mbi blerësin dhe kështu, në qoftë se pronja i është dorëzuar blerësit, jetërsuësi mundet t'a kërkojë prapë, tue invokuar nulitetin absolut të aktit juridik. Blerësi në padien do të përgjigjet tue bërë prapsimin e shitjes, por shitësi do të kundërshtojë *prapsimin e nulitesit absolut* të aktit juridik.

2. Akti juridik i vesuar me një nulitet absolut nuku mundet të konfirmohet, të ratifikohet prej atyrevet që e bënë. Dispozita e *nenit 1306 të Kodit Civil* është e shprehun mbi këtë pikë. Me të vërtet konfirmim i një akti, quhet renoncimi i invokimit të shkakut të nulitetit që e cënon. Pra, kjo sypozon se padia dhe prapsimi për nulitet janë në dispozisionin vetëm të një personë, të asaj që renoncon; Kjo ngjet kur nuliteti është relatif. Por, kur nuliteti është absolut rasti ndryshon; Renoncimi ose konfirmimi i njërës palë në këto nuku ka efekt, *massi kurkush nuku mund të renoncojë të drejtën e një të treti.* Për shëmbëll: një i mitur premton një send, por ky akt është i vesuem me një nulitet absolut. Në qoftë se ky premtim ratifikohet prej premtuësit në madhorinë e tij, prapë ay premtim është nul, massi — sikundër theshin romanët — *"quod ab initio vitiosum est, tractu temporis convalescere non potest,"* domethënë: *ajo që është e vesuar qysh në fillim, nuku mund të ndreqet me kalimin e kohës.*

3. Dispozitat e *nenit 1301 të Kodit Civil,* për parash-

krimin e padies për anullimin e aktevet juridike, nuku kanë aplikim në nulitetet absolute.

Nuliteti absolut nuku mundet të parashkruhet, domethënë kalimi i kohës nuku e mbulon. Akti juridik i vesuem me një nulitet absolut sado i vjetër qoftë, nuku mundet të sjellë as një efetk; Do të ishte me të vërtet një gjë e çuditëshme që me kalimin e kohës të mernin fuqi akte juridike të ndaluara prej ligjës. Adazhi i së drejtës romane *"quod ab initio vitiosum est, tractu temporis convalescere non potest,"* është absolut.

4. Thamë më sipër se aktet juridike të vesueme me një nulitet absolut nuku eksistojnë; Pra, në konformitet me parimin *"accessorium sequitur principalis,"* dhe gjithë garancitë që jepen për sigurimin e aktit juridik, si për shëmbëll *ipoteka, pengu, dorëzânia* janë *nul* dhe këto, massi nuku eksiston gjë që të mundë të sigurohet.

Për të plotësuar studjimin mbi nulitetet absolute, duhen bërë dhe këto dy vërejtje:

a) Parimisht gjithë dispozitat *ndaluëse* ose *urdhënuëse* të ligjës, kanë si sanksion nulitetin. Me gjith' këtë, eksepcionalisht, takon që shkelja e dispozittës nuku ka si konsekancë çvleftësimin e aktit iuridik. Një shëmbëll kësodore eksiston në dispozitat e Kodit Civil relative me martesën, Ndalimet e martesës çquhen në ndalime prohibitive të thjeshta (simplement prohibitifs) dhe në ndalime që kanë si konsekancë nulitetin absolut (dirimants). Por, ndonse gjithë dispozitat e Kodit Civil që i përkasin martesës kanë një karakter ndaluës ose, ndryshe, urdhënuës, ndalimet prohibitive të thjeshta nuku ja çënojnë vleftën martesës, ndonse të celebruar kontra ndalimevet të përshkruara prej ligjës. Vetëm ndalimet *dirimante* shkakëtojnë nulitetin e martesës të celebruar jashtë regullavet të caktuara prej ligjës;

b) Ligja nuku e deklaron gjithë-monë shprehimisht nulitetin. Shpesh herë Kodi Civil mjaftohet në formullën ndaluëse, tue thënë: *"nuku mundet, nuku duhet"*, ose me formullën urdhënuëse, sikundër ngjet *në nenet 245 dhe*

1325 të Kodit Civil. Ligja urdhëron ose ndalon, por nuku cakton sanksionin; Nuku mbetet as pak dyshim se, në këto raste, nuliteti mundet të deklarohet në bazë të vulnetit të heshtur të legjislatorit; Nuliteti është virtual, vepëron me fuqin' e vetë. Por, cilat janë këto raste, nga do të kupëtohet se legjislatori dëshëron të sanksionojë me nulitet absolut aktet juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë ligjore *urdhënuëse* ose *ndaluëse* të vënë prej tij? As një kriterium nuku eksiston, që të përmetojë të jepet një gjegje e përgjithëshme kësaj pyetjeje; Kjo zgjidhet dyke studjuar, për çdo rast të veçantë, në të cilën do të prezantohet, shpirti i ligjës, si dhe shkaket për të cilat u vu dispozita urdhënuëse ose ndaluëse. Në qoftë se ato dispozita të ligjës janë kaqe esenciale, kaqe themelore sa akti që ka për t' u çmuar mos të jetë e mundur të kupëtohet pa u respektuar ato dispozita të përshkruara prej ligjës, at' here ato shkakëtojnë nulitetin absolut të aktit juridik.

§ 79 *bis* — Anulluëshmënia ose nulitete relative.

I anulluëshmë quhet akti juridik që ka një eksistencë jo vetëm naturale, por dhe juridike, por i cili mundet të përmbyset nga shkaku i një vesi q' eksiston në 'të.

Anulluëshmënia ose nuliteti relatif nuku rezulton nga shkelja e një dispozite ligjore, karakteri urdhënuës ose ndaluës i të cilës i përket interesit të përgjithëshmë. Shkaket kryesore që e bëjnë një akt të anulluëshmë janë:

1. Deklarimi i vulnetit të atij që e bëri aktin juridik është i vesuem prej *dhelit, dhunës, lajthimit* dhe në disa raste dhe prej *lëndimit.*

2. Persona që e bëri aktin juridjk është *e pa-zotë* dhe vepërovi pa respektuar regullat e çaktuara prej ligjës.

Nuliteti relatif ose, ndryshe, anulluëshmënia na prezantohet me një karakter të çaktuar mirë, i cili e çquan qartazi prej nulitetit absolut. Nuliteti relatif është një masë mprojtjeje të një ose shumë interesavet pri ate. Kjo masë shpjegohet nga fakti se një personë ra viktimë për shkak

se i mungonte eksperienca, se ra në lajthim ose për shkak se ju dhunua vulneti ose se u përdorë kontra 'tij dredhira dolozive ose, më në fund, se u lëndua në një nga ipotezat eksepsionale, në të cilat ligja e mer parasysh lëndimin; Mënyra më e mirë për t' a mprojtur viktimën është, jo anullimi i aktit juridik, massi ky shërim do të kapërxente shpesh herë qëllimin, por subordonimi i eksistencës të aktit nga vulneti i të interesuarit, i cili po t' a gjejë të dobishmë aktin juridik, do t' a konfirmojë, për ndryshe do të kërkojë anullimin.

Në Kodin Civil eksistojnë disa raste të tjera, në të cilat, ndonse anulluëshmënia bazohet në idhenë të mprojtjes të interesavet private, por këto ndryshojnë pak nga interesat që u treguan më sipër; Për shëmbëll: *neni 89 i Kodit Civil* dispozon që, *ata të cilëvet u është akorduar posedimi i përkohëshmë i pasurisë të absentit, nuku mundet të bëjnë pa lejën e gjykatës veprime të tjera, përveç atyrevet të administrîmît të thjeshtë; Pra, në qoftë se këta bëjnë veprime që kapèrxejnë pushtetin e administrîmît që u akordon ligja, vetëm absentî* — në rast që këthehet — *mundet të kërkojë anullimîn e atyre veprîmevet,* massi ligja vetëm për interesin e absentit ka limituar të drejtat e atyrevet që u akordohet posedimi i përkohëshmë i pasurisë së tij.

Thamë më sipër se i anulluëshmë quhet akti juridik, që ka një eksistencë jo vetëm naturale, por dhe juridike, por ay akt mundet të përmbyset për shkak të një vesi që eksiston në 'të, si për shëmbëll: A më thotë "ja më jep orën, ja se të vrava;" Unë nga frika i jap orën. Akti juridik i bërë është i fuqishmë dhe zotërimi i orës t' ime u transferua mbi A, por ndonse akti juridik eksiston juridikisht, mundet të atakohet prej të interesuarit, prej një persone të caktuar dhe të përmbyset. Deri në minutën që akti juridik nuku është i atakuar, efektet juridike të aktit vazhdojnë të eksistojnë.

N. E. Tsitso — Parimę të Përgjithëshmę.

Nga kuptimi që u dha për nulitetin relatif të aktit juridik, që ay domethënë ka një eksistencë jo vetëm naturale por dhe juridike, rjedhin këto konsekanca:

a') Akti juridik i anulluëshmë krijon, ndryshon ose shuan të drejta, massi është deri në një pikë i vlefshmë; Për shëmbëll: **A** me dredhira dhe mjete dhelparake më bind t' i dhuronj 1000 franga. Akti juridik i bërë midis meje dhe **A** është i fuqishmë dhe bëhem debitor' i **A** për këtë sumë; Akti juridik sjell gjithë efektet deri sa t' a atakonj unë.

b') Nulitetin relatif mundet t' a invokojë vetëm persona, në favor të së cilës u vu kjo dispozitë ligjore, si për shëmbëll: **A** me mjete mashtruëse më bind t' i dhuronj një send. Vetëm unë kam të drejtë të kërkonj përmbysjen e aktit juridik dhe jo çdo i tretë, sikundër ngjet me nulitetin absolut. Tjetër shëmbëll: një i mitur ble një pronjë pa qënë i autorizuar ose i përfaqësuar prej tytorit të tij; I mituri ka të drejtën të kërkojë anullimin e konvencionit, kurse shitësi nuku mundet *(nenî 1088 î Kodît Cîvîl)*, massi kjo dispozitë ligjore është vënë vetëm në favor të të miturit.

c') Aktet juridike të anulluëshme mundet të konfirmohen prej atij, i cili ka të drejtën të kërkojë anullimin. Konfirmimi formon renoncim të padies për anullim. Me konfirmimin akti juridik mer gjithë fuqinë e tij, konsiderohet sikur nuku ka qënë i vesuem kurë no nj' herë *(nenî 1305 î Kodît Civil)*. Por për t' u konfirmuar akti juridik i anulluëshmë lypen këto dy kondita: *Primo*, në kohën kur bëhet konfirmimi duhet që të jenë plotësuar konditat që lypen për vleftësiën e tij, domethënë shkaku që e vesonte aktin juridik të ngrihet, si, për shëmbëll, dhuna, lajthimi, pazotësia të pushojë, dhe *sekondo*, konfirmimi të bëhet ose *shprehîmîsht* ose *me eksekutimîn e oblîgîmit të bërë vulnetarîsht dhe tue dîjtur nulîtetîn që e vesonte aktîn jurîdîk.*

ç') Padia për nulitet relatif shuhet me parashkrimin, kur ay që e ka të drejtën t' a përdorë lé të shkojë një kohë pa atakuar aktin. Parashkrimi është një mjet, me të cilin me

kalimin e kohës dhe me kondita të caktuara një personë fiton një të drejtë ose librohet nga një obligim. Koha e parashkrimit ordinar është tridhjetë vjet; Por, për nulitetin relatif dhe për sa u përket konvencionevet, ligja ka caktuar një parashkrim më të shkurtër, i cili është *pesëvjeçar* dhe bazohet në idhenë të një konfirmimi të heshtur. Ay, i cili ka të drejtë të ngrehë padien për anullimin e aktit juridik të anulluëshme, konsiderohet se mas kalimit të këtij afat ka renoncuar nga benefici i kësaj padijeje dhe kështu heshtësisht ka konfirmuar aktin e atakuëshme (*neni 1301 i Kodit Civil*).

Ky afat, në rast dhune fillon të ecë qysh prej ditës që kjo ka pushuar; Në rast lajthimi ose dheli qysh prej ditës të zbulimit të këtyre, për veprimet e të miturvet qysh prej ditës madhorisë së tyre, për veprimet e të ndaluemvet ose të pa-aftësuemvet qysh prej ditës të pushimit të ndalimit ose të pa-aftësimit.

d') Akti juridik i anulluëshmë, para se të përmbyset sjell gjithë konsenkancat ligjore. Por, me t' u përmbysur, gjithë konsekancat për të arthmen humbasin, po ato që u krijuan në të kaluemen vazhdojnë të eksistojnë.

e') Sigurimet, si ipoteka, pengu, garancia të dhëna për aktin juridik të anulluëshme janë dhe këto, sikundër dhe akti kryesor vetë, të vlefshme, por të anulluëshme simbas parimit "*accessorîum sequîtur prîncipalis*". Në qoftë se sigurimi është dhënë për garantimin e kreditorit për rastin që debitori do të përdorte të drejtën që ka t' a atakojë dhe t' a përmbysë aktin juridik, at' here ky sigurim nuku është i anulluëshmë.

Për të plotësuar sa u thanë më sipër mbi nulitetet duhen shtuar dhe këto: Aktet juridike nga pik-pamja e nulitetevet ndahen në 1) akte juridike të goditura me nulitet absolut dhe në akte juridike të anulluëshme. Cilat janë këto nulitete dhe pikat karakteristike të tyre u treguan gjërë e gjatë më sipër. 2) Akte juridike të goditura me nulitet të përgjithëshme, dhe akte juridike të goditura me nulitet

pjesërisht. *Nulitet i përgjithëshmë* quhet ay, i cili i përket të gjithë aktit juridik. *Nulitet pjesërisht* eksiston' kur ay i përket vetëm një pjese të aktit juridik; Në këtë rastin e dytë akti juridik nuku është i tërë nul ose i anulluëshmë, por vetëm për sa i përket pjesës së vesueme; Në këtë rastin e dytë ka aplikim adazhi "*utile per inutile non vitiatur*" domethënë e *dobishmeja nuku vesohet nga e pa dobishmeja.* 3) Akte juridike të goditura me *nulitet inicial* (*qysh në krye*) dhe akte juridike të goditura me *nulitet të mâ-pasme.* Nulitet inicial quhet ay, i cili eksiston qysh prej formimit të aktit juridik. Nulitet i mâ-pasmë quhet ay, i cili ngjet më von se krijimi i aktit juridik, si për shëmbëll: **A** redakton tes'amentin e vetë dhe, massi nuk ka fëmijë, emëron **B** trashëgimtarin e tij të përgjithëshme; Më pas i lind një djalë. Testamenti është nul dhe nuliteti këtu është i mâpasmë *(neni 617 i Kodit Civil).* Tjetër shëmbëll: I dhuronj **A** një mijë franga, dhurimi është i vlefshmë. Më pas **A** provohet se është një mos-mirënjojtjes; Akti juridik bëhet i anulluëshme (*neni 1510 i Kodit Civil*).

§ 80. — Ineksistencë.

Pranë aktevet të goditura me një nulitet absolut, doktrina shpesh herë vé një kategori të veçantë dhe të çquar aktesh juridike: është ajo e aktevet të *pa-qëna, ineksîstente.* Jurisprudenca franceze, e influencuar nga kjo theori, ka të tregojë dhe disa vendime që e pranojnë distinksionin e aktevet juridike të pa-qëna. Simbas kësaj theorie konsiderohen akte juridike të pa-qëna, për shëmbëll, një konvencion shitjeje midis dy palëvet, të cilat nuku kanë parasysh një objekt të konvencionit massi njëri nga kontraktantët dëshëron të shesë shtëpinë dhe tjetri të blerë magazenë; Gjith' ashtu — si mbas kësaj theorie — janë akte juridike të paqëna: një martesë midis dy personavet, nga të cilat njëra nuku e ka seksin të çaktuar, një akt juridik i çdo lloji i bërë prej një të çmënduri, në kohën që ky ndodhej në krizën e sipër të sëmundjes.

Me gjithë këto që u thanë, as e gjithë doktrina, as jurisprudenca kanë pranuar kategori të veçantë aktesh juridike ineksistente, të pa-qëna dhe as që rezulton nga ligja nonjë kësilloj kategorie.

KAPTINA D.

§ 81. — Modalitetë e aktevet juridike

Në parim aktet juridike janë të thjeshta dhe semple, domethënë vulneti i autorit tyre është i qëndruëshmë dhe i lirë nga çdo përkufizim, kështu, pra, cilido qoftë akti juridik i plotë, efektet e tij realizohen për nj' herjesh dhe për gjithëmonë.

Por, shpesh herë akti juridik pasohet prej kushtesh përkufizuës, të cilët quhen *modalitete*, për shkak se modifikojnë efektet e aktit juridik. Kur themi modalitè duhet të kuptojmë tregimin e një ngjarjeje të pritme të caktuar prej palëvet dhe nga realizimi i së cilës mvaren efektet e aktit juridik.

Modalitetet përdoren me dy mënyra të ndryshme. Nga do nj' herë palët shtyjnë efektet e aktit juridik deri në realizimin e ngjarjes të treguar dhe në këtë rast modaliteti quhet *pezulluës*; Herë të tjera, prapë, palët lenë efektet e aktit juridik të produktohen përnj' herjesh, por mbeten d' akord se ato efekte do të marin fund me t' u realizuar ngjarja dhe në këtë rast modaliteti është *zgjidhës*. Pra, modalitetet të aktevet juridike mundet të kenë qëllime të kundërta, disa vonojnë, disa shuajnë efektet e aktevet juridike.

Modalitetet që sjellin rezultatet e sipërtreguara janë dy llojesh: 1) *Afati* dhe 2. *Kondita*.

Si afati ashtu edhe kondita mundet të jenë, njëra dhe tjetra, pezulluës ose zgjidhës, por efektet e tyre nuku i sjellin në një mënyrë.

Modalitetë, afati dhe kondita, përmblidhen në librin e IV të Kodit Civil, por, massi këto mundet të bashkohen

me gjithë aktet juridike, studjimi i tyre e ka vëndin në këtë libër të parimevet të përgjithëshme.

§ 82. — Kondita.

(*Nenet 1183—1190 të Kodit Civil*).

Konditë quhet fakti, ngjarja e arthme dhe e pa-saktë, nga realizimi i së cilës palët mvarin krijimin, ndryshimin ose zgjidhjen e një të drejte, ose, ndryshe, konditë quhet një ngjarje e arthme dhe me realizim të pa saktë, e cila pezullon qoftë lindjen, qoftë zgjidhjen të një të drejte dhe e cila sjell efektin e saj me prapaveprim. Për shëmbëll: Do të të jap 1000 franga, po të vijë anija nga Amerika.

Kondita, në kuptimin juridik të fjalës, që të eksistojë, duhet të konkurojnë dy gjëra:

1. Fakti, ngjarja nga e cila mvaret lindja ose zgjidhja e një të drejte, duhet të jetë objektivisht e pa-saktë. Pra, ngjarja duhet të jetë e *arthme*, massi vetëm ngjarjet e arthme janë të pa-sakta. Në qoftë se ngjarja i referohet kohës së tanishme ose asaj të kaluar, nuk eksiston konditë.

2. Nuku mjafton vetëm që ngjarja të jetë e arthme, duhet të jetë dhe e *pa-saktë*, massi eksistojnë ngjarje të arthme që janë të sakta, gjë e cila ngjet në afatin. Pra, në qoftë se një ngjarje, ndonse e arthme, do-mos-do do të ngjasë ose nuku do të ngjasë për shkake naturale ose ligjore, at' here nuku eksiston konditë në kuptimin teknik të fjalës. Për shëmbëll: do të të jap 1000 franga, po të lindë djelli nesër nga perëndimi, ose po të çikësh qjellin me dorë, ose po të pish detin. Në këto shëmbëlla, ndonse ngjarja referohet në të arthmen, por ësh'ë e saktë se djelli nuku do të lindë nga perëndimi, se nuku është e mundur të çiket qjelli me dorë, se nuku është e mundur të pijet deti, kështu, pra, nuku eksiston konditë.

3. Ngjarja mos të formojë një element të nevojëshmë për t' u produktuar rezultati juridik. Për shëmbëll: Do t' i shes **A** orën, po të mbetemi d' akord mbi çmimin; Në këtë shëmbëll ngjarja është e pritme dhe e pa-saktë, por

akordi mbi çmimin formon një element të nevojëshmë dhe, të do-mos-doshme për t' u produktuar akti juridik, domethënë shitja. Pra, nuku eksiston konditë.

Nga sa u thanë më sipër rezulton se nuku janë kondita, në kuptimin teknik të fjalës:

a) Konditat që i referohen kohës së tanishme osë të kalueme,

b) Konditat që nuku munden të realizohen,

c) Konditat e nevojëshme, dhe

ç) Konditat juridike.

Konditat, massi eksistojnë shumë llojesh të tilla, çquhen në:

A. — Kondita pozitive dhe kondita negative.

Kondita quhet *pozitive*, kur ngjarja, nga e cila mvaret rezultati ligjor, është pozitive, si për shëmbëll: të shes orën, por, po të më bëhen propozime më të dobishme, shitja të quhet e pa bërë.

Kondita quhet *negative*, kur ngjarja, nga e cila mvaret rezultati ligjor, është negative, si për shëmbëll: të premtonj 1000 franga, po të mos vesh në Paris.

B. — Kondita *reale*, si për shëmbëll: po të vijë ania nga Amerika ose kondita *legale*, si për shëmbëll: po të bëhem zot i shtëpisë.

C. — Konditat pezulluëse dhe konditat zgjidhëse.

Kondita quhet *pezulluëse*, kur lindja dhe rezultati i një relasjoni ligjor pezullohet deri sa të plotësohet kondita ose ndryshe, *simbas dispozitës të nenit 1184 të Kodit Civil*, konditë pezulluëse është ajo, nga e cila mvaret eksistenca e obligimit. Për shëmbëll: do të të jap orën, po të më vijë djali nga Amerika; T' a shes shtëpinë për 10000 franga po të emërohem nëpunës në Tiranë; Një kompani sigurimi kontra zjarrit mer përsipër detyrimin që t' a çdamojë pronjarin e një shtëpie, në qoftë se kjo digjet ose prishet prej zjarrit. Gjithë këto kondita janë pezulluëse.

Kondita quhet *zgjidhëse*, kur eksistenca dhe vazhdimi i një relasioni ligjor mvaret nga një ngjarje të pa-sakte ose

simbas definisionit të dhënë prej *nenit 1184 të Kodit Civil*, konditë zgjidhëse është ajo, e cila, po të verifikohet, zgjith obligimin dhe sjell punët në gjëndjen që ishin sikur të mos kish eksistue kurrë obligimi. Për shëmbëll: të dhuronj shtëpinë, por, po të më vijë djali nga Amerika, të quhet dhurata si e pa bërë.

Deri sa kondita zgjidhëse nuku realizohet, akti juridik sjell konsekanca, por, me t' u plotësuar kondita zgjdhëse, akti juridik ngrihet ipso jure dhe bashkë me 'të edhe të drejtat që u bazuanë në 'të.

Ngjarja kondicionale mundet të jetë ose absolutisht independente nga vulneti i të interesuemvet ose, përkundrazi, një vepër që është në vulnetin e tyrevet t' a bëjnë ose mos t' a bëjnë. Nga kjo pikëpamje konditat ndahen në tre grupe:

I. *Kondita fâtore* quhen ato, të cilat mvaren nga fati dhe realizimi i të cilavet nuku mvaret as nga vulneti i kreditorit, as nga ay i debitorit. Për shëmbëll: Po të vdesë donatari para dhuruësit.

II. *Kondita potestative* quhen ato, të cilat mvarin ekzekutimin e konditës nga një ngjarje, të cilën vulneti i njërës palë që obligohet mundet t' a realizojë ose t' a ndalojë. — "*Obligimi i kontraktuem me një konditë, e cila mvar atë obligim nga vulneti i të obliguemit, është nul*, dispozon *neni 1187 i Kodit Civil*. Kondita potestative mundet të jetë ose sempël ose e thjeshtë.

Konditë potestative sempël është ajo, e cila nuku rezulton nga një manifestim arbitrar i vulnetit të debitorit, por duhet që nga ana e tij të përmbushet një fakt i përjashtmë, të cilin ky mos të jetë në pozitë t' a ekzekutojë. Për shëmbëll: si mbas dispozitavet *të nenit 1449 të Kodit Civil*, shitësi me riblemje konvencionale i rezervon vehtes të drejtën t' a blerë rishtas sendin e shitur, por duhet të paguajë çmimim. *Kondita potestative sempël nuku është nul, është e fuqishme.*

Kondita potestative e thjeshtë, për kundrazi, është ajo

që nuku lyp veçse një manifestim vulneti; Mund të formullohet kështu: po të dua, po t' a gjykonj të arësyëshme. Kondita potestative e thjeshtë përmban këtë deklarim: *"dua të detyrohem, po të dua më von"* Neni 1187 i Kodit Civil për këtë lloj kondite bën fjalë. Dhuratat midis bashkëshortëvet na japin një shëhbëll kondite potestative të thjeshtë, massi simbas dispozitavet të nenit 1487 të Kodit Civil janë të revokuarshme; Dhuruësi mundet t' a revokojë dhuratën që i ka bërë bashkëshortit tij kur të dojë, me një fjalë dhuruësi bën këtë deklarim: *dua të t' a dhuronj, po të dua më von.*

Interesi i të çquemit të konditës potestative në sempël dhe në të thjeshtë është ky:

Është nul çdo obligim i kontraktuar nënë një kondite potestative të thjeshtë, kur është e mvarur nga vulneti i atij që obligohet dhe kur ka për objekt *pezullimin* e formimit të aktit juridik. Ky regull është i vetëkupëtuëshmë; Një personë që thotë: "Do të të dhuronj shtëpinë po t' a gjenj të arësyëshme," nnku obligohet seriozisht.

Përkundrazi një konditë potestative e thjeshtë, zgjidhëse, nuku shkakëton anullimin e aktit; Kështu, simbas *nenit 1634 të Kodit Civil,* kontrata e punës e lidhur pa caktim kohe, mundet të pushojë gjith monë me vulnetin e njërit vetëm prej kontraktantëvet.

Më anën tjetër, kondita potestative sempël, e mvarur nga vulneti i debitorit vetë, nuku ndalon vleftësinë e lidhjes së detyruëshme, qoftë dhe kur ka karakterin e një kondite pezulluëse. Debitori, i cili mer një obligim në këtë mënyrë, jetërson një pjesë të lirisë së tij. Për t' a bërë themën mâ të kupëtuarshme, po tregojmë dy shëmbëlla: Në qoftë se vendos të shes shtëpinë, ju premtonj t' u preferonj; Ose në qoftë se vendos të banonj në një qytet tjetër, ju premtonj t' u jap me qira shtëpinë t' ime. Në këto dy shëmbëlla obligimi mvaret naturisht nga vulneti i debitorit, i cili me gjithë këtë është i lidhur, massi cirkonstancat mundet t' a detyrojnë ose t' a shesë shtëpinë ose të ndrojë

banimin.

III. *Kondita mikste* quhen ato, që mvarin ekzekutimin e konditës nga një ngjarje e cila dhe ajo mvaret nga vulneti i të dy palëvet kontraktuëse, të cilat mundin t' a realizojnë ose t' a anullojnë. Për shëmbëll, dhurata me konditë që donatari të martohet me X është një akt juridik i mvarur nga një konditë mikste, massi për realizimin e konditës nuk mjafton vulneti i donatarit, por është i nevojëshmë dhe ay i një persone të tretë.

§ 83. — Disa kondita të veçanta.

Kondita të pa-mundëshme quhen ato, të cilat është e pa-mundur të realizohen për arësyena naturale ose juridike, si për shëmbëll: të premtonj 1000 franga, po të cikësh qjellin, po të pish detin; Është e qartë se këto kondita nuku mundet të realizohen për shkake naturale, se qjelli nuku mundet të çiket, se deti i tërë nuku mundet të pijet.

Kur themi: të premtonj 1000 franga, në qoftë se i mituri A, do të redaktojë testament të fuqishmë, ose: në qoftë se i çmënduri A do të redaktojë testament të fuqishmë, kjo konditë është e pa-mundur të realizohet për shkake juridike.

Kondita immorale ose të kontraligjëshme quhen ato, në të cilat deklarimi i vulnetit ka për përmbajtje një send që vjen në kundrështim me regullat e së drejtës ose të moralit. Për shëmbëll: do të ju jap 1000 franga, po të mos martohi, ose: po të çnderosh me fjalë A, ose: po të bësh dëshmi të remë. Aktet që përmbajnë kësilloj kondita janë nul. Kësilloji dispozita janë shprehimisht të ndaluara prej *nenit 11 të dispozitavet mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjavet përgjithësisht,* massi një deklarim vulneti në kundrështim me urdhërin publik ose me moralin goditet me nulitet.

Neni 1186 i Kodit Civil thotë: "*Kondita që është e pa-mundëshme ose kontra ligjës ose kontra zakonit të mirë e bën nul obligimin që mvaret nga ajo konditë, kur koj*

është pëzullueše; Kur kondita në fjalë është zgjidhëse, at' here obligimi është i fuqisdmë, por kondita konsiderohet si e pa qënë; Por, në rastin që kondita zgjidhëse e kontraligjëshme ose immorale ka qënë shkaku determinuës për formimin e obligimit, at' here shkakëton nulitetin e të gjithë aktit juridik".

Kondita të nevojëshme quhen ato, realizimi i të cilavet në kohën e deklarimit të vulnetit është i sigurtë, massi ngjarja, nga e cila mvaret rezultati ligjor do të mbushet nevojërisht për shkake naturale ose juridike. Konditat e nevojëshme, ndonse sipërfaqësisht duken si kondita, nuku janë kondita të vërteta, massi ngjarja, nga e cila mvaret realizimi i tyre nuku është objektivisht e pa saktë, por përkundrazi është e saktë, kështu që në këto mungon elementi kryesor i konditavet të vërteta: pasaktësia.

§ 84. — Gjendja tue qënë kondita e mvarur.

Deri sa kondita është e mvarur, rezultani juridik, të cilin pati për qëllim deklarimi i vulnetit, nuku produktohet, kështu që deri sa kondita është e mvarur nuku ka as kreditor, as debitor. Pra, në qoftë se debitori prej kondite paguan sendin e premtuem me konditë, dyke pandehur se kondita u plotësua, at' here ka të drejtë t' a kërkojë, tue u bazuar në padijen *për pagim të pa-detyruem.* Për shëmbëll: I premtonj **A** 1000 franga, në qoftë se vjen anija nga Amerika; Dyke pandehur se anija erdhi, i jap **A** sumën e premtuem; Më pas mësonj se anija nuku ka ardhur édhe. Në këtë rast kam të drejtë të kërkonj sumën që dhashë, dyke ngrehur padijen për pagimin e një sendi të pa-detyruem.

Por, kjo nuku do të thotë se deklarata e vulnetit, për deri sa kondita është e mvarur, është nul; Me gjithë që rezultati juridik nuku produktohet, eksiston shpresa për produktimin e tij dhe kjo shpresë formon përmbajtjen e një të drejte të fitueme prej personës, në favor të së cilës u bë premtimi. I premtonj **A** 1000 franga; Deri sa kondita

është e mvarur, nuku formohet as një e drejtë, me gjithë këtë **A**, ndonse nuku ka të drejtë t' a kërkojë sumën e premtuar, por ka fituar të drejtën që të bëhet kreditor, të marë të 1000 frangat, në rastin që kondita mbushet. Bilé, simbas dispozitavet të nenit 1190 dhe 1787 të Kodit Civil, mundet të kërkojë të meret dhe masa konservative e sekvestros si dhe të bëhet dhe çdo tjetër veprim konservatif. Kjo e drejtë, domethënë të bëhët kreditori me konditë një kreditor i vërtetë, të fitojë sendin e premtuar, mundet t' a quajmë të *drejtë shprese.*

Konsekancat e së drejtës të shpresës janë këto:

1. Ay që premtovi me konditë nuku mund t' a thyejë arbitrarisht aktin juridik, por detyrohet të presë përfundimin e konditës, massi kreditori me konditë e ka fituar të drejtën, që të bëhet dhe në realitet kreditor, në rastin që kondita plotësohet.

2. Debitori prej kondite është i detyruar mos të bëjë veprime, të cilat t' a bëjnë tërësisht ose pjesërisht të pamundur produktimin e rezultatit juridik. Për shëmbëll: të premtonj një kalë, po të vijë anija nga Amerika; Jam i detyruar të mos shkakëtonj humbjen e kalit as me dhel, as me pa-kujdesi, se për ndryshe me plotësimin e konditës jam i detyruar me çdamime.

3. Debitori prej kondite detyrohet, deri sa kondita mbetet e mvarur, të mos ndalojë plotësimin e saj me mënyra që vijnë në kundrështim me kuptimin e aktit juridik, përndryshe kondita quhet e realizuarë. "*Kondita* — thotë neni 1189 i Kodit Civil — *quhet e verifikueme, kur vetë debitori q' asht obligue me atë konditë ka ndalue përmbushjen e saj.*" Për shëmbëll: i premtonj **A** një mijë franga, po të vijë anija nga Amerika. Në këtë rast jam i detyruar që mos ndalonj realizimin e konditës, dyke i shkrojtur kapedanit anijes mos të vijë; Po t' a ndalonj realizimin e konditës, kondita quhet e plotësuar.

4. E drejta e shpresës, domethënë e drejta që ka fituar kreditori prej kondite që të bëhet dhe në realitet kre-

ditor dhe të fitojë sendin e premtuar, *mundet të transmetohet në tjetër personë* me akte midis të gjallëvet. Gjith' ashtu dhe me akte për shkak vdekjeje e drejta e shpresës është e transmetueshme, por me kusht që kondita të realizohet në gjallje të personës të nderuarë me 'të; "*Çdo disponim testamentar i bame me një konditë pezulluëse nuku ka efekt*, — disponon neni 582 i Kodit Civil — *në qoftë se persona, në favorin e së cilës është bërë, vdes para se të verifikohet kondita.*"

5. Deri sa kondita të mbetet e mvarur, rezultati juridik që ajo ka për qëllim nuku produktohet, kështu që nuku mundet të ngrehet padia për prestimin e sendit të detyruem me konditë. Por, kjo nuku ndalon ngritjen e padinavet të tjera që kanë për shkak sendin e detyruem me konditë. Pra, kreditori prej kondite mundet të ngrehë padie kontra debitorit për prestimin prej këtij të një sigurimit, në rastin që ndodhet në rezik realizimi i arthmë i së drejtës të pritme. "*Kreditori* — thotë neni 1190 i Kodit Civil — *para se të verifikohet kondita, mundet me ushtrue gjithë veprimet konservative të së drejtavet të veta.*" Për shëmbëll: i premtonj **A** një shtëpi nënë një konditë; Deri në realizimin e konditës e përdor shtëpinë të premtuar me një kësilloj mënyre, që është frikë se mos humbasë. Kreditori i jem nënë konditë, në konformitet me nenin 1190 të Kodit Civil, ka të drejtë të kërkojë çdo lloj sigurimi dhe të marë gjithë masat konservative të ligjëshme, deri sa të plotësohet kondita.

Në legët, në qoftë se eksiston nonjë rezik për mos realizimin e rezultatit që ka për qëllim akti juridik, legatari me konditë mundet të kërkojë sigurim prej trashëgimtarit deri në realizimin e konditës (*neni 585 i Kodit Civil*).

Gjith' ashtu kreditori prej kondite, në rastin që konkurojnë kreditorë në pasurinë e debitorit tij prej kondite, ka të drejtë të ngrehë padie dhe të kërkojë që të radhitet dhe ay midis kreditorëvet të tjerë; Natyrisht kreditori prej kondite nuku ka të drejtë të marë pjesë në pjesëtimin e pasurisë, por kreditorët e radhitur, që e ndajnë pasurinë, janë të

detyruar t' i japin garanci.

6. Në qoftë se debitori prej kondite i një sendi, para se të plotësohet kondita, ja dorëzovi sendin e premtuem kreditorit tij, u transferua zotërimi i këtij sendi mbi kreditorin ose jo? Për shëmbëll: A i shiti B kalën, me konditën "po të vijë anija nga Amerika," dhe para se të vijë anija ja dorëzovi B kalën; Pyetet: u transferua zotërimi i kalit ose jo? Kjo është një çështje interpretimi. Në qoftë se dorëzuësi desh të transferonte zotërim dhe marësi t' a marë në zotërim sendin, në këtë rast zotërimi transferohet, massi për transferimin e zotërimit duhet nga njëra anë vulnet për transferimin e zotërimit, dhe nga ana tjetër vulnet për fitimin e zotërimit. Por, në qoftë se ay që dorëzovi sendin nuku desh t' a transferonte zotërimin, ky nuku transferohet. Në rast dyshimi, domethënë në se ka transferim ose jo zotërimi, transferim nuk eksiston.

§ 85. — Efektet e konditavet.

Për të caktuar cilat janë efektet që sjellin konditat, duhet të kemi para-sysh tre gjendje të ndryshme.

1. Deri sa kondita është e mvarur, një pasaktësië rëndon mbi fatin e aktit juridik kondicional.

Në konditat zgjidhëse akti juridik sjell provizorisht gjithë efektet e tij, sikurse do të ishte i thjeshtë dhe i pakondicionuar. Ajo që është e pasaktë, është fakti në se akti juridik do të qëndrojë ose do të zgjidhet. Për shëmbëil: të dhuronj një shtëpi, por dhurata do të zgjidhet po të vdeç para meje. Për nj' heresh do të merni gëzimin e shtëpisë dhe do t' a gëzoni sa të roni; Por, në rastin që do të vdisni para meje, trashëgimtarët tuaj do të jenë të detyruar të m' a ngëthejnë shtëpinë.

Për kundrazi në konditat pezulluëse, deri sa ato nuku janë realizuar, nuku dihet në se akti juridik do të ngjasë, në se e drejta do të lindë, si për shëmbëll: Do t' ju shes shtëpinë, po të banonj në një qytet tjetër. Kjo shitje nuku mund të realizohet, përveç se ditën që ngjarja e parashiku-

ar do të realizohet, në qoftë se ngjet. Në çdo rast, kjo e drejtë kondicionale tërheq qysh prej tash disa konsekanca. Beneficiari, si kundër u tha më sipër, mundet të marë masa konservative për t' i ruajtur të drejtat e tij, simbas nenit 1190 të Kodit Civil; Mundet që, qysh në gjalljen e tij, t' i transferojë këto të drejta në një të tretë.

2. Kondita mundet mos të realizohet. Kjo ngjet, kur një fakt i parashëkuar nuku do të realizohet.

Pra, në konditat pezulluëse as një e drejtë nuku lind dhe akti juridik konsiderohet si i pa bërë, si, për shëmbëll: i premtonj A një mijë franga, në qoftë se anija do të vijë nga Amerika. Në qoftë se kondita nuku realizohet për shkak se, fjala bije, u mbyt anija, akti juridik quhet si i pa bërë.

Në konditat zgjidhëse, me mos realizimin e konditës, nuku çduket rezultati juridik i lindur dhe rezulton sigurimi se nuku do të shuhet as në të arthmen. Akti juridik konsolidohet dhe efektet e tij bëhen definitive, si për shëmbëll: i dhuronj A një shtëpi, por në rastin që të ngjasë kjo ose ajo, dhurata të quhet si e pa-bërë. Ne qoftë se as një nga ngjarjet e parashëkuara nuku realizohet, dhurata vazhdon.

3. Kondita, më në fund, mundet të mbushet, të realizohet me plotësimin e ngjarjes të parashëkuarë. Në këtë rast çdo pa-saktësi mer fund. Në qoftë se kondita është pezulluëse, akti juridik sjell gjithë efektet e tij, që deri tash ishin të pa-sakta. Në qoftë se kondita është zgjidhëse, akti zgjidhet anullohet.

Realizimi i konditës vepëron *ipso-jure*, domethënë me t' u realizuar kondita, kur kjo është zgjidhëse, sendet ngëthehen vetiu në gjëndjen e tyre të mâ-parëshme. Kjo do të thotë se zotërimi, e drejta reale ngëthehet në zotënuësi i parë, si për shëmbëll: i dhuronj A një shtëpi nënë një konditë zgjidhëse. A bëhet zot deri sa kondita është e mvarur. Me t'u plotësuar kondita, zotërimi ngëthehet ipso jure në mua, bëhem unë prapë zoti i shtëpisë. Konsenkanca pratikę është kjo: në qoftë se marësi kondicional e ngarko-

vi sendin me nonjë barë, si, bije fjala, ipotekë, këto barë shuhen vetiut me t' u realizuar kondita, shuhet e drejta e zotërimit të marësit kondicional dhe bashkë me 'të dhe barët që u vunë mbi sendin.

Por, cila është gjendja juridike në kohën që ndërmjetëson midis formimit të aktit juridik nënë konditë dhe të realizimit të konditës? Që nga cila kohë konsiderohet se u fitua zotërimi i sendit të dhënë me konditë pezulluëse, nga koha e deklarimit të vulnetit ose nga koha e realizimit të konditës? Kondita e realizuar ka fuqi retroaktive?

Kondita me t' u realizuar prapavepron deri në ditën kur u redaktua akti. Simbas dispozitavet të nenit 1185 të Kodit Civil "*Kondita e verifikueme prapavepron dhe sjell efekt qysh prej kohës që është lidhur obligimi, përveç kur simbas vulnetit të palëvet ose simbas naturës të veprimit efektet e obligimit ose zgjidhja e tij duhet të fillojnë qysh prej një kohe tjetër*".

Në qoftë se kondita ishte pezulluese, akti juridik quhet i lindur jo ditën e realizimit të konditës, por ditën që për herën e parë u manifestua vulneti. Kështu, blerësi ose legatari nënë konditë pezulluëse quhen se janë bërë zotër të sendit të blerë ose të leguar që nga minuta e shitjes ose nga vdekja e testatorit.

Në qoftë se kondita ishte zgjidhëse, akti juridik quhet si i pa-ngjarë kurë-no nj' herë. Kështu, blerësi ose legatari nënë konditë zgjidhëse jo vetëm që duhet t' a ngëthejnë objektin, kur plotësohet kondita, por quhen se kurë nonjë herë nuku kanë qënë zotnuës dhe pronjarë *(neni 1184 i Kodit Civil)*.

Provimi i aktevet juridike nënë konditë bëhet simbas regullavet të pergjithshme të provimit. Për shëmbëll: paditësi thotë në padien e tij "*i shita të paditunit kalën t' im për çmim shitje 1000 franga, kërkonj të detyrohet të më paguajë atë sumë*". I padituni i gjegjet padies, tue thënë: "*E bleva kalën 1000 franga, por me konditë në se do të emërohem major*". Me qënë se kandita e formulluar prej të

paditunit formon një prapsim, duhet që ky të provojë se akti juridik u bë me kondítë. Duhet shtuar se shkrimtarët ndodhen në grindje për mënyrën e provimit të aktevet juridike kondicionale.

§ 86. — Afati.

(Nenet 1191—1195 të Kodit Civil)

Afat quhet shtimi që bëhet në deklarimin e vulnetit, me të cilin krijimi i efektit juridik mvaret nga një pikë kronike e caktuar, ose ndryshe, *afati është një ngjarje e arthme dhe me realizim të saktë, që pezullon qoftë kërkueshmënien, qoftë të shuemit të një të drejte dhe që sjell efektin e tij pa retroaktivitet.*

Afati nuku pezullon obligimin, por cakton kohën e ekzekutimit ose atë të shuemjes të obligimit (*neni 1191 i Kodit Civil*). Me një fjalë afati është një fakt juridik i pritme, por i saktë, si për shëmbëll: "më 28 Nëntor do t' i paguanj A një mijë franga".

Afati është dy llojesh: 1) pezulluës, dhe 2) zgjidhës.

Afat pezulluës quhet ay, i cili ka për qëllim vonimin, e ekzekutimit të obligasionit deri në një datë të arthme dhe të caktuar, si për shëmbëll: në një kontrato shitjeje palët mbeten d' akord që blerësi të paguajë çmimin pas një viti. Një testator lé një leg për një të mitur dhe stipullon që suma t' i paguet kur legatari të bëhet madhor.

Afat zgjidhës quhet ay, i cili ka për qëllim shuemjen e efektevet të aktit juridik në fund të një kohe të caktuar, si për shëmbëll: një pronjar jep me qira shtëpinë për tre vjet; me mbarimin e këtyre tre vjetevet, kontrata do të marë fund. Gjith' ashtu, një bujk mer një shërbëtor për kohën e lëmit; me t' u mbaruar lëmënjtë, kontrata do të marë fund.

Afati zgjidhës takohet gjith' ashtu dhe në dispozitat me titull darovor, si për shëmbëll: një testator i ngarkon trashëgimtarët e tij që të paguajnë një *rantë jetore* njëj të treti; Ky obligim do të marë fund ditën e vdekjes të *kredi-*

rantierit.

Nga shëmbëllat e sipërtreguara kupëtohet se, aqe afati pezulluës, sa edhe afati zgjidhës mundet të jenë ose një datë e caktuar ose një fakt, i cili nevojërisht do të produktohet, por nuku dihet se kur, si vdekja e një persone të caktuar; Në rastin e parë afati është i *sigurtë,* në të dytin është i *pa-sigurtë.*

Afati i sigurtë mundet të jetë:

1. I sigurtë në se do të ngjasë dhe i sigurtë kur do të ngjasë (dies certus an, certus quando), si për shëmbëll: më 1 Prill do të të jap 1000 franga.

2. I sigurtë në se do të ngjasë, i pa-sigurtë kur do të ngjasë (dies certus an, incertus quando), si për shëmbëll: do të të jap 1000 franga, kur të vdesë **X.**

3. I pa-sigurtë në se do të ngjasë, por i sigurtë kur do të ngjasë (dies incertus an — certus quando), si për shëmbëll: i premtonj të miturit **B** se do t' i jap 1000 franga ditën e madhorisë së tij.

4. I pa-sigurtë ne se do të ngjasë, dhe i pa-sigurtë kur do të ngjasë (dies incertus an, incertus quando); I premtonj **A** t' i jap 1000 franga, ditën që do të zgjidhem deputet.

Afati, kur është e *pa-sigurtë* në se do të realizohet ngjarja, është gjithë—monë me konditë dhe në këtë rast aplikohen dispozitat për konditë. Kur afati është i *sigurtë* në se do të realizohet ngjarja, në rast dyshimi ka fuqi si afat i thjeshtë, pa u marë para sysh në se *kur* do të realizohet ngjarja është e sigurtë ose jo.

Afati pezulluës ka për rezultat vonimin e ekzekutimit të aktit juridik deri në fund të datës caktuar.

Në kontratat, e drejta e kreditorit lind ditën e kontratos, por nuku mund të realizohet përveç se ditën e skadimit. Gjer në atë ditë nuku mundet të bëhen ndjekje kontra debitorit. Gjith' ashtu titullari i një të drejte reale të mvarur nga një afat nuku mund të eksersojë të drejtat e tij, perveç se ditën e skadimit: Kështu, pra, nuku ka të drejtë

as në frutat, as në kamatat e dhëna prej sendit, për veç se nga dita e mbarimit të afatit.

Afati zgjidhës iu jep fund efektevet të aktit juridik. I ndërpren, por nuku i çduk në të kaluemen.

Në aktet juridike me afat vulneti i palëvet është i fuqishmë dhe i detyruëshmë; Posë kësaj, ka dhe influençë legale, massi është gjë e sigurtë se rezultati që pritet do të realizohet dhe vetëm ky sigurim i jep të drejtën atij, në favor të të cilit është bërë deklarimi i vulnetit. Konsekancat e këtyrevet janë:

a) Debitori me afat nuku mund t' a thyejë kontraton, por duhet të presë skadimin e afatit.

b) Debitori me afat duhet mos t' a bëjë të pa-mundëshme produktimin e rezultatit, q' është qëllimi i aktit juridik.

c) E drejta me afat është e ceduëshme, dhe

ç) Kreancat si dhe detat me afat u transmetohen trashëgimtarëvet.

Afati sjell efektet e tij pa retroaktivitet.

KAPTINA E.

§ 87. — Veprimet e pa-ligjëshme.

Thamë më sipër se për krijimin, ndryshimin ose të shuemit e së drejtavet, duhet të realizohen disa ngjarje, dhe këto i qojtmë *ngjarje juridike.* Ngjarjet juridike mundet të futen në këto kategori: ose janë deklarimi i vulnetit të personavet, domethënë janë *akte juridike,* ose janë *vendime gjyqësore,* ose janë disa ngjarje të tjera që nuku mundet të konsiderohen as akte juridike, as vendime gjyqësore. Midis këtyre ngjarjevet juridike të tjera — të cilat nuku janë as akte juridike, as vendime gjyqësore — ato që zenë vëndin më me rëndësi janë *veprimet e pa-ligjëshme* dhe *kalimi i kohës.*

Veprim i pa-ligjëshmë — në kuptimin e gjërë të fjalës — quhet çdo *veprim* ose *mos-veprim*, me të cilin i shkakëtohet tjetrit një dëm në të drejtat e tij dhe kështu vepruesi obligohet t' i paguajë të damtuemit dëm-shpërblime. Të çquemit e veprimevet të pa ligjëshme në delikte dhe në gati-delikte, massi nuku ka as një dobi pratike, nuku është pranuar prej Kodit Civil. Sjellim disa shëmbëlla veprimesh të pa-ligjëshme: një njeri plagos ose çnderon një personë ose prish pasurinë e një të treti me qëllim; Plumbi i një gjahtori axhami plagos ose vret një njeri; Një njeri nga pa-kujdesia i ve zjar shtëpisë, ku banon dhe shkakëton djegjen dhe të shtëpisë fqinjë; Një barnator haron të verë në shishen me ilaç një etiqetë, ku të shënohet se ilaçi është helmë, dhe nga ky ometim shkakëtohet vdekja e një njeriut.

Nga shëmbëllat që u treguan më sipër kupëtohet se veprimi ose mos-veprimi, me qëllim ose pa qëllim damtimi qoftë bërë, me që i shkakëton një të treti dëm është, nga pikë-pamja e së drejtës civile, veprim' i pa-ligjëshmë.

Veprimi i pa-ligjëshmë i së drejtës civile duhet të çquhet nga faji penal. Sikundër u tha më sipër, në veprimet e pa ligjëshme civile përmblidhen gjithë veprat që bën njeriu dhe që i shkakëtojnë një të treti dëm, kurse faji penal është sinonim me fjalën frëngjishte *infraction* dhe përmbleth gabimet dhe deliktet, domethënë gjithë veprat, të cilat paravështrohen dhe ndëshkohen prej Kodit Penal. Gjithë veprimet e pa-ligjëshme nuku janë dhe faje dhe *vice-versa* gjithë fajet nuku janë dhe veprime të pa-ligjëshme të së drejtës civile.

Eksistojnë faje penale që nuku janë veprime të pa-ligjëshme të së drejtës civile, janë ato që nuku i shkakëtojnë kur-kujt as nonjë dëm, si është, për shëmbëll, lypësia, ose mbajtja e arrëvet pa lejën e autoritetevet kompetente ose ato, të cilat në realitet nuku kanë shkakëtuar nonjë dëm, si është, për shëmbëll, tentative vrasjeje ose vjedhjeje që nuku solli efekt.

Për kundrazi, shumë veprime të pa-ligjëihme që shka-

këtojnë dëm nuku ndëshkohen prej Kodit Penal dhe kështu nuku janë veçse veprime të pa-ligjëshme civile; Këshilloji janë shumica e veprimevet të bëra pa qëllim.

§ 88. — Elementat e veprimit të pa-ligjëshmë.

Që të jetë e mundur të paditet një personë si përgjegjëse për një veprim të pa-ligjëshmë, duhet t' i ketë shkaktuar një të treti *një dëm nga faji i vetë*; Pra, elementat e veprimit të pa-ligjëshmë janë:

Dëmi. Veprim i pa-ligjëshmë pa dëm nuku mundet të eksistojë. Vepra që nuku i sjell nonjë dëm tjetrit nuku mundet të bëjë civilisht përgjegjës vepruësin, qoftë dhe kur ajo vepër formon një faj, si për shëmbëll: **A** m' i ve zjarr shtëpisë t' ime, por një tjetër tue shkuar e shuan dhe kështu nuku më gjen as një dëm; Me gjithë që vepra e **A**, nga pikëpamja e së drejtës penale, formon një tentativë djegjeje dhe ndëshkohet, nuku kam të drejtë të ngreh padie civile kontra **A** për tentativën e tij, massi as nonjë dëm nuk më gjeti. Tjetër shëmbëll: **A** padit dhe kërkon dëm-shpërblime prej **B**, i cili ngjitas me 'të mban një shtëpi tolerence; Në rastin që **A** nuku justifikon dëmin që e gjen nga kjo fqinjësië, padia e tij është e pa pranuëshme. Tjetër shëmbëll: një notar paditet për shkak se nuku vepërovi transkriptimin e një akt-shitjeje, të redaktuar prej tij, simbas dispozitavet *të nenit 1864 të Kodit Civil;* Faji i tij është i qartë, por akti i shitjes anullohet për shkak se pronja e shitur është e pa jetërsuëshme si pronjë dotale. Pra, massi nga pa-kujdesia, nga ometimi i noterit nuku e gjeti blerësin e pronjës as një dëm, nuku ka të drejtë të kërkojë kurgjë.

Por, nuku është e domosdoshme që veprimi i pa-ligjëshmë t' i shkakëtojë tjetrit *një dëm material*, domethënë t' a lëndojë në pasurinë e tij ose dhe në personën e tij, tue i shkakëtuarë plagë, tue i dhënë një sëmundje ngjitëse; Dhe *dëmi moral*, domethënë cënimi i nderit, i famës së mirë, të konsiderasionit *(çnderim, difamasion, shkelje kunore*

e tjera), është veprim i pa-ligjëshmë dhe jep të drejtë në dëm-shpërblime. Bilé jurisprudenca e tanishme vete dhe më tej: Vendos se hidhërimi i shkakëtuar në gjininë e flisë të një vrasjeje, mjafton kjo vetëm — përveç dëmevet materiale që ata mundet të pësojnë nga kjo vdekje — që të justifikojë një dënim me dëm-shpërblime. Këto konkluzione si të doktrinës, ashtu dhe të jurisprudencës i përmbleth Kodi Civil në nenin 1160, ku thuhet: *"Obligimi i shpërblimit përfshin gjithë dëmet materiale dhe morale, që janë shkakëtue prej faktit të pa-ligjëshme. Ve,anërisht gjyqtari mundet me caktue një shpërblim për flinë, në rast lëndimi trupor, cënimi në nderin, ne famën e tij ose të families së tij, dhunimi të lirisë personale ose të banesës ose të një të fshehte që i përket anës së lëndueme.*

Gjith' ashtu gjyqtari, në rast vdekjeje të flisë, mund të caktojë një shpërblim për gjinitë, krushqit ose bashkëshortin e tij si reparim për hidhërimin e pësuem."

Faji. Ay që kërkon reparimin e një dëmi nga një personë të tretë, duhet të provojë që ay dëm ka për shkak fajin e këtij të treti. Pra, duhet të provojë fajin dhe më pas lidhjen, e cila eksiston midis fajit si shkak dhe dëmit që e ka gjetur si efekt. Ky nosjon i fajit është kondita e nevojëshme e përgjegjësisë.

Kondita e parë për eksistencën e një faji është pandeheshmënia. Kjo domëthënë se shkakëtari i veprimit të të pa-ligjëshmë duhet të ketë ndërgiegjen e vepravet të tija, të ketë vepruar tue patur fuqinë mendore çmuëse. Pra, në qoftë se veprimi i pa ligjëshmë është shkakëtuarë prej një të çmënduri, një idioti ose një të mituri që nuku ka fuqinë mëndore çmuëse, ky, parimisht, nuku është përgjegjës për veprimin e tij të pa-ligjëshmë. Por, ky parim nuku duhet të meret absolutisht, massi është përkufizuar me dispozitat e *nenevet 1150 dhe 1151 të Kodit Civil,* simbas të cilëvet *"i pazoti është përgjegjës për veprimet e tij të pa-ligjëshme...."* dhe *"në qoftë se një dëm është shkakëtuar prej një persone, që nuku ka pas fuqinë mendore çmuëse dhe i*

damtuemi nuku ka muejt me u shpërblye prej atij që ka detyrimin e vëzhgimit mbi atë personë, gjyqtari, dyke marë para-sysh gjendjen e palëvet, mundet me e dënue dëmtuësin me një shpërblim t' arësyeshme".

Shkakëtari i veprimit të pa-ligjëshmë duhet të ketë vepruar *lirisht.* Po të sypozohet se një njeri, me dhunë dhe pa dëshirën t' ime, m' a mer dorën dhe kështu me 'të shkakëtohet një dëm, i dëmtuemi nuku mund të ngrehë padie kontra meje për reparimin e dëmit që e gjeti; Ose po të më shtyjë një njeri tjetër dhe të bije mbi një send dhe t' a dëmtonj ose t' a prish, i zoti i sendit të dëmtuar ose të prishur nuku mundet të kërkojë shpërblim për dëmin që e gjeti, massi nuku vepërova lirisht. Simbas dispozitavet të *nenit 1157 të Kodit Civil,* quhet se nuku ka veprim të lirë kur faji ka rjedhur *nga faji i të dëmtuemit, nga fakti i një të treti, prej rasti fator* ose *nga forca madhore.*

Gjith' ashtu nuku është përgjegjës ay që i shkakëton dëm një tjetrit për mprojtjen legjitime të vehtes ose të një të treti, *(neni 1152 § 1).*

Në rastin që shkakëtari i veprimit të pa-ligjëshme ndodhet në *gjendje nevoje* dhe, për t' u ruajtur vetë ose për të mprojtur një të tretë prej një *dëmi të gadëshmë dhe shumë të rëndë,* i shkakëton dëm një tjetri, nuku detyrohet me dëm-shpërblime, për veç se kur dhe për sa e gjen të arësyëshme gjyqtari (*neni 1152 § 2).*

Naturisht, që të eksistojë pandeheshmënia duhet që veprimi i pa-ligjëshmë të rjedhë nga vulneti i vepruësit, të eksistojë *qëllim për damtim.* Por, obligimi për dëm-shpërblime eksiston dhe për atë, i cili, tue kapërxyer në ushtrimin e një të drejte të vetë kufitë të caktuara prej mirëbesimit ose prej qëllimit për të cilin i është njojtur ajo e drejtë, i shkakëton tjetrit një dëm *(neni 1149 i Kodit Cívil)* Një pronjar bën gërmime dhe pret ujën e pusit ose të krojit të pronjës fqinjë. Një industrial installon një fabrikë, zhurma ose era e ndytë e së cilës damton fqinjët. Një patron pushon një punëtor për arësye të huaja me profesio-

nin e tij, bije fjala për arësye politike. Në këto shëmbëlla, proniari, industriali, patroni ushtrojnë regullisht të drejtën e tyre ose kapërxejnë kufinat e së drejtës? Kur mundet të thuet se ka abuzim në eksersimin e një së drejte?

1. Abuzim eksiston kur shkakëtari i veprimit të pa-ligjëshmë ushtron të drejtën e tij vetëm dhe vetëm për t' i sjellë dëm tjetrit, si për shëmbëll, kur pronjari gërmon në pronjën e vetë, jo që të nxjerë ay ujë për nevojat e tij, por vetëm me qëllim që t' i presë ujën fqinjës.

2. Për eksistencën e abuzimit të së drejtës nuku është i domosdoshme *qëllimi i keq* i vepruësit. Abuzim eksiston dhe në rastin që vepruësi nuku ka marë masat e duhura të nevojëshme për largimin e një dëmi. Për shëmbëll: pushim pa lajmërim i një punëtori të pajtuarë për një kohë të gjatë.

Në ushtrimin e së drejtës së pronësisë fqinjësia sjell disa pengime, të cilat fqinjët duhet t' i tolerojnë. Por, se cila prej tyre duhet të përkujdeset që mos kapërxejë kufinë normale, se për ndryshe eksiston abuzim të drejte, i cili angazhon përgjegjësinë të abuzuësit. Shëmbëll: ata që ushtrojnë një industrië, e cila sjell erë të ndytë ose çqetëson fqinjët me zhurmën e madhe të mashinavet dhe të punëtorëvet ose me tymin që nxjerin tymorët e fabrikavet detyrohen me dëm shpërblime, massi kapërxejnë kufitë në ushtrimin e së drejtës së tyre, qoftë dhe kur ajo industri është installuar me lejën e autoritetit kompetent.

Por, kur e drejta ushtrohet normalisht dhe brenda kufivet të caktuara prej mirëbesimit ose prej qëllimit, për të cilin i është njojtur ajo e drejtë, në këtë rast nuku eksiston abuzim të drejte, qoftë dhe sikur t' i shkakëtohet tjetrit një dëm; Për shëmbëll: një tregëtar, i cili me reklamën dhe me zotësin' e tij tërheq klientët e një konkurentit të tij, nuku i detyron ketij dëm-shpërblime. Pronjari, i cili për nevojat e tij gërmon dhe bën një pus të rri dhe kështu i pret ujën pronjës fqinjë, gjith' ashtu nuku është përgjegjës.

Kur eksistojnë elementat e sipërtreguara, at' here the-

mi se shkakëtari ndodhet në faj.

§ 89 — Shkallësimi i veprimit të pa-ligjëshmë.

Vepërimi i pa-ligjëshmë mundet të rjedhë ose nga dheli ose nga shkake të tjera.

Dhel quhet vepërimi i pa-ligjëshmë i bërë me dîje dhe me qëllim damtimî. Debitori i cili është fajtor dheli, ësh'ë gjithëmonë përgjegjës për dëmin që shkakëton. "*Dolus semper praestatur*" domethënë dheli gjithëmonë detyron, theshin juriskonsultët romanë. Dheli është më i rëndë nga gjithë fajet dhe debitori fajtor dheli me as një mënyrë nuku mund të shpëtojë nga përgjegjësia e tij.

Gjithë veprimet e tjera të pa-ligjëshme, nga të cilat mungon dheli quhen *faj* në kuptimin e ngushtë të fjalës. Kur themi që një njeri bëri një *faj* kupëtojmë me këtë se vepërovi me pa-zotësi, me axhamillëk, nuku vuri oroe, është neglixhent.

Nga gjithë këto rezulton një krahësim me kalitetet e zotësisë, e mënçurisë, e vërejtjes, e regullit; Kështu, pra, për të gjykuar një personë në se ndodhet në faj, duhet që t' a krahasojmë me një njeri të zotin, të mënçur, që ka regull dhe i bën me vërejtje punërat e veta. Këtë njeri TYP, Kodi Civil e quan "*atë familjeje të mirë*" *(bonus pater familias).* Pra, sa herë ndodhemi përpara një vepre që i shkakëton dëm tjetrit, duhet të ekzaminojmë në se vepruësi u suall sikundër do të silleshe në atë rast një atë familjeje i mirë, në se mori gjithë masat që duhet të merte një njeri i mënçur; Në qoftë se po, nuku është civilisht përgjegjës, përndryshe ndodhet në faj dhe duhet të paguajë dëm-shpërblime. Për shëmbëll, për të gjykuar resposabilitetin e një inxhinieri, e një mjeku, e një notari, duhet t' a krahasojmë sjelljen e tij me atë të një persone tjetër me cilësitë të një ati familieje të mirë të ndodhur po n' ato çirkostanca dhe n' atë profesion.

Aplikimin e këtij regulli e shohim shpesh herë në Kodin Civil, si, për shëmbëll, në nenin 1172, ku thuhet se, ay

që ka marë përsipër barën me konservue ose me administrue një gjë detyrohet me ekzekutue këtë obligim me gjithë kujdesinat *e një ati familieje të mirë;* Në nenin 852 K.C. për uzufruktuarin, në nenin 881 për ata që kanë të drejtë përdorjeje dhe butjeje, në nenin 1557 për qiramarësin, në nenin 1749 për huamarësin në kontratën e huapërdorjes, të cilët që të gjithë duhet të derdhin kujdesinë e një ati familjeje të mirë.

Ndonse Kodi Civil e ka semplifikuar theorinë e fajevet, dyke pranuar parimisht fajin në kuptimin e ngushtë të fjalës, sikundër u tregua më sipër, por në Kodin Civil eksistojnë disa raste, në të cilat faji çquhet simbas sistemit të së drejtës romane, si, për shëmbëll, në *nenet 1172 § 2' 1697, 1671, 696, të Kodit Civil.* Nga ky shkak do të bëjmë fjalë dhe mbi shkallësimin e fajit, në kuptimin e ngushtë të fjalës, në mënyrën që e çquanin dhe juristët romanë.

Faji çquhet në *faj të rëndë* (*culpa lata*) dhe në *faj të lehtë* (*culpa levis*).

Faj të rëndë bën ay, i cili nuku derth kujdesinë e njeriut me mëndje ordinare. Për fajin e rëndë romanët theshin se barasohet me dhelin, "*culpa lata dolo aequiparatur*".

Faj i lehtë eksiston kur persona nnku vé kujdesin e një ati familieje të mirë. Faji i lehtë çquhet në *faj të lehtë abstrakt (culpa levis in abstracto)* dhe në *faj të lehtë konkret* (*culpa levis in concreto).*

Faj i lehtë abstrakt eksiston, kur fajtori nuku ka vënë kujdesinë e një ati familieje të mirë.

Faj i lehtë konkret eksiston, kur fajtori vé po atë kujdesi që vé dhe në çështjet e veta *(diligentiam quam in suis).*

§ 90. — Resposabilitet eksepsional në rastet fatore.

Debitori, parimisht, nuku është përgjegjës as për rastet fatore, as për forcën madhore. Ky regull i përgjithëshme rjeth nga *nenet 1157 dhe 1171 të Kodit Civil,* prej të cilëvet i fundit thotë "*.... nga një shkak i huaj, që nuku mund*

t' i ngarkohet debitorit," dhe nga parimi se, për të *pa-mundëshmen kur-kush nuku është përjgegjës* (*impossibilium nulla est obligatio*). Kështu, pra, cilido qoftë dëmi që e ka gjetur kreditorin, debitori nuku detyrohet të paguajë kur-gjë.

Përjashtim nga ky regull formojnë këto dy raste, në të cilat *forca madhore* ose *rasti fator* mbeten në kuris të debitorit, i cili detyrohet t' i paguajë kreditorit dëm-shpërblime:

1. Në qoftë se debitori është ngarkuar me një *konvencion të posaçmë*, i cili mundet të jetë i shprehun ose i heshtun, dhe me atë mer përsipër dhe rastin fator dhe atë të forcës madhore.

2. Në qoftë se nhodhet në *morë*. Kështu, në obligimin *me dhanë* objekti i konvencionit mbetet në rezikun e debitorit me t' u vënë ky në morë. (*Neni 1163 §2 i Kodit Civil*).

§ 91. — Modifikime konvencionale të regullavet ligjore.

Regullat që përcaktojnë përgjegjësinë e debitorit, mundet të ndryshohen prej palëvet me konvencione partikollare? Përgjegjet janë të ndryshme simbas rastevet që çfaqen.

Konvencione relative me rastet fatore. Për rastet fatore ose force madhore, sikundër u tha më sipër, debitori mundet t' i marë përsipër me konvencion partikolar. Ky konvencion është i ligjëshmë. Në këtë rast debitori lot rolin e një *siguruësi* në favor të kreditorit, i cili me këtë mënyrë çkarkohet nga çdo rezik.

Konvencione relative me dhelin. Për dhelin solusioni është krejt i kundërtë. Debitori nuku mundet të marë përsipër me konvencion partikolar rastin e dhelit. Një konvencion i tillë, i cili do të përjashtonte debitorin nga konsekancat e dhelit që do të përdorte në përmbushjen e obligimit tij, do të ishte në kundërshtim me besimin e mirë dhe si i tillë *nul* (dolus semper praestatur).

Konvencione relative me fajet. Parimisht është pranu-

ar se debitori mundet me një konditë të shprehun të konvencionit të përjashtohet nga konsekancat e fajevet të tij. Por, disa vendime të dhëna prej gjykatavet franceze përjashtojnë nga ky solusion konditën e përjashtimit të debitorit për fajin e rëndë (culpa lata), massi faji i rëndë barasohet me dhelin (culpa lata dolo aequiparatur). Pra, debitori duhet të jetë absolutisht përgjegjës për fajin e rëndë, sikundër edhe për dhelin.

Kondita mos përgjegjësie. Konvencionet, me të cilat debitori përjashtohet nga faji çfaqen në pratikë nënë formën e konditavet, me të cilat debitori çvishet nga çdo përgjegjësi në disa raste të caktuara mos ekzekutimi të kontratos. Në parim këto kondita janë të vlefshme, massi mundet të konsiderohen si një determinim konvencional i obligimevet të debitorit, por gjithë monë përjashtohen konditat për mos përgjegjësinë të debitorit për dhel dhe faj të rëndë. Neni 1180 i Kodit Civil thotë: "*Nuk munt të kontraktohet shkarkimi i debitorit nga efektet e dhelit ose të fajit të rëndë të tij.*" Kjo dispozitë i përket urdhërit publik.

§ 92. — Provimi i fajevet.

Kur debitori është i detyruar me një obligim pozitif për *me dhënë* ose *me bâ*, kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin mé të provuar eksistencën e kreancës së tij. Mé t'u provuar kjo debitori duhet të detyrohet, përveç kur provon eksistencën e një fakti liruës. Ndryshe sypozohet se obligimi nuku është përmbushur dhe debitori nuku mund të lirohet nga obligimi, përveç se kur provon se mos ekzekutimi i obligimit u shkakëtua nga një pa-mundësi prej rasti fator ose force madhore.

Provimi i rastit fator ose i forcës madhore, massi formon një prapësim, i takon debitorit që e pretandon, tue ndjekur regullën proceduriale "*reus in excipiendo fit actor*" domethënë: *i padituni kur bën prapsime bëhet paditës*, kështu që si i tillë duhet të provojë pretendimet e tija.

Kur debitori është i detyruar me një obligim negatif

"*mos me bâ,*" kreditori nuku ka se ç' të kërkojë deri sa nuku është konstatuar se debitori shkel konvencionin. Në këtë rast bara e provimit i bie kreditorit, massi provimi i shkeljes të konvencionit është kondita e domosdoshme për t' a dënuar debitorin. Po të mos eksistojë një fakt i këtillë, kreditori nuku ka se ç' i kërkon debitorit, kur se në obligimet *me dhânë, me bâ,* kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e konvencionit në bazë dhe me fuqinë të titullit që ka në dorë. *Neni 1167 i Kodit Civil* thotë: "*kur obligimi është mos me bâ, kontravajtësi, vetëm se ka shkel këtë obligim, detyrohet me dëm-shpërblime.*" Nga teksti i këtij neni rezulton se shkelja e obligimit *për mos me bâ* duhet të provohet prej kreditorit.

KAPTINA Ë.

§ 87. — Koha.

Thamë më sipër se për t' u krijuar, ndryshuar ose shuar të drejtat, duhet të realizohen disa ngjarje dhe këto i quajmë ngjarje juridike. Këto ngjarje ose janë akte juridike, ose vendime gjyqësore ose ngjarje të tjera që nuku futen në as njërën nga të dy kategorit' e para. Midis këtyre ngjarjevet të tjera që nuku janë as akte juridike, as vendime gjyqësore dhe që krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë të drejta, ka një rëndësi të madhe dhe *kalimi i një intervali kohë të caktuar.* Influenca e kohës në marëdhëniet juridike është e ndryshme.

Vazhdimi i jetës të njeriut formon parasypozimin për shumë relasione juridike, si për shëmbëll: për zotësinë juridike, për zotësinë me kontraktue martesë, për t' u betuar, për t' u çfaqur si dëshmimtar, për të adoptuar ose për t' u adoptuar, për të redaktuar testament e tjera.

Disa të drejta, veprime dhe deklarime vulneti duhet të ushtrohen, të vepërohen ose të deklarohen në një kohë

të caktuar ose brenda një afati, massi përndryshe shuhet e drejta ose humbet pushteti për t' u bërë vepra ose për t' u deklaruar vulneti, si për shëmbëll: Ay që, tue patur prej një kohe më tepër se një vit posedimin legjitim të një pronje ose të një të drejte reale ose të një përgjithësin sendesh të lujtëshme, çytet prej një tjetri, mundet brenda një viti të kërkojë mbajtjen e tij në atë posedim *(neni 1052 i Kodit Civil)*. Në këtë kategori të drejtash, vepërimesh dhe deklarimesh vulneti hyjnë dhe afatet procedimore, si edhe e drejta e kërkimit të pagimit të kambialit ditën e skadencës dhe, për konstatimin e mos pagimit, redaktimi i protestos të nesërmen e skadencës, simbas dispozitavet të Kodit Tregëtar, e tjera.

Gjith' aahtu mos përmbushja e disa detyravet brenda një afati të caktuar, ka si konsenkancë rezimin nga të drejtat, siknndër ngjet për shëmbëll në *enfiteozin*, ku enfiteomarësi në rastin që nuku paguan *kanonin* e dy vjetevet rjesht dhe refuzon t' a paguajë edhe mas komunikimit të një kujtesjeje, i jepet konceduësit e drejta të kërkojë prej gjyqtarit zgjidhjen e enfiteozit *(neni 1536 i Kodit Civil)*.

Një pikë kohësore mundet të jetë, simbas vulnetit të deklaruësit, fillimi ose fundi i një relasioni juridik, si për shëmbëll ngjet në akte juridike me afat pezulluës ose zgjidhës.

Gjendja reale, që eksistovi në një kohë të caktuar dhe me parasypozime të caktuara, njihet prej së drejtës dhe sanksionohet prej saj. Kjo ngjet në *uzukapionë* ose *parashkrimin vetësimtar*, i cili është një mënyrë fitimi të një të drejte reale kryesore, pronësi, uzufrukt, servitudë, me ushtrimin e gjatë të kësaj të drejte në një kohë të caktuar, e cila parimisht është tridhjetë vjet *(neni 2034 i Kodit Civil)*. Por, kjo kohë zbritet në dhjetë vjet, kur ay që me mirëbesim vetëson një send të pa lujtëshmë ose një të drejtë reale mbi një t' atillë send, me fuqinë të një titulli që është transkriptuar regullisht dhe që nuku është nul për të meta forme, tue plotësuar kështu në favorin e vetë parashkrimin

vetësimtar me kalimin e dhjetë vjetevet qysh prej datës transkriptimit të titullit *(neni 2037 i Kodit Civil)*. Gjith' ashtu ngjet dhe me parashkrimin *libruës*, i cili është një mjet shuemje të drejtash patriominale, që rezulton nga mos ushtrimi i atyre të drejtavet prej titullarit në një kohë të caktuar; Kjo kohë, ne parim, është tridhjetë vjet, por mundet të jetë dhe m' e shkurtër *(nenî 2034 i Kodît Civil)*.

§ 94. — Pjesëtimi i kohës.

Koha ndahet në pjesa dhe pjesëtimin e saj të qëndrueshme na e tregon *kalendari*, i cili është *masa e pranuar për kohën*. Pjesat kryesore dhe më me rëndësi të kohës, të bazuara në ligjat naturale, janë dita, muaji dhe viti.

Dita, simbas kalendarit, është një pjesë kohe, e cila fillon nga mezi i natës dhe mbaron në mezin e natës tjetër; Muaji fillon që në ditën e parë të tij dhe mbaron në atë të fundit edhe viti fillon që më një Janar dhe mbaron më tridhjet' e një Dhjetor.

Dita, simbas kalendarit, ndahet në njëzet e katër pjesa të njëjta dhe secila prej këtyre pjesavet quhet *orë*.

Muaji, simbas kalendarit, është një pjesë kohe, e cila përbëhet prej një të dymbëdhjetës (1)12) të vitit. Por, të dymbëdhjetë muajtë të vitit nuku kanë vazhdim të njëjtë; Shtatë prej tyrevet kanë nga tridhjetë e një ditë, katër nga tridhjetë dhe njëri njëzet e tetë ditë në vitet ordinare dhe njëzet e nëntë në vitet bisekte.

Java nuku formon pjesë të kalendarit; Përbëhet prej shtatë ditësh, fillon ditën e së Djelës dhe mbaron në mezin e natës të së Shtunës.

Viti astronomik përbëhet prej 365 ditë, 5 orë, 48 minuta dhe 48 sekonda. Papa i Romës Grigor i XIII pranovi në vitin 1581 kalendarin e ri, të qojtur nga emëri i tij *gregorian*, tue lënë atë të bërë prej *jul Cesarit*, massi ky i fundit ishte m' i math nga viti astronomik ekzakt 11 minuta dhe 12 sekonda. Kalendari gregorian është pranuar prej gjithë botës së qytetëruar si më ekzakt.

Pos kësaj llogaritjeje të kohës eksiston dhe një tjetër, simbas të cilës pjesat e ndryshme të kohës nuk meren pas kalendarit, por në mënyrë abstrakte, pa nonjë fillim ose fund të qëndrueshmë. Koha që llogaritet në këtë mënyrë quhet e *lujtëshme* dhe kjo mënyrë llogaritjeje është më e zakonëshmja dhe më e shpeshta në jetën juridike. Këto pjesa të kohës nuku mvaren nga kalendari, por nga ngjarje juridike të caktuara, si për shëmbëll: në stasjonet e ndryshme të moshës nga lindja, në uzukapionë ose parashkrimin vetësimtar të një sendi të pa-lujtëshme qysh prej datës transkriptimit të titullit.

§ 89. — Dita e ndërkallur.

Viti roman, simbas kalendarit të *Numa*-s, përbëhej prej 355 ditë dhe nga ky shkak ngjiste një konfuzion kaqe i math, sa muajt' e dimbrit përbënin në realitet stinën e vjeshtës. Jul Cesari në vitin 708 qysh prej themelimit të Romës i shtovi vitit 707 nëntëdhjetë ditë. Kalendari i korizhuar, i cili mori emërin e Julit, hyri në fuqi në vitin 709 prej themelimit të Romës dhe ka pas qënë në zbatim në Orientin e afërmë deri këtu e disa vjet më parë.

Simbas ndryshimit që i solli kalendarit Jul Cesari, viti përbëhet prej 365 ditë dhe 6 orë; Këto të 6 orët të mbledhura çdo katër vjete përbëjnë 24 orë, domethënë një ditë. Kjo është arësyeja, për të cilën çdo vit i katërtë, *vîti bîsekt*, përbëhet prej 366 ditë. Kjo ditë e tepërtë i shtohet muajit Fruer, i cili kështu në vitet bisekte përbëhet prej 29 ditë. Kalendari i Jul Cesarit u korizhua prej Pappës Grigor XIII, sikundër u tha më sipër. Kalendari gregorian është në zbatim në Mbretërinë Shqiptare.

§ 90. — Përcaktimi i kohës.

Koha përcaktohet ose me pikë kohësore ose me interval kohe. Kur themi: 1 Janar, ora 1 pas mes ditës të 1 Janarit ose minuta e parë e orës të parë pas mes dite të 1 Janarit, këto quhen pika kohësore. Interval kohe është afatj.

Pika kol ësore kupëtohet si një pjesë e pa ndarë e kohës, kur se afati është një mbledhje pjesash të kohës. Në qoftë se për ekzekutimin e obligimit është caktuar ditë, për shëmbëll 28 Nëntor, dhe jo nënëpjesëtimi i saj, si për shëmbëll ora ose minuta, prestimi mundet të bëhet brënda asaj dite të caktuar.

Simbas dispozitavet të nenit 508 të shtojcës së dytë të Procedurës civile, në llogaritjen e një afati të caktuar me ditë, nuku numurohet dita me të cilën takon koha ose ngjarja, mbas së cilës duhet të fillojë afati.

Afatet e caktueme me javë, muaj ose vit mbarojnë me kalimin e asaj dite të javës të fundit, të muajit të fundit, e cila i korespondon në emër ose në numur ditës, kur ka filluar afati Në qoftë se kjo ditë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës të fundit të këtij muaji. Për shëmbëll: paditet A, i cili ndodhet në Amerikë. Simbas dispozitavet të nenit 511 të shtojcës së dytë të procedurës civile, afati për 'të është 2 muaj. Pra, në qoftë se komunikimi i bëhet me datën 31 Dhjetor, afati mbaron më 28 Fruer.

Fundi i një afati mundet të shënohet në një ditë të caktueme të kalendarit.

Simbas Kodit Tregëtar muajt janë sikurdër caktohen në kalendar, pra, afatet llogariten prej date në datë, domethënë afati i një muaji që fillon më 9 Janar mbaron më 9 Fruer, dhe kur fillon më 9 Fruer mbaron më 9 Mars, tue mos u marë para sysh diferenca që eksiston në rastin e parë se Janari ka 31 ditë dhe në rastin e dytë se Frueri ka vetëm 28 ose 29 ditë. Kur afati fillon nga dita e fundit e një muaji të gjatë dhe mbaron në një muaj që nuku ka ditë po t' atij numuri, afati mbushet me kalimin e ditës së fundit të muajit, domethënë një afat 2 muajsh që fillon më 31 Dhjetor plotësohet më 28 ose më 29 Fruer.

§ 97. — Llogaritja e Kohës.

Koha, kur përcaktohet me kalendar — me pikë kohë-

sore të caktuar ose me interval kohe — nuku ka nevojë për caktim tjetër. Përkundrazi, në kohën e lujtëshme që llogaritet nga një ngjarje juridike të caktuar, koha duhet të llogaritet dhe të caktohet, që të raportohet në kohën e kalendarit, simbas këtyre parimevet:

1. Në përcaktimin e afatit në orë ose minuta, koha llogaritet minutë më minutë, simbas llogarimit natural (*computatio naturalis*). Për shëmbëll: një afat një viti, i cili fillon më ora 2 të 1 Janarit mbaron më orën 2 të 2 Janarit të vitit tjetër.

2. Kur afati caktohet me pjesa kohe më të mëdha se ora, fjala bije me ditë, me muaj, aplikohet llogaritja civile ose juridike (*computatio civilis*) me ditë të kalendarit të pa pjesetuara. Për shëmbëll: në parashkrimin vetësimtar të nenit 2037 të Kodit Civil të filluar më ora 2 të 1 Janarit, llogaritet e gjithë dita 1 Janar dhe uzukapioni mbushet me kalimin e ditës së fundit. Koha zakonisht llogaritet me pjesëtime kohe më të mbëdha se ora si dita, java, muaji, viti. Për shëmbëll: neni 2032 i Kodit Civil thotë: "parashkrimi llogaritet me ditë të plota e jo me orë. Parashkrimi që llogaritet me muaj plotësohet kur kalon numuri i caktuem i muajvet, pa u marë parasysh diferenca e numërit të ditëvet që kanë ata muaj".

Në afatet procedimore afati nuku fillon nga dita e komunikimit të aktit gjyqësor, por nga e nesërmja dhe mbaron në fund të ditës së fundit. Simbas dispozitavet të Kodit Civil, në ipotekat nuku kanë rëndësi pjesëtimet e kohës më të vogëia se dita, për sa i përket përfitimit në radhën e së drejtës ipotekore. Neni 1941 i Kodit Civil thotë: "*Numuri renduer i inskriptimevet cakton radhën e tyre. Me gjith këtë, në rast që njëkohësisht shumë persona kërkojnë inskriptime kontra po një persone dhe po mbi ato pronja, ipotekat inskkriptohen po me një numur, tue u bă shënim për këtë në dëftesën që i jep ruejtësi seicilit prej kërkuësavet*".

Kohë e dobishme (*tempus utilis*) quhet ajo, në të ci-

lën nuku meren parasysh ditët e fundit të një afati, kur ato ditë takojnë të jenë ditë e Djelë ose festë. Simbas dispozitavet të nenit 509 të shtojcës së dytë të Procedurës Civile *"të Djelat dhe ditët feste nuku pezullojnë fillimin dhe ecjen e afatevet ligjore dhe gjyqësore. — Në qoftë se fundi i një afati takon në një ditë të Djelë ose festë, konsiderohet si e fundit ajo ditë pune që vjen mbas asaj të pushimit"*.

Një tjetër shëmbëll kohe të dobishme gjejmë në nenin 2033 të Kodit Civil, ku thuhet: *"Parashkimi plotësohet kur përmbushet dita e fundit të kohës; For, në rast që kreditori prej një force madhore ka qënë ndaluar të veprojë atë ditë, parashkrimi pezullohet deri sa të kalojë dita që vjen mas pushtimit të ndalimit"*.

KAPTINA F.

Parashkrimi.

§ 98. — Definisioni dhe arësyet justifikative.

Definisionin e parashkrimit na e jep neni 2009 i Kodit Civil: *"Parashkrimi është një mjet me të cilin, me kalimin e kohës dhe me kondita të caktueme, një person fiton një të drejtë ose librohet nga një obligim"*. Pra, me parashkrimin një *gjendje reale* që eksiston ndryshohet, me kalimin e kohës dhe me kondita të caktueme, në *një gjëndie juridike*.

E drejta në drejtimin e saj për me bind vulnetet e tjera tue mos ushtruar brenda në kohën e caktuar prej ligjës, ndonse eksiston një gjendje reale në kundrështim me të drejtën, shuhet; Pra, dy janë parasypozimet e parashkrimit: *kalimi î kohës* dhe *mos ushtrimi i së drejtës*.

Parashkrimi i së drejtavet nuku është ndëshkim për neglizhencën, massi ndëshkimi parasypozon një faj dhe ay që nuku ushtron të drejtën e vetë nuku i sjell dëm kurkujt; Kjo provohet edhe nga fakti se parashkrimi eksiston dhe

ecën dhe kontra atij, i cili ka një të drejtë por nuku e dij. E drejta i jep kohës fuqinë që, një gjëndje reale që eksiston t' a legjitimojë dhe t' a bëjë të pa atakueshme, domethënë e drejta mpron gjendjen e tashme kontra të kaluemes me shuemjen e së drejtavet Ngjarjet reale mbi të cilat bazohet gjendja juridike, si të tilla, nuku shpëtojnë nga gjithëfuqishmënia e kohës, por humbasin dhe këto dyke u fshirë nga mëndja e njerësvet. Kështu, provimi i atyre ngjarjevet bëhet tepër i vështirë, në mos i pa-mundur, prandaj dhe vetëm nga ky shkak e drejta pranon si të ligjëshmë atë që eksiston tani; tue mos përmetuar as një kontestim. Ay që, tue mos respektuar ç' i dorëzon koha, kërkon një gjëndje reale të ndryshme, nuku është i sigurtë se gjen gjithë monë të drejtën dhe të vërtetën; Heshtja dhe kalimi i një kohe të gjatë, në të cilën nuku u bë as një vepërim, i bëjnë hetimet e gjyqtarit të pa-mundëshme, provimin të vështirë dhe mprojtjen e të paditunit problematike. Prandaj nuku meret parasysh në se, ay që bën prapsimin e parashkrimit, është me besim të mirë ose jo.

Parashkrimi nga natura e tij formon të drejtë të detyruëshme (*jus cogens*) dhe i përket urdhrit publik, pra, koha e caktueme prej ligjës për parashkrim nuku mund të ndryshohet me konvecion të palëvet. Është nul konvecioni, me të cilin koha e parashkrimit zgjatet më shumë se ay i caktuar prej ligjës. Koha e parashkrimit a mundet të shkurtohet me anë konvencioni? Jo, thotë ligjëvuësi me nenin 2011 të Kodit Civil, "*koha e caktueme për parashkrim nuku mund të ndryshohet me konvecion të palëvet*". Parashkrimi është një regull i urdhrit publik dhe si i tillë me as një mënyrë nuku mundet të përmetohet që aplikimi i tij të mvaret nga vulneti i palëvet. Dispozita e ligjës është krejt e qartë dhe nuku ngreh interpretim.

Thamë më sipër se parashkrimi formon të drejtë të detyruëshme, pra, prapsimet e parashkrimit i përkasin urdhrit publik dhe mundet të bëhen në çdo stancë të gjykimit dhe para Gjyqit Apelit. Por, simbas dispozitavet të nenit

2012 të Kodit Civil, gjyqtari nuku mundet kryesisht të marë parasysh një parashkrim të pa-kundërshtuar.

Neni 2009 i Kodit Civil thotë se parashkrimi është një mjet, me të cilin fitohet një e drejtë ose shuhet një obligim; Pra, ligja njeh dy lloj parashkrime: parashkrimin *vetësimtar* dhe parashkrimin *libruës.*

Parashkrim vetësimtar ose *uzukapion* quhet ay, me të cilin krijohet një e drejtë.

Parashkrim libruës quhet ay, me të cilin debitori librohet nga obligasioni, shuhet e drejta. Parashkrimi libruës vepëron gjithëmonë si *prapsim*, massi ka për efekt përmbysjen e së drejtës të kreditorit, i cili kërkon pagimin e kreancës së tij. Por dhe parashkrimi vetësimtar vepëron si prapsim, në rastin që i zoti i mâ-parëshmë revandikon pronjën; Në këtë rast zoti i ri me uzukapion pretandon parashkrimin e tij vetësimtar, i cili naturisht vepëron në mënyrë prapsimi. Por, parashkrimi vetësimtar kryesisht vepëron si padie; Tue i krijuar një të drejtë atij, që plotësovi parashkrimin, i jep edhe mjetin që t' a valorizojë, t' a bëjë të vjefshme atë të drejtë.

Përgjithësisht në parashkrimin zbatohen këto regulla:

Parashkrimi nuku ka vënd në të gjitha relasionet juridike, për shëmbëll nuku aplikohet në relasionet e së drejtës familiare. Atje ku aplikohet, bazohet në dispozita të së drejtës pozitive.

Parashkrimi — *thotë neni 2015 i Kodit Civil* — nuku ka vënd për gjanat që janë jashtë tregëtimit.

Midis sendevet që janë jashtë tregëtimit përmblidhen pa dyshim ato që janë destinuarë për përdorim të përgjithëshme, si për shëmbëll portet (limanet), udhët, rugët dhe përgjithësisht ato që formojnë pasurinë domaniale të Shtetit ose të komunavet, sende këto që nuku i shtrohen parashkrimit. Por, kur destinasioni i tyre kryesor ndryshohet, pushojnë të jenë të pa-jetërtuëshme dhe mundet të fitohet zotërimi mbi 'to me parashkrim.

"*Shteti*, dispozon neni 2016 i Kodit Civil, *për pasurin*

e vetë patrimoniale dhe gjithë trupat, si dhe personat juridike i shtrohen parashkrimit dhe mund t' a pretandojnë po si privatët." Në qoftë se pasuria e Shtetit nuku është prej atyre të dispozuar për përdorim publik, por bën pjesë të pasurisë patrimoniale të Shtetit, në këtë rast kjo pasuri është e tregëtuëshme *(întra commercio)* dhe i shtrohet parashkrimit. Zyrat shtetnore, për sa i përket pasurisë së tyre patrimoniale, nuku përjashtohen nga parashkrimi, por, në bazë të njëjësisë, kanë të drejtë dhe t' a përdorin në favor të Shtetit.

Gjithë të drejtat që i përkasin gjendjes së personavet (*status personae*) dhe interesit të përgjithëshme janë jashtë tregëtimit, dhe kontra këtyre të drejtavet nuku ecën parashkrimi. Në rast që të kem bërë një vepër kontra ligjavet që regullojnë shëndetësinë, sigurimin botënor ose nonjë tjetër interes të një nature të përgjithëshme, posedimi i gjatë nuku më jep aš një të drejtë që t' i mbanj gjërat në gjendjen që i vura, massi interesi privat nuku mundet të predominojë mbi interesin publik dhe massi të drejtat e shoqërisë, si të pa jetërsuëshme, nuku i shtrohen parashkrimit.

Parashkrimi fillon qysh prej kohës, që mund të ngrehet padia. Pra, që të ecë parashkrimi, duhet e drejta të eksistojë tani dhe të jetë e padistuëshme. Në qoftë, pra, se një e drejtë është me afat ose me konditë, koha e parashkrimit fillon qysh prej kalimit të afatit ose realizimit të konditës. Posaçërisht mbi fillimin e parashkrimit duhen thënë këto:

a) Parashkrimi i padies për revandikim dhe i padievet të tjera reale fillon qysh prej kohës që pronjari ndalohet në ushtrimin e së drejtës së tij, si për shëmbëll: në padien për revandikim më t' u pushtuar sendi prej një tjetri, massi para kësaj ngjarjeje nuku eksistojnë elementat e lypuna prej ligjës për të ngrehur padie.

b) Në obligimet *mos me bâ* parashkrimi fillon qysh prej kohës që u bë vepra që duhej ometuar.

c) Në obligimet *me bâ*, në të cilat debitori duhet të bëjë një veprim, parashkrimi fillon qysh prej formimit të obligimit. Pò ky solusion duhet dhënë dhe në ato obligasione, për të cilat nuku u caktua afat, por në të cilat nga natura e tyre parasypozohet një vazhdim pak a shumë i gjatë (depozito, hua pa afat e tjera.)

ç) Në aktet juridike dy-anëshe parashkrimi fillon me t' u bërë akti juridik, dhe jo për secilën nga palët veçanërisht me të bërë kjo prestimin.

d) Në të drejtat për prestime kohe-pas-kohe *(periodike)*, parashkrimi fillon për se cilin prestim me t' u bërë ky i kërkuëshme. Por, kur parashkruhet e drejta mbi kryegjënë, parashkruhet dhe e drejta për kamatat.

dh) Padinat e të mitunit kontra tytorit ose mbi tytorit dhe ato të tytorit kontra të mitunit dhe që rjedhin nga tytoria parashkruhen pas dhjetë vjetvet; Parashkrimi fillon qysh prej ditës së madhorisë ose prej ditës vdekjes të së administruemit (*neni 365 i Kodit Civil*).

e) Parashkrimi fillon qysh prej mbarimit të veprës në rastet e nëmëruara *në nenet 2039 dhe 2040 të Kodit Civil.*

ë) Parashkrimi fillon te ecë në favor të gjyqtarëvet, arbitravet, avokatëvet, sekretarëvet të gjyqit për detyrimin e tyre me dhënë llogari për aktet që u përkasin padinavet qysh prej datës që ato padina janë gjykuar ose ndryshe përfunduar. Për ftuësit parashkrimi fillon qysh prej ekzekutimit të porosisë ose prej komunikimit të aktevet, me të cilat ishin ngarkuar (*neni 2043 î Kodit Civil*)

f) Eksepsionalisht parashkrimi fillon të ecëj para se e drejta të jetë e kërkuëshme n' ato raste, në të cilat ay që e ka të drejtën — pa qënë i lidhur prej nonjë afati — deklaron shprehimisht ose heshtësisht se nuku do të përdorë të drejtën e tij; Për shëmbëll: **A** i jep **B** një hua, tue i deklaruar se mund t' a mbajë deri sa t' ja kërkojë.

Sikundër u tha dhe më sipër, në parashkrimin libruës nuk është nevojë të eksistojë *besimî î mirë* i atij, në favorin e të cilit ecën parashkrimi.

§ 99. — Renoncim i parashkrimit.

Parashkrimi nuku mundet të renoncohet, përveç se massi të jetë plotësuar (*nenî 2011 §1 i Kodit Cîvil*). Parashkrimi i përket urdhrit publik; Kupëtohet, pra, arësyeja për të cilën vulneti privat nuku mund të ndalojë plotësimin e parashkrimit, kur konditat e lypuna prej ligjës verifikohen. Një dispozitë e kundërtë e ligjës do t' i vinte debitorët në dispozision të kreditorëvet, të cilët, dyke përfituar nga pozita e tyre avantazhoze, do t' i detyronin debitorët te renonconin.

Kur parashkrimi plotësohet dhe formon një të drejtë, at' here mundet të renoncohet si gjithë të drejtat patrimoniale. Renoncimi duhet të rjedhë prej një vulneti të lirë dhe të jetë në dijenin e renoncuësit; Që të dy këto elementa prezumohet se eksistojnë, deri sa të provohet e kundërta.

Renoncimi, *thotë nenî 2013 î Kodit Cìvil*, i parashkrimit bëhet shprehimisht ose heshtësisht.

Renoncimi heshtësuer rezulton nga çdo fakt që është i pa-pajtueshmë me vulnetin me përfitue nga parashkrimi. Por, ndërgjyqësi, i cili përdori të tjera mjete mprojtimi, nuku prezumohet me këtë vetëm se renoncovi parashkrimin.

Renoncimi i shprehun i parashkrimit është ay, i cili konsiston në manifestimin drejt për-së-drejti të vulnetit për të mos përfituar nga parashkrimi. Për vleftësinë e një kësilloj renoncimi, ligja nuku lyp no një formë të posaçme; Pra, sido qoftë bërë renoncimi, verbalisht ose me shkresë, parashkrimi nuku mund të kundrështohet më për ves nga pikëpamja e formës.

Massi ligja nuku përmban dispozita të posaçme, me të cilat të regullohet renoncimi i parashkrimit, aplikohen në këtë dispozitat e përgjithëshme të së drejtës; Dhe massi një e drejtë mundet të renoncohet me konditë, kështu edhe renoncimi i parashkrimit mund të bëhet me konditë.

"*Ay që nuku mundet me jetërsue, nuku mundet me renoncue parashkrimin*" thotë ligja. Pra, i mituni dhe i nda-

luemi nuku mundin në as një rast të renoncojnë parashkrimin, qoftë dhe me autorizimin e tytorëvet të tyre. I mituri tregëtar mundet të renoncojë parashkrimet relative me veprat e tregëtisë së tij. Gjiith' ashtu është i vlefshmë renoncimi i parashkrimit i bërë prej prodigut të asistuar prej këshillës së tij familiare.

Tytori nuku mund të renoncojë parashkrimin, qoftë dhe i autorizuarë prej këshillit familiar. Massi renoncimi i parashkrimit barasohet me renoncimin e një të drejte, domethënë me renoncimin e së drejtës me kundërshtue parashkrimin dhe me përfitue nga efekti i saj; Këshilli familiar do të kapërxente, pa dyshim, fushën e të drejtavet të tij po të mos përdorte një të drejtë, me të cilën pasuria e të mitunit do të shtohej.

Personat morale, të cilat nuku mundin të jetërsojnë, pa autorizimin e duhur, nuku mundin as të renoncojnë parashkrimin, me të cilin mund të shtohet pasuria e tyre. Pra, në qoftë se nuku janë të detyruara të marin autorizimin për të jetërsuar, at' here mundet t' a renoncojnë parashkrimin.

Neni 1181 i Kodit Civil u jep kreditorëvet të drejtën të ushtrojnë të gjitha të drejtat edhe padinat e debitorit, posë atyre që janë ekskluzivisht të lidhura me personën e debitorit *(jura personalissima)*. Pra, massi parashkrimi është një e drejtë patrimoniale, kreditorët dhe çdo personë tjetër që ka interesë, kanë të drejtë t' a kundrështojnë, që kështu mos të pakësohet pasuria e debitorit tyre, qoftë dhe sikur ky ose zotnuësi të neglizhojë ose t' a renoncojë. Por, kreditori ose persona që ka interesë, duhet të provojë se renoncimi ose neglizhenca e damtojnë në interesat e tij si të tillë dhe se renoncimi i shkakëtovi ose shtovi insolvabilitetin e debitorit tij *(neni 2014 i Kodit Civil)*.

Kur, në fillimin e gjykimit prapsimi i parashkrimit rëzohet, kjo nuku ndalon përdorimin e prapsimevet të tjera. Me t' u rëzuar prapsimi i paraskkrimit, mundet, për shëmbëll, të propozohet prapsimi i kompensimit.

§ 100. — Pezullimi i parashkrimit.

Për arësye të caktuara parashkrimi nuku ecën, ndonse e drejta nuku ushtrohet, domethënë parashkrimi as fillon, as i filluari vazhdon; Në këtë rast themi se parashkrimi pezullohet.

Pezullimi ndryshon nga ndërpremja, massi në ndërpremjen koha e kaluar vete dëm, humbet dhe nuku llogaritet, në rastin që fillon parashkrimi i ri. E kundërta ngjet ne pezullim, massi në këtë me t' u çdukur arësyet e pezullimit, parashkrimi vazhdon dhe koha e kaluar bashkohet dhe llogaritet me kohën të mâ-pasme. Shkaket që e pezullojnë parashkrimin caktohen prej ligjës.

Parashkrimi nuku ecën, *simbas dispozitavet të nenit 2022 të Kodit Civil,* kontra:

1. Të mitunvet të pa-emanqipuem dhe të ndaluemvet për shkak dobësie mëndore.

Interesi i përgjithëshmë i shoqërisë që të drejtat të jenë të siguruara qëndrimisht dhe dëshira për t'ja arirë këtij qëllimi, krijuan institusionin e parashkrimit. Më anën tjetër i përket interesit social që ato persona, të cilat janë të pazota të mprojnë vetë-vehten, të mprohen prej ligjës, se përndryshe, po t' ju mungonte një mprojtje e tillë sendi që zotërohet sot prej një familieje nuku dijet në se do të zotërohet prej saj dhe nesër, në qoftë se kryetari i families është i ndaluar ose një të mituri i vjen një trashëgim. Legjislatori duhet të zgjithte midis parashkrimit të së drejtavet dhe interesit të këtyre të pa-zotëvet, dhe preferovi të verë në heshtje interesin social, deri sa të pushojë gjendja e pa-zotësisë së tyre, në favor të të mitunvet dhe të ndaluemvet. Nga kjo rezulton dhe konsekanca se legjislatori është ay, i cili përcakton personat, në favor të së cilavet pezullohet parashkrimi; Pra, massi ligja dispozon se përfitojnë nga pezullimi të mitunit të pa-emanqipuem dhe të ndaluemit për shkak dobësie mendore, rezulton se i mituri i emanqipuen dhe ay që pëson prej një dobësie mendore,

por nuku është i ndaluar, nuku përfitojnë nga ky benefic, kësktu që parashkrimi ecën regullisht kontra tyre.

2. Të mobilizuemvet dhe gjithë personavet të tjera që shëmbëllohen me këto në bazë të ligjavet të posaçme.

I mobilizuemi në kohë lufte nuku mundet të konsiderohet se ndodhet në pamundësi të ushtronjë të drejtat e tij, massi këtë mundet t'a bëjë me anën e një përfaqësuesi; Por, ligjëvuësi tue marë parasysh se i mobilizuemi në kohë lufte vé vehten në rezik për mprojtjen e Atdheut dhe kështu bën sakrificën më të madhe, i akordon këtij beneficin e pezullimit të parashkrimit, tue lënë më nj' anë interesin e përgjithëshme të Shoqërisë për ecjen e parashkrimit.

Elementat, që lyp ligja për pezullimin e parashkrimit në këtë rast, janë dy: a) *kohë lufte,* dhe b) *persona e favorizueme të jetë mobilizuarë.* Ekspresioni i ligjës është limitatif dhe benefici nuku zgjatet tej rastevet të caktuara shprehimisht prej ligjës. Pra, sikur të sypozohet se një i mobilizuem në kohë paqe vé vehten në rezik tue ndjekur brigandë nuku përfiton nga benefici i ligjës.

Me t' u mbaruar shtati i luftës me nënëshkrimin e një traktati paqeje, parashkrimi fillon të ecë përsëri, simbas parimevet të përgjithëshme të ligjës.

Nga ky benefic përfitojnë dhe gjith' ato persona të tjera, të cilat në bazë të ligjavet të posaçme barasohen me të mobilizuemit në kohë lufte.

3. Kontra padies për garantim, deri sa nuku është bâ eviksion. Për shëmbëll: **A** më shet një shtëpi, zotërimin e së cilës e fitonj me besim të mirë, dyke e pandehur se shitësi është zot dhe transkriptonj dhe titullin. Para se të kalojnë të dhjetë vjetet dhe të plotësohet parashkrimi vetësimtar dhjetëvjetuer, m' a revandikon shtëpinë **B**, i cili është i zoti i vërtetë i pronjës. Në këtë rast pyetet: koha që kaloj qysh prej datës që ma shiti pronjën **A** deri në ditën që u bë eviksioni a llogaritet në parashkrimin e padies për garantim që kam unë kontra shitësit **A**? Ligja ho'ë se ajo kohë nuku llogaritet, parashkrimi nuku ecën,

mbetet pezull dhe fillon vetëm që prej ditës që u bë eviksioni.

Nuku duhet të bëhet konfuzion midis eviksionit edhe çytjes. Eviksioni ka për qëllim detyrimin e shitësit për t' i paguar dëm-shpërblime blerësit, për shkak se i shiti një send të huaj, të cilin një i tretë e revandikovi. Pra, në qoftë se një i tretë me çytë në posedimin ose në gëzimin e lirë të sendit, nuku mund të ngreh padien për garantim, e cila ka vënd vetëm kur sendi revandikohet. Nga gjithë këto kupëtohet se çytja nuku shkakëton fillimin e parashkrimit të padies për garantim që ka blerësi kontra shitësit.

Gjith' ashtu parashkrimi nuku ecën, domethënë mbetet pezull, përgjithësisht kundrejt çdo kredie deri sa kreditori nuku mundet me ngref padie.

Kjo dispozitë e ligjës bazohet në parimin e përgjithëshmë, se parashkrimi pezullohet kundrejt gjithë atyrevet që ndodhen në pa-mundësi të ngrehin padie, simbas adazhit "*contra non valentem agere non currit praescriptio.*" Teksti i ligjës nuku është limitatif, kështu që gjithë pamundëshmënitë për të ngrehur padie duhet të pranohen si shkake pezullimi të parashkrimit, ndonse nuku janë të deklaruara si të tilla prej ligjës. Pamundëshmënia mundet të shkakëtohet prej një force madhore, prej ligjës, prej konvencionit.

Shkaket, që ndalojnë parashkrimin, të shënuara *në nenin 2022 të Kodit Civil* nuku kanë vënd në parashkrimin tridhjetëvjetor kontra poseduësit të tretë të një pronje ose të një të drejte reale mbi një pronjë, thotë *neni 2023 i Kodit Civil.*

Shkake të tjera që pezullojnë parashkrimin janë ato që reshtohen në tekstin e *nenit 2021 të Kodit Civil;* Këto shkake vepërojnë vetëm për sa u përket relasionevet midis personavet të caktuara limitativisht prej ligjës, të cilat nuku mundet të përfitojnë nga kalimi i kohës që të invokojnë në favorin e tyre parashkrimin, i çdo lloji qoftë ky.

Personat e para, që tregon *neni 2021 i Kodit Civil,* janë bashkëshortët. As njëri prej tyre nuku mund të para-

shkruajë në dëm të tjetrit. Pra, në qoftë se, në vazhdim të martesës, buri posedon si të vetë një send të gruas, ose gruaja mban si zonjë një send të burit, as njëri, as tjetra nuku mund të gëzojnë posedimin e tyre në kohën e martesës për t' a llogaritur si parashkrim, qoftë dhe sikur ky posedim të jetë tridhjetëvjetuer. Shkaket justifikuëse të kësaj dispozite janë këto: Bashkëshortet janë të bashkuar midis tyre me lidhjen më të ngushtë që eksiston dhe me qënë se afeksioni dhe interesat e përbashkëta, me të cilat jetojnë, kanë si efekt që t' a ushtrojë njëri prej tyre një të drejtë që e ka tjetri, duhej ndaluar që njëri nga bashkëshortët t' a ngëthejë besimin ose afeksionin e tjetrit në një mjet të ligjëshmë për t' a çveshur. Midis bashkëshortëvet nuku ecën as një parashkrim, cili do qoftë ky. Pò ky solusion duhet të jepet dhe në rastin që është vendosur veçimi personal i bashkëshortëvet, massi dhe mas veçimit këta nuku pushojnë së qëni bashkëshortë

Parashkrimi nuku ecën midis fëmiës që gjendet nënë pushtetin atënor dhe prindëvet të tij; Midis të mitunit ose të ndaluemit dhe tytorit të tij, deri sa nuku ka pushuar tytoria dhe nuku është dhënë dhe aprovuar definitivisht llogaria; Midis të mitunit të emancipuem ose të pa-aftësuem dhe kujdestarit; Përgjithësisht midis personavet, të cilat me ligjë janë vënë nënë administrimin e tjetrit dhe atij që administron, deri sa nuku është dhënë dhe aprovue definitivisht llogaria.

Arësye morale dhe drejtësie e determinuan legjislatorin të urdhërojë që mos të ecëj parashkrimi kontra personavet të numuruara më sipër. Personat të vëna prej ligjës nënë administrimin e tjetrit janë, për shëmbëll, *absentët, trashëgimi vakant* e tjera. Pra, ay që administron pasurinë të një absenti ose të një trashëgimi vakant, deri sa vazhdon administrimi nuku mund t' a parashkruajë në favor të vetë kontra të administrruemit.

Personat morale, ndonse kanë nevojë që të reprezantohen dhe t' u administrohet pasuria, nuku mundet të qu-

het se janë të vëna nënë administrimin e një tjetri, massi ato administrohen vetë me anën e personavet, të cilat janë përfaqësuësat e ligjëshme të tyre. Pra, pezullimi i parashkrimit i *nenît 2021 §5 të Kodit Civil* nuku mundet të aplikohet në raporet që eksistojnë midis personës morale dhe atij që e përfaqëson, massi veçanërisht, tue qënë se kjo dispozitë është eksepsionale, nuku mundet të interpretohet gjërë.

Më në fund parashkrimi nuku ecën midis trashëgimtarit dhe trashëgimit të pranuar me benefic inventari. Parashkrimi në këtë rast nuku ecën as në favor të trashëgimtarit kontra trashëgimit të pranuar me benefic inventari, as në favor të këtij trashëgimi kontra trashëgimtarit dhe kjo ka aplikim mbi çfarë-do të drejtë ose pasdie. Qëllimi i pranimit të trashëgimit me benefic inventari është që ky trashëgim mos të përzjehet me pasurinë të trashëgimtarit. Massi të dy pasunitë janë të ndara administrimi i pasunisë të trashëgimit i mbetet trashëgimtarit; Pra, midis trashëgimit dke trashëgimtarit eksistojnë relasione si ato midis administruësit dhe të administruemit, dhe nga ky shkak ligja ndalon ecjen e parashkrimit midis treshëgimit të pranuar me benefic inventari dhe trashëgimtarit.

Thamë më sipër se pezullimi i parashkrimit në rastin e *§4 të nenit 2021 të Kodit Civil* aplikohet mbi çdo të drejtë, çfarëdo qoftë kjo. Lé të sypozojmë se *de cujus*-i si posesor i një pronje të zotëruar prej atij që u emërua trashëgimtar kishte filluar të parashkruajë kontra këtij; Ky paraskkrim pezullohet me t' u pranuar trashëgimi me beneficin e inventarit prej trashëgimtarit, dhe parashkrimi nuku mundet të ecë në dëm të trashëgimtarit dhe në favor të pasurisë të trashëgimit, qoftë dhe sikur trashëgimtari mos të bëjë as një veprim për t'a ndërprerë ecjen e parashkrimit.

§ 101. — Nderpremja e parashkrimit.

Kur e drejta ushtrohet brenda kohës të caktuar për parashkrim, ky ndërpritet, humbet për sa i përket kohës

së kaluar, e cila me as një mënyrë nuku është më e mirë për t' u llogaritur në parashkrim; Por, pas ndërpremjes mundet të ecë një parashkrim i ri.

Parashkrimi, dispozon *neni 2024 i Kodit Civil,* mund të ndërpritet naturisht ose civilisht. Ndërpritet naturisht, shton *neni 2025 i Kodit Civil,* kur poseduësi privohet për më tepër se një vit nga gëzimi i gjasë.

Shkakëtari i privimit mundet të jetë një i tretë, qoftë që nuku ka as një të drejtë, qoftë dhe zoti i vërtetë i pronjës, dhe nuku ekzaminohet në se privimi i këtij posesioni për më shumë se një vit u bë në dijë ose jo të posesorit. Por, ndërpremja naturale — e cila mundet të jetë rezultati i një dhune, i një vetëgjyqësie — duhet të shkakëtojë privimin absolut të posesorit nga i tërë sendi, disa vepra të vogla nuku kanë efekt. Forca madhore dhe sidomos mbytj' e ujit, qoftë dhe sikur t' a privojë posesorin dhe më shumë se një vit, nuku janë shkake për ndërpremjen e parashkrimit.

Parashkrimi ndërpritet civilisht — thotë *neni 2026 i Kodit Civil* — me padie edhe sikur kjo të ngrehet përpara një gjyqtari inkompetent, me lajmim për pagim ose me sekuestrim, ose me çdo veprim tjetër që ven debitorin në morë për me ekzekutue obligimin.

Parashkrimi ndërpritet, pra, civilisht me shumë mënyra. Mënyra e parë është kërkesa e padies e bërë qoftë dhe përpara një gjyqtari inkompetent.

Kur themi kërkesë padieje duhet të kupëtojmë atë akt, me të cilin thëritet një personë përpara gjyqtarit, me qëllim që të vleftësojë një të drejtë që propozuësi i kërkimit e konsideron si të tinë. Pra, një akt, me të cilin kundërgjyqësi nuku është thirur édhe para gjyqtarit, nuku ka fuqi që të ndërpresë parashkrimin; Prandaj kërkesa që bëhet para gjyqit për t' u emëruar një avokat d' office, për t' ju emëruar një kujdestar personës që do të padistojë një tjetër, dhe fakte të tjera pregatitëse të këshilloji nuku formojnë kërkesë padieje dhe nuku kanë efekt për ndërpre-

mjen e ecjes të parashkrimit. Posë kësaj duhet që e drejta e kërkuar me kërkesën e padies të jetë po ajo që formon objektin e parashkrimit, se përndryshe nuku mund të ndërpresë parashkrimin. Për shëmbëll: një pronja e ime posedohet prej **A** dhe njëkohësisht **B** ekserson mbi këtë pronjë një prej atyre servitudevet që fitohen me parashkrim. Revandikonj prej **A** pronjën, naturisht për sa i përket këtij, parashkrimi ndërpritet, por parashkrimi vazhdon të ecë në favor të **B** massi e drejta e tij është e ndryshme nga ajo që revandikonj para gjyqtarit.

Kërkesa e padies, sikundër u tha më sipër, ndërpret parashkrimin qoftë dhe kur bëhet përpara një gjyqtari inkompetent; Përkundrazi, simbas *nenit 2029 të Kodit Civil*, ndërpremja konsiderohet si e pa bërë, në qoftë se kërkesa e padies është nul për shkak inkompetence të ofiqarit publik, përveç kur mundet të jetë e vlefshme si një akt vumjeje në morë. Gjith' ashtu konsiderohet si e pa bërë ndërpremja, në qoftë se paditësi heq dorë nga padia, në qoftë se e lé padien të perimohet ose në qoftë se kjo i rëzohet.

Parashkrimi ndërpritet civilisht jo vetëm me padie, por dhe me lajmim për pagim ose me sekuestrim ose me çdo veprim tjetër, që vé debitorin në morë për me ekzekutue obligimin.

Lajmimi për pagim mundet të jetë ose prej Zyrës Përmbarueëse, mas dënimit të debitorit, për të ekzekutuar obligimin ose për ekzekutimin e një kontratoje të deklaruar të ekzekutueshme prej palëvet. Në qoftë se lajmimi bëhet prej një ofiqari inkompetent, parashkrimi në këtë rast nuku ndërpritet.

Kur parashkrimi ndërpritet prej një lajmimi për pagim, ca më tepër duhet të kenë këtë efekt veprimet ekzekutive, ndonse për këto ligja nuku bën fjalë.

Neni 2027 i Kodit Civil thotë: *"Për me ndërpré parashkrîmîn padia mund të ngrehet kontra të tretit me qëllim që të deklarohet se eksiston e drejta, edhe sikur kjo të mvaret nga një afat ose kondítë."*

Për të kupëtuar këtë dispozitë të ligjës, duhet të kemi parasysh dhe *nenet 2022 §3 dhe 2023 të Kodit Civil.* Për shëmbëll: Lé të sypozohet se pronja që më është lënë leg me një konditë ose me afat shitet prej trashëgimtarit. Naturisht, massi nuku është realizuar kondita, as afati ka arrihur, nuku mund të ngreh një padie për revandikim. Më anën tjetër pamundëshmënia e ime që të ngreh padie nuku ndalon ecjen e parashkrimit në favor të blerësit. Në këtë rast, po të sypszohet se kondita realizohet pas tridhjetë vjetvet, blerësi do të ketë mbushur parashkrimin tridhjet vjetuer të *nenit 2023 të Kodit Civil.* Raste kësilloji ka paravështruar ligjëvuësi dhe ka vendosur dispozitën e *nenit 2027 të Kodit Civil,* i cili ka për qëllim konservimin e një të drejte, e cila bën pjesë të pasurisë të kreditorit, ndonse kreditori nuku mund të ngrehë padien.

Kompromesua ndërpret parashkrimin, massi kjo parasypozon eksersimin e padies nga ana e kreditorit, i cili d' akord me debitorin e vé në gjykimin e arbitravet të besuar prej të dy palëvet.

Inskriptimi dhe përsëritja e ketij nuku ndërpresin parashkrimin e ipotekavet, dispozon *neni 2028 i Kodit Civil.* Për të kupëtuar përmbajtjen e kësaj dispozite, duhet të kemi parasysh *nenin 1963 të Kodit Civil,* i cili thotë: "*Ipotekat shuhen dhe me parashkrim, i clli për pronat e poseduеme prej debitorit plotësohet me parashkrimin e kredisë, dhe sa për pasurinë të poseduеme prej të tretëvet, plotësohet edhe me kalimin e tridhietë vjetevet, simbas regullavet të caktueme në titullin "Parashkrimi".*

Kur parashkruhet deta, të drejtat që rjedhin prej kësaj parashkruhen dhe ato, dhe me qënë se ipoteka është një e drejtë që rjeth nga kreanca, një aksesori i saj, parashkruhet dhe kjo bashkë me atë.

Qëllimi, për të cilin ligjëvuësi urdhërovi që, për pronjat e poseduara prej debitorit, parashkrimi plotësohet me

parashkrimin e kreancës, është që të çquhet diferenca që eksiston në shuemjen e ipotekës përsa u përket raporevet midis kreditorit edhe debitorit dhe atyre që eksistojnë midis poseduësit të tretë të sendit të ipotekuem dhe kreditorit. Debitori nuku mund t' a invokojë parashkrimin e kreancës, përveç se kur të plotësohet koha e parashkrimit dhe kreanca të shuhet; Por, në qof'ë se parashkrimi i kreancës ndërpritet, massi ipoteka është aksesore e kreancës, ndërpritet parashkrimi edhe për sa i përket ipotekës. Përkundrazi, poseduësi i tretë i pronjës të ipotekuar mund të përdorë kundrejt kreditorit jo vetëm parashkrimi qe ka goditur kreancën e tij, massi në këtë mënyrë humbi lidhja që rëndonte pronjën, qoftë kjo e ndodhur në dorë të debitorit ose në atë të poseduësit të tretë, por ky i fundit mundet të invokojë edhe parashkrimin tridhjetëvjetuer, simbas dispozitavet *të nenit 1963 të Kodit Civil.*

Padia reale, që i rjeth kreditorit prej ipoteke, parashkruet vetëm me kalimin e tridhjetë vjetevet, sikundër dispozon *neni 1963 i Kodit Civil*; M' anën tjetër *neni 2037 i Kodit Civil* dispozon se zotërimi i pronjës parashkruet pas dhjetë vjetëvet, kur eksiston titull i transkriptuar regullisht dhe që nuku është nul për të meta forme bashkë me besim të mirë. Poseduësi i tretë a mundet të fitojë me parashkrimin vetësimtar dhjetë vjetuer të drejtë kontra kreditorit ipotekor? Jo, koha e dhjetë vjetevet nuku është e mjaftë që të shuajë padien reale, që i rjeth prej ipotekës kreditorit, ipotekë e cila nuku parashkruhet veç se me kalimin e tridhjetë vjetevet.

Massi u dhanë këto çkoqttje, le të vimë në *nenin 2028 të Kodit Civil.* Nga sa u ekspozuan më sipër, lehtazi kupëtohet se dispozitat e *nenit 2028 të Kodit Civil*, në bazë të së cilavet inskriptimi dhe përsëritja e ipotekës nuku ndërpresim parashkrimin aplikohen kaqe në pronjat e ipotekuara të poseduara prej debitorit vetë, sa edhe në ato që posedohen prej një të treti. Pra, në raporet midis kreditorit ipotekor dhe debitorit, *parashkrimi i kreancës* nuku lé

të eksistojë *inskriptimi ipotekor,* me gjithë që, qysh prej datës të inskriptimit tij ose asaj të përsëritjes, mos të kenë kaluar tridhjetë vjet.

Për sa u përket raporevet midis kreditorit ipotekor edhe poseduësit të tretë, gjithë ky solusion jepet prej *nenit 2028 të Kodit Civil.* Kreditori që të nërpresë parashkrimin ipotekor kontra posesorit të tretë, ka të drejtë të ngrehë kontra këtij padien që i rjeth prej *nenit 2027 të Kodit Civil* që të deklarohet se i eksiston e drejta.

Parashkrimi ndërpritet civilisht, thotë *neni 2030 i Kodit Civil,* kur debitori ose poseduësi njeh të drejtën e atij, kontra të cilit kishte filluar parashkrimi. Ligjëvuësi ka krijuar institusionin e parashkrimit për të siguruar stabilitetin dhe saktësinë e së drejtave dhe për të ndaluar që padiet të vazhdojnë gjithë jetën; Interesi që ka shoqëria nga parashkrimi i padievet ësthë i qartë dhe i pa kontestuar. Por, kur vjen vetë posesori ose debitori edhe e njeh të drejtën, tue treguar kështu qëllimin e tij që t' i japë kësaj satisfaksion, nuku mundet të thuhet se shoqëria ka interes që ky mos të plotësojë detyrën ose mos të njohë tjetrin si zot, për shkak se kalovi një kohë pak a shumë e gjatë

Njohtja e së drejtës që ndërpret ecjen e parashkrimit është *një akt unilateral (një anëshë);* Në qoftë se, për krijimin e një të drejte dhe të detyrës që i korespondon, duhet të bashkohet hiri i dy personavet, kur kjo e drejtë eksiston, mjafton vulneti i personës që detvrohet t' i japë satisfaksion kësaj te drejte, që t' a njohë këtë. Kështu, pra, nuku mundet t' i mohohet aktit të njojtjes të së drejtës fuqia për ndërpremjen e parashkrimit, për shkak se kreditori ose proprietari nuku mori pjesë në aktin. Njohtja e së drejtës që ndërpret parashkrimin nuku i shtrohet as një formaliteti; Mundet të jetë e shprehun ose e heshtun.

Çdo ndërpremje parashkrimi kundrejt debitorit kryesor sjell efektet e saj edhe kundrejt dorëzânësit, thotë neni 2031 i Kodit Civil Padia që ka kreditori kontra debitorit është

e ndryshme nga ajo që ka kontra dorëzânësit, por me gjithë këtë padia kontra dorëzânësit është një aksesore e padies që ka kreditori kontra debitorit. Simbas parimit "*accessorium sequitur principalis*," fatin e padies origjinale që ka kreditori kontra debitorit origjinal do të ndjekë dhe padia kontra dorëzânësit; Pra në rastin që parashkrimi i padies që ka kreditori kontra debitorit origjinal ndërpritet, dhe parashkrimi që ecën në favor të dorëzânësit ndërpritet dhe ky. Dispozitat e *nenit 2031 të Kodit Civil*, massi kanë një karakter eksepsional, nuku mundet të zgjanohen tej kufisë të caktuar prej ligjëvuësit. Pra, ndërpremja e parashkrimit kontra dorëzânësit nuku dâmton debitorin origjinal, i cili në ç' do rast mund t' a pretandojë parashkrimin e plotësuar në favorin e tij.

§ 102. — Koha që lypet për parashkrim.

Ligjëvuësi ka caktuar shumë lloj parashkrime, dhe se e cila prej tyre plotësohet në terma të ndryshme. Termat e lypuna për parashkrim konsistojnë në periudha muajsh ose vjetesh.

Me ç' mënyrë llogaritet terma e caktuar prej ligjës për t' u plotësuar parashkrimi? Para se t' i jepet përgjigja kësaj pyetjeje, duhet të çquajmë parashkrimin vetësimtar prej parashkrimit libruës.

Thamë më sipër se kur fillon parashkrimi i obligasionevet të ndryshme. Në obligimet kondicionale ose me afat, parashkrimi ecën vetëm me skadimin e afatit ose me realizimin e konditës. Kur obligimi nuku është i kondicionuar as i mvarur prej nonjë afati, parashkrimi fillon të ecë, kur obligimi bëhet i plotë, massi vetëm qysh prej kësaj kohe kreditori ka të drejtë të ngrehë padie. Në kontratat që lidhen midis personavet që banojnë në vise të ndryshme, parashkrimi fillon jo prej minutës të propozimit, as prej asaj të pranimit, por qysh prej kohës që propozuësi mer dijeni se propozimi i tij ju pranua. Gjith' ashtu, në qoftë se një kontrato për t' u bërë e plotë duhet të jepet aprovimi i

një të treti, parashkrimi nuku ecën para se të jepet ky aprovim.

Përkundrazi në parashkrimin vetësimtar — i cili bazohet në posedimin — parashkrimi nuku fillon nga data e kontratos, por nga data e posedimit të pronjës, objekt të kontratos. Për shëmbëll: A më shet një pronjë, i së cilës nuku është zot; Në rastin që unë jam me mirëbesim dhe titulli im i saktë është transkiptuar regullisht, me kalimin e dhjetë vjetvet bëhem zot i pronjës që më është shitur prej atij që nuku mundte t' a dispozonte. Por, ky afat i dhjetë vjetevet nuku fillon të ecë qysh prej ditës që kontrata e shitjes u bë e plotë, por prej ditës që hyra në posesion të pronjës që bleva.

Thamë më sipër se termat e lypuna për parashkrim konsistojnë në periudha muajsh ose vietesh. Por, si llogariten muajtë ose vjetet që lypen për parashkrim? Kur fillon të ecë "*parashkrimi llogaritet me ditë të plota dhe jo me orë*" na thotë *neni 2032 i Kodit Civil.* Parashkrimi fillon të ecë nga mezi i natës që i suksedon ditës, në të cilën u fitua e drejta për të vepëruar kontra debitorit. Parimi, si mbas të cilit nuku llogaritet dita që ecën për efektet e parashkrimit, është i justifikuar, massi, në qoftë se shumë herë është gjë e vështirë për t' u caktuar dita ekzakte e posedimit, është e pa-mundur që të sigurojë njeriu në cilën orë të një dite të caktuar ka filluar posedimi. Ky imposibilitet pratik në konstatimin me presizion të orës është shkaku, për të cilin ligja nuku e llogarit ditën e parë, nga e cila posedimi ose e drejta eksistojnë.

Massi u caktua koha ekzakte, në të cilën parashkrimi fillon, mbetet të konstatohet se me ç' mënyrë duhet të llogariten muajtë ose vitet e lypuna për plotësimin e parashkrimit dhe kur terma e caktuar konsiderohet e skaduar dhe parashkrimi bëhet efektif.

"*Parashkrimi që llogaritet me muaj* — thotë *neni 2032 §2 i Kodit Civil — plotësohet kur kalon numuri i caktuar i muajvet, pa u marë parasysh diferenca e numu-*

rit të ditëvet që kanë ata muaj." Me këtë dispozitë ligjëvuësi ka dashur të bëjë mâ të qartë methudhën e llogaritjes të parashkrimit me muaj, diferenca e të cilëvet në ditë nuku meret parasysh; Me një fjalë, muajtë qofshin 28, 29, 30 ose 31 ditësh, kanë një lloj efekti për parashkrimin me muaj.

Për sa i përket llogaritjes të vitevet që lypen për parashkrim, ligja heshtë. Nga kjo heshtja e ligjevuësit kupëtohet se ky me fjalën *vit* ka patur para sysh atë masë kohe të kalendarit gregorian, i cili përbëhet prej dymbëdejetë muajsh, dhe se i cili prej këtyrevet ka atë numur ditësh të caktuara po n' atë kalendar. Pra, në qoftë se më 16 Janar 1930 filova posedimin e një pronje, viti i parë i parashkrimit fillon nga mezi i natës që nga 16 në 17 të këtij muaji, domethënë fillon më 17 Janar dhe plotësohet me t' u mbaruar dita 17 Janar 1931.

"*Parashkrimi plotësohet* — thotë *neni 2033 i Kodit Civil — kur përmbushet dita e fundit të kohës.*" Pra, në qoftë se dita e fundit nuku është përmbushur édhe, parashkrimi nuku mund të invokohet. Dhe me qënë se dita e fundit e termës mbarohet me hyrjen e ditës tjetër, parashkrimi mund të invokohet vetëm në ditën që i suksedon skadimit të termës të caktuar prej ligjës për parashkrim. Për shëmbëll: lé të sypozohet se dua të invokonj parashkrimin vetësimtar tridhjetvjetuer për një pronjë, posedimin e së cilës e mora me shpirt pronjari më 21 Janar 1900. Massi dita që hyra në posedim nuku llogaritet, parashkrimi fillovi qysh prej 22 Janar 1900. Qysh prej kësaj date të tridhjetë vjetet plotësohen në mezin e natës të 22 me 23 Janar 1930, kështu që më 22 Janar 1930 nuku mund t' a invokonj parashkrimin, përveç se më datën 23 Janar 1930. Pra, në qoftë se më 22 Janar 1930 pronjari ngreh padije revandikimi, nuku mund të propozonj prapsimin e parashkrimit, massi ditën që m' u komunikua padia, ditë e fundit e termës të parashkrimit, nuku është përmbushur dhe massi nuku u përmbush, parashkrimi nuku është i plotë dhe nuku mundet të pretandohet.

"*Por,* — shton *neni 2033 i Kodit Civil, — në rast që kreditori prej një force madhore ka qënë ndalue me veprue atë ditë, parashkrimi pezullohet deri sa të kalojë dita që vjen mas pushimit të ndalimit*".

Ligjëvuësi me dispozitën e përmëndur *të nenit 2033* ka dashur të zbutë regullin, simbas të cilit parashkrimi plotësohet me plotësimin e ditës së fundit; Konsideron me një fjalë se pa-mundësia për veprim të kreditorit ose të pronjarit që shkakëtohet prej një force madhore, e cila ngjet në këtë ditën e fundit të parashkrimit është një skkak pezullimi të parashkrimit, i cili mbaron me të kaluar dita që i pason asaj, në të cilin pushon pa mundësia ose ndalimi.

Kur persona që parashkruan dhe ajo kontra së cilës ecën parashkrimi kanë një shtetësi të ndryshme, pas ligjës të cilit shtet do të ecë parashkrimi që të konsiderohet i plotësuar ose jo?

Për sa i përket parashkrimit vetësimtar, përgiegja është e lehtë; *Neni 6 §2 i dispozitavet mbi aplikimin dhe interpretimin e ligjavet përgjithësisht* thotë: "*Sendet e palujtëshme u shtrohen ligjavet te vëndit, ku ndodhen*". Pra, ligjës të vëndit, ku ndodhet pronja i përket të caktojë konditat e lypuna për parashkrim, si edhe kohën e posesionit që lypet për të konsideruar parashkrimin të plotësuar.

Por, kur objekti i parashkrimit është një obligim? Mbi këtë çështje mejtimet nuku janë d' akord. Disa thonë se në këtë rast parashkrimi regjohet simbas ligjës të shtetësisë të kreditorit, të tjerë simbas ligjës të vëndit, ku u lith konvencioni. Simbas një mejtimi tjetër që ka partizanët me të tepërtë, parashkrimi duhet të regullohet simbas ligjës të Shtetit të debitorit. Sikundër është e ditur, parashkrimi libruës është pranuar si një mjet për të ndalua[r] eternizimin, motimin e padinavet dhe për të siguruar kështu qetësinë e familievet. Pra, parashkrimi i një obligimi i përket qetësisë të debitorit dhe të families së tij; Dhe, me

qënë se parashkrimi i përket urdhërit publik, ky duhet të regullohet simbas ligjës të Shtetit, së cilit i cënohet urdhëri publik. Kështu, parashkrimi në rastin që kemi para sysh duhet të regjohet pas ligjës të Shtetit të debitorit, të cilit i cënohet qetësia.

Neni 2034 i Kodit Civil, thotë: "*Posë kur ka dispozitë të kundërtë, gjithë padinat reale ashtu dhe personale parashkruhen mbas tridhjetë vjetvet pa qënë i obliguem pretenduesi i parashkrimit me paraqit titull dhe pa mos muejt me ju kundrejtue këtij mungesa e mirëbesimit*" Më tej ligjëvuësi me *nenin 2035 të Kodit Civil* shton: "*E drejta e kreditorit me kërkue një shumë që përmban akt gjykimi, me të cilën është dënuar debitori i tij, parashkruhet në çdo rast qysh prej deklarimit të vendimit.*"

Për veç parashkrimit tridhjetë vjetuer, i cili është i përgjithëshmë, ligjevuësi ka caktuar dhe disa parashkrime të posaçme, si për shembëll parashkrimin vetësimtar dhjetëvjetuer *të nenit 2037 të Kodit Civil,* i cili ka aplikim vetëm për sendet e pa-lujtëshme ose të drejtat reale q'u përkasin kësilloj pronjavet; Parashkrimin njëvjetor *të nenit 2038 të Kodit Civil,* atë dyvjetor *të nenit 2039 të Kodit Civil,* atë trevjetor *të nenit 2040 po të këtij Kodi* e tjera.

§ 103. — Konsenkancat e parashkrimit.

Në sendet e pa-lujtëshme me t' u plotësuar parashkrimi vetësimtar ose uzukapioni, posesori bëhet zot. Por, në pamje të parë *neni 2034 i Kodit Civil* jep kuptimin se me parashkrimin tridhjetëvjetor, parashkruësi nuku bëhet zot pronjar, massi ay nen i jep parashkruësit një prapsim, por jo një padie revandikimi. Me gjithë këtë parashkrimi është një mënyrë për fitimin e zotërimit në çdo rast dhe kjo provohet:

1. *Neni 1067 i Kodit Civil* thotë se zotërimi mund të fitohet dhe me parashkrim, pa bërë as nonjë përjashtim.

2. *Neni 2009 i Kodit Civil* thotë me ekspresion të përgjithëshme: "*Parashkrimi është një mjet, me të cilin...*

një person fiton një të drejtë".

Sa për parashkrimin vetësimtar *të nenît 2037 të Kodit Civil*, nuku mundet të eksistojë as pak dyshim, massi ky me mënyrë formele thotë: *vetëson një send*, domethënë bëhet zot i sendit të poseduar.

Parashkrimi — thotë *neni 2009 i Kodit Civil* — libron nga obligimi, domethënë obligimi shuhet. Në obligimet parashkrimi vepëron si prapsim perimuës, domethënë si një mjet mprojtjeje që i përmeton debitorit t' a prapsojë padien dhe të mos paguajë.

Parashkrimi nuku vepëron vetiu, duhet të kundrështohet prej debitorit, i cili nuku librohet, përveç se kur e përdor si një mjet mprojtjeje. Thamë më sipër se parashkrimi është një institusion që i përket urdhërit publik, por me gjithë këtë gjyqtari nuku mund t' a marë *ex officio* parasysh (*neni 2012 i Kodit Civil*). Pra, gjyqtari edhe sikur të konstatojë se obligimi është i parashkruar, është i detyruar t' a dënojë debitorin, në qoftë se ay nuku e pretandon prapsimin e parashkrimit.

Parashkrimi mundet të pretandohet në çdo stancë të gjyqit, domethënë deri sa gjyqtari nuku i ka dhënë gjyqit fund. Pra, në qoftë se gjithë pretandimet e para të debitorit nuku u muar parasysh, mundet fë përdoret parashkrimi si armë e fundit, mjafton që mos jetë renoncuar prej debitorit.

Kur në padien e kreditorit kundrështohet prej debitorit parashkrimi, ky ka për efekt paralizimin e padies të kreditorit. Por, shuhet krejt e drejta e kreditorit, apo lé të eksistojë një obligim natural? Shumica e shkrimtarëvet thonë se e drejta nuku shuhet, pra, në rast që debitori vepëron pagimin e detës së tij, pagimi është i vlefshmë dhe nuku mund të kërkojë sendin e paguar me padien për pagim të pa-detyruem. Të tjerë refuzojnë t' a pranojnë këtë mejtim, tue thënë se, me t' u propozuar parashkrimi, obligi-

mi shuhet definitivisht dhe as një e drejtë nuku i mbetet më kreditorit.

§ 104. — Parashkrimi i prapsimevet.

Prapsimet janë të parashkruëshme ose të pa parashkruëshme? Doktrina mbi këtë çështje është e ndarë: Disa janë të mejti nit se parashkrimi ecën kontra të gjithëvet pa përjashtim dhe në çdo rast; Pra, simbas këtij mejtimi, dhe prapsimet janë të parashkruëshme, sikundër edhe padiet.

Të tjerë, parimisht, pranojnë se prapsimet janë të paparashkruëshme dhe justifikojnë këtë parim në këtë mënyrë: Ay që ka një prapsim nuku ka pushtetin t' a përdorë atë kur të dojë dhe kështu të evitojë rëzikun e humbjes të mjetevet provuëse të prapsimit të vetë, tue qënë se në këtë pikë mvaret nga ngrehja e padijes kontra tij. Pra, në qoftë se pushteti për të realizuarë një fakt me rugën e prapsimit do të parashkruhej, kjo do të ishte kontra së drejtës (équitée.) Nga kjo pikëpamje regulli i mos parashkrimit të prapësimevet është plotësisht i justifikuarë, por, ky regull nuku është absolut: duhet të çquajmë midis personavet që janë në të drejtat e tyre dhe për këta prapsimet janë të përherëshme dhe të pa-parashkruëshme dhe atyre që për t' i sanksjonuarë ato të drejta duhet të bëjnë padie, dhe për këta prapsimet janë të parashkruëshme. Këtë theori ndjek edhe jurisprudenca.

Një e drejtë e parashkruarë nuk mundet të rehalizohet as me anë prapsimi të kompesimit, as si shkak mbajtjeje *(jus retencionîs)* mundet të konsiderohet

PJESA E PESTË

KAPTINA A.

Sigurimi i të drejtavet.

§ 105. — Sigurimet.

Çdo e drejtë mundet të atakohet. Për mprojtjen e saj eksistojnë si në të drejtën civile, ashtu dhe në atë procedu-riale mjete të ndryshme sigurimi, të cilat quhen *"sigurime" (cautiones)* në kuptimin e gjërë të fjalës.

Kur themi sigurim duhet të kupëtojmë çdo mjet juri-dik të aftë për mprojtjen e një të drejte. Sigurime në kup-timin e ngushë të fjalës janë paktet që u shtohen konven-cionevet, me të cilat palët sigurojnë ekzekutimin të një obli-gimi të tanishmë ose të arthmë.

Sigurimet në kuptimin e ngushtë të fjalës çquhen në *sigurime vulnetare* dhe në *sigurime të nevojshme.*

1. Sigurime të nevojëshme janë ato që jepen, massi e urdhëron ligja, si, për shëmbëll, ajo e uzufruktuarit (*neni 852 i Kodit Civil*), ajo që detyrohet të japë tytori në kon-formitet me dispozitat e *nenit 348 të Kodit Civil*, ajo që jepet prej diktuësit simbas *nenit 222 të Procedurës Civile*, ajo që jepet në rast sekvestrimi konservatif (*neni 272 i Pro-cedurës Civile*) e tjera.

2. Sigurime vulnetare janë ato që rjedhin prej akti ju-ridik ose prej vepre të vulnetit të mbrame. Të tilla janë: *dorëzania, pengu, ipoteka.*

E Drejta mundet të sigurohet dhe me *sekuestron*, do-methënë me depozitimin e sendit të kontesteum në duart e një të treti të pa interesuem me hirin e palëvet ose me vendim të gjyqtarit (*nenet 1782, 1787 të Kodit Civil*).

Sigurimi ngrihet me renoncim, me çdukjen e shkakut,

për të cilën u dha ose me parashkrim.

Shteti nuku detyrohet të japë sigurim.

§ 106. — Sekuestrimi.

Sekuestrimi është një mjet për sigurimin e realizimit të obligimit të debitorit ndaj kreditori, massi e privon debitorin nga pushteti me e dispozue sendin e sekuestruem. Sekuestro kontra shtetit nuku përmetohet *(neni 53 i ligjës së përmbarimit.)*

Sekuestrimi është dy llojsh: sekuestrim konservatif dhe sekuestrim ekzekutif.

Këtu bëhet fjalë vetëm për sekuestrimin konservatif, i cili formon një masë sigurimi, sikundër rezulton dhe nga fakti se përmetohet revokimi i këtij sekvestrimi, në qoftë se jepet një garanci.

Mënyra dhe procedimi i këtij mjeti sigurimi regullohet prej Procedurës Civile (nenet 271 etjera të procedurës civile dhe 389 etjera të shtojcës së dytë të kësaj procedure).

Simbas dispozitavet të procedurës civile në fuqi, sekuestrimi konservatif vendoset prej gjykatës paqtuëse, prej gjyqtarit fillor ose prej gjykatës kolegjiale, simbas rastevet, për shkake të caktuara dhe në konformitet me dispozitat e ligjës.

§ 107. — Burgim për detë.

Midis mjetevet sigurimi është dhe burgimi, në rastin e caktuar prej *nenit 52 të Procedurës Civile*, ku thuhet: "Në qoftë se në seancën e parë nuku është e mundur të jepet vendimi dhe i padituni nuku ka banim, ky detyrohet të caktojë të tillë; Kjo shënohet në procesverbal. Ne qoftë se refuzon të caktojë të tillë dhe është i dyshimtë për hikje, me kërkimin e paditësit i kërkohet dorëzanës. Në qoftë se refuzon të japë dorëzanës *burgoset* dhe ditën e nesërme gjykohet çeshtja më parë se çdo tjetër".

Nga burgimi si masë sigurimi duhet të çquajmë burgimin për detë si masë ekzekutive.

§ 108. — Vumja e vulavet.

Vula (scellés) quhen fille peri ose letre të vëna prej një ofiqari mbi portën e një vëndi të mbyllur, ose në hapësirën e një mobille, dhe të fiksuara me qiri të vulosur me vulën zyrtare të ofiqarit, për të ndaluar humbjen ose çdukjen e sendevet të lujtëshme ose të aktevet të ndodhura në 'të ose të mbyllura në mobillën. Vumja e vulavet bëhet kryesisht me qëllim që të pregatitë veprimin e redaktimit të inventarit. Pra, vumja e vulavet bëhet vetëm mbi sende të lujtëshme për shkak të arësyëshme dhe mundet të kërkohet prej cilit do që mund të provojë ose dhe vetëm të sigurojë se ka një interesë të ligjëshme dhe ushtrohet simbas dispozitavet të Procedurës Civile (*nenet 323 — 341 të shtojcës së dytë të Procedurës Civile*). Simbas dispozitavet të *nenit 325 të kësaj shtojce*, vumja e vulavet mund të kërkohet prej Prokurorit të shtetit ose mbi deklarimin e Komiserit të Bashkisë ose të Kryetarit të Komunës të vëndit ose dhe kryesisht, në këto raste:

1. Në qoftë se bashkëshorti ose njëri prej trashëgimtarëvet nuku ndodhet në atë vënd;

2. Në qoftë se midis trashëgimtarëvet ka të mitur ose të ndaluar që nuku kanë tytor ose kujdestar;

3. Në qoftë se i vdekuri ka qënë depozitar publik. Depozitarë publikë janë gjith' ato persona, të cilat nga nëpunësia ose fonksioni që kanë patur në gjalljen e tyre kanë qënë depozitarë aktesh, të hollash, si notarët e tjerë.

Zakonisht vumja e vulavet bëhet pas vdekjes të një persone. Por, kjo mundet të ngjasë edhe tue qënë gjallë një personë, në këto raste:

a) Në rast ndalimi të vendosur ose dhe vetëm të kërkuar mbi një personë, për interesat e së cilës nuku kujdeset kurkush, prej tytorit me t' u emëruar ky.

b) Në rast që humbet një njeri dhe prezumohet absent dhe pasuria e tij mbetet e shkretë, prej palëvet të interesuara ose prej Prokurorit të Shtetit.

c) Në rast falimentoje, prej sindikëvet.

Vumja dhe heqja e vulavet bëhet prej gjyqtarit paqtuës *(nenët 323, 335 të Shtojcës II të Procedurës Civile.)*

Inventari. Inventar quhet akti që permban:

a) Numurimin përshkruës dhe çmuës të sendevet të lujtëshme që përbëjnë një pasuri (*trashëgimi, aktivi i një shoqërie ose î një tregëtari të falimentuar).*

b) Kujtimin dhe përshkrimin e shkurtër të letravet, të shënimevet dhe të shkresavet relative me gjendjen aktive ose pasive *(nenet 342—350 të Shtojcës II të Procedurës Civile).*

Inventari redaktohet gjithë monë mbi kërkimin e të interesuemvet, "*prej cilit do që ka të drejtë me lypë heqjen e vulavet,*" thotë *neni 342 i shtojcës naltpërmëndur,* dhe bëhet ose prej kryesekretarit të gjykatës paqtuëse ose prej një noteri të vëndit.

Inventar kanë të drejtë ose detyrohen të bëjnë:

1. *Pas çeljes të trashëgimit,* trashëgimtari që dëshëron të mundë t' a pranojë ose t' a refuzojë trashëgimin, tue dijtur në ç' gjendje ndodhet trashëgimi, ose t' a pranojë me benefic inventari *(nenî 681* i *Kodit Civil).*

2. *Bashkëshorti pasjetuës (nenet 540 dhe 851 të Kodit Civil).*

3. *Uzufruktuarî (neni 851 i Kodit Civil)*

4. *Tytori (neni 337 i Kodit Civil).*

5. *Kujdestari î trashëgimit vakant (neni 708 i Kodit Civil),* e tjerë.

Mënyrën e procedimit në inventarët e caktoo Shtojca e dytë e Procedurës Civile.

§ 109. — E drejta e mbajtjes.

(Jus retentionis)

Shumë herë eksistojnë raste, në të cilat kreditori që mban një send të debitorit, mund të refuzojë kthimin e sendit deri sa nuku paguhet, ndonse ay send nuku ju la për sigurimin e kredisë. Në këtë rast themi se kreditori

ka të drejtë mbajtjeje *(jus retentionis, droit de rétention)*.

E drejta e mbajtjes ndryshon nga kompensimi; E para ka për qëllim detyrimin e të zotit të sendit të bëjë prestimin që detyron, kur se kompensimi shuhan obligimin.

Në të drejtën e mbajties duhet:

1. Posedimi i sendit, përndryshe ushtrimi i së drejtës është i pa-mundur.

2. Sendi të jetë i aftë për t' u mbajtur *(res retinenda)*, i lujtëshmë ose i pa-lujtëshmë, dhe,

3. Shkaku i mbajtjes *(causa retinendi)* të jetë i ligjëshmë.

Deta duhet të jetë e atij vetë, kontra të cilit ushtrohet e drejta e mbajtjes, por në çdo rast duhet të jetë e kërkuëshme dhe jo me konditë ose me afat.

E drejta e mbajtjes ushtrohet, sikundër dhe ajo e kompensimit, me prapsim. Gjyqtari, kur pranon prapsimin, dënon të paditunin të ngëthejë sendin me konditë, domethënë *në qoftë se paditësi paguan.*

Konsekancat e së drejtës mbajtjes janë këto:

E drejta e mbajtjes është një refuzim i ligjëshmë për të ngëthyer sendin, pra ay që e ushtron vetëm mban sendin. Në qoftë se humbet posedimin e sendit, nuku ka as një mjet juridik që t' a marë prapë sendin. Nuku ka të drejtë t' a jetërsojë sendin, as no një privilegjë në reshtimin e kreditorëvet. Nuku ka të drejtën e përdorjes mbi sendin. Për sa u përket frutavet, e drejta e mbajtjes zgjatet dhe mbi 'to.

Massi ay që ushtron të drejtën e mbaitjes nuku ka të drejtë përdorjeje dhe jetërsimi të sendit, por vetëm një mbajtje të çveshur prej çdo të drejte tjetër (nuda detentio), nuku mund as t' a ndryshojë sendin, as t' a ipotekojë, as t' a pengojë.

Kur i zoti i sendit të mbajtur plotëson konditën, domethënë obligimin e vetë, mbajtësi detyrohet t' a ngëtheje sendin me gjithë shtimet *(cum omnî causa)*.

Ushtruësi i së drejtës mbajtjes duhet t' a mbajë sen-

din me kujdesinë e një ati familjeje të mirë.

Tregojmë disa ras'e, në të cilat e drejta e mbajtjes pranohet prej Kodit Civil:

Në të drejtën e akcedimit relativisht me sendet e lujtëshme dhe ato të pa lujtëshme (nenet 808, 825 të Kodit Civil). Në konferimin prej bashkëtrashëgimtarit të një pronje në naturë (neni 784 i Kodit Civil). Në shit-blemjen peshin (neni 1407 i Kodit Civil). Në riblemjen konvencionale shitësi nuku mund të marë në posedim pronën para se të mbushë gjithë obligimet e caktuara prej ligjës (neni 1460 i Kodit Civil). Në kontraton e depozitos, depozitari ka të drejtë të ndalë gjënë e depozuem.e deri sa depozuësi t' i paguajë plotësisht ç' ka i detyrohet për shkak të depozitos (neni 1781 i Kodit Civil). Kur debitori i detyron po atij kreditori një detë tjetër, e cila ka lé mbas kushtituimit të pengut dhe âsht bâ e kërkuëshme para pagimit të ma-parëshme, kreditori ka të drejtë me ndalë gjanë deri sa t' i paguhen plotësisht të dy kredinat (neni 1808 i Kodit Civil).

KAPTINA B.

§ 110. — Mprojtja e së drejtavet.

Ushtrimi i një së drejte përmban manifestimin real të pushtetit që ka një personë mbi një send të caktuar me vepra të ligjëshme.

Kur e drejta ndalohet në ushtrimin e saj të ligjëshme, është nevojë të ngrihet ndalimi, tue u mprojtur e drejta simbas ligjës. Kjo mprojtje mundet të bëhet ose me *mprojtjen* (*défense*) e të drejtës ose me rivendosjen e gjendjes reale në konformitet me të drejtën. Nga kjo rezulton se mprojtja e së drejtavet mundet të bëhet ose me fuqinë e vetë ose me anën e pushtetit gjyqësor.

Mprojtja me fuqinë të vetë eksiston, kur gjithë ajo

personë, së cilës i atakohet e drejta, me fuqin' e vet'ë mpron të drejtën e saj. Dhe, kur persona mpron të drejtën e vetë kundrejt një atakimi të tentuar *(tentative)*, eksiston *mprojtja*. Kur persona mpron të drejtën e vetë të atakuar me fuqin' e vetë, at' here themi se eksiston *vetëgjyqësi.*

Mprojtja e së drejtavet me fuqin' e vetë nuku është mjeti as më i saktë, as më i sigurtë, massi në këtë i damtuari bëhet dhe gjyqtar; Prandaj dhe shteti, tue pasur pushtet të vendosë me autoritet, tue qëndruar i pa-anëshmë ndaj palëvet dhe mbi 'to, është më kompetent që të mprojë të drejtën e atakuar tue vepëruar në këtë rast me veglat e tij të posaçme, të cilat janë gjykatat. Vetëgjyqësia paravështrohet prej Kodit Penal si faj edhe ndëshkohet.

Nga kjo mburon dhe kështu justifikohet mprojtja gjyqësore e së drejtavet, e cila ushtrohet prej gjykatavet, në të cilat drejtohet i damtuari, massi ato nuku gjykojnë *ex officio.* Mjetet e mprojtjes gjyqësore të së drejtavet i cakton procedura civile dhe prej tyre ato që kanë rëndësinë më të madhe janë: 1) *padia*, me të cilën fillon lufta gjyqësore, 2) *mprojtja kontra padies* domethënë përgjigja ose prapsimi, 3) *provat*, dhe 4) *vendimi.*

Këto veprime eksaminohen nga pikë-pamja e formës dhe nga ajo e lândës. Eksaminimi i formavet i përket procedurës civile, kur se ajo e landës i përket së drejtës civile.

KAPTINA C.

Mprojtja e së drejtavet me fuqinë e vetë.

§ 111. — Mprojtja dhe vet-gjyqësia.

Mprojtje quhet prapsimi me fuqimë e vetë të një atakimi të pa-drejtë të gadëshmë.

E drejta përmeton mprojtjen, e cila është një ndjenjë

e ndodhur brënda në naturën e njeriut që mos presë qetësisht t' i ngjasë atakimi dhe më pas të kërkojë mprojtjen me anën e rugës gjyqësore. Juristët romanë theshin se mprojtja mburon nga e drejta naturale.

Mprojtja paravështrohet prej paragrafever *2 dhe 3 të nenit 50 të Kodit Penal*, simbas të cilavet elementat e mprojtjes janë këto: 1) *violencë e atë-çasme dhe e pa-drejtë; 2) Mungesa e kohës dhe e mjetevet të tjera më të lehta për prapsimin e violencës; 3) Mbrojtja*, ose ndryshe *kontra-veprimi*, të jetë shkakëtuar nga nevoja me prapsë një violencë, e cila drejtohet kontra personës ose nderit, domethënë kontra jetës, kontra integritetit personal dhe kontra lirisë si edhe kontra nderit, si për shëmbëll në një tentative violence karnale; 4) *Mos kapërxim î kufinavet të caktueme prej ligjës, nevojës ose shtrëngimit*, dhe 5) *kontra-veprimi të bëhet para se të bëhet violenca dhe jo pas si të kalojë reziku.*

Gjith' ashtu, simbas *nenit 417 të Kodit Penal*, përmetohet mprojtja e pasunisë së vetë kontra auktorëvet të njërit nga fajet e parapame në *nenet 450, 451, 452, 454 të Kodit Penal* ose nga plaçkitja, dhe për me prapse auktorët e një ngjitjeje, thyemje.

Vetgjyqësi *quhet realizimi me fuqinë e vetë të së drejtavet veta.* Por, shoqëri e organizuar dhe vetëgjyqësi janë gjëra të pa-pajtuara, prandaj vetëgjyqësia ndalohet.

Simbas dispozitavet të *nenit 269 të Kodit Penal*, vetgjyqësi quhet marja e të drejtavet të veta tue përdor violencë mbi sende, me të vetëmin qëllim ushtrimin e një të drejte të pretendueme, *në rastet që mundesh me ju drejtue autoritetit.* Pra, ligja përmeton vetgjyqësinë në ato raste, në të cilat nuku është e mundur me ju drejtue autoritetit. Nuku bën vetëgjyqësi:

a) Pronjari, i cili pret rënjët ose degët e një druri të huaj, që zgjatet mbi pronjën e tij.

b) Ay që pret degët e një gardhi drurësh, që ndaloj-

në rugën.

c) Ay që vazhdon të eksersojë një të drejtë kullote, ndonse është e mvarur një padie, me të cilën kontestohet kjo e drejtë.

ç) Nuku bën vetëgjyqësi ay, i cili ka vepëruar nga nevoja që të mprojë posedimin e vetë mbi një send.

d) Gjith' ashtu nuku bën vetëgjyqësië ay, i cili përdor violencë për të larguar një atakim të pa drejtë kontra pasurisë së vetë (*vim vî repellere licet.*)

KAPTINA Ç.

Mprojtja gjyqësore.

§ 112. — Padia.

Thamë më sipër se të drejta quhen pushtetet që i janë njohur prej ligjës personës, pushtete të cilat i përmetojnë të bëjë vepra të caktuara. E drejta nevojërisht sypozon një forcë të përjashtme, dometënë fakultetin me ju drejtue autoritetit gjyqësor për t' u njohur prej tij e drejta e kontestuar ose për t' u imponuar respektimi i së drejtës të shkelur; Ky drejtim tek autoriteti gjyqësor quhet *padie.* Po të mos eksistonte padia, do të ndodheshim në gjendjen alternative ose të shohim të drejtat t' ona të shkelen prej të tjerëvet, ose të bëjmë vepra vetëgjyqësie, gjë kjo që është e pa-pajtuëshme me regjimin e një Shteti të policuar. Pra, idhea e së drejtës përmban nevojërisht atë të padies, bilé mundet të thuhet se padia është e drejta vetë, e cila mbetet pasive deri sa nuku kontestohet, por mé t' u shkelur bëhet aktive.

Konsekancat e këtyre që u thanë më sipër janë këto:

I. — Nuku eksiston e drejtë pa padie. Ligja, tue krijuar një të drejtë, nuku ka nevojë t' i shtojë shprehimisht dhe një padie, massi me t' eksistuar e drejta, një-kohësisht me ketë eksiston edhe padia. Ky regull ka tre për-

jashtime, në të cilat ligja njeh eksistencën e një obligimi të aftë që të sjellë efekte juridike, por nuku i ka akorduar padie. Këto raste janë:

1. Rasti i obligimit natural, debitori i të cilit nuku mund të kërkojë kthimin e atyrevet që vulnetarisht pagovi kundrejt detës së paraskkruar, ekzekutimin e të cilit obligim kreditori nuku mund t' a kërkojë me anën e gjykatës *(neni 1141 §2 i Kodit Civil).*

2. Obligimi i prindërvet për mirëvendosjen e fëmijës me martesë, tregëti ose me çdo titull tjetër është krejt moral — thotë *neni 201 i Kodit Civil* — dhe fëmija nuku kanë të drejtë padijeje kontra prindërvet për këto. Dhe,

3. Detat e rjedhura prej lojës ose jadecit paguhen vleftësisht, disponon *neni 1745 i Kodit Civil,* kur pagimi është bërë me hir, në rastin që nuku është përdorur as ndonjë mashtrim, por, thotë *nenî 1743 i Kodit Civil, "ligja nuku akordon të drejtë padieje për pagimin e një dete që rjeth nga loja ose jadeci."* Nga dispozita e *nenit 1743 të Kodit Civil* përjashtohen lojet që stervisin në përdorimin e armëvet, vrapat e çdo lloji dhe çdo tjetër lojë sportive vetëm për sa u përket jadecevet midis atyreve që marin pjesë në këtë lojë, thotë *neni 1744 i Kodit Civil.* Lotariet, shton *neni 1746 i Kodit Civil,* nuku japin të drejtë padieje veçse kur janë të autorizueme prej autoritetit administratif të vëndit.

II. — Në çdo të drejtë eksiston vetëm një padie. Kjo padie mundet të ushtrohet shumë herë, deri sa nuku i kundrështohet autoriteti i gjësë së gjykueme; Bilé mundet të eksersohet me shumë mënyra, si për shëmbëll: viktima e një delikti ose e një kontravencioni mundet të padistojë fajtorin ose para gjykatës penale ose dhe para gjykatës civile veçanërisht, por gjith' monë po ajo padie është. Në qoftë se shumë padie ngrehen po prej një persone, kjo do të thotë se në atë personë bashkohen shumë të drejta, si për shëmbëll: posesori i nxjerë prej pronjës që mban

ka të drejtë të zgjedhë midis padies posesore për t' u rivendosur në pronjën, massi çytet në posesionin e tij, padies revendikimit, massi cënohet në të drejtën e tij zotërimi, dhe padies për dëm shpërblime, massi është kreditor për shpërblimin e dëmit që ju shkakëtua padrejtësisht.

III. – Sikundër e drejta mundet të jetë personale ose reale e tjera, kështu dhe padia që formon pjesë të së drejtës mundet të jetë personale ose reale, e lujtëshme ose e pa lujtëshme, e transmetuëshme ose e pa transmetuëshme në trashëgimtarët, e ceduëshme ose e pa-ceduëshme, e pjesëtuëshme ose e pa pjesëtuëshme.

IV. — Numuri i padinavet është i pa-kufizuar: Sa të drejta krijohen me konvencione, aqe janë edhe padiet; Pra, konvencionet janë të lira dhe mundet të krijohen obligime me numur të pa-kufizuar, por me konditë që ato mos të vijnë në kundrështim me urdhërin publik dhe me zakonet e mira.

§ 113. — Pjesëtimi i padievet.

Padiet çquhen: simbas naturës të së drejtës të pretenduar në padie *reale, personale* dhe *mikste.* Simbas naturës të objektit të kërkuar në padie të *lujtëshme* dhe të *pa-lujtëshme;* Simbas formës, me të cilën bëhen në padie *kryesore, incidente,* dhe *kontra-padie.* Padiet cilësohen prej qëllimit tyre të vërtetë dhe jo prej emërit që kanë, massi ky mundet dhe mos të jetë ekzakt, prej qëllimit kryesor ose të paditësit dhe jo prej kërkimevet aksesore të tij.

Padie reale quhet ajo, në të cilën paditësi invokon një të drejtë reale. Padia reale mundet të ngrehet kontra çdo mbajtësi të sendit që është objekt i padies. Pra, janë padie reale gjith' ato padie, me të cilat paditësi invokon si të drejtë kryesore një të drejtë reale. Këto janë: Padia e revandikimit, që drejtohet kontra çdo të treti mbajtës të sendit, në bazë të së drejtës zotërimit të paditësit; Padia

që rjeth prej trashëgimit, me të cilën trashëgimtari paditës kërkon të vleftësojë të drejtën e tij trashëgimi dhe zotërimi mbi një ose shumë sende të mvarura nga një trashëgim që i erdhi; Padia që rjeth prej servitudi *(actio confessoria)*, me të cilën paditësi invokon kontra një mbajtësi të tretë një të drejtë uzufrukti, përdorjeje, bujtjeje, ose tjetër servitudi; Padia negative *(actio negatoria)*, me të cilën paditësi pretandon se sendi i tij nuk u është i rënduar me as një të drejtë uzufrukti, përdorjeje, bujtjeje ose servitudi tjetër dhe vërteton se e drejta zotërimi i tij është e plotë;, Padia ipotekore, me të cilën kreditori ipotekor kërkon të vleftësojë kontra një mbajtësi të tretë të drejtën e privilegjit tij të pa-lujtëshme ose ipotekor; Padiet për posesion, me të cilat posesori kërkon të mbahet në posedim ose të vendoset rishtas në posedimin që ka humbur; Padiet për çartje, nulitet ose revokim të një të drejte reale, kur ato drejtohen kontra një mbajtësi të tretë. Gjith' ashtu reale është dhe padia për pjesëtim.

Fakti se paditësi bashkon me padien kryesore kërkime aksesore për prestime personale — si kthimin e frutavet ose reparimin e dëmevet të bëra mbi sendin prej posesorit — këto nuku ja humbasin padies karakterin e saj real.

Padie personale janë gjith' ato, në të cilat paditësi pretendohet kreditor dhe nuku invokon të drejtë tjetër përveç kreancës, cilido qoftë mburimi i asaj kreance; Shëmbëlla padinash personale: Padia që rjeth prej një obligimi *me bâ* ose *mos me bâ* është personale; Padiet që rjedhin prej veprimevet të pa ligjëshme dhe obligimet që rezultojnë nga autoriteti i ligjës janë gjith' ashtu personale. Janë gjith' ashtu personale dhe padiet për nulitet, çartje, zgjidhje ose revokim të një obligimi, massi në këto paditësi nuku invokon nonjë të drejtë reale, por vetëm pretandon se i padituni do të begatonte mbi kuris të t' obliguemit, dyke mbetur kreditor i një obligimi që është pa shkak (qëllim) juridik, të kushtituuar me një akt nul ose të mvarur nga një

kondítë zgjidhëse të pa realizuar, pra, duhet t' i shtrohet anullimit, çartjes, zgjidhjes ose revokimit të së drejtës së tij. Gjith' ashtu janë personale padia për begatim pa shkak, për pagim të pa-detyruem ose për shkak të pa-ligjëshmë.

Padie Mikste quhet ajo, me të cilën kërkohet një objekt në bazë të dy të drejtavet të bashkuara, një të drejte personale dhe një të drejte reale. Për shëmbëll: blerësi i një sendi të paluitëshme ka dy padie, njërën personale me kalitetin e tij si kreditor, dhe tjetrën reale, në bazë të së drejtës reale që ka me t' u lidhur kontrata dhe e cila u kushtituua me akordin e palëvet.

Padiet që i përkasin gjendjes personavet nuku janë as personale, as reale, ca më tepër nuku janë mikste, por korespondojnë n' ato, që romanët i quanin *"actîones praejudiciales"*.

Padie të lujtëshme. Për të dijtur cilat janë padiet e lujtëshme, duhet të referohemi në *nenet 784 — 787 të Kodit Civil,* në të cilët numurohen sendet e lujtëshme; Pra, padie e lujtëshme quhet ajo, që ka për objekt një send të lujtëshme prej atyrevet që numurohen në ato nene. Padia për pagimin e një sume të hollash, nuku mund të jetë e pa lujtëshme, qoftë dhe kur ka për objekt sumën e një kreance të garantuar me ipotekë.

Padie të pa-lujtëshme. Nenet 775—782 të Kodit Civil na tregojnë cilat janë sendet e pa lujtëshme dhe njëkohësisht dhe padiet e pa-lujtëshme. Uzufrukti i një pronje të pa-lujtëshme është një e drejtë reale, massi bazohet në një send të pa-lujtëshme, pra dhe padia që rjeth prej kësaj të drejte është e pa-lujtëshme. Gjith' ashtu e pa-lujtëshme është dhe padia ipotekore, massi ipoteka është një e drejtë e pa-lujtëshme, si e bazuar në një send të pa-lujtëshme, ndonse ipoteka ka për qëllim garantimin e pagimit të një kreance, e cila zakonisht është një e drejtë e lujtëshme,

§ 114. — Bashkim padinash.

Shpesh herë paditësi takon që të ketë më shumë se një padie, domethënë takon që nga një fakt juridik të lindin ose shumë të drejta dhe për secilën prej tyre eksiston një padie, ose lind vetëm një e drejtë, për realizimin ose mprojtjen e së cilës janë hapur shumë padie.

Bashkim padinash quhet bashkimi i shumë padinavet po të një paditësi kontra po atij të padituni me qëllim bashkëgjykimin *(cumulatio actionum)*. Bashkimi i padinavet duhet të bëhet po në një akt gjyqësor, padiet mos përjashtojnë dhe mos të vijnë në kontradiksjon njëra me tjetrën dhe gjykata të jetë kompetente. Bashkimi i shumë padinauet po në një akt gjyqësor prezantohet me shumë mënyra: a) Po ay paditës kërkon gjith nga ay i paditun sende të ndryshme, tue bazuar se cilin prej këtyre kërkimevet mbi bazë të ndryshme, për shëmbëll kërkon kthimin e huas dhe të depozitos. (*Neni 483 i Sh. II i Pr. Civile*). b) Gjith' ay i paditun kërkon po prej atij të padituni gjith' atë send, tue buzuar këtë kërkimin e tij në baza të ndryshme, për shëmbëll kërkon dorëzimin e shtëpisë më nj' anë si trashëgimtar i të zot dhe më anën tjetër si blerës tue mos dijtur se kishte trashëguar zotërimin e saj, ose më njërën anë në bazë të porosisë dhe m' anën tjetër në bazë të gjerimit punëvet. c) Gjith' ay paditës kërkon po prej atij të padituni sende të ndryshme, tue bazuar secilin prej kërkimevet të tij po mbi atë bazë, si, për shëmbëll, madhori ngreh padie kontra tytorit tij dhe kërkon më nj' anë dhënien e llogarivet dhe më anën tjetër kthimin e një sendi të caktuar në bazë të gjerimit të pasurisë të bërë prej tytorit, ose dhënien e llogarivet për gjerimin prej tytorit të një pjese të pasurisë dhe m' anën tjetër kthimin e të mbeturës. Mundet që të një padie të bashkohet edhe padia e saj prejudiciale, për shëmbëll me padien për yshqim bashkohet ajo e njojtjes të bijësisë, por në këtë rast hetimi dhe gjykimi i padies prejudiciale duhet t' i precedojë padies

për hyshqim.

Bashkimin e padinavet duhet t' a çquajmë nga *konkurimi i padinavet* (*concursus actionum*), simbas të cilës paditësi po për një send ka shumë padie, por ushtrimi i njërës prej tyre përjashton ushtrimin e tjetrës, si për shëmbëll: depozuesi për kthimin e sendit të depozuem ka kontra depozitarit dy padie, padien për revandikim dhe atë të depozitos, por në rastin që përdor njërën humbet tjetrën.

§ 115. — Konsekancat e ngrehjes të padies.

Veprimi i parë dhe kryesor i gjyqit është *padia*, e cila redaktohet me shkresë. Si veprim atakuës duhet të përmbajë: 1) *arësye ligjore* domethënë një dispozitë ligjore, në të cilën bazohet padia 2) *Shkakun historjk* domethënë ekspozimin e qartë të gjithë ngjarjevet që, si mbas ligjës, janë parasypozimi i nevojëshmë i së drejtës të kërkueme; Mirë është që këto ngjarje të prezantohen dhe të formullohen nënë një formë juridike, dhë më në fund 3) Padia duhet të përmbajë *kërkim*.

Lufta gjyqësore ka shumë konsekanca mbi të drejtat. Por, kur fillon padia dhe cilat janë konsekancat e fillimit të saj? Padia konsiderohet se fillon qysh prej datës që ajo regjistrohet në sekretarinë e giykatës dhe konsekancat e fillimit saj janë:

a) Ndërpremja e parashkrimit, massi me padien pronjari zot ose kreditori tregojnë qëllimin të eksersojnë të drejtat e tyre. Në qoftë se padia është *nul*, nuku ka për efekt ndërpremjen e parashkrimit, por, sikundër u tha dhe më sipër, padia e ngrehur qoftë dhe përpara një gjykate inkompetente *rationae personae* ose *rationae materiae*, e ndërpret parashkrimin.

b) Objekti i padies hyn në grindje, bëhet litizhios, tue u ndaluar çdo veprë e re ose ndryshim mbi atë send, domethënë ndalohet çdo veprim material mbi sendin, i cili ndryshon përdorimin ose substancën e sendit.

c) Fillojnë të ecin kamatat moratore, massi komunikj-

mi i padies ze vëndin e një sonasioni dhe ve debitorin në morë. Simbas dispozitavet të nenit *1767 të Kodit Civil*, caka e kamatës ligjore është *tetë për qind* në vit në çështje civile dhe *nëntë për qind* në çështje tregëtare dhe ka vënd në ato raste, në të cilat detyrohet kamatë dhe mungon një konvencion që cakton masën e saj. Kamata konvencionale mund të paktohet deri në *dymbëdhjetë* për qind në vit në çështje civile dhe *pesëmbëdhjetë* për qind në çështje tregëtare.

Naturisht, që të ecin kamatat moratore duhet që me vendimin e gjykatës të njihet në favor të paditësit eksistenca e një kreance, në rast të kundërtë kamata moratore nuku mundet të ecin.

Kërkimi i kapitalit ka si konsekancë dhe kërkimin e kamatavet moratore dhe gjykata mundet t' i akordojë — dhe në rastin që nuku janë të kërkuara me padien — pa që të cënohet nga kjo parimi procedurial *"judex ne eat ultra petita partium,"* simbas të cilit gjyqtari nuku duhet të vejë tej kërkimevet të palëvet.

KAPTINA D.

§ 116. — Prapsimet.

I padituni mprohet ose dyke mohuar bazën historike të padies, domethënë eksistencën e ngjarjevet në të cilat bazohet padia ose të bazës ligjore të saj, ose dyke kundrështuar incidente të rea që janë të huaja me bazën e padies, me të cilat ka për qëllim të shpëtojë tërësisht ose pjesërisht nga e drejta e kërkuem prej paditësit. Pra, prapsim quhet vepra që kundrështohet kontra padies; Ky ka bazë të vetë sikundër edhe padia dhe shkakëton humbjen përkohësisht ose gjithëmonë të së drejtës të paditësit ose dhe vetëm pezullon përgjigjen në padie.

Regullavet, simbas të cilavet regjohen prapsimet, janë

këto:

1. Çdo prapsim si vepër atakimi duhet të ketë elementat e padies, pra duhet të përmbajë arësye ligjore, shkak historik dhe kërkim (*Reus in excipiendo fit actor*). I padituni, pra, duhet të provojë, në qoftë se i mohohet, bazën historike të prapsimit të tij.

2. Prapsimet janë independente nga përgjigja dhe, kur kjo është ometuar, nuku e plotësojnë, për shëmbëll: i padituni kundrështon tue thënë: *pagova* ose *m' u fal deta*, pa pohuar ose mohuar padien; kjo nuku do të thotë se pohon tërthorazi padien.

3. I padituni, tue qënë i lirë të regullojë mënyrën e mprojtjes së tij me çdo mjet, mundet të bëjë dhe prapsime kontradiktoare, domethënë mundet të bëjë prapsime që vijnë të kontrathënie midis tyre ose me padien, si për shëmbëll: i padituni thotë "u hojta, por pagova, por posë kësaj m' a fale detën" ose "nuku të kam nonjë hua, por dhe sikur të të kem marë nonjë hua, t' a pagova".

4. Prapsime të rjedhura prej së drejtës të një të treti nuku janë të pranueshmë (*exceptiones ex jure tertii non admituntur*), massi prapsimi, si një e drejtë që ka i padituni, duhet të jetë e tija, domethënë dhe për prapsimet duhet të eksistojë legjitimasioni. Nga ky parim përjashtohen dorëzânësit, të cilët, simas *nenit 1860 të Kodit Civil* mundet t' i kundrështrojnë kreditorit gjithë prapsimet që i takojnë debitorit kryesor dhe që janë të lidhura me detën, por nuku munden të kundrështojnë prapsimet që janë fjeshtë personale të debitorit. Gjith' ashtu munden të kundrështojnë prapsimet dhe suksesorët me titull universal ose partikolar.

5. Sikundër paditësi padien, kështu edhe i padituni prapsimet duhet t' i provojë (*Reus in excipiendo fit actor*).

Prapsimet janë ose pezulluëse ose perimuëse.

Prapsime *pezulluëse* quhen ato, që pezullojnë gjykimin e themelit të padies, tue çkarkuar të paditunin nga detyra që t' i gjegjet padies. Kësilloji prapsime janë: prapsimi kompetencës *ratione materiae* dhe *ratione persone*. Prej

këtyrevet prapsimi *ratione personae (kompetenca lokale)* duhet të bëhet që në audiencën e parë, ndryshe është e pa-pranueshme, kurse ajo *ratione materiae (kompetenca lândore)* mundet të bëhet në çdo gjendje të gjyqit. *(Prapsimi i litispendës*, i cili, po të pranohet, ka si konsekancë dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente dhe refuzimin e padies; Litispendencë eksiston kur po ajo grindje ndodhet e mvarur në dy gjykata të ndryshme. Prapsimi për garanci, të cilën detyrohen t' a japin shtetasit e huaj: Shqiptari që paditet prej një të huaji ka të drejtë të kërkojë prej këtij garanci dhe deri sa ajo nuku jepet, mundet mos t' i përgjigjet padies (Nenet 94 dhe 98 Sht. II. Pr. Civ). Prapsimi i mos-komunikimit të aktevet gjyqësore; Se i cili nga ndërgjyqësit ka të drejtë të marë dije të aktevet, që i kundrështohen rë gjyq; Pra, deri sa t' i komunikohen ato, ka të drejtë të kërkojë pezullimin e bisedimit të çështjes. Prapsimi i pranimit të trashëgimit me benefic inventari; Trashëgimtarët kanë një afat prej tré muajsh qysh prej datës çeljes të trashëgimit ose prej asaj që marin dijeni se u ka erdhur trashëgimi që të redaktojnë inventarin dhe më pas të deklarojnë në se e pranojnë ose jo trashëgimin; Para se të kalojë ky afat mundet të prapsin çdo padie për sendet e trashëgimit me prapsimin e pranimit të trashëgimit me benefic inventari, me të cilin shtyet gjykimi i çështjes. Prapsimi i beneficit të ndarjes, të eskutimit dhe të mos skadimit të obligimit; Në qoftë se prej shumë dorëzanës të një dete paditet njëri për pagimin e sumës së tërë, në rastin që ky ka rezervuar të drejtën e ndarjes, mund t' a kundrështojë padien me prapsimin e ndarjes. Beneficin e eskutimit e ka dorëzanësi i padistuar prej kreditorit, massi dorëzânësi nuk është i detyruar ndaj kreditori që t' a paguajë, përveç se kur nuku paguan debitori kryesor. Gjith' ashtu prapsen gjithë padiet për kreanca të pa-skadueme me prapsimin pezulluës të mos skadimit.

Prapsime perîmuëse janë: Parashkrimi, paqësimi, kom-

pensimi dhe gjëja e gjykueme. Kompesimi ka vënd — thotë *neni 1292 i Kodit Civil* — cilat do qofshin shkaket e njërës ose të tjetrës detë, posë rastevet të poshtëshënuem:

1 — Kur kërkohet kthimi i një gjëje që i është marë pa-drejtësisht zotënuësit.

2. — Kur kërkohet kthimi i një sendi të lanë depozito ose të dhënë me huapërdorje.

3. — Kur kredia është deklaruar e pa-sekuestruëshme.

4. — Ku debitori ka renoncue që mâ parë kompensimin.

Prapsimet e parashkrimit, të paqësimit, të kompensimit dhe të gjësë së gjykueme, kur pranohen prej gjyqtarit, shkakëtojnë rëzimin e padies.

§ 117. — Kontrapadia.

Kontrapadie quhet padia incidente e bërë prej të paditunit në gjykatën, ku giykohet padia kryesore e paditësit. Me një fjalë kontrapadia nuku është vetëm mjet mprojtjeje për të paditunin por edhe atakimi, massi me këtë i padituni kërkon jo vetëm rëzimin e padies të paditësit, por dhe dënimin e këtij të fundit që t' i bëjë prestimin që i detyron ose formon kërkime kontra tij. Për shëmbëll: **A** padit **B** dhe i kërkon eksekutimin e një shitjeje; **B** kërkon jo vetëm mos pranimin e këtij kërkimi, por edhe çartjen e konvencionit të shitjes.

Kontrapadia duhet të ketë elementat e padies, domethënë *bazë historike, bazë ligjore* dhe *kërkim*, duhet të bëhet që në audiencën e parë dhe gjykohet së bashku me padien kryesore. *"Kontrapadie kontra kontrapadies nuk është e pranueshme" (reconventio reconventionis non datur)*, massi paditësi detyrohej që t' i bashkonte që në krye gjithë kërkimet e tij së bashku në padien kryesore, përndryshe do të shkakëtohej koklavitja dhe motimi i gjyqevet.

KAPTINA E.

§ 118. — Provimi.

Vendimi i gjyqtarit për kontestimin e vënë nënë gjykimin e tij mvaret nga vërtetësia e faktevet të invokuara prej ndërgjyqësvet, fakte mbi të cilat këta bazojnë të drejtat e tyre. Çdo giyq përbëhet prej elementash juridike dhe reale. Ligjën që duhet t' aplikojë, detyrohet t' a dijë vetë gjyqtari, por për konstatimin e pretendimevet reale të ndërgjyqësvet që kontestohen çmon faktet që i parashtrohen prej tyre, *"facta probantur, jus novit curia"* thotë adazhi roman. Pra, tërësia e vepravet që bëjnë ndërgjyqësit për të konstatuar elementat reale të çështjes dhe për formimin e konviksionit në gjyqtari, quhet *provim.*

Gjyqtari bindet për vërtetësinë e faktit që duhet provuar ose me provimin e faktit ose me provimin e një fakti tjetër, nga i cili rezulton llogjikisht konsekanca dhe për eksistencën dhe të 'tij *(prezumimet).*

Neni 100 i Shtojcës së dytë të Procedurës Civile thotë: *"ndërgjyqësi që pretandon një fakt, duhet t' a provojë."* Nga ky regull rezultojnë këto:

I. — Duhet të provohen faktet reale të kontestuara dhe që kanë influencë me rëndësi në çështjen dhe për eksistencën e të cilavet gjyqtari si i tillë nuku është bindur. Pra, duhen provuar:

a) Faktet reale me rëndësi dhe jo kanunet e së drejtës, të cilët gjyqtari duhet t' i dijë, *"facta probantur, jus novit curia."* Eksepsionalisht eksistojnë ligja, të cilat gjyqtari nuku i dij, për këto mundet të vendosë provim. Të tilla ligja janë ligjat e shtetevet të huaja dhe zakonet *(neni 102 i Shtojcës së dytë të Procedurës civile).*

b) Faktet e kontestuara, për të cilat gjyqtari nuku është bindur édhe si i tillë. Pra, nuku kanë nevojë provimi faktet e pohuara, ngjarjet botënisht të dijtura, si lufta e përbotëshme, dhe faktet që kanë hyrë në njoftuniën e gjyka-

tës. Konsiderohen se kanë hyrë në njoftuniën e gjykatës ato fakte vetëm, të cilat, massi kanë hyrë në njoftuniën e gjyqtarit me mënyrën e duhur, janë të vërteta kontra të gjithëvet, për shëmbëll kur gjykata në tjetër gjykim ka deklaruar një personë të ndaluar ose e ka vënë nënë tytori; Pra, nuku duhet të konsiderohen si të hyra në njoftuniën e gjykatës ato fakte, të cilat gjyqtari i dij si privat ose të bazohet në konviksionin që pati formuar që më parë nga një çështje tjetër, fjala bije për një zakon.

Gjith' ashtu nuku kanë nevojë provimi ngjarjet, që konsiderohen prej ligjavet se janë kështu ose ashtu; Kësilloj ngjarje janë prezumimet e caktuara prej ligjës, për shëmbëll: "*Buri është ati i fëmijës të zânun në kohën e vazhdimit të martesës*" thotë *neni 225 i Kodit Civil.*

II. — Bara e provimit të faktit i takon atij ndërgjyqësi që e pretandon (*necessitas probandi incubit illi, qui agit*). Nga kjo rezulton se paditësi duhet të provojë pretendimet, në të cilal bazon padien e tij, dhe i padituni pretendimet, në të cilat bazohen prapsimet që bën.

Kur nuku provohet fakti, në të cilin bazohet padia ose prapsimi, at' here këto rezohen. Kjo, nuku do të thotë se ajo palë që nuku mundi të provojë nuku ka të drejtë por se vetëm i munguan mjetet provuëse (*non deficit jus, sed probatio*).

KAPTINA Ë.

§ 119. — Vendimi.

Veprimi kryesor i gjykatës vërtitet reth zgjidhjes të kontestimit; Vepra që e sjell në këtë rezultat quhet *vendim.* Me vendimin i jepet fund gjyqit. Vendimi i gjykatës nuku krijon të drejtë, por vetëm e deklaron atë.

Nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre, vendimet çquhen në definitive, në pregatitëse, në të përkohëshme dhe

në paragjykimore.

1. *Definitîf* quhet vendimi, i cili i jep fund gjyqit dhe e çvesh gjyqtarin prej çdo pushteti të mâ-pasme, është vendimi i fundit mbi çështjen.

2. *Pregatitës* quhet vendimi, me të cilin gjykata tue mos cënuar themelin urdhëron një masë, e cila lehtëson rjedhjen e gjyqit dhe pregatit vendimin definitif, si për shëmbëll, vendimi që emërohen ekspertat, shtyhet gjyqi për paraqitjen e një dokumenti.

3. *I përkohëshmë* është vendimi, i cili urdhëron një masë relative me gjyqin, masë e cila duhet të meret para vendimit definitif; Për shëmbëll: Vendimi për sekuestro gjyqësore, vendimi që i cakton hyshqim gruas në një padie për veçim personal.

4. *Paragjykimor* është vendimi, i cili urdhëron një masë për lehtësimin e gjykimit, me të cilën pregatitet zgjidhja e çështjes dhe njëkohësisht nënëtregohet vendimi definitif; Për shëmbëll: Paditet **B** për gagimin e një dete shoqërie; Në rast që paditësi provon se **B** është anëtar i asaj shoqërie dhe deklarohet si i tillë prej gjyqit, nënëkuptohet dhe vendimi definitif, me të cilin **B** do të detyrohet të paguajë.

Vendimet mund të jepen çfaqësisht, mungimisht, të premë, në këshillë.

Vendim çfaqësisht quhet ay, i cili jepet prej gjykatës në prezencën e të dy palëvet, të cilat marin pjesë në gjykimin dhe paraqitin justifikimet e tyre.

Vendim mungimisht është ay, i cili jepet në prezencën vetëm të njërës palë.

Vendim i premë quhet ay, që nuku është i diktuëshmë.

Vendime në këshillë quhen ato, të cilat meren prej gjykatës mbi kërkesa që nuku kanë elementat e padies dhe të cilat në rastet më të shumëta referohen në çështjet e *jurisdiksionit vulnetar (jurisdictio volumtaria)* si është, për

shëmbëll, një vendim për korigjim moshe, akt njoftunitë.

Jurisdiksjon vulnetar quhet pushteti që ka autoriteti gjyqësor me urdhënue masa konservative dhe me vërtetue akte juridike të caktuara për ndalimin e kontestimevet eventuale. Jurisdiksjoni vulnetar ushtrohet midis personavet që dëshërojnë *(inter volentes)*, massi në këtë personat i drejtohen pushtetit gjyqësor jo që të kërkojnë mprojtje, por për sigurim; Kështu, pra, mvaret nga vulneti i tyre që të çfaqen ose jo përpara gjykatës të mveshur me jurisdiksjonin vulnetar, e cila hetimin e çështjes e bën jo në bazë të regullavet të Procedurës Civile. por e formon konviksjonin e vetë simbas rastit. Krejt e kundërta ngjet në *jurisdiksjonin kontencîos,* i cili ushtrohet prej gjykatavet midis personavet që janë të detyruara të kërkojnë ndihmën e gjyqit për zgjidhjen e kontestimit që eksiston midis tyre (*inter invitos et litîgantes).* Në çështjet e jurisdiksjonit kontencios gjykata detyrohet t' a hetojë çështjen dhe të vendosë jo simbas informatavet dhe njoftuniës që ka, por dyke ruajtur forma proceduriale të caktuara, dyke marrë para sysh faktet e pretenduara prej të dy palëvet ndërgjyqëse dhe deri sa ato ligjërisht u provuan (*secundum allegata et probata*).

Jurisdiksjoni vulnetar çquhet: a) në jurisdiksjon vulnetar të thjeshtë, me të cilin persona ka për qëllim të bëjë ç' do veprim juridik me anën e autoritetit publik, si për shëmbëll: veprime noteriale, veprime të gjendjes civile, inskriptim inpoteke, transkriptim e tjera; Dhe b) në jurisdiksjon vulnetar mikstë, në të cilin nuku bëhen veprime juridike prej autoritet publik, por prej atyrevet që kanë interes t' i bëjnë, dhe autoriteti gjyqësor i mvesh me sanksjonin e tij gjyqësor që kështu të jenë të fuqishme dhe të mundin të sjellin efekte ligjore. Veprime të jurisdiksjonit vulnetar mikstë janë: adoptimi, emancipimi, emërimi i tytorit dhe i kujdestarit, jetësimi i pronjavet të jetimëvet të mitur ose të atyrevet që nuku gëzojnë të drejtën e ushtrimit të së drejtavet

të tyre.

Veprimet e jurisdiksjonit vulnetar të thjeshtë ndryshojnë nga ato të jurisdiksjonit vulnetar mikstë, për shkak se të parat mbajnë karakterin e tyre të jurisdiksjonit vulnetar gjithëmonë të pa ndryshuar, kurse ato të jurisdiksjonit vulnetar mikstë mundet të çvishen nga ay karakter dhe të ndryshohen në veprime të jurisdiksjonit kontencios, në rastin që ndërhyn një i tretë, i cili konteston vleftësinë e veprimit të bërë (*jurisdictîo voluntaria transit in contentîosam interventi justi adversarii*). Për shëmbëll: Massi u prezantua fëmija e adoptuem, prindrit e tij natyralë dhe adoptuësi dhe si u bënë deklarimet e adoptimit, gjykata e shkallës së parë homologon adoptimin. Por, massi të vdesë adoptuësi, trashëgimtarët ab intestato të tjerë, dyke parë se pasuria e *dé cujus*-it po i vjen fëmijës të adoptuem, atakojnë vleftësinë e adoptimit, për shkak se nuku provohet konsantëmani i prindit ose për shkak se mungon diferenca e moshës që lyp ligja. Në këtë rast jurisdiksjoni vulnetar ndryshohet në jurisdiksjon kontencios.

Vendimi *dënon* ose *lîbron, shpëton* (*sentatia condemnatoria, sententia absolutoria*).

Vendimet janë të ndryshme simbas kërkesë padievet, por padia dhe vendimi kanë po atë objekt që të dyja. Gjith' ashtu dënon të pa-ditunin me atë që kërkohet me padien, tue mos mundur të kapërxejë kufitë e kërkesë-padies (*judex ne eat ultra petita partium*).

Në padiet që kanë për objekt njojtjen e një të drejte, gjykata deklaron vetëm eksistencën e së drejtës, për shëmbëll cilësinë e një persone si trashëgimtar.

Në padiet personale dënon të paditunin *me dhanë, me bâ, me prestue, (dare, facere, praestare)*. Në padiet reale, në ato të posedimit dhe në obligimet mos me bâ, gjykata vendos mos përsëritjen e veprës, që shkakëtovi kontestimin. Në padiet reale gjyqtari deklaron eksistencën e së drejtës dhe urdhëron rivendosjen e saj.

Vendimet libruëse përmbajnë një zgjidhje negative të kon-

testimit, domethënë deklarojnë padien e paditësit të pa-themeltë dhe librojnë, shpëtonjë të paditunin; Por, duhet shënuar se kjo u referohet vendimevet që gjykojnë themelin, massi, kur padia rëzohet nga shkaku i një prapsimi pezulluës ose anullatif, padia mundet të përsëritet prapë.

§ 120. — Gjëja e gjykueme.

Ekspresioni *"gjë e gjykueme"* tregon atë gjë, që është vendosur me vendim gjykate. Autoriteti i gjësë së gjykueme konsiston në këtë: se nuku mundet të rigjykohet një çështje, mbi të cilën është dhënë një herë një vendim. Simbas ligjavet në vepërim gjëja e gjykueme formon një prezumim *"juris et de jure"* se vendimi i gjykatës është e vërteta, *"res judicata pro veritate habetur"*.

Fuqia e gjësë së gjykueme kryesisht bazohet në interesin e shoqërisë, të urdhërit publik që mos motohen gjyqët, prandaj dhe ligjëvuësi e konsideron gjënë e gjykueme si të vërtetë. Naturisht gjyqtari mundet dhe të gabohet; Por, massi dhe një vendim i dytë mundet të jetë i gabuar, është më e preferuëshmë që vendimi i parë — në qoflë se është dhënë me gjithë garancitë e lypuna prej ligjës — t'i japë definitivisht fund kontestimit. Posë kësaj, po të përmetohej drejtimi tek gjyqtari shumë herë po për një send, do të ndodheshim përpara eventualitetit të dalin vendime në kundrështim njëra me tjetrën, gjë e cila do të damtonte rëndë prestigjin e autoritetit gjyqësor dhe të urdhrit publik. Fuqinë e gjësë së gjykueme e ka vetëm pjesa urdhënuëse e vëndimit.

Simbas dispozitavet *të nenit 239 të Shtojcës së dytë të Procedurës Civile, "fuqia e gjësë së gjykueme ka vënd vetëm për çka formue objektîn e gjykimit. Duhet që gjëja e kërkueme të jetë po ajo; Që kërkesa të bazohet mbî atë shkak; Që kërkesa të jetë midis atyre palëvet dhe të ngrehet prej tyre dhe kontra tyre po me atë cilësi"*. Pra, elementat e gjësë së gjykueme janë këto:

1. *Identitet në personat*. Çdo gjyq rjeth midis personash të caktuara, të cilat janë ndërgjyqësit. Nga vendimi i dhënë prej gjykatës në favor të njërës palë kontra tjetrës,

nuku mundet as të përfitojnë, as të damtohen të tretët, pra, sikundër edhe kontratat, gjëja e gjykueme është relative. Nga sa u thanë më sipër, kupëtohet se prapsimi i gjësë së gjykueme, me të cilën personat imponojnë respektin e fuqisë të gjësë së gjykueme, nuku mund të përdoret përveç se prej personavet që kanë qënë ndërgjyqës ose janë suksesorë të palëvet. Kur suksesori është partikolar, prapsimi i gjësë së gjykueme mundet të propozohet vetëm kur gjëja e gjykueme është mâ e vjetër nga data, në të cilën u transferue mbi 'të e drejta që e bëri suksesor partikolar. Efekti ralatif i gjësë së gjykueme eksprimohet me këtë formullë latine: "*res inter alîos judicata, alîis non nocet, nec podest*", domethënë gjëja e gjykueme midis të tjërëvet, as dëm, as dobi ju sjell të tjerëvet. Pra, kondita e parë që lypet për t' u bërë prapsimi i gjësë së gjykueme është identiteti i palëvet.

2. *Identitet në objekt.* Nuku mjafton mprojtja e së drejtës të së tretëvet ose të ndërgjyqësvet në marëdhëniet e tyre me të tretët, dyke përkufizuar përsonat që mundin t' a invokojnë prezumimin e gjësë së giykueme ose kontra të cilavet mund të kundrështohet kjo; Efekti i gjësë së gjykueme midis palëvet duhet të përkufizohet vetëm mbi objektin e grindjes, tue lënë palët të lira të gjykohen për të drejtat e tjera të tyre. Pra, për t' u bërë prapsimi i gjësë së gjykueme, duhet që objekti i së dy padinavet të jëtë i njëjtë, identik. Për shëmbëll: Kur padia për pagimin e qirasë u rëzua, një padie e re që ka për objekt-qira për terma të tjera nuku mund të kundrështohet me prapsimin e gjësë së gjykueme. Por në qoftë se një personë, tue u pretanduar trashëgimtar, kërkon disa sende dhe padia e tij rëzohet, se provohet që ay nuku është trashëgimtar, në këtë rast, në qoftë se ngreh padie tjetër tue kërkuar trashëgimin e tërë, ka vënd prapsimi i gjësë së gjykueme.

3. *Identitet në shkakun.* Kur themi shkak, duhet të kupëtojmë një fakt juridik që formon bazën imediate, të drejt-për-drejtë të së drejtës që invokohet. Mundet me një padje të dytë të kërkojë paditësi po atë gjë, që kërkonte

me padien e mâ-parëshme të rëzuar, në qoftë se invokon një fakt juridik të ndryshmë. Për shëmbëll: Paditësi me padien e parë ka kërkuar nulitetin e testamentit për shkak të vesevet nga forma, dhe padia nuku i ishte pranuar. Më pas ngreh një padie tjetër tue kërkuar që të deklarohet testamenti nul për shkak se testatori ka qënë në dobësi mendore, në kohën e redaktimit të testamentit Pra, massi nuku ka indentitet në shkakun, nuku mundet të kundrështohet padia e dytë me prapsimin e gjësë së gjykueme.

Prapsimi i gjësë së gjykueme mund të kundrështohet vetëm në padiet, pra, përjashtohen çështjet e jurisdiksionit vulnetar.

Një vendim që të ketë fuqinë e gjësë së gjykueme, duhët të jetë definitif. Pra, nuku kanë fuqinë e gjësë së gjykueme vendimet pregatitëse, vendimet e përkohëshme, vendimet paragjykimore dhe vendimet që jepen në çështjet e jurisdiksionit vulnetar.

Fuqinë të gjësë së gjykueme e kanë vetëm *vendimet definitive të dhëna prej gjykatavet shqiptare* dhe këto e kanë këtë fuqi vetëm kur hyjnë në themel të çështjes, se, në qoftë se vendimi rezheton padien vetëm për shkak nuliteti forme ose për shkak inkompetence, mundet të ngrehet vleftësisht tjetër padie, dhe kontra kësaj nuku mundet të kundrështohet prapsimi i giësë së gjykueme.

§ 121 — Influenca në gjyqin Penal të gjësë së gjykueme në gjyqin civil.

Jurisdiksioni ndëshkimor është independent prej jurisdiksionit civil dhe vendimet e dhëna prej këtij të fundit nuku kanë fuqi detyruëse për gjykatën ndëshkimore. Kështu, pra, reparimi civil për një dëm, i vendosur prej një gjykate—kompentente ose jo—nuku ndalon ushtrimin e padies botënore për ndëshkimin po t' asaj ngjarjeje; Gjyqtari që do të refuzonte t' a gjykonte për këtë shkak do të aplikonte keq dispozitat e nenit 239 të Sht. Il. Pr. Civ. Si do qoftë kjo ngjet, kur padia civile e gjykuar para ushtrimit të padies të së drej-

tës botënore nuku është *paragjykimore (action prejudicielle)* për këtë të fundit. Vendimi, pra, i dhënë në gjyqin civil mbetet pa influencë në gjykimin e çështjes para gjykatës represive. Për shëmbëll: Gjykata ndëshkimore, e cila heton një çështje falsifikimi, nuku mundet të konsiderojë se faji eksiston vetëm dhe vetëm për shkakun se një gjykatë civile ka konsideruarë dhe vendosurë se falsifikimi eksiston; Për kundrazi, duhet t' a hetojë rishtazi pikën në se eksiston falsifikim dhe më pas të hetojë në se i pandehuri është autori. Gjith' ash'u ngjet dhe në rastin e kundërtë. Në rastin që një gjykim civil deklaron pozitivisht se një shkresë nuku është falco, nuku ndalon as pak padien e së drejtës botënore po për atë falsifikim.

Kur vendimi i dhënë në gjykatën civile ka vendosur mbi *një çështje paragjykimore*, regulli simbas të cilit vendimet civile nuku kanë nonjë autoritet në gjykatën ndëshkimore, aplikohet me një ngushticë të madhe. Në këtë rast duhet të çquajmë midis *çështjevet paragjykimore*, gjykimi i të cilavet u takon gjykatavet ndëshkimore dhe atyrevet, gjykimi i të cilavet u është rezervuarë ekskluzivisht gjykatavet civile. Gjëja e gjykueme në civile nuku e lith as pak gjykatën ndëshkimore, kur duhet të shqyrtohet një çështje paragjykimore, hetimi dhe gjykimi i të cilës i takon gjykatës ndëshkimore. Por, gjëja e gjykueme në gjykatën civile i imponohet gjyqtarit ndëshkimor, kur duhet shqyrtuar një çështje paragjykimore, gjykimi i të cilës i takon ekskluzivisht gjykatës civile. Sido qoftë, gjëja e gjykueme në çështjet paragiykimore nuku ka influencë në çështjet aksesore që i bashkohen, cila do qoftë lidhja, e cila i bashkon njërën me tjetrën.

Gjëja e gjykueme në civile e pretenduar se ka kushtituuarë një raport të drejte të ré midis palëvet, duhet të respektohet prej gjyqtarit ndëshkimor; Massi një kësilloj vendimi u dha, formon një titull ligjor që gjyqtari ndëshkimor duhet t' a marë në konsiderasion. Pra, një gjykim civil që

ka deklaruarë se një njeri është zot i një sendi të lujtëshmë, ky njeri mundet të dënohet për shkak se ka tërhequr atë send të lujtëshme në një kohë më parë se të dalë vendimi i gjykimit civil, massi deklarimi i gjyqtarit civil nuku e lith gjyqtarin ndëshkimor; Por, nuku do të ishte i mundur të ndëshkoheshe për shkak se ka tërhequr gjith' po atë send në një kohë më pas se gjykimi civil, massi gjykimi civil ka kusktituuar një të drejtë, e ka bërë zot të sendit të lujtëshme për kundrejt personës kontra së cilës është dhënë vendimi civil.

§ 122. — Influenca në gjyqin civil të gjësë së gjykueme në gjykatën ndëshkimore.

Deri tash u bë fjalë për autoritetin e gjësë së gjykueme civile në gjykatën civile, si dhe për autoritetin e gjëse së gjykueme civile në gjykatën penale. Tani kemi për t' u okupuar me këtë çështje: vendimet e gjykatavet ndëshkimore a mundet të kenë para gjykatavet civile fuqin' e gjâsë së gjykueme, domethënë është e mundur të bazohet njeriu në një kësilloj vendimi për të kundrejtuar prapsimin e gjâsë së gjykueme (exceptio rei judicatae) në një padie të ngrehur para një gjykate civile?

Vendimet e gjykatavet penale janë gati-vërtetësisht kaqe të drejta dhe ekzakte, sa dhe ato të gjykatavet civile; Do të duheshe, pra, të konsideroheshin dhe ato si të veshura me fuqin' e gjâsë së gjykueme, absolutisht si në vendimet civile. Dhe këtu, kur bëhet fjalë për vendim, duhet të kemi para sysh *vendime definitive*, që i japin fund ndjekjevet të filluara para gjykatës penale. Pra, vendimet e dhëna prej gjyqtarëvet me cilësi hetuësie, si për shëmbëll një vendim q' urdhëron ndalimin e gjykimit, nuku mundet të konsiderohen se kanë autoritetin e gjâsë së gjykueme, massi vendimet kësilloji anullohen, në rastin që dalin prova të rea kontra të pandehurit.

Me gjithë këto, si doktrina, ashtu dhe jurisprudenca kanë kontestuarë parimin e autoritetit të gjësë së gjykueme

në gjykatën penale para gjyqit civil, dyke çquar raste të ndryshme; Kështu, pra, autoriteti i gjësë së gjykueme penale nuku ka autoritetin absolut të gjësë së gjykueme në civile.

Në rastin që persona e damtuar nga vepra deliktuoze ka ndodhur në gjyqin penal si paditëse civile *(partie civile)*, vendimi i dhënë në gjykatën penale kundrejtohet pa dyshim në gjykatën civile, domethënë ka fuqin' e gjësë së gjykueme, simbas dispozitavet të nenit 239 të Shtojcës së dytë të Procedurës Civile. Për shëmbëll: një personë, viktimë e një aksidenti, çfaqet si paditëse civile *(partie civile)* në gjyqin penal që rjeth para gjykatës represive kontra autorit të aksidentit, por gjykata penale nuku ja pranovi paditësit civil kërkimin për dëm-shpërblime. Paditësi në fjalë, të cilit ju rëzua padia në gjykatën penale, nuku do të mundë të ngrehë një padie të ré për dëm-shpërblime përpara gjykatës civile, massi do t' i kundrejtohet me sukses prapsimi i gjâsë së gjykueme në penalen.

Kur persona e lënduar nga vepra deliktuoze nuku prezantohet si paditëse civile, fuqia e gjësë së gjykueme në penalen imponohet me një mënyrë absolute në gjyqin civil, në gjithë rastet, në të cilat padia me zgjidhjen e të cilës është ngarkuar gjykata civile ka për qëllim shqyrtimin e një pike të zgjidhur definitivisht prej gjykatës penale. Gjykata civile nuku mundet as të shqyrtojë rishtas, as të paralizojë vendimet e jurisdiksionit ndëshkimuer; Ky parim duhet të meret në këtë kuptim, se nuku i përmetohet kurrë gjykatës civile të mos marë në konsiderasion atë që nevojërisht dhe sigurisht u vendos prej gjykatës ndëshkimore. Ky sistem ka predominuarë, si në doktrinë, ashtu edhe në jurisprudencë. Autoriteti i gjësë së giykueme në penale i imponohet absolutisht gjykatës civile si *për eksistencën e faktit* që formon bazën e bashkëtë të padies të së drejtës botënore dhe të padies civile, ashtu dhe *për kalifikimîn legal t' atij fakti*, dhe gjith' ashtu *për marjen pjesë ose jo* të personavet po

n' atë fakt. Kjo ngjet si në rast pafajësie, ashtu dhe në rast dënimi.

Gjithë vendimet ndëshkimore të së gjitha jurisdiksjonevet, pa përjashtim, kanë po atë autoritet të gjësë së gjykueme. Vendimet në mungesë të dhëna prej gjykatavet ndëshkimore kanë po atë autoritet të gjâsë së gjykueme, sikundër edhe vendimet e dhëna çfaqësisht; Por, mbi këtë pikë, ka dhe mejtime të kundërta. Naturisht që të bëhet prapsimi i gjësë së giykueme në penalen para jurisdiksjonit civil, vendimi i gjykatës penale duhet të jetë dhënë më parë se vendimi civil.

§ 123. — Arbitrazhi.

Palët ndërgjyqëse, në vënt që t' u drejtohen gjyqevet të shtetit, munden t' u ngarkojnë zgjidhjen e kontestimit tyre një ose shumë personavet privatë, që quhen arbitra. Për këtë qëllim duhet të eksistojnë dy konvencione: 1) një konvecion, me anën e të cilit palët ndërgjyqëse mbeten d' akord që zgjidhjen e grindjes së tyre t' ja ngarkojnë një të treti dhe marin përsipër detyrën që t' i binden vendimit arbitral; Ky konvecion i parë quhet "*kompromesso*", dhe 2) një konvencion tjetër midis ndërgjyqësve dhe personës të mbesimit tyre, me të cilin kjo e fundit pranon detyrën që të vepëroje si arbitër; Ky konvencion i dytë quhet "*receptum*".

Që të dy konvencionet, si edhe relasjonet juridike që krijohen prej tyre kanë një karakter të drejte private; Me gjithë këtë ligja i ka dhënë këtij lloji zgjidhjeje të kontestimevet një karakter të drejte botënore. Neni 429 i shtojcës së dytë të Procedurës Civile thotë: "Vendimi arbitral ka midis palëvet efektin e një vendimi gjyqësor që ka fuqiën e gjasë së gjykueme...." Vendimi arbitral bëhet i ekzekutueshmë me anën e një *ordonance për ekzekutim* të dhënë prej kryetarit të gjykatës civile.

Arbitrazhi, për sa u përket konsekancavet, i përngjet më shumë ujdisë, se vendimit gjyqësor; Por, në çdo rast themelon padie për eksekutim dhe krijon prapsim kontra

padies që ka një objekt, i cili vjen në kundrështim me vendimin arbitral.

Kompromesua, ndonse është një nga kontratat më me rëndësi, nuku trajtohet prej Kodit Civil përveç se incidentalisht në dispozitat e nenit 1693 §2 të Kodit Civil. Simbas dispozitavet të Nenit 412 §1 të shtojcës së dytë të Procedurës Civile, *"paktohet vleftësisht kompromesso, kur palët kanë zotësinë dhe munden ligjërisht me lidhë paqësîm mbi objektin e kontestimit"*. Kompromeso mundet të bëhet për kontestime që eksistojnë ose janë në të lindur e sipër. Paragrafi i dytë i nenit 412 i shtojcës së dytë të Procedurës Civile, shton: *në një kompromesso mund të paktohet vleftësisht që kontestime, të cilat mund të lejnë në t' ardhëshmen prej një raporti jurikik të caktuem të zgjidhen me anë një ose shumë arbitrash. Kompromesua* — shton neni 412 §3 i shtojcës në fjalë — *duhet të bëhet me shkresë.*"

Hollësinat mbi institusjonin e arbitrazhit formojnë lândë të së Drejtës të Procedurës Civile; Mbi procedimin arbitral bëhet fjalë në nenet 412 — 434 të shtojcës së dytë të Procedurës Civile.

Shtyp. DHORI KOTI — Korçë

BKSH

N.H
17.703

KONTROLL
1974-1976

BKSH

BKSH

BKSH

Çmimi: 10 fr. ar